

32014L0065

DIREKTIVË 2014/65/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 15 MAJ 2014, "PËR TREGJET E INSTRUMENTEVE FINANCIARE DHE QË NDRYSHON DIREKTIVËN 2002/92/KE DHE DIREKTIVËN 2011/61/BE"

(riformulim)

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 53, paragrafi 1,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas komunikimit të projektaktit legjislativ në parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Bankës Qendrore Evropiane.

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative,

Meqë:

1. Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit është ndryshuar disa herë në mënyrë thelbësore. Meqë do të bëhen ndryshime të reja, kjo direktivë duhet të riformulohet për të qenë më e qartë.

2. Direktiva e Këshillit 93/22/KEE që kërkohet për vendosjen e kushteve, sipas të cilave shoqëritë e autorizuara të investimit dhe bankat mund të ofrojnë shërbime të specifikuar ose të krijojnë degë në shtete të tjera anëtare në bazë të autorizimit apo mbikëqyrjes së shtetit të origjinës. Për këtë qëllim, direktiva synonte harmonizimin e autorizimit fillestar dhe të kërkesave operative për shoqëritë e investimit, duke përfshirë rregullat e ushtrimit të veprimtarisë. Ajo gjithashtu parashikonte harmonizimin e disa kushteve që rregullojnë operimin e tregjeve të rregulluara.

3. Gjatë viteve të fundit, janë aktivizuar më shumë investitorë në tregjet financiare, për të cilët ofrohet një grup shërbimesh dhe instrumentesh më komplekse, dhe me gamë më të gjerë. Në funksion të këtyre zhvillimeve, kuadri ligjor i Bashkimit Evropian duhet të përfshijë të gjithë gamën e aktiviteteve të orientuara drejt investitorit. Për këtë qëllim, është e nevojshme të garantohet shkalla e harmonizimit të nevojshëm për t'u ofruar investitorëve një nivel të lartë mbrojtjeje dhe për të lejuar shoqëritë e investimit të ofrojnë shërbimet në të gjithë Bashkimin Evropian, duke qenë një treg i brendshëm, nën mbikëqyrjen e shtetit të origjinës. Kështu, Direktiva 93/22/KEE zëvendësohet me Direktivën 2004/39/KEE.

4. Kriza financiare ka nxjerrë në pah dobësitë e funksionimit dhe të transparencës së tregjeve financiare. Evolucionit i tregjeve financiare ka nxjerrë në pah nevojën për fuqizimin e kuadrit rregullator të tregjeve të instrumenteve financiare, duke përfshirë rastin kur tregtimi në këto tregje bëhet mbi banak, me qëllim rritjen e transparencës, mbrojtjen më të mirë të investitorëve, forcimin e besimit, trajtimin e zonave të parregulluara dhe garantimin që mbikëqyrësve t'u jepen kompetencat e mjaftueshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

5. Organet rregullatore kanë rënë dakord ndërmjet tyre në nivel ndërkombëtar, ku dobësitë rregullatore të korporatave për shumë nga institucionet financiare, duke përfshirë mungesën e kontrolleve dhe të balancave efikase, kanë shërbyer si faktor ndikues në krizën financiare. Marrja e rrezikut të tepërt dhe të pakontrolluar mund të sjellë falimentimin e institucioneve financiare të veçanta dhe probleme sistemike në shtetet anëtare dhe në botë. Sjellja e gabuar e shoqërive që ofrojnë shërbime për klientët mund të sjellë dëme dhe humbje të besimit të investitorit. Për adresimin e mundësisë së efektit të dëmshëm lidhur me dobësitë e rregullave të qeverisjes së korporatave, Direktiva 2004/39/KE duhet të plotësohet me parime më të hollësishme dhe me standardet minimale. Këto parime dhe standarde zbatohen duke marrë në konsideratë llojin, shkallën dhe kompleksitetin e shoqërive të investimit.

6. Grupi i nivelit të lartë mbikëqyrës financiar i Bashkimit Evropian ftoi Bashkimin Evropian për të krijuar një paketë më të harmonizuar të rregullores financiare. Në kontekstin e arkitekturës së ardhshme të mbikëqyrjes evropiane, Këshilli i Evropës i 18 dhe 19 qershorit 2009, gjithashtu theksoi nevojën e krijimit të një pakete të vetme rregullash të zbatueshme për të gjitha institucionet financiare të tregut të brendshëm.

7. Kështu, Direktiva 2004/39/KE duhet pjesërisht të riformulohet sipas kësaj direktive dhe pjesërisht të zëvendësohet nga Rregullorja (BE) nr. 600/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit. Këto instrumente ligjore formojnë së bashku kuadrin ligjor të rregullimit të kërkesave të zbatueshme për shoqëritë e investimit për tregjet e rregulluara, për ofruesit e shërbimeve të raportimit të të dhënave dhe për shoqëritë e vendeve të treta, të cilat ofrojnë shërbimet ose aktivitetet e investimit në Bashkimin Evropian. Kështu, kjo direktivë duhet të lexohet së bashku me rregulloren. Kjo direktivë duhet të përmbajë dispozitat që rregullojnë autorizimin e veprimtarisë, blerjen e pjesëmarrjeve influencuese, ushtrimin e lirisë së themelimit dhe të ofrimit të shërbimeve, kushtet operative të shoqërive të investimit për garantimin e mbrojtjes së investitorit, kompetencat e organeve mbikëqyrëse të shteteve anëtare të origjinës dhe pritëse, dhe regjimin e vendosjes së sanksioneve. Meqë objektivi kryesor dhe objekti i kësaj direktive është harmonizimi i dispozitave kombëtare në lidhje me zonat e përmendura, ajo duhet të bazohet në nenin 53, paragrafi 1 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Për të lejuar dispozitat e zbatueshme për zonat e mbuluara nga kjo direktivë, aty ku shihet e nevojshme, është me vend rregullimi i formës së direktivës ndaj çdo specifike ekzistuese në tregun dhe në sistemin ligjor përkatës të çdo shteti anëtar.

8. Është e përshtatshme që lista të përfshijë instrumentet financiare të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë dhe të tjera, të cilat përbëhen dhe tregtohen në mënyrë që të nxjerrin në pah çështjet e rregulloreve të krahasueshme me instrumentet financiare tradicionale.

9. Fusha e zbatimit e instrumenteve financiare përfshin kontratat energjisë që parashikojnë dorëzimin fizik, të cilat tregtohen në platformën e përbashkët të tregtimit, përveçse

kur ato blihen sipas Rregullores (BE) nr. 1227/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Janë marrë disa masa për zbatimin e ndikimit të kësaj përfshirjeje në shoqëritë e tregtimit të këtyre produkteve. Në ditët e sotme, këto shoqëri përjashtohen nga kërkesat për fonde vetjake sipas Rregullores (BE) nr. 575/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe ky përjashtim i nënshtrohet rishikimit sipas nenit 493, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje përpara përfundimit të saj, jo më vonë se fundi i vitit 2017. Meqë kontratat janë instrumente financiare, kërkesat ligjore të tregjeve financiare zbatohen që në fillim, duke zbatuar kufijtë e lejueshëm për pozicionet, raportimin e transaksioneve dhe të abuzimit në treg, si për datën e hyrjes në fuqi të zbatimit të kësaj direktive, ashtu dhe për Rregulloren (BE) nr. 600/2014. Megjithatë, për zbatimin e detyrimeve të klerimit dhe të marzheve, sigurohet futja e tyre graduale për një periudhë 42 mujore, që përcaktohet në Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

10. Kufizimi i fushës së zbatimit në lidhje me derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, që parashikojnë dorëzimin fizik në platformën e përbashkët të tregtimit, kushtëzohet me qëllim shmangien e boshllëqeve të mundshme që mund të çojnë në shitjen e njëkohshme në disa tregje. Kështu, është i nevojshëm të parashikohet një akt i deleguar për specifikimin e mëtejshëm të kuptimit të shprehjes "duhet të parashikojnë dorëzimin fizik", të paktën duke marrë në konsideratë krijimin e detyrimit të kushtëzuar dhe të detyruar për dorëzimin fizik, i cili nuk shtjellohet dhe nuk ka të drejtë të zgjidhë në kesh ose të zbresë nga transaksionet, përveç rastit të forcave madhore, dështimeve apo paafësive të tjera për të vepruar, të trajtuara në mirëbesim.

11. Tregjet sekondare të kursit aktual kanë shfaqur një sërë praktikash mashtrimi në lidhje me kuotat e shkarkimeve, të cilat mund të cenojnë besueshmërinë e skemave të tregtimit të kuotave të shkarkimeve, të ngritura sipas Direktivës 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, si dhe po merren masa për forcimin e sistemit të regjistrave të kuotat e shkarkimeve dhe të kushteve të hapjes së llogarive për tregtimin e këtyre të fundit. Për përfundimin e integritetit dhe të masave mbrojtëse për funksionimin efikas të këtyre tregjeve, përfshirë mbikëqyrjen e plotë të aktivitetit tregtar, është i përshtatshëm plotësimi i masave të marra sipas Direktivës 2003/87/KE, duke integruar plotësisht kuotat e shkarkimeve sipas fushës së zbatimit të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, duke i klasifikuar ato si instrumente financiare.

12. Qëllimi i kësaj direktive është mbulimi i sipërmarrjeve, profesioni i rregullt ose veprimtaria e të cilave është ofrimi, në mënyrë profesionale, i shërbimeve të investimit dhe/ose kryerja e veprimtarive të investimit. Kështu, qëllimi i saj nuk duhet të mbulojë personat me aktivitete të ndryshme profesionale.

13. Për rregullimin e ekzekutimit të transaksioneve në instrumente financiare, pavarësisht metodave të tregtimit që përdoren për ekzekutimin e këtyre transaksioneve, është e nevojshme të themelohet regjimi i plotë rregullator, me qëllim garantimin e cilësisë së lartë për ekzekutimin e transaksioneve të investitorit dhe për ruajtjen e integritetit dhe efikasitetit të përgjithshëm të sistemit financiar. Duhet të parashikohet kuadri rregullator, koherent dhe me ndjeshmëri të rrezikut, për rregullimin e urdhërpagesave kryesore ende aktive në tregun financiar evropian. Është e nevojshme të njihet formimi i gjeneratës së re të sistemeve të organizuara tregtare, së bashku me tregjet e rregulluara që duhet t'i nënshtrohen detyrimeve të përcaktuara, me qëllim

ruajtjen e funksionimit efikas dhe të rregullt të tregjeve financiare, si dhe për të garantuar që sistemet e organizuara të tregtimit të mos përfitojnë nga boshllëqet rregullatore.

14. Të gjitha vendet e tregtimit, përkatësisht tregjet e rregulluara, platformat shumëpalëshe të tregtimit (MTF-të) dhe platformat e përbashkëta të tregtimit, duhet të përcaktojnë rregulla transparente dhe jodiskriminuese për rregullimin e aksesit të ambienteve. Gjithsesi, ndërkohë që tregjet e rregulluara dhe MTF-të vazhdojnë t'i nënshtrohen kërkesave të ngjashme në lidhje me anëtarët ose pjesëmarrësit e pranuar prej tyre, platformat e përbashkëta të tregtimit duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë dhe të kufizojnë aksesin, ndër të tjera, në bazë të rolit dhe të detyrimeve në lidhje me klientët e tyre. Në këtë drejtim, vendet e tregtimit duhet të jenë në gjendje të specifikojnë parametrat rregulluese të sistemit, si latencat minimale, me kusht që kjo të arrihet në mënyrë të hapur dhe transparente, si dhe të mos përfshijë diskriminim nga ana e operatorit të platformës.

15. Një kundërpalë qendrore (CCP) përkufizohet sipas Rregullores (BE) nr. 648/2012 si person juridik që ndërhyh ndërmjet palëve në kontratat e tregtuara në një ose më shumë tregje financiare, duke u bërë blerës për çdo shitës dhe shitës për çdo blerës. Kundërpalët qendrore nuk përfshihen në termin "platformë e përbashkët e tregtimit", siç përkufizohet në këtë direktivë.

16. Personat me akses në tregjet e rregulluara ose në MTF-të përkufizohen si anëtare ose pjesëmarrëse. Të dy emërtimet përdoren në mënyrë të ndërsjellët. Këto emërtime nuk përfshijnë përdoruesit me akses në vendet e tregtimit vetëm përmes aksesit të drejtpërdrejtë elektronik.

17. Subjektet e brendshme sistematike duhet të përkufizohen si shoqëri të investimit, që tregtojnë për llogari të tyre, në mënyrë të organizuar, të shpeshtë, të rregullt dhe thelbësore gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit jashtë tregut të rregulluar, MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregtimit. Për të garantuar zbatimin objektiv dhe efikas të këtij përkufizimi për shoqëritë e investimit, çdo tregtim dypalësh i zhvilluar me klientët duhet të ruajë përshtatshmërinë dhe kriteret e zhvilluara për identifikimin e shoqërive të investimit, të cilave u kërkohet regjistrimi si subjekt i brendshëm sistematik. Ndërsa vendet e tregtimit janë ambiente ndërvepruese të sistemit të palëve të treta shumëpalëshe blerëse dhe shitëse të interesave, subjekti i brendshëm sistematik nuk duhet të lejohet të bashkojë interesat e palëve të treta blerëse dhe shitëse sipas të njëjtës mënyre funksionale me atë të tregut rregullator.

18. Personat administrues të aktiveve dhe sipërmarrjeve të tyre që nuk ofrojnë shërbime ose nuk kryejnë aktivitete të investimit, të ndryshme nga tregtimi për llogari të tyre në instrumentet financiare që nuk janë derivate të mallrave me përdorim të gjerë, kuota të shkarkimeve apo derivate të tyre, nuk duhet të mbulohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, përveçse kur ato janë krijuar të tregut, anëtarë ose pjesëmarrës në tregun e rregulluar ose në MTF-në, ose kanë akses të drejtpërdrejtë elektronik në vendin e tregtimit, zbatojnë teknikën e tregtimit algoritmik me shpejtësi të lartë, ose tregtojnë për llogari të tyre gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit.

19. Komunikata e datës 15 prill 2011 e ministrave të financës të G20-ës dhe e guvernatorëve të bankave qendrore, thekson se pjesëmarrësit në tregjet e derivateve të mallrave për përdorim të gjerë duhet t'i nënshtrohen rregulloreve të përshtatshme dhe mbikëqyrjes, duke sjellë modifikimin e mundshëm të përjashtimeve të caktuara nga Direktiva 2004/39/KE.

20. Personat që tregtojnë për llogari të tyre, duke përfshirë krijuesit e tregut të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë, të kuotave të shkarkimeve ose të derivateve e tyre dhe duke përfshirë personat që tregtojnë për llogari të tyre gjatë ekzekutimit të urdhrave për klientin ose që ofrojnë shërbime investimi të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë ose të kuotave të shkarkimeve ose derivateve të tyre, për konsumatorët ose për ofruesit e aktivitetit të tyre kryesor, nuk duhet të mbulojnë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, me kusht që aktiviteti, në bazë grupi, të jetë ndihmës për aktivitetin kryesor, dhe që aktiviteti kryesor të mos përbëjë as ofrim të shërbimeve të investimit brenda kuptimit të kësaj direktive, as aktivitet bankar brenda kuptimit të Direktivës 2013/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe as krijim të tregut të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë, si dhe këta persona të mos zhvillojnë teknikën e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë. Në rastin e aktivitetit ndihmës për aktivitetin kryesor, kriteret teknike duhet të qartësohen përmes standardeve të rregulloreve teknike, duke marrë në konsideratë kriteret që specifikohen në këtë direktivë.

Këto kriteret duhet të garantojnë mbulimin e shoqërive financiare, të cilat trajtojnë instrumente financiare në mënyrë joproporcionale krahasuar me nivelin e investimit në aktivitetin kryesor, sipas fushës së zbatimit të kësaj direktive. Gjatë këtij veprimi, këto kriteret duhet të paktën të marrin në konsideratë nevojën e aktivitetit ndihmës për të qenë një pakicë në aktivitetet në nivel grupi, si dhe madhësinë e aktivitetit të tyre tregtar krahasuar me aktivitetin e përgjithshëm të tregut për këtë klasë të aktiveve. Në rastin kur detyrimi për të ofruar likuiditetin në vendin e tregtimit kërkohet nga autoritetet rregullatore, në përputhje me ligjet e Bashkimit Evropian ose me legjislacionin e brendshëm, me rregulloret dhe me dispozitat administrative, ose me tregjet e rregulluara, është me vend përjashtimi i transaksioneve të kryera për arritjen e detyrimeve nga vlerësimi i natyrës ndihmëse të aktivitetit.

21. Për qëllime të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014, që rregullojnë si tregjet mbi banak, ashtu dhe instrumentet derivate të tregtuara në bursa, në kuptimin e Rregullores (BE) nr. 600/2014, aktivitetet e konsideruara objektivist të matshme në lidhje me reduktimin e rreziqeve që lidhen drejtpërsëdrejti me aktivitetin tregtar ose me aktivitetin e financimit të thesarit dhe transaksionet ndër-institucionale duhet të konsiderohen në mënyrë konsistente me Rregulloren (BE) nr. 648/2012.

22. Personat që tregtojnë derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, kuotat e shkarkimeve dhe derivatet e tyre, gjithashtu mund të tregtojnë si pjesë e aktivitetit të tyre jotregtar për menaxhimin e rrezikut të thesarit, instrumente të tjera financiare për mbrojtjen e tyre ndaj rreziqeve, si rreziku i kursit të këmbimit. Kështu, është e rëndësishme të sqarohet se përjashtimet zbatohen në mënyrë kumulative. Për shembull, përjashtimi në nenin 2, paragrafi 1, germa "j" mund të përdoret së bashku me përjashtimin e nenit 2, paragrafi 1, germa "d".

23. Megjithatë, për shmangien e çdo keqpërdorimi të mundshëm të përjashtimeve, krijuesit e tregut të instrumenteve financiare, përveç atyre të tregut të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë, të kuotave të shkarkimeve, ose të derivateve të tyre, duhet të mbulojnë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive dhe nuk duhet të përfitojnë nga ndonjë përjashtim, me kusht që aktiviteti i krijimit të tregut të jetë ndihmës për aktivitetin e tyre kryesor, të konsiderohet në bazë grupi, dhe me kusht që ata të mos zbatojnë teknikën e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë. Personat që tregtojnë për llogari të tyre gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit, ose që zbatojnë

teknikën e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë, gjithashtu duhet të mbulohen nga fusha e zbatimit e kësaj direktive dhe nuk duhet të përfitojnë nga përjashtimet e mundshme.

24. Gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit, tregtimi për llogari të tyre duhet të përfshijë shoqëritë e ekzekutimit të urdhrave të klientëve të ndryshëm, të ndërthurura sipas parimit të përputhjes (tregtimi back-to-back), të cilat konsiderohen se veprojnë si principal dhe duhet t'i nënshtrohen dispozitave të kësaj direktive për mbulimin, si të ekzekutimit të urdhrave në emër të klientëve, ashtu dhe të tregtimit për llogari të tyre.

25. Përbushja e urdhrave për instrumente financiare si aktivitet ndihmës ndërmjet dy personave, aktiviteti kryesor i të cilëve, në bazë grupi, nuk përbën as ofrimin e shërbimeve të investimit në kuptim të kësaj direktive, dhe as aktivitetet bankar në kuptim të Direktivës 2013/36/BE, nuk duhet të konsiderohet si tregtim për llogari të tyre kur përbushin urdhra të e klientit.

26. Termi "persona" kudo që përdoret në tekst përfshin si personat fizik, ashtu edhe ata juridik.

27. Sipërmarrjet e sigurimit (të jetës), aktivitetet e të cilave i nënshtrohen monitorimit të përshtatshëm përmes autoriteteve kompetente të mbikëqyrjes së kujdesshme dhe që i nënshtrohen Direktivës 2009/138/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, duhet të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive gjatë zhvillimit të aktiviteteve të përmendura në këtë direktivë.

28. Personat që nuk ofrojnë shërbime për palë të treta, por bizneset e të cilave përfshijnë ofrimin e shërbimeve të investimit vetëm për shoqëritë e tyre mëmë, për filialet e tyre ose për filialet e tjera të shoqërive mëmë nuk duhet të mbulohen nga kjo direktivë.

29. Disa shoqëri rajonale të sektorit të energjisë dhe disa operatorë të impianteve industriale që mbulohen nga Skema e Kuotave të Shkarkimeve të BE-së grupojnë dhe transferojnë veprimtaritë e tyre tregtare me qëllim mbrojtjen e filialeve të pakonsoliduara nga rreziku tregtar. Këto bashkime shoqërish të sipërmarrjeve të përbashkëta nuk ofrojnë shërbime të tjera dhe kryejnë saktësisht të njëjtin funksion me funksionin e personave që përmenden në deklaraminën 28. Për garantimin e rregullave të barabarta, shoqëritë e sipërmarrjeve të përbashkëta gjithashtu mund të përjashtohen nga fusha e zbatimit e kësaj direktive, në rastet e pronësisë së përbashkët të shoqërive rajonale të sektorit energjetik ose të operatorëve, të parashikuara në nenin 3, germa "f" të Direktivës 2003/87/KE që nuk ofrojnë shërbime të ndryshme nga shërbimet e investimit për shërbimet dhe operatorët vendas të energjisë, të parashikuar në nenin 3, germa, "f" të Direktivës 2003/87/KE dhe me kusht që shoqëritë rajonale të sektorit energjetik ose operatorët sipas nenit 2, paragrafi 1, germa "j" të përjashtohen nëse kryejnë shërbime të investimit. Megjithatë, për garantimin e caktimit të masave mbrojtëse dhe mbrojtjes së investitorëve, në mënyrë të përshtatshme, shtetet anëtare që zgjedhin të përjashtojnë sipërmarrjet e përbashkëta, duhet t'u nënshtrohen të paktën kërkesave analoge me ato të përcaktuara në këtë direktivë, në veçanti gjatë dhënies së autorizimit për vlerësimin e reputacionit dhe të eksperiencës së tyre dhe të përshtatshmërisë së çdo aksionari, në lidhje me rishikimin e kushteve të autorizimit fillestar dhe me mbikëqyrjen e vazhdueshme, si dhe me detyrimet për ushtrimin e aktivitetit.

30. Personat që ofrojnë, vetëm mbi baza rastësore, shërbimet e investimit gjatë aktivitetit të tyre profesional, duhet të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, me kusht që aktiviteti të rregullohet dhe rregullat përkatëse të mos ndalojnë rastësisht ofrimin e shërbimeve të investimit.

31. Kështu, personat që ofrojnë shërbime të investimit që përfshijnë administrimin ekskluziv të skemave të pjesëmarrjes së punëmarrësve dhe të cilët nuk ofrojnë shërbime të investimit për palë të treta nuk duhet të mbulohen nga kjo direktivë.

32. Është e nevojshme që bankat qendrore dhe organet e tjera që zhvillojnë funksione të ngjashme, si dhe organet publike të ngarkuara me ose që ndërhyjnë në administrimin e borxhit publik sipas konceptit që mbulon investimin e tyre të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, me përjashtim të organeve në pronësi të plotë ose të pjesëshme shtetërore, me natyrë tregtare ose të lidhura me blerjen e pjesëmarrjeve.

33. Për të sqaruar regjimin e përjashtimeve të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), të organeve të tjera kombëtare që ushtrojnë funksione të ngjashme, dhe të organeve që ndërhyjnë në administrimin e borxhit publik, është me vend kufizimi i këtyre përjashtimeve për organet dhe institucionet që ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, si dhe për organet kombëtare, në të cilat një ose më shumë shtete anëtare janë anëtarë dhe kanë qëllim mobilizimin e fondeve dhe ofrimin e asistencës teknike në dobi të anëtarëve të tyre, të cilët përjetojnë ose kërcënohen nga probleme të rënda të financimit, si Mekanizmi Evropian i Stabilitetit.

34. Është e nevojshme që sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe fondet e pensionit, si dhe depozituesit ose menaxherët e këtyre sipërmarrjeve, të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, pavarësisht koordinimit ose jo në nivel Bashkimi Evropian, duke qenë se i nënshtrohen rregullave specifike të përshtatura drejtpërsëdrejti me aktivitetet e tyre.

35. Është e rëndësishme që operatorët e sistemeve të transmetimit të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive sipas përkufizimit të nenit 2, paragrafi 4 të Direktivës 2009/72/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ose të nenit 2, paragrafi 4 të Direktivës 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre sipas atyre direktivave, sipas Rregullores (KE) nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, sipas Rregullores (KE) nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ose sipas kodeve të rrjetit ose udhëzimeve të miratuara sipas këtyre akteve ligjore. Në përputhje me aktet ligjore, operatorët e sistemit të transmetimit kanë detyrime dhe përgjegjësi specifike, i nënshtrohen certifikimeve specifike dhe mbikëqyren nga autoritetet specifike sipas sektorit. Operatorët e sistemeve të transmetimit duhet gjithashtu të përfitojnë nga ky përjashtim, në rastin kur ato përdorin persona të tjerë, të cilët veprojnë si ofrues të shërbimeve për kryerjen e detyrave në emër të tyre, sipas akteve legislative, ose sipas kodeve të rrjetit ose udhëzimeve të miratuara sipas këtyre rregulloreve. Gjatë ofrimit të shërbimeve ose të aktiviteteve të investimit të instrumenteve financiare, operatorët e sistemeve të transmetimit nuk duhet të përfitojnë nga ky përjashtim, duke përfshirë rastin e operimit të platformës së tregtimit të drejtave të transmetimit për shërbimet financiare në tregjet sekondare.

36. Për përfitimin nga përjashtimet e kësaj direktive, personi i interesuar duhet të pajtohet vazhdimisht me kushtet e caktuara të këtyre përjashtimeve. Në mënyrë të veçantë, nëse një person ofron shërbime të investimit ose kryen aktivitete të investimit, të konsideruara në bazë grupi, dhe përjashtohet nga kjo direktivë për shkak se shërbimet ose aktivitetet ndihmojnë aktivitetin kryesor të tij, ky person nuk mbulohet nga përjashtimi në lidhje me shërbimet ndihmëse, në rastin kur ofrimi i shërbimeve ose i aktiviteteve të tilla nuk ndihmon më veprimtarinë e tij kryesore.

37. Personat që ofrojnë shërbime të investimit dhe/ose kryejnë aktivitete të investimit të mbuluara nga kjo direktivë, duhet t'i nënshtrohen autorizimit nga shtetet anëtare të origjinës, me qëllim mbrojtjen e investitorëve dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar.

38. Institucionet kredituese që autorizohen sipas Direktivës 2013/36/BE nuk kanë nevojë, për autorizime të tjera, sipas kësaj direktive, për të ofruar shërbime investimi ose për të kryer veprimtari investimi. Kur institucioni kreditor vendos të ofrojë shërbime investimi ose të kryejë aktivitete investimit, përpara autorizimit sipas Direktivës 2013/36/BE, autoritetet kompetente duhet të verifikojnë pajtueshmërinë e tij me dispozitat përkatëse të kësaj direktive.

39. Depozitat e strukturuar shfaqen si formë e produktit të investimit, por nuk mbulohen nga aktet legjislativë për mbrojtjen e investitorëve në nivel Bashkimi Evropian, ndërsa investime të tjera të strukturuar mbulohen nga akte të tilla ligjore. Kështu, është e përshtatshme të fuqizohet besimi i investitorëve dhe të kryhet trajtimi rregullator në lidhje me shpërndarjen sa më të njëtrajtshme të produkteve të ndryshme të investimit të paketave për klientë individë, me qëllim garantimin e nivelit të përshtatshëm të mbrojtjes së investitorëve në të gjithë Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, është e përshtatshme përfshirja e depozitave të strukturuar në fushën e zbatimit të kësaj direktive. Në këtë drejtim, duke qenë se depozitat e strukturuar janë një formë e produktit të investimit, është e nevojshme të sqarohet se ato nuk përfshijnë depozitat e lidhura vetëm me normat e interesit, si Euribor ose Libor, pavarësisht parashikimit ose jo të normave të interesit, ose natyrës fikse apo variabël të tyre. Kështu, këto depozita duhet të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive.

40. Zbatimi i kësaj direktive për shoqëritë e investimit dhe për institucionet kredituese gjatë shitjeve ose këshillimit të klientëve në lidhje me depozitat e strukturuar duhet të kuptohet njësoj si në rastin kur veprohet si ndërmjetësues për ato produkte të emetuara nga institucionet kreditore që mund të pranojnë depozita në përputhje me Direktivën 2013/36/BE.

41. Depozitarët qendror për letrat me vlerë janë institucione sistemike të rëndësishme për tregjet financiare, të cilat garantojnë regjistrimin fillestar të letrave me vlerë, administrimin e llogarive që përmbajnë letrat me vlerë të emetuara dhe shlyerjen e pothuajse çdo tregtimi të letrave me vlerë. Depozitarët qendror për letrat me vlerë rregullohen në mënyrë specifike sipas ligjit të Bashkimit Evropian dhe i nënshtrohen, në veçanti, autorizimit dhe kushteve të caktuara operative. Megjithatë, depozitarët qendror për letrat me vlerë, përveç shërbimeve bazë të përmendura në ligje të tjera të Bashkimit Evropian, ofrojnë shërbime dhe aktivitete investimit, të cilat rregullohen sipas kësaj direktive.

Për të garantuar që subjektet që ofrojnë shërbime dhe veprimtari investimi të jenë objekt i të njëjtit kuadër rregullator, është me vend të garantohet që depozitarët qendror për letrat me

vlerë të mos jenë objekt i kërkesave të kësaj direktive për sa i përket autorizimit dhe kushteve të caktuara operative, por ligji i Bashkimit Evropian që rregullon depozitarët qendror të letrave me vlerë të garantojë që ata të jenë objekt i dispozitave të kësaj direktive, në rastin kur ata ofrojnë shërbime ose ushtrojnë veprimtarinë e investimit përveç shërbimeve të specifikuar në atë ligj të Bashkimit Evropian.

42. Për fuqizimin e mbrojtjes së investitorëve të Bashkimit Evropian, është i përshtatshëm kufizimi i kushteve, sipas të cilave shtetet anëtare mund të përjashtojnë zbatimin e kësaj direktive për personat të cilët u ofrojnë shërbime investimi klientëve që si rezultat nuk mbrohen nga kjo direktivë. Në veçanti, është më vend që shteteve anëtare t'u kërkohej zbatimi i kërkesave që janë paktën të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë direktivë, sidomos gjatë fazës së dhënies së autorizimit, të vlerësimit të reputacionit të tyre, përvojës dhe përshtatshmërisë së çdo aksioneri, gjatë rishikimit të kushteve për autorizimin fillestar dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve për ushtrimin e aktivitetit.

Gjithashtu, personat e përjashtuar nga zbatimi i kësaj direktive duhet të mbulohen nga një skeme e kompensimit të investitorit, që njihet në përputhje me Direktivën 97/9/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ose përmes sigurimit të përgjegjësisë profesionale që garanton mbrojtje të barasvlershme të klientëve të tyre në rrethanat e mbuluara nga kjo direktivë.

43. Nëse shoqëria e investimit ofron, jo rregullisht, një ose më shumë shërbime investimi të pambuluara nga autorizimi që i është dhënë ose ushtron një ose më shumë aktivitete të pambuluara nga autorizimi që i është dhënë, asaj nuk i nevojitet autorizim shtesë sipas kësaj direktive.

44. Sipas qëllimit të kësaj direktive, veprimtaria e marrjes dhe e transmetimit të urdhrave gjithashtu duhet të përfshijë bashkimin e dy ose më shumë investitorëve, për kryerjen e transaksionit ndërmjet këtyre dy investitorëve.

45. Shoqëritë e investimit dhe institucionet kredituese që shpërndajnë instrumente financiare të emetuara prej tyre, duhet t'i nënshtrohen kësaj direktive kur u ofrojnë konsulencë investimi klientëve të tyre. Për eliminimin e pasigurive dhe fuqizimin e mbrojtjes së investitorit, është më vend që të sigurohet zbatimi i kësaj direktive, në rastin kur shoqëritë e investimit dhe institucionet kredituese shpërndajnë, pa ofruar këshillim, instrumentet financiare të emetuara prej tyre në tregun primar. Për këtë qëllim, kërkohej zgjerimi i përkufizimit të shërbimit të ekzekutimit të urdhrave në emër të klientëve.

46. Parimet e mbikëqyrjes së ndërsjellët dhe të mbikëqyrjes së shtetit anëtar të origjinës kërkojnë që autoritetet kompetente të shteteve anëtare të heqin ose të refuzojnë dhënien e autorizimit, në rastin kur faktorët si përmbajtja e programeve të operacioneve, shpërndarja gjeografike ose veprimtaritë e ushtruara dhe të ndjekura, tregojnë qartë se shoqëria administruese preferon sistemin ligjor të një shteti anëtar për qëllimet e shmangies së standardeve më strikte në fuqi, në një shtet tjetër anëtar, brenda territorit në të cilin ajo synon të ndjekë ose ndjek pjesën më të madhe të veprimtarive të saj. Shoqëria e investimit që është personi juridik duhet të autorizohet në shtetin anëtar, në të cilin ka selinë e regjistruar. Shoqëria e investimit që nuk është person juridik duhet të autorizohet në shtetin anëtar, në të cilin ka zyrën qendrore. Gjithashtu,

shtetet anëtare duhet të kërkojnë që zyra qendrore e një shoqërie investimi të jetë në çdo rast në shtetin anëtar të origjinës së saj dhe të ushtrojë veprimtarinë në atë vend.

47. Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit parashikon kriteret e hollësishme të vlerësimit të kujdesshëm për blerjet e propozuara në një shoqëri investimi, dhe për procedurën e zbatimit të tyre. Për ofrimin e sigurisë juridike, të qartësisë dhe të parashikueshmërisë në lidhje me procesin e vlerësimit, si dhe në lidhje me rezultatin e tij, është me vend konfirmimi i kriterëve dhe i procesit të vlerësimit të kujdesshëm të përcaktuar në këtë direktivë.

Në veçanti, autoritetet kompetente duhet të vlerësojnë përshtatshmërinë e blerësit të propozuar dhe stabilitetin financiar të blerjes së propozuar kundrejt kriterëve të mëposhtme: reputacioni i blerësit të propozuar; reputacioni dhe përvoja e çdo personi që do të drejtojë veprimtarinë e shoqërisë së investimit, pas blerjes së propozuar; stabiliteti financiar i blerësit të propozuar; a do të jetë në gjendje shoqëria e investimit të përmbushë kërkesat prudenciale sipas kësaj direktive dhe direktivave të tjera, sidomos sipas Direktivave 2002/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe 2013/36/BE; a ka baza të arsyeshme për të dyshuar se po kryhet, është kryer ose është tentuar të kryhet pastrim parash ose financim terrorizmi, në kuptim të nenit 1 të Direktivës 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ose se blerja e propozuar do të rrishte rrezikun për sa më lart.

48. Shoqëria e investimit, e autorizuar në shtetin anëtar të origjinës, ka të drejtë të ofrojë shërbime investimi ose të kryejë veprimtari investimi në të gjithë Bashkimin Evropian, pa qenë nevoja të kërkojë autorizim të veçantë nga autoriteti kompetent në shtetin anëtar në të cilin ajo dëshiron t'i ofrojë këto shërbime ose t'i kryejë këto veprimtari.

49. Duke qenë se shoqëritë e investimit përjashtohen nga detyrime të caktuara të vendosura nga Direktiva 2013/36/BE, ato janë të detyruara të mbajnë ose një shumë minimale të kapitalit ose sigurimin e përgjegjësisë profesionale ose një kombinim të tyre. Përshtatjet e shumave të këtij sigurimi duhet të marrin në konsideratë përshtatjet e bëra në kuadër të Direktivës 2002/92/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Ky trajtim i veçantë, për qëllime të mjaftueshmërisë së kapitalit, nuk duhet të cenojë asnjë vendim në lidhje me trajtimin e përshtatshëm të këtyre shoqërive sipas ndryshimeve të ardhshme në ligjin e Bashkimit Evropian për mjaftueshmërinë e kapitalit.

50. Duke qenë se fusha e zbatimit të rregullores prudenciale, duhet të kufizohet në subjekte, të cilat nëpërmjet zhvillimit të portofolit tregtar mbi baza profesionale, përfaqësojnë burim të rrezikut të kundërpalës për pjesëmarrësit e tjerë të tregut, subjektet që tregojnë për llogari të tyre instrumente financiare, të ndryshme nga derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, kuotat e shkarkimeve ose derivatet e tyre, të cilët nuk janë krijuar të tregut, nuk tregtojnë për llogari të tyre gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit, nuk janë anëtarë ose pjesëmarrës të tregut ose të MTF-së nuk kanë akses të drejtpërdrejtë elektronik në vendin e tregtimit dhe nuk zbatojnë teknikën e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë, duhet të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive.

51. Për mbrojtjen e pronësisë së investitorit dhe të të drejtave të tjera të ngjashme që lidhen me sigurimet dhe të drejtat e investitorit, në lidhje me fondet që i besohen një shoqërie,

këto të drejta duhet të trajtohen qartësisht në dallim nga ato të shoqërisë. Gjithsesi ky parim nuk e pengon shoqërinë që të ushtrojë veprimtarinë në emër të saj por për llogari të investitorit, kur një gjë e tillë kërkohet nga vet natyra e transaksionit dhe investitori ka rënë dakord, siç është për shembull huadhënia e kuotave.

52. Kërkesat në lidhje me mbrojtjen e aktiveve të klientit janë një mjet thelbësor për mbrojtjen e klientëve gjatë ofrimit të shërbimeve dhe të aktiviteteve. Këto kërkesa mund të përjashtohen në rastin e transferimit të pronësisë së plotë të fondeve dhe të instrumenteve financiare në shoqërinë e investimit, për mbulimin e çdo detyrimi të tanishëm ose të ardhshëm, qoftë real ose i mundshëm. Gama e gjerë e mundësive mund të krijojë pasiguri dhe të rrezikojë efikasitetin e kërkesave në lidhje me mbrojtjen e aktiveve të klientit. Kështu, të paktën në rastin kur përfshihen aktive të klientëve individë, është me vend të kufizohet mundësia e shoqërive të investimit për të realizuar marrëveshje kolaterali financiar për transferimin e titullit të pronësisë, siç përcaktohet nga Direktiva 2002/47/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për të siguruar përmbushjen, ose ndryshe mbulimin, e detyrimeve të tyre financiare.

53. Është e nevojshme të fuqizohet roli i organeve drejtuese të shoqërive të investimit, të ofruesve të shërbimeve në tregje të rregulluara dhe të ofruesve të shërbimeve të raportimit të të dhënave, për të siguruar menaxhim të mirë dhe të kujdesshëm të shoqërive, si dhe për të promovuar integritetin e tregut dhe interesin e investitorëve. Organet drejtuese të shoqërisë së investimit, të tregjeve të rregulluara dhe të ofruesve të shërbimeve të raportimit të të dhënave duhet t'i kushtojë gjithmonë kohën e mjaftueshme dhe të zotërojë bashkërisht njohuritë e mjaftueshme, aftësitë dhe përvojën, në mënyrë që të arrijnë të kuptojë aktivitetet e shoqërisë, duke përfshirë rreziqet kryesore. Për shmangien e mendimit në grup dhe për lehtësimin e shprehjes së mendimeve të pavarura dhe të kundërshtimeve kritike, organet drejtuese duhet të kenë larminë e mjaftueshme lidhur me moshën, gjininë, prejardhjen gjeografike, dhe arsimimin e përvojën profesionale, në mënyrë që të shfaqin pikëpamje dhe përvoja të larmishme. Përfaqësimi i punëmarrësve në organet drejtuese, duke qenë se ata do të jepnin një perspektivë shtesë dhe informacione reale mbi punët e brendshme në shoqëri, mund të shihet gjithashtu si një mënyrë pozitive për rritjen e diversitetit. Për rrjedhojë, diversiteti duhet të jetë një nga kriteret për përbërjen e organeve drejtuese. Diversiteti gjithashtu duhet të trajtohet në mënyrë më të përgjithshme në politikat e rekrutimit të shoqërive. Kjo politikë, për shembull, duhet të inkurajojë shoqëritë të përzgjedhin nga lista kandidatë nga të dyja gjinitë. Në interes të qasjes koherente ndaj qeverisjes së korporatës, është i dëshirueshëm harmonizimi, sa më shumë të jetë e mundur, i kërkesave për shoqëritë e investimit me ato të përfshira në Direktivën 2013/36/KE.

54. Për mbikëqyrjen efikase dhe kontrollin e aktiviteteve të shoqërive të investimit, të tregjeve të rregulluara, dhe të ofruesve të shërbimit të raportimit të të dhënave, organi drejtues është përgjegjës për strategjinë e përgjithshme të shoqërisë, duke marrë në konsideratë profilin e biznesit dhe të rrezikut të shoqërisë. Gjatë ciklit të biznesit të shoqërisë, organi drejtues duhet të marrë përsipër përgjegjësi të qarta në fushat e identifikimit dhe të përkufizimit të objektivave strategjike, të strategjisë së rrezikut dhe të rregullimit të brendshëm të shoqërisë në lidhje me miratimin e organizimit të tij të brendshëm, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe të trajnimit të personelit, mbikëqyrjen efikase të drejtorëve të lartë, përkufizimin e politikave të përgjithshme rregullatore për ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve, duke përfshirë shpërblimin e stafit të sektorit të shitjeve dhe miratimin e produkteve të reja për tu shpërndarë te klientët. Monitorimi periodik dhe vlerësimi i objektivave strategjike të shoqërive, organizimi i tyre i brendshëm dhe

politikat e tyre të ofrimit të shërbimeve dhe të aktiviteteve duhet të sigurojë aftësinë e tyre të vazhdueshme për garantimin e menaxhimit të mirë dhe të kujdesshëm, në interes të integritetit të tregjeve dhe të mbrojtjes së investitorëve. Kombinimi i një numri shumë të lartë anëtarësish në organe drejtuese do ta parandalonte një anëtar të organit drejtues që të kalonte një kohë të mjaftueshme për kryerjen e këtij roli mbikëqyrës.

Ndaj, duhet që të kufizohet numri i organeve drejtuese ku një anëtar i organit drejtues të një institucioni mund të jetë pjesë në të njëjtën kohë në subjekte të ndryshme. Megjithatë, anëtarësia në organizata që nuk kryejnë veprimtari kryesisht tregtare, si organizatat jofitimprurëse ose bamirësie, nuk duhet të merren në konsideratë për qëllimet e zbatimit të këtij kufiri.

55. Në të gjitha shtetet anëtare përdoren struktura të ndryshme qeverisjeje. Në shumicën e rasteve përdoret një strukturë bordi unitare ose me dy nivele. Përkufizimet që përdoren në këtë direktivë synojnë të integrojnë të gjitha strukturat ekzistuese pa mbrojtur asnjë strukturë të caktuar. Ato shërbejnë vetëm për të përcaktuar rregullat që synojnë një rezultat të caktuar, pavarësisht nga legjislacioni kombëtar për shoqëritë tregtare që zbatohet për një institucion në secilin prej shteteve anëtare. Ndaj, përkufizimet nuk duhet të cenojnë alokimin e përgjithshëm të kompetencave në përputhje me legjislacionin kombëtar për shoqëritë tregtare.

56. Gama e zgjeruar e aktiviteteve të ndërmarra nga shumë shoqëri investimi ka rritur njëkohësisht probabilitet më të madh për konflikt interesi ndërmjet këtyre aktiviteteve të ndryshme dhe interesave të klientëve të tyre. Ndaj, është e nevojshme të parashikohen rregulla për garantimin e mosndikimit negativ të konflikteve të tilla në interesin e klientëve të tyre. Shoqëritë kanë për detyrë të marrin hapat efikase për identifikimin dhe parandalimin ose administrimin e konflikteve të interesit dhe për zbutjen maksimale të ndikimit të mundshëm rreziqeve të tilla. Nëse rreziku i mbetur vazhdon ende të ndikojë në dëm të interesave të klientit, këtij të fundit duhet t'i jepet informacion i qartë për natyrën e përgjithshme dhe/ose burimet e konfliktit të interesit, si dhe rreth hapave të ndërmarra për zbutjen e këtyre rreziqeve, përpara se të fillohet një aktivitet në emër të tij.

57. Direktiva e Komisionit 2006/73/KE lejon shtetet anëtare të kërkojnë, në kontekstin e kërkesave organizative për shoqëritë e investimit, regjistrimin e bisedave telefonike ose komunikimet elektronike, të cilat përfshijnë urdhrat e klientit. Regjistrimi i bisedave telefonike ose i komunikimeve elektronike, të cilat përfshijnë urdhrat e klientit, përputhet me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) dhe justifikohet me qëllim fuqizimin e mbrojtjes së investitorit, përmirësimin e mbikëqyrjes së tregut dhe rritjen e sigurisë juridike në interes të shoqërive të investimit dhe të klientëve të tyre. Rëndësia e regjistrave të tillë përmendet edhe në këshillat teknike për Komisionin, të botuara nga Komiteti Evropian i Rregullatorëve të Letrave me Vlerë, më 29 korrik 2010. Këto regjistra duhet të garantojnë ekzistencën e provave për vërtetimin e kushteve të çdo urdhri të dhënë nga klienti, dhe korrespondencën e tij me transaksionet e ekzekutuara nga shoqëritë e investimit, si dhe për të dalluar çdo sjellje që mund të ketë të bëjë me abuzim të tregut, duke përfshirë rastin kur shoqëritë veprojnë për llogari të tyre.

Për këtë qëllim, regjistrat nevojiten për të gjitha bisedat ku janë të përfshirë përfaqësues të shoqërisë, dhe që kanë lidhje me tregtimin ose synimin për të tregtuar për llogari të shoqërisë.

Nëse urdhrat e klientëve komunikohen jo në rrugë telefonike, këto komunikime duhen bërë përmes mjeteve të qëndrueshme si p.sh., me postë, me faks, me email dhe përmes mbajtjes së dokumentacionit të urdhrave të klientit të bëra gjatë takimeve. Për shembull, përmbajtja e bisedave ballë për ballë me një klient mund të regjistrohen duke përdorur procesverbalet ose shënimet me shkrim. Këto urdhra duhet të konsiderohen të barasvlershme me ato të marra përmes telefonit. Nëse mbahen procesverbale për bisedat ballë për ballë me klientët, shtetet anëtare duhet të garantojnë vënien në zbatim të masave mbrojtëse të përshtatshme, me qëllim garantimin e shmangies së humbjeve të mundshme të klientëve, si pasojë e regjistrimit të gabuar të procesverbaleve të komunikimit ndërmjet palëve. Këto masa mbrojtëse nuk nënkuptojnë marrjen përsipër të ndonjë detyrimi nga klienti.

Për ofrimin e sigurisë juridike në lidhje me fushën e zbatimit të detyrimit, është me vend zbatimi i saj për të gjitha pajisjet e siguruara ose të lejuara për përdorim nga shoqëria e investimit, dhe t'i kërkohet shoqërive të investimit të ndërmarrin hapat e arsyeshme për të siguruar që të mos përdoret asnjë pajisje në pronësi private në lidhje me transaksionet. Këto regjistra duhet të vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente në përmbushje të detyrave të tyre mbikëqyrëse dhe në zbatimin masave ekzekutive sipas kësaj direktive dhe sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014, Rregullores (BE) nr. 596/2014 dhe Direktivës 2014/57/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në mënyrë që të ndihmohen autoritetet kompetente në identifikimin e sjelljeve, që nuk përputhen me kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e shoqërive të investimit. Këto regjistra gjithashtu duhet të vihen në dispozicion të shoqërive të investimit dhe të klientëve për të vërtetuar zhvillimin e marrëdhënieve të tyre për urdhrat e transmetuara nga klientët dhe transaksioneve të kryera nga shoqëritë. Për këto arsye, është me vend që në këtë direktivë të parashikohen parimet e regjimit të përgjithshëm për regjistrimin e bisedave telefonike ose të komunikimeve elektronike që kanë të bëjnë me urdhra të klientëve.

58. Në përputhje me konkluzionet e këshillit për fuqizimin e mbikëqyrjes financiare evropiane të qershorit 2009 dhe për të kontribuar në krijimin e një pakete të vetme rregullash për tregjet financiare të Bashkimit Evropian, për të ndihmuar zhvillimin e mëtejshëm të rregullave të barabarta për shtetet anëtare dhe pjesëmarrësit e tregut, për fuqizimin e mbrojtjes së investitorit dhe për përmirësimin e mbikëqyrjes dhe të zbatimit, Bashkimi Evropian angazhohet për minimizimin, kur është e përshtatshme, të lirisë së veprimit në dispozicion të shteteve anëtare sipas ligjit të shërbimeve financiare të Bashkimit Evropian. Përveç prezantimit në këtë direktivë të regjimit të përbashkët për regjistrimin e bisedave telefonike ose të komunikimeve elektronike që përfshijnë urdhrat e klientëve, është me vend të reduktohet mundësia e autoriteteve kompetente për delegimin, në raste të caktuara, të detyrave mbikëqyrëse, të kufizohet liria e veprimit, në lidhje me kërkesat e zbatueshme për agjentët e lidhur dhe për raportimin nga degët.

59. Përdorimi i teknologjisë tregtare ka evoluar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit dhe tashmë përdoret gjerësisht nga pjesëmarrësit e tregut. Shumë pjesëmarrës të tregut tashmë përdorin tregtimin algoritmik, në të cilin algoritmi kompjuterik përcakton automatikisht aspektet e një urdhëri, me ndërhyrje minimale ose pa ndërhyrje fare nga ana e njeriut. Duhet të rregullohen rreziqet që lindin nga tregtimi algoritmik. Megjithatë, përdorimi i algoritmeve në përpunimin pas tregimit të transaksioneve të ekzekutuara nuk përbën tregtim algoritmik. Shoqëria e investimit që kryen tregtim algoritmik, duke ndjekur strategjinë e krijimit të tregut, duhet vazhdimisht të zhvillojë krijimin e tregut, përgjatë intervaleve specifike të orëve të tregtimit në vendin e tregtimit. Standardet teknike rregullatore duhet të sqarojnë atë çka përbën

pjesën specifike të orëve së tregtimit në vendin e tregtimit, duke garantuar rëndësinë e pjesës specifike në krahasim me kohën totale të tregtimit dhe duke marrë në konsideratë likuiditetin, shkallën dhe natyrën e tregut specifik, si dhe karakteristikat e instrumentit financiar të tregtuar.

60. Shoqëritë e investimit që kryejnë tregtim algoritmik, duke ndjekur strategjinë e krijimit të tregut, duhet të vendosin në zbatim sistemet dhe kontrollet e përshtatshme për këtë aktivitet. Ky aktivitet duhet të kuptohet në mënyrë specifike sipas kontekstit dhe qëllimit të tij. Kështu, përkufizimi i këtij aktiviteti është i pavarur nga përkufizime të tilla si "aktivitetet e krijimit të tregut" në Rregulloren (BE) nr. 236/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

61. Nëngrupi specifik i tregtisë përmes algoritmeve është tregtimi algoritmik me frekuencë të lartë, ku sistemi tregtar analizon me shpejtësi të lartë të dhënat ose sinjalet e tregut dhe, në përgjigje të kësaj analize dërgon ose përditëson një numër të madh të urdhrave brenda një kohe shumë të shkurtër. Në veçanti, tregtimi algoritmik me frekuencë të lartë mund të përmbajë elemente si iniciimi i urdhrat, gjenerimi, kursi dhe ekzekutimi, që përcaktohen nga sistemi, pa ndërhyrje manuale, për çdo tregtim ose urdhër individuale, me afat të shkurtër kohor për krijimin dhe likuidimin e pozicioneve, xhiro të lartë ditore, raport të lartë ditor urdhër/tregtim dhe mbyllje të ditës tregtare në ose pranë një pozicioni të sheshtë. Ndër të tjera, tregtimi algoritmik me frekuencë të lartë karakterizohet nga norma ditore të larta të mesazheve që kanë të bëjnë me urdhrat, kuota ose anulime. Për përcaktimin e asaj çka përbën normë ditore të lartë të mesazheve, duhet të merret në konsideratë identiteti i klientit, kohëzgjatja e periudhës së vëzhgimit, krahasimi me aktivitetin e përgjithshëm tregtar për këtë periudhë dhe përqendrim relativ ose copëzimi i aktivitetit. Zakonisht, tregtimi algoritmik me frekuencë të lartë kryhet nga tregtarët që përdorin kapitalin e tyre në tregtime dhe, më tepër se sa një strategji në vetvete është zakonisht përdorim i teknologjisë së sofistikuar për të implementuar më shumë strategji tregtare tradicionale, si ajo krijimit të tregut ose shitja e njëkohshme në disa tregje.

62. Zhvillimet teknike kanë lejuar tregtimin me frekuencë të lartë dhe evoluimin e modeleve të biznesit. Tregtimi me frekuencë të lartë lehtësohet përmes kolokacionit të ambienteve të pjesëmarrësve të tregut në afërsi fizike të ngushtë me sistemet e rakordimit të urdhrave. Për garantimin e kushteve të rregullta dhe të drejta të tregtimit, është e nevojshme t'u kërkohej vendeve të tregtimit të ofrojnë këto shërbime kolokacionit në baza jodiskriminuese, të drejta dhe transparente. Përdorimi i teknologjisë së tregtimit ka rritur shpejtësinë, kapacitetin dhe kompleksitetin e mënyrës së tregtimit të investitorëve. Kjo u lejon pjesëmarrësve të tregut lehtësimin e aksesit të drejtpërdrejtë elektronik të tregut nga klientët e tyre, përmes përdorimit të ambienteve të tyre tregtare, aksesit të drejtpërdrejtë në treg ose aksesit të sponsorizuar. Teknologjia e tregtimit i ka sjellë shumë përfitime tregut dhe pjesëmarrësve të tregut në përgjithësi, të tilla si, pjesëmarrje më të gjerë në tregje, rritje të likuiditetit, marzhe të reduktuara, luhatshmëri afat-shkurtër të reduktuar dhe mënyra më të mira ekzekutimi të urdhrave të klientit. Gjithsesi vazhdojnë të lindin rreziqe të mundshme nga kjo teknologji e tregtimit, të tilla si rrezik më i madh i mbingarkesës së sistemeve në vendet e tregtimit, për shkak të volumeve të mëdha të urdhrave, rreziqe të gjenerimit të urdhrave të dublikuara ose të gabuara përmes tregtimit algoritmik apo keqfunksionime të tjera që krijojnë çrregullime në treg.

Përveç kësaj, ekziston një rrezik i reagimit të tepruar të sistemeve të tregtimit algoritmik ndaj ngjarjeve të tjera në treg që përkeqësojnë luhatshmërinë në rastet e problemeve në treg. Së fundmi, si çdo lloj tjetër tregtimi, tregtimet algoritmike ose teknikat e tregtimit algoritmik me

frekuencë të lartë, ashtu si çdo formë tjetër tregtimi, mund të përshtaten për disa lloje sjelljesh, që janë të ndaluara sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014. Për shkak të avantazhit të informacionit që u jepet tregtuesve me frekuencë të larta, tregtimi me frekuencë të lartë mund të nxisë investitorët të zgjedhin të bëjnë tregti në vendet ku mund të shmangin ndërveprimin me tregtuesit në frekuencë të larta. Është me vend që teknikat e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë, që mbështeten në karakteristika të caktuara specifike, t'i nënshtrohen shqyrtimit rregullator. Ndërkohë që ato janë kryesisht teknikat që mbështeten në tregtimin për llogari të vet shoqërive, ky shqyrtim gjithashtu duhet të zbatohet në rastin kur zbatimi i teknikës është strukturuar në mënyrë të tillë që të shmangë ekzekutimin për llogari të vet shoqërisë.

63. Mënyra më e mirë për zbutjen e rreziqeve të mundshme që vijnë nga rritja e përdorimit të teknologjisë, është përmes kombinimit të masave dhe të kontrolleve specifike të rrezikut që orientohen ndaj shoqërive, të cilat zhvillojnë tregtimin algoritmik ose teknikat e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë që sigurojnë aksesin e drejtpërdrejtë elektronik, dhe të masave të tjera që orientohen ndaj operatorëve në vendet të tregimit që aksesohen nga këto shoqëri. Për fuqizimin e fleksibilitetit të tregjeve në kontekstin e zhvillimeve teknologjike, këto masa duhet të pasqyrojnë dhe të bazohen në udhëzime teknike, të nxjerra nga Autoriteti Evropian i Mbikëqyrjes (Autoritetit Evropian i Tregut të Letrave me Vlerë) (ESMA) i themeluar nga Rregullorja (BE) nr. 1095/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në shkurt të vitit 2012, për sistemet dhe kontrollet e mjedisit të tregtimit të automatizuar të platformave tregtare, të shoqërive të investimit dhe të autoriteteve kompetente (ESMA/2012/122). Preferohet të garantohet autorizimi i të gjitha shoqërive të tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë. Ky autorizim duhet të garantojë që këto shoqëri të jenë objekt i kërkesave organizative sipas kësaj direktive dhe të kenë mbikëqyrjen e duhur. Megjithatë, subjektet që janë të autorizuar dhe të mbikëqyrura sipas ligjit të Bashkimit Evropian që rregullon sektorin financiar dhe që përjashtohen nga kjo direktivë, por që kryejnë tregtim algoritmik ose teknika të tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë nuk është e nevojshme të pajisjen me autorizim sipas kësaj direktive dhe u nënshtrohen vetëm masave dhe kontrolleve që synojnë trajtimin e rreziqeve specifike që lindin nga këto lloje tregtimi. Në këtë drejtim, ESMA duhet të luajë një rol të rëndësishëm koordinues, përmes përcaktimit të çmimit të shprehur në njësi, me qëllim garantimin e tregjeve të rregullta në nivel Bashkimi Evropian.

64. Shoqëritë e investimit, si dhe vendet e tregtimit, duhet të garantojnë caktimin e masave të qëndrueshme për garantimin e shmangies së parregullsive në treg nga tregtimi algoritmik ose teknikat e tregtimit algoritmik, si dhe mospërdorimin e tyre për qëllime abuzive. Vendet e tregtimit duhet gjithashtu të garantojnë fleksibilitetin dhe testimin e përshtatshëm të sistemeve të tyre tregtare, për përballjen e fluksit të urdhrave ose kushtet e tensionuara të tregut dhe caktimin e ndërprerësve të veprimtarisë së sigurimeve, duke ndaluar përkohësisht ose kufizuar tregun në rastin e lëvizjeve të papritura në çmim.

65. Me qëllim nxitjen e kushteve të tregut të parregulluar, është gjithashtu e nevojshme të garantohen struktura tarifore transparente, jodiskriminuese dhe të drejta, si dhe të mos strukturohen, në mënyrë të atillë që nxit kushtet e parregullta të tregut. Kështu, është me vend lejimi i vendeve të tregtimit për t'u përshtatur me tarifën e tyre të anulimit të urdhrave, sipas afatit kohor të ruajtjes së urdhrit, si dhe për kalibrimin e tarifave në çdo instrument financiar ku ato zbatohen. Shtetet anëtare duhet të kenë kompetencën për të autorizuar vendet e tregtimit të zbatojnë tarifa më të larta për transmetimin e urdhrave që anulohen më pas, ose për pjesëmarrësit

me përqindje të lartë të urdhrave të anuluar dhe për operatorët e teknikës së tregimit algoritmik me frekuencë të lartë, për pasqyrimin e ngarkesës së shtuar mbi kapacitetin e sistemit, pa qenë e nevojshme të sjellë përfitime për pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

66. Përveç masave që lidhen me teknikat e tregimit algoritmik me frekuencë të lartë, në rastin kur aksesin nuk i nënshtrohet sistemeve dhe kontrolleve të duhura, shoqëritë e investimit duhet të ndalohen të sigurojnë aksesin e drejtpërdrejtë elektronik të klientëve të tyre në treg. Pavarësisht formës së aksesit të drejtpërdrejtë elektronik të parashikuar, shoqëritë që ofrojnë këtë akses duhet të vlerësojnë dhe të rishikojnë përshtatshmërinë e klientëve që përdorin atë shërbimit dhe të sigurohen që të kryhen kontrole të rrezikut për përdorimin e shërbimit dhe që ato shoqëri të mbajnë përgjegjësi tregimin e dorëzuar nga klientët e tyre përmes përdorimit të sistemeve ose të kodeve të tyre tregtare. Në lidhje me kërkesat e hollësishme organizative, është me vend që të përshkruhen më hollësisht kërkesat e standardeve të rregulloreve teknike për llojet e reja të tregimit. Kjo garanton ndryshimin e kërkesave aty ku nevojitet, për përballjen e inovacionit të mëtejshëm dhe të zhvillimeve në atë zonë.

67. Për garantimin e mbikëqyrjes efikase dhe për t'i lejuar autoritetet kompetente të marrin masat e përshtatshme dhe në kohë ndaj strategjive algoritmike të gabuara ose me defekte, është e nevojshme të shënohen të gjithë urdhrat që prodhohen nga tregtimi algoritmik. Përmes shënimit, autoritetet kompetente kanë mundësi të identifikojnë dhe të dallojnë urdhrat me origjinë nga algoritme të ndryshme, si dhe të rindërtojnë me efikasitet dhe të vlerësojnë strategjitë që përdorin tregtarët algoritmik. Kjo duhet të zbusë rrezikun që urdhrat të mos i atribuohen qartazi një strategjie dhe një tregtari algoritmik. Shënimi lejon reagimin efikas dhe efektiv të autoriteteve kompetente ndaj strategjive të tregimit algoritmik që sillen në mënyrë abuzive ose rrezikojnë funksionimin e rregullt të tregut.

68. Për garantimin e ruajtjes së integritetit të tregut në kontekstin e zhvillimeve teknologjike të tregjeve financiare, ESMA duhet të kërkojë rregullisht të dhënat nga ekspertët kombëtar për zhvillimet në lidhje me teknologjinë e tregimit, duke përfshirë tregtimin me frekuencë të lartë dhe praktikën e reja që përbëjnë abuzimin e mundshëm në treg, për identifikimin dhe nxitjen e strategjive efikase të parandalimit dhe trajtimit të këtij abuzimi.

69. Aktualisht, ekziston një shumëllojshmëri vendesh të tregimit që operojnë në Bashkimin Evropian, një ndër të cilat është dhe tregtimi i instrumenteve identike financiare. Për trajtimin e rreziqeve të mundshme ndaj interesave të investitorëve, nevojitet formalizimi dhe koordinimi i mëtejshëm i proceseve në lidhje me pasojat e tregimit në vendet e tjera tregtimi, në rastin kur shoqëria e investimit ose operatori i tregut që operon në vendin e tregimit, vendos pezullimin ose çregjistrimin e instrumentit financiar nga veprimtaria tregtare. Në interes të sigurisë juridike dhe për trajtimin siç duhet të konflikteve të interesit gjatë vendimit të pezullimit ose të çregjistrimit të instrumentit financiar nga veprimtaria tregtare, në rastin kur shoqëritë e investimit ose operatorët e tregut që operojnë në vendin e tregimit ndërpresin tregtimin për shkak të mospërputhjeve të rregullave të tyre, duhet të garantohet ndjekja e vendimit nga të tjerët, në rastin kur autoritetet kompetente marrin këtë vendim, përveçse kur tregtimi i vazhdueshëm justifikohet nga rrethana të jashtëzakonshme. Përveç kësaj, nevojitet formalizimi dhe përmirësimi i shkëmbimit të informacionit, dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente lidhur me pezullimin dhe çregjistrimin e tregimit të instrumentit financiar nga vendi i tregimit. Këto rregullime duhet të zbatohen në mënyrë që të parandalojnë vendet e tregimit

nga përdorimi i informacionit të transmetuar sipas kontekstit të pezullimit ose të përjashtimi për qëllime jotregtare, të instrumentit financiar nga veprimtaria tregtare.

70. Numri i investitorëve aktiv në tregjet financiare ka pësuar rritje, të cilëve u ofrohet një grup kompleks dhe me gamë të gjerë shërbimesh dhe instrumentesh, dhe nisur nga këto zhvillime, është e nevojshme të garantohet shkalla përkatëse e harmonizimit, me qëllim ofrimin e nivelit të lartë të mbrojtjes së investitorëve në të gjithë Bashkimin Evropian. Pas miratimit të Direktivës 2004/39/KE, varësia në rritje e investitorëve ndaj rekomandimeve personale kërkoi përfshirjen e ofrimit të këshillave mbi investimet si shërbim investimi, që i nënshtrohet autorizimit dhe detyrimeve specifike për ushtrimin e aktivitetit. Rëndësia e vazhdueshme e rekomandimeve personale për klientët dhe rritja e kompleksitetit të shërbimeve dhe e instrumenteve kërkojnë fuqizimin e ushtrimit të detyrimeve të aktivitetit, për të fuqizuar mbrojtjen e investitorit.

71. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që shoqëritë e investimit të veprojnë në përputhje me interesat më të larta të klientëve të tyre, si dhe të jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj direktive. Shoqëritë e investimit duhet përkatësisht të kuptojnë veçoritë e instrumenteve financiare që ofrohen ose rekomandohen, dhe të krijojnë e rishikojnë politika efikase dhe masa për identifikimin e kategorive të klientëve, të cilëve do t'u ofrohen produktet dhe shërbimet. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që shoqëritë e investimit që prodhojnë instrumente financiare të garantojnë që këto produkte të prodhohen për të plotësuar nevojat e një tregu të synuar, të identifikuar të klientëve fundorë, brenda kategorisë përkatëse të klientëve, të ndërmarrin hapat e arsyeshme për të garantuar që instrumentet financiare t'i shpërndahen tregut të synuar të identifikuar dhe të rishikojnë në mënyrë periodike, identifikimin e tregut të synuar të produkteve që ata ofrojnë dhe performancën e atyre produkteve. Shoqëritë e investimit që ofrojnë ose u rekomandojnë klientëve instrumente financiare jo të prodhuara prej tyre, duhet gjithashtu të kenë në zbatim masat e përshtatshme për të marrë dhe kuptuar informacionin përkatës për procesin e miratimit të produktit, duke përfshirë tregun e synuar të identifikuar dhe karakteristikat e produktit që ato ofrojnë ose rekomandojnë. Ky detyrim duhet të zbatohet pa cenuar asnjë vlerësim të përshtatshmërisë të zhvilluar nga shoqëria e investimit në lidhje me ofrimin e shërbimeve të investimit në bazë të nevojave personale, karakteristikave dhe objektivave të secilit klient.

Për garantimin e ofrimit ose rekomandimit të instrumenteve financiare, vetëm sipas interesit të klientit, shoqëritë e investimit që ofrojnë ose rekomandojnë produktet e prodhuara nga shoqëritë që nuk i nënshtrohen kërkesave rregullatore të produkteve të përcaktuara në këtë direktivë, ose të cilat prodhohen nga shoqëri të vendeve të treta, duhet të vendosin masat e përshtatshme për të marrë informacionin e mjaftueshëm lidhur me instrumentet financiare.

72. Për t'i dhënë investitorëve të gjithë informacionin përkatës, është me vend që shoqërive të investimit t'u kërkohet ofrimi i këshillave të investimit për bërjen publike të kostos së këshillimit, për të sqaruar bazën e këshillimit të ofruar prej tyre, në veçanti gamën e produkteve që ata marrin parasysh kur iu bëjnë rekomandime personale klientëve, si në rastin e ofrimit të këshillave të investimit, në mënyrë të pavarur, ashtu dhe në rastin kur iu ofrojnë klientëve vlerësim periodik të përshtatshmërisë së instrumenteve financiare të rekomanduara prej tyre. Është gjithashtu e përshtatshme që shoqërive të investimit t'u kërkohet t'u shpjegojnë klientëve të tyre arsyet e këshillimit që u ofrohet atyre.

73. Për përcaktimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator për ofrimin e këshillave mbi investimet, njëkohësisht duke i dhënë mundësinë e zgjedhjes shoqërive të investimit dhe klientëve, është me vend të vendosen kushtet për ofrimin e këtij shërbimi, në rastin kur shoqëritë njoftojnë klientët se shërbimi ofrohet në mënyrë të pavarur. Kur këshillimi ofrohet në mënyrë të pavarur, duhet të vlerësohet një gamë e mjaftueshme e produkteve të ofruesve të ndryshëm të produkteve, përpara se të bëhen rekomandime personale. Nuk është e nevojshme që këshilluesit të vlerësojnë produktet e investimit të hedhura në treg nga të gjithë ofruesit ose emetuesit e produkteve, por gama e instrumenteve financiare duhet të kufizohet në instrumentet financiare të emetuara ose të ofruara nga subjektet të lidhura ngushtë me shoqërinë e investimit, ose përmes marrëdhënieve të tjera ligjore ose ekonomike, si marrëdhëniet kontraktuale, të cilat kanë afërsi të atillë me njëra-tjetrën, sa rrezikojnë pavarësinë e këshillës së ofruar.

74. Për fuqizimin e mbrojtjes së investitorëve dhe rritjen e qartësisë së klientëve në lidhje me shërbimin e marrë, është gjithashtu me vend kufizimi i mundësisë së shoqërive që ofrojnë shërbim këshillues për investimet, në mënyrë të pavarur, dhe shërbimin e administrimit të portofolit, që të pranojnë e të mbajnë tarifa, komisione ose përfitime të tjera monetare ose jomonetare nga palë të treta, e sidomos nga emetuesit ose ofruesit e produktit. Kjo nënkupton se, shoqëria pasi merr pagesat e të gjitha tarifave, komisioneve dhe çdo përfitim tjetër monetar të paguar ose të ofruar nga palët e treta, duhet t'i kthehen plotësisht klientit, sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe shoqëria të mos lejohet të zbrisë nga tarifat që klienti duhet t'i paguajë shoqërisë, asnjë pagesë të palëve e treta. Klienti duhet të informohet saktësisht dhe, sipas rastit, në mënyrë periodike mbi tarifat, komisionet dhe përfitimet e marra nga shoqëria, në lidhje me ofrimin dhe kalimin të klientit të shërbimit të investimit. Shoqëritë që ofrojnë këshilla të pavarura ose administrimin e portofolit duhet të krijojnë një politikë, si pjesë e kërkesave të tyre organizative, për të garantuar që pagesat e marra nga palët e treta t'i alokohen e ti transferohen klientëve. Duhet të lejohen vetëm përfitime të vogla jomonetare, me kusht që ato t'i komunikohen qartësisht klientit në lidhje me aftësinë e tyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, dhe të cilat gjykohen se nuk dëmtojnë aftësinë e shoqërive të investimit për të vepruar në interesin më të lartë të klientëve të tyre.

75. Ofrimi i shërbimit këshillues për investimet në mënyrë të pavarur dhe shërbimi i administrimit të portofolit, tarifat, komisioneve, ose përfitimeve jomonetare të paguara ose të ofruara nga një person në emër të klientit, duhet të lejohen vetëm nëse personi ka dijeni që këto pagesa janë kryer në emër të tij dhe vlera e shpeshësia e tyre është rënë dakord ndërmjet klientit dhe shoqërisë së investimit dhe nuk janë përcaktuar nga pala e tretë. Rastet e përmbushjes së kërkesave përfshijnë rastin kur klienti paguan drejtpërdrejt faturën e një shoqërie, ose fatura paguhet nga një palë e tretë e pavarur, e cila nuk ka asnjë lidhje me shoqërinë e investimit për sa i përket shërbimit të investimit që i është ofruar klientit dhe vepron vetëm sipas udhëzimeve të dhëna nga klienti, si dhe rastet kur klienti negocion një tarifë për një shërbim të ofruar nga shoqëria e investimit dhe e paguan atë tarifë. Përgjithësisht ky është rasti i kontabilistëve ose avokatëve që veprojnë sipas udhëzimeve të qarta të dhëna nga klientët për kryerjen e pagesave, ose rasti kur një person vepron thjesht si person që kryen pagesën.

76. Kjo direktivë parashikon kushtet dhe procedurat që duhet të zbatohen shtetet anëtare kur planifikojnë të vendosin kërkesa shtesë. Këto kërkesa mund të përfshijnë ndalimin ose kufizimin e mëtejshëm të ofrimit ose pranimit të tarifave, të komisioneve, ose të çdo përfitimi

tjetër monetar ose jomonetar, që paguhet ose ofrohet nga çdo palë e tretë ose person që vepron në emër të palës së tretë në lidhje me ofrimin e shërbimit të klientit.

77. Për mbrojtjen e mëtejshme të konsumatorëve, është gjithashtu me vend të garantohet që shoqëritë e investimit të mos vendosin nivele të tilla page apo të vlerësojnë performancën e stafit të tyre në mënyrë të tillë që do të binte ndesh me detyrimin e shoqërisë për të vepruar në interesin më të lartë të klientëve të tyre, për shembull përmes pagave, objektivave të shitjes ose ndryshe, që ofrojnë incentiva për rekomandimin ose shitjen e një instrumenti financiar të caktuar, kur ka produkte të tjera që mund të përmbushin më mirë nevojat e klientit.

78. Nëse jepet informacioni i mjaftueshëm mbi kostot dhe tarifat përkatëse ose mbi rreziqet në lidhje me vetë instrumentin financiar, në përputhje me një ligj tjetër të Bashkimit Evropian, ky informacion duhet të konsiderohet i përshtatshëm, për qëllimet e ofrimit të informacionit të klientit sipas kësaj direktive. Megjithatë, shoqëritë e investimit ose institucionet kredituese që shpërndajnë atë instrument financiar, duhet gjithashtu të informojnë klientët e tyre mbi të gjitha kostot dhe tarifat e tjera përkatëse lidhur me ofrimin prej tyre të shërbimeve të investimit lidhur me atë instrument financiar.

79. Nisur nga kompleksiteti i produkteve të investimit dhe nga inovacioni i vazhdueshëm i projektimit të tyre, është gjithashtu e rëndësishme të garantohet që stafi që këshillon apo që shet produkte investimi për klientët individë, të ketë një nivel të përshtatshëm njohurish dhe kompetencash në lidhje me produktet e ofruara. Shoqëritë e investimit duhet t'i japin stafit kohën dhe burimet e mjaftueshme për marrjen e këtyre njohurive dhe kompetencave, si dhe për zbatimin e tyre gjatë ofrimit të shërbimeve për klientët.

80. Shoqëritë e investimit lejohen të ofrojnë shërbime investimi që përbëhen vetëm nga zbatimi dhe/ose marrja dhe transmetimi i urdhrave të klientit, pa qenë e nevojshme të merret informacion në lidhje me njohurinë dhe përvojën e klientëve, në mënyrë që të vlerësohet përshtatshmëria e shërbimit ose e instrumentit financiar për klientin. Duke qenë se këto shërbime përfshijnë ulje të ndjeshme të mbrojtjes së klientit, është e përshtatshme të përmirësohen kushtet për ofrimin e tyre. Për të lejuar kryerjen e transaksioneve, është veçanërisht e përshtatshme të përjashtohet mundësia e ofrimit të këtyre shërbimeve së bashku me shërbimin ndihmës, që përbëhet nga dhënia e kredive ose e huave për investitorët, për t'u dhënë atyre mundësinë të kryejnë një transaksion në të cilin janë të përfshira shoqëritë e investimit, duke qenë se kjo rrit kompleksitetin e transaksionit dhe vështirëson të kuptuarit e rrezikut që lidhur me të. Është me vend që të përkufizohen më mirë kriteret për përzgjedhjen e instrumenteve financiare, me të cilat duhet të lidhen këto shërbime, në mënyrë që të përjashtohen disa instrumente financiare të caktuara, duke përfshirë ato që përmbajnë një derivative apo strukturë që e bën të vështirë për klientin të kuptojë rrezikun e përfshirë, aksionet e sipërmarrjeve që nuk janë Sipërmarrje të Investimeve Kolektive në Tituj të Transferueshëm (SIKTT) (sipërmarrje të investimeve kolektive jo SIKTT) dhe SIKTT-të e strukturuar, siç përmenden në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë të Rregullores së Komisionit (BE) nr. 583/2010. Trajtimi i disa SIKTT-ve si produkte komplekse nuk duhet të cenohet përkufizimin në ligjet e ardhshme të Bashkimit Evropian, të objektit dhe të rregullave të zbatueshme për këto produkte.

81. Praktikrat e shitjeve të ndërthurura janë strategji të zakonshme të ofruesve të shërbimeve financiare për klientët individë në të gjithë Bashkimin Evropian. Këto shitje mund të

sigurojnë përfitime për klientët individë, por gjithashtu mund të përfaqësojnë praktikave, për të cilat interesi i klientit nuk konsiderohet siç duhet. Për shembull, disa forma të praktikave të shitjeve të ndërthurura, konkretisht praktikave të ndërlidhura ku dy ose më shumë shërbimeve financiare shiten bashkërisht në një paketë dhe të paktën një nga këto shërbime nuk është i disponueshëm veçmas, mund të shtrembërojnë konkurrencën dhe të ndikojnë negativisht në lëvizshmërinë dhe aftësinë e klientit për të bërë zgjedhje të informuara. Një shembull i praktikave të ndërlidhura mund të jetë ai i hapjes së domosdoshme të llogarive rrjedhëse, në rastin kur një shërbim investimi i ofrohet një klienti individ. Ndërsa praktikave të grupimit, ku dy ose më shumë shërbime financiare shiten së bashku në një paketë të vetme, por secili prej shërbimeve mund të blihet edhe veçmas, gjithashtu mund të shtrembërojnë konkurrencën dhe të ndikojnë negativisht në lëvizshmërinë dhe aftësinë e klientit për të bërë zgjedhje të informuara, ato lejojnë të paktën mundësinë e zgjedhjes për konsumatorin, duke ulur rrezikun e përmbushjes nga shoqëritë e investimit të detyrave të tyre sipas kësaj direktive. Përdorimi i këtyre praktikave duhet të vlerësohet me kujdes, në mënyrë që të nxisë konkurrencën dhe zgjedhjen e konsumatorit.

82. Gjatë ofrimit të këshillave të investimit, shoqëria e investimit duhet të specifikojë në deklaratën me shkrim mbi qëndrueshmërinë, mënyrën sesi këshillimi përshtatet me preferencat, nevojat dhe karakteristikat e tjera të klientit individ. Deklaratat duhet të jepen me mjete të qëndrueshme, duke përfshirë formatin elektronik. Përgjegjësinë për kryerjen e vlerësimit të përshtatshmërisë dhe për t'u dhënë klientëve një raportim të saktë mbi përshtatshmërinë, e ka shoqëria e investimit, dhe duhen marrë masat e përshtatshme për të garantuar që klienti mos të pësojë humbje si pasojë e faktit që raporti paraqet në mënyrë të pasaktë dhe të padrejtë rekomandimin personal, duke përfshirë mënyrën sesi rekomandimi i dhënë është i përshtatshëm për klientin dhe disavantazhet e linjës së rekomanduar të veprimit.

83. Për përcaktimin e asaj çka përbën dhënien e informacionit në kohën e duhur, përpara afatit të përcaktuar nga kjo direktivë, shoqëria e investimit duhet të marrë në konsideratë, duke pasur parasysh urgjencën e situatës, nevojën e klientit për të pasur në dispozicion kohën e mjaftueshme për ta lexuar dhe kuptuar atë përpara se të marrë një vendim investimi. Klienti mund të kërkojë më tepër kohë për shqyrtimin e informacionit të dhënë për një produkt apo shërbim kompleks ose të panjohur, ose një produkt apo shërbim me të cilin klienti nuk ka eksperiencë, krahasuar me një klient, i cili konsideron një produkt ose shërbim më të thjeshtë dhe më të njohur, ose në rastin kur klienti ka pasur eksperiencë të mëparshme.

84. Kjo direktivë kurrësi nuk detyron shoqëritë e investimit të japin të gjithë informacionin e kërkuar rreth shoqërisë së investimit, instrumenteve financiare, kostove dhe tarifave përkatëse, ose në lidhje me masat mbrojtëse të instrumenteve financiare të klientit ose fondeve të klientit, menjëherë ose njëkohësisht, me kusht që ato të përmbushin detyrimin e përgjithshëm të dhënies së informacionit përkatës në kohën e përshtatshme, përpara afatit të përcaktuar në këtë direktivë. Duke qenë se informacioni i komunikohet klientit në kohën e përshtatshme përpara ofrimit të shërbimit, kjo direktivë kurrësi nuk detyron shoqëritë e investimit ta japin informacionin veçmas ose ta përfshijnë atë në marrëveshjet me klientin.

85. Një shërbim duhet të konsiderohet i ofruar me iniciativën e klientit, përveç rastit kur klienti e kërkon atë si përgjigje ndaj një komunikimi të personalizuar nga ose në emër të shoqërisë drejt këtij klienti, i cili përmban ftesën ose synon të ndikojë te klienti, në lidhje me një

instrument financiar specifik ose transakcion specifik. Një shërbim konsiderohet i ofruar me iniciativë të klientit, pavarësisht nëse klienti e kërkon atë në bazë të komunikimeve me përmbajtje nxitëse ose ofruese të instrumenteve financiare, të bëra përmes çdo mënyre, që është me natyrë të përgjithshme dhe i drejtohet publikut ose një grupim më të madh apo një kategorie klientësh ose klientësh të mundshëm.

86. Një nga objektivat e kësaj direktive është të mbrojë investitorët. Masat për mbrojtjen e investitorëve duhet të përshtaten ndaj veçorive të secilës kategori të investitorëve (individ, profesionistë dhe kundërpalë). Megjithatë, për të zgjeruar kuadrin rregullator të zbatueshëm për ofrimin e shërbimeve, pavarësisht kategorive të klientëve përkatës, është me vend të bëhet e qartë se në marrëdhënien me klientët zbatohen parimet e të vepruarit me ndershmëri, në mënyrë të drejtë dhe me profesionalizëm, si dhe detyrimi për të qenë i drejtë, i qartë dhe jo çorientues.

87. Shpeshherë, investimet që përfshijnë kontrata sigurimi vihen në dispozicion të konsumatorëve si alternativa të mundshme ose si zëvendësues të instrumenteve financiare, në zbatim të kësaj direktive. Për ofrimin e mbrojtjes konsistente të klientëve individë, dhe për sigurimin e nivelit të barabartë ndërmjet produkteve të ngjashme, është e rëndësishme që produktet e investimit për sigurime t'u nënshtrohen kërkesave të përshtatshme. Duke pasur parasysh kërkesat e kësaj direktive për mbrojtjen e investitorit, të cilat duhet të zbatohen njësoj dhe për investimet e paketuara sipas kontratave të sigurimit, ndryshimet në strukturat e tyre të tregut dhe karakteristikat e produkteve e bëjnë më të përshtatshme vendosjen e kërkesave të detajuara në Direktivën 2002/92/KE, që është në proces rishikimi, sesa parashikimin e tyre në këtë direktivë. Kështu, ligji i ardhshëm i Bashkimit Evropian, i cili rregullon veprimtaritë e ndërmjetësve të sigurimit dhe të shoqërive të sigurimit, duhet të sigurojë në mënyrë të përshtatshme qasjen konsistente rregullatore në lidhje me dorëzimin e produkteve të ndryshme financiare, të cilat plotësojnë nevoja të ngjashme të investitorit dhe për rrjedhojë krijojnë vështirësi në mbrojtjen e investitorit. Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), i themeluar përmes Rregullores (BE) nr 1094/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Autoriteti Evropian i Tregut të Letrave me Vlerë duhet të punojnë së bashku për arritjen e konsistencës maksimale të standardeve mbi ushtrimin e aktivitetit për këto produkte të investimit. Kërkesat e reja për produktet e investimeve të lidhura me skemat e sigurimit duhet të përcaktohen në Direktivën 2002/92/KE.

88. Për të harmonizuar rregullat lidhur me konfliktet e interesit, parimet e përgjithshme dhe informacionin për klientin dhe për t'u lejuar shteteve anëtare të vendosin kufizime mbi pagën e ndërmjetësve të sigurimit, duhet të ndryshohet përkatësisht Direktiva 2002/92/KE.

89. Produktet e investimit të lidhura me skemat e sigurimit, të cilat nuk ofrojnë mundësi investimi dhe depozita me ekspozim vetëm ndaj normave të interesit duhet të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive. Produktet e pensioneve individuale dhe profesionale kanë qëllim kryesor t'i ofrojnë investitorit të ardhura pas daljes në pension, duhet të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, duke konsideruar veçoritë dhe objektivat e tyre.

90. Duke deroguar nga parimi i autorizimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të detyrimeve në lidhje me operimin e degëve në shtetin anëtar të origjinës, është e përshtatshme marrja përsipër e përgjegjësive nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës, për zbatimin e disa detyrimeve të përcaktuara në këtë direktivë, në lidhje ushtrimin e aktivitetit përmes një dege brenda territorit në

të cilin ndodhet dega, duke qenë se autoriteti është më afër saj, dhe vendndodhja e tij është më e përshtatshme për zbulimin dhe ndërhyrjen në lidhje me shkeljet e rregullave që rregullojnë operacionet e degës.

91. Është e nevojshme të vendoset një detyrim efektiv për "ekzekutimin më të mirë", për të garantuar që shoqëritë e investimit të ekzekutojnë urdhrat e klientit sipas kushteve që janë më të favorshmet për klientin. Ky detyrim duhet të zbatohet në rastin kur shoqëria ka detyrime kontraktuale ose sipas marrëveshjes së agjencisë me klientin.

92. Duke pasur parasysh që tashmë në Bashkimin Evropian disponohet një gamë më e gjerë e platformave të ekzekutimit të urdhrave, është me vend fuqizimi i kuadrit më të mirë ekzekutues për investitorët individë. Gjatë zbatimit të kuadrit më të mirë ekzekutiv, duhet të konsiderohen zhvillimet teknologjike të monitorimit të ekzekutimit më të mirë, në përputhje me nenin 27, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë dhe i tretë.

93. Me qëllim përcaktimit të ekzekutimit më të mirë të mundshëm, gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit individ, kostot e lidhura me zbatimin duhet të përfshijnë komisionet e vetë shoqërisë së investimit ose tarifat e faturuara për klientin sipas qëllimeve të kufizuara, në rastin e më shumë se një vendi të renditur në politikën ekzekutive të shoqërisë, të aftë për ekzekutimin e urdhrave të caktuara. Në këto raste, duhet të merren në konsideratë komisionet dhe kostot e vetë shoqërisë, në lidhje me ekzekutimin e urdhrave për secilën platformë të kualifikuar për ekzekutimin e urdhrave, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e rezultateve të klientit, të arritshme përmes ekzekutimit të urdhrave në secilin vend të tregimit. Megjithatë, shoqërisë nuk synohet t'i kërkohet krahasimi i rezultateve të arritshme për klientët e saj, në bazë të politikës së ekzekutimit dhe komisioneve dhe tarifave të saj, me rezultatet e mundshme të arritshme për të njëjtin klient nga çdo shoqëri tjetër, në bazë të politikave të ndryshme të ekzekutimit, ose të një strukture të ndryshme të komisioneve ose tarifave. Nuk synohet t'i kërkohet shoqërisë as krahasimi i ndryshimeve në komisionet e saj, të cilat i atribuohen diferencave sipas llojeve të shërbimeve, që shoqëria i ofron klientëve.

94. Dispozitat e kësaj direktive, të cilat sigurojnë përfshirjen e kostove të ekzekutimit në komisionet e vetë shoqërisë së investimit, ose tarifat e faturuara për ofrimin e shërbimit të investimit për klientin, nuk duhet të zbatohen me qëllim përcaktimit të platformave të ekzekutimit të urdhrave, të cilat duhet të përfshihen në politikën e ekzekutimit të shoqërisë, për qëllime të nenit 27, paragrafi 5 të kësaj direktive.

95. Shoqëria e investimit duhet të konsiderohet se strukturon ose faturon komisionet e saj në mënyrë diskriminuese dhe të padrejtë ndërmjet platformave të ekzekutimit të urdhrave, nëse ajo vendos komisione të ndryshme ose marzhe për klientët e platformave të ndryshme të ekzekutimit të urdhrave, dhe se kjo diferencë nuk pasqyron diferencat aktuale në kosto të shoqërisë ekzekutive në këto vende të tregimit.

96. Për përmirësimin e kushteve, përmes të cilave shoqëritë e investimit përmbushin detyrimet e tyre për të ekzekutuar urdhra sipas kushteve më të favorshme për klientët e tyre, në përputhje me këtë direktivë, është e përshtatshme të kërkohet nënshtrimi i këtyre instrumenteve financiare ndaj detyrimit tregtar të neneve 23 dhe 28 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, në lidhje me çdo vend tregtimi ose subjekt të brendshëm sistematik, si dhe në lidhje me instrumentet e

tjera financiare, për vënien në dispozicion të publikut nga secili vend ekzekutiv, të të dhënave në lidhje me cilësinë e ekzekutimit të transaksioneve në çdo vend të tregtimit.

97. Shpeshherë, informacioni i siguruar nga shoqëritë e investimit për klientët, në lidhje me politikën e tyre të ekzekutimit, ka natyrë të përgjithshme dhe standarde, dhe nuk lejon klientët të kuptojnë mënyrën e ekzekutimit të urdhrave dhe të verifikojnë përmbushjen nga shoqëritë të detyrimeve të tyre për të ekzekutuar urdhra sipas kushteve më të favorshme për klientët e tyre. Për fuqizimin e mbrojtjes së investitorit, është me vend të specifikohen parimet në lidhje me informacionin që shoqëritë e investimit u japin klientëve të tyre për politikën e ekzekutimit, si dhe t'u kërkohej shoqërive të bëjnë publike, një herë në vit, për secilën kategori të instrumenteve financiare, pesë platformat më të mira të ekzekutimit të urdhrave, ku ata kanë ekzekutuar urdhrat e klientit një vit më parë, si dhe të merret në konsideratë që informacioni dhe informacioni i bërë publik nga platformat e ekzekutimit të urdhrave, në lidhje me cilësinë e ekzekutimit në politikat e tyre për ekzekutimin më të mirë.

98. Gjatë vendosjes së marrëdhënies tregtare me klientin, shoqëria e investimit mund t'i kërkojë klientit ose klientit të mundshëm, të bjerë njëkohësisht dakord, si me politikën e ekzekutimit, ashtu dhe me mundësinë e ekzekutimit të urdhrave jashtë vendit të tregtimit të tij.

99. Personat që ofrojnë shërbime investimi në emër të dy ose më shumë shoqërive investuese nuk duhet të konsiderohen si agjentë të lidhur, por si shoqëri investimi, në rastin kur ato përfshihen sipas përkufizimit të parashikuar nga kjo direktivë, me përjashtim të personave të caktuar që përjashtohen.

100. Kjo direktivë nuk duhet të cenojë të drejtën e agjentëve të lidhur për të kryer aktivitetet e mbuluara nga direktiva të tjera, dhe të aktivitete të lidhura me to, për shërbime ose produkte financiare që nuk mbulohen nga kjo direktivë, duke përfshirë ato në emër të pjesëve të të njëjtit grup financiar.

101. Kushtet për ushtrimin e aktivitetit jashtë ambienteve të shoqërisë së investimit (shitja derë më derë) nuk duhet të mbulohen nga kjo direktivë.

102. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare nuk duhet të regjistrojnë ose duhet të tërheqin regjistrimin, në rastin kur veprimtaritë e ushtruara realisht, tregojnë qartë se një agjent i lidhur preferon sistemin ligjor të një shteti anëtar, për qëllimet e shmangies së standardeve më strikte në fuqi në një shtet tjetër anëtar, brenda territorit të të cilit ai synon të ushtrojë ose ushtron pjesën më të madhe të veprimtarive të tij.

103. Për qëllime të kësaj direktive, kundërpalët e tjera të kualifikuara duhet të konsiderohen se veprojnë si klientë.

104. Kriza financiare ka treguar kufizime të aftësisë së klientëve individë për vlerësimin e rrezikut të investimeve të tyre. Ndërkohë që duhet konfirmuar zbatimi i rregullave të ushtrimit të aktivitetit në lidhje me investitorët, të cilët kanë më tepër nevojë për mbrojtje, është e përshtatshme të kalibrohen më mirë kërkesat e zbatueshme për kategori të ndryshme të klientëve. Për këtë qëllim, është e përshtatshme të zgjerohet gama e kërkesave për informacion dhe raportim në marrëdhënien me kundërpalët e kualifikuara. Në veçanti, kërkesat përkatëse duhet të lidhen me masat mbrojtëse të instrumenteve financiare dhe fondeve të klientit, si dhe me

kërkesat për informacion dhe raportim, në lidhje me instrumente dhe transaksione financiare më komplekse. Për përkufizimin më të saktë të klasifikimit të bashkive dhe të autoriteteve publike vendore, është i përshtatshëm përjashtimi i qartë i tyre nga lista e kundërpalëve të tjera të kualifikuara dhe të klientëve, të cilët konsiderohen si profesionistë, duke i lejuar ata klientë të kërkojnë të trajtohen si klientë profesionistë.

105. Në lidhje me ekzekutimin e transaksioneve ndërmjet kundërpalëve të kualifikuara, detyrimi i bërjes publike të urdhrave të kufizuara të klientit, duhet të zbatohet vetëm në rastin kur kundërpala, në mënyrë eksplicite, i dërgon shoqërisë së investimit urdhrin limit për t'u ekzekutuar.

106. Shtetet anëtare duhet të garantojnë respektimin e të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën 2002/58/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të cilat rregullojnë përpunimin e të dhënave personale, të kryer në zbatim të kësaj direktive. Përpunimi i të dhënave personale nga ESMA në zbatim të kësaj direktive, është objekt i Rregullores (BE) nr. 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

107. Shoqëritë e investimit duhet të kenë mundësi të barabarta për t'u bërë pjesë ose për të aksesuar tregjet e rregulluara në të gjithë Bashkimin Evropian. Pavarësisht mënyrës së organizimit aktual të transaksioneve në shtetet anëtare, është e rëndësishme të anulohen kufizimet teknike dhe ligjore për aksesin në tregjet e rregulluara.

108. Për lehtësimin e finalizimit të transaksioneve ndërkufitare, është e përshtatshme të parashikohet akses në sistemet e klerimit dhe të shlyerjes, të shoqërive të investimit në të gjithë Bashkimin Evropian, pavarësisht nëse transaksionet përfundohen ose jo përmes tregjeve të rregulluara të shtetit anëtar përkatës. Shoqëritë e investimit që dëshirojnë të marrin pjesë në sistemet e shlyerjes të shteteve të tjera anëtare, duhet të përmbushin kërkesat operationale dhe tregtare përkatëse për anëtarësimin dhe masat e kujdesshme për ruajtjen e funksionimit normal dhe të rregullt të tregjeve financiare.

109. Ofrimi i shërbimeve në Bashkimin Evropian, nga shoqëri të vendeve të treta, i nënshtrohet regjimeve dhe kërkesave kombëtare. Shoqëritë e autorizuar në përputhje me to, nuk gëzojnë lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe të drejtën e themelimit në shtetet anëtare, të ndryshme nga ato të themelimit të tyre. Nëse shteti anëtar konsideron se niveli i përshtatshëm i mbrojtjes së klientëve të tij individë ose klientëve individë që kanë kërkuar të trajtohen si klientë të kategorisë profesionist, mund të arrihet përmes krijimit të një dege, nga një shoqëri e një vendi të tretë, është e përshtatshme të prezantohet kuadri minimal rregullator i përbashkët në nivel Bashkimi Evropian, në lidhje me kërkesat e zbatueshme për këto degë, dhe në kontekstin e parimit, sipas të cilit, shoqëritë e vendeve të treta nuk duhet të trajtohen në mënyrë më të favorshme sesa shoqëritë e Bashkimit Evropian.

110. Gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj direktive, shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) për juridiksionet me mangësi në parandalimin strategjik të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për të cilat zbatohen masat parandaluese, ose juridiksionet me mangësi në parandalimin strategjik të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat nuk kanë treguar progres të mjaftueshëm

në lidhje me adresimin e mangësive, ose të cilat nuk angazhohen në planin e veprimit, të zhvilluar së bashku me FATF-in, për adresimin e këtyre mangësive.

111. Dispozita e kësaj direktive, që rregullojnë ofrimin e shërbimeve ose të aktiviteteve të investimit nga shoqëritë e vendeve të treta në Bashkimin Evropian, nuk duhet të ndikojë mundësinë e personave të themeluar në Bashkimin Evropian për të marrë shërbime investimi nga shoqëritë e vendeve të treta, sipas nismës së tyre ekskluzive. Kur një shoqëri e një vendi të tretë ofron shërbime sipas nismës ekskluzive të një personi të themeluar në Bashkimin Evropian, shërbimet nuk konsiderohen të ofruara në territorin e Bashkimit Evropian. Nëse shoqëria e vendeve të treta kërkon klientët ose klientët të mundshëm në Bashkimin Evropian, apo nxit ose reklamon shërbimet ose aktivitetet e investimit së bashku me shërbimet ndihmëse, në Bashkimin Evropian, shërbimi nuk konsiderohet si shërbim i ofruar sipas nismës ekskluzive të vetë klientit.

112. Autorizimi për operimin e tregut të rregulluar duhet të shtrihet në të gjitha aktivitetet, që lidhen drejtpërdrejt me paraqitjen, përpunimin, zbatimin, konfirmimin dhe raportimin e urdhrave nga pika e marrjes së urdhrave në tregun e rregulluar, në pikën e transmetimit për finalizimin e mëtejshëm, si dhe në lidhje me aktivitetet e pranimi të instrumenteve financiare për tregtim. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë transaksionet e ekzekutuara përmes mjetit të krijuesve të tregut, të caktuar nga tregu i rregulluar, të cilat ndërmerren nga sistemet e tyre dhe në përputhje me rregullat që rregullojnë këto sisteme. Jo të gjitha transaksionet e ekzekutuara nga anëtarët ose pjesëmarrësit e tregut të rregulluar, MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregtimit, konsiderohen të ekzekutuara brenda sistemeve të tregut të rregulluar, MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregtimit. Transaksionet dypalëshe të ekzekutuara nga anëtarët ose pjesëmarrësit, dhe të cilat nuk përbushin të gjitha detyrimet e caktuara për tregun e rregulluar, MTF-në, ose platformën e përbashkët të tregtimit sipas kësaj direktive, duhet të konsiderohen transaksione të ekzekutuara jashtë tregut të rregulluar, MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregtimit për qëllime të përcaktimit të subjektit të brendshëm sistematik. Në këtë rast, detyrimi i shoqërive të investimit për bërjen publike të kuotave të shoqërisë zbatohet në rast se përbushen kushtet e vendosura nga kjo direktivë dhe nga Rregullorja (BE) nr. 600/2014.

113. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e sigurimit të likuiditetit për funksionimin e rregullt dhe efikas të tregjeve, shoqëritë e investimit që zhvillojnë tregtimin algoritmik për ndjekjen e strategjisë së krijimit të tregut, duhet të lidhin me shkrim marrëveshje me vendet e tregtimit, ku të sqarohen detyrimet e tyre për të ofruar likuiditet në treg.

114. Kjo direktivë kurrsesi nuk u kërkon autoriteteve kompetente miratimin ose ekzaminimin e përmbajtjes së marrëveshjes me shkrim ndërmjet tregut të rregulluar dhe shoqërisë së investimit, e cila kërkohet për shkak të pjesëmarrjes në skemën e krijimit të tregut. Megjithatë, kjo as nuk i ndalon ato nga ky veprim, për sa kohë që çdo miratim ose ekzaminim i tillë bazohet vetëm në respektimin nga tregjet e rregulluara të detyrimeve të tyre sipas nenit 48.

115. Ofrimi i shërbimeve të të dhënave thelbësore të tregut, si thelbësore për përdoruesit, në lidhje me përfitimin e përshkrimit të dëshiruar të aktivitetit tregtar të tregjeve financiare të Bashkimit Evropian, dhe për autoritetet kompetente në lidhje me marrjen e informacionit të saktë dhe gjithëpërfshirës për transaksionet përkatëse duhet t'i nënshtrohen autorizimit dhe rregulloreve, me qëllim garantimin e nivelit të nevojshëm të cilësisë.

116. Skemat e publikimit të miratuar duhet të përmirësojnë cilësinë e informacionit të transparencës tregtare të botuar në hapësirën "OTC", si dhe të kontribuojnë ndjeshëm për garantimin e botimit të këtyre të dhënave, me qëllim lehtësimin e konsolidimit të tyre me të dhënat e botuara nga vendet e tregtimit.

117. Tani që është vendosur struktura e tregut, e cila lejon konkurrencën ndërmjet vendeve të shumëfishta të tregtimit, është thelbësore që të vihet në zbatim, sa më shpejt të jetë e mundur, qarku i shiritit të kontrollit elektronik (QSHKE), i cili të jetë i konsoliduar, gjithëpërfshirës dhe efektiv. Prezantimi i zgjidhjes tregtare, për qarkun e shiritit të kontrollit elektronik për kapitalin dhe instrumentet financiare të ngjashme me kapitalin, duhet të mbështesë krijimin e një tregu më të integruar evropian dhe të lehtësojë aksesin e pjesëmarrësve të tregut në informacionin e transparencës tregtare që është në dispozicion. Zgjidhja e parashikuar bazohet në autorizimin e ofruesve, të cilët punojnë sipas parametrave të paracaktuara dhe të mbikëqyrura, të cilat konkurrojnë me njëra tjetrën, në mënyrë që të mbërrijnë në zgjidhje teknike tepër të sofistikuar dhe inovatore, në shërbim të tregut, në shkallën më të madhe të mundshme, dhe të garantojnë vënien në dispozicion të të dhënave konsistente dhe të sakta të tregut. Duke u kërkuar të gjithë ofruesve të QSHKE-ve konsolidimin e të dhënave për të gjitha skemat e publikimit të miratuara dhe vendet e tregtimit, do të garantohet konkurrenca mbi bazën e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve dhe jo mbi shtrirjen e të dhënave të mbuluara. Megjithatë, për momentin është i përshtatshëm parashikimi i vënies në zbatim të QSHKE-ve, përmes procesit të prokurimit publik, nëse mekanizmi i parashikuar nuk çon në dorëzimin në kohë të QSHKE-ve gjithëpërfshirëse dhe efikase të kapitaleve dhe të instrumenteve financiare të ngjashme me kapitalin.

118. Zbatimi i krijimit të QSHKE-së të instrumenteve financiare jokapitale konsiderohet më i vështirë se ai në lidhje me QSHKE-në e instrumenteve financiare kapitale, dhe ofruesit e mundshëm duhet të jenë të aftë të fitojnë eksperiencë, përpara zhvillimit, në lidhje me këtë të fundit. Kështu, për lehtësimin e krijimit të mirëfilltë të QSHKE-së të instrumenteve financiare jokapitale, është e përshtatshme të sigurohet shtyrja e datës së zbatimit të masave kombëtare që transpozojnë dispozitën përkatëse. Megjithatë, për momentin, është i përshtatshëm parashikimi i vendosjes në zbatim të QSHKE-ve përmes procesit të prokurimit publik, nëse mekanizmi i parashikuar nuk zbaton në kohë QSHKE-të gjithëpërfshirëse dhe efikase të kapitaleve dhe të instrumenteve financiare jokapitale.

119. Gjatë përcaktimit në lidhje me instrumentet financiare jokapitale, vendet e tregtimit dhe skemat e publikimit të miratuar, të cilat duhet të përfshihen në informacionin pas aktivitetit tregtar, i cili shpërndahet nga ofruesit e QSHKE-ve, ESMA duhet të garantojë arritjen e objektivit të themelimit të tregut të integruar të Bashkimit Evropian për ato instrumente financiare dhe duhet të garantojë trajtimin jodiskriminues të skemave të publikimit të miratuar dhe të vendeve të tregtimit.

120. Ligji i Bashkimit Evropian për kërkesat lidhur me fondet vetjake duhet të përcaktojë kërkesat për kapitalin minimal, që duhet të përmbushin tregjet e rregulluara për të qenë të autorizuar, duke marrë në konsideratë natyrën specifike të rreziqeve në lidhje me këto tregje.

121. Operatorët e tregut të rregulluar duhet gjithashtu të operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj direktive.

122. Dispozitat e kësaj direktive, në lidhje me pranimin e tregtimit të instrumenteve financiare në zbatim të rregullave të vendosura nga tregu i rregulluar, nuk duhet të cenojë zbatimin e Direktivës 2001/34/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe të Direktivës 2003/71/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Tregu i rregulluar nuk duhet të pengohet nga zbatimi i kërkesave më strikte se ato të vendosura sipas kësaj direktive, në lidhje me emetuesit e instrumenteve financiare, të cilët konsiderohen për t'u pranuar në veprimtari tregtare.

123. Shtetet anëtare duhet të jenë të afta të caktojnë autoritete të ndryshme kompetente për zbatimin e një game të gjerë detyrimesh, të përcaktuara në këtë direktivë. Këto autoritete duhet të jenë publike dhe të garantohet pavarësia e tyre nga aktorët ekonomikë dhe shmangia e konflikteve të interesit. Në përputhje me legjislacionin e brendshëm, shtetet anëtare duhet të sigurojnë financimin e duhur të autoritetit kompetent. Përcaktimi i autoriteteve publike nuk duhet të përjashtojë delegimin nën përgjegjësinë e autoritetit kompetent.

124. Për garantimin e komunikimit efikas dhe në kohë ndërmjet autoriteteve kompetente në lidhje me pezullimet, çregjistrimet, parregullsitë, kushtet e parregullta tregtare dhe rrethanat që tregojnë abuzimin e mundshëm të tregut, është i nevojshëm procesi efikas, komunikues dhe koordinues ndërmjet autoriteteve kombëtare kompetente, i cili arrihet përmes masave të vendosura nga ESMA.

125. Samiti i G20-ës në Pitsburg më 25 shtator 2009, ra dakord për përmirësimin e rregullores, funksionimin dhe transparencën e tregjeve financiare dhe të mallrave bazë, për adresimin e luhatshmërive në teprinë e çmimit të mallrave. Komunikatat e Komisionit, datë 28 tetor 2009, "Për funksionimin më të mirë të zinxhirit të furnizimit ushqimor në Evropë", dhe datë 2 shkurt 2011, "Për trajtimin e sfidave në tregjet e mallrave bazë dhe të lëndëve të para", paraqitën masat që do të ndërmerren në kontekstin e rishikimit të Direktivës 2004/39/KE. Në shtator të vitit 2011, Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë botoi parimet për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të instrumenteve derivative të mallrave me përdorim të gjerë. Këto parime u nënshkruan nga samiti i G20-ës në Kanë më 4 nëntor 2011, i cili bëri thirrje për t'i caktuar rregullatorëve të tregut kompetencat formale të administrimit të pozicioneve, duke përfshirë kompetencën e caktimit ex ante, aty ku është e përshtatshme, të kufijve të lejueshëm për pozicionet.

126. Kompetencat në dispozicion të autoriteteve kompetente duhet të plotësohen me kompetencat eksplicite për marrjen e informacionit nga çdo person, në lidhje me volumin dhe qëllimin e pozicioneve në kontratat e instrumenteve derivative, në lidhje me mallrat, dhe për t'u kërkuar personave të ndërmarrin hapa për të reduktuar volumin e pozicionit në kontratat e instrumenteve derivative.

127. Për garantimin e koordinimit dhe konsistencës më të lartë në zbatimin e marrëveshjes së G20-ës, nevojitet një regjim i harmonizuar i kufijve të lejueshëm për pozicionet, në veçanti për kontratat e tregtuara në Bashkimin Evropian. Kështu, autoriteteve kompetente duhet t'u jepen kompetenca eksplicite për vendosjen e kufijve, në bazë të metodologjisë së vendosur nga ESMA, për pozicionin që mund të mbajë çdo person, në një nivel të agreguar grupi, në një kontratë të instrumenteve derivative, në lidhje me mallra, në çdo kohë, me qëllim parandalimin e abuzimit të tregut, qoftë edhe relativisht, si dhe për mbështetjen e vendosjes së rregullt të çmimeve dhe të kushteve të shlyerjes, duke përfshirë parandalimin e pozicioneve që

shtrembërojnë tregun. Këto kufij duhet të nxisin integritetin e tregut në lidhje me instrumentin derivativ dhe mallrat bazë, pa cenuar zbulimin e çmimit për artikujt bazë të tregut, dhe nuk duhet të zbatohet për pozicionet, që në mënyrë objektive pakësojnë rreziqet e drejtpërdrejta të aktiviteteve tregtare në lidhje me artikujt. Gjithashtu, duhet të qartësohet dallimi ndërmjet kontratave spot të mallrave dhe kontratave të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë. Për arritjen e regjimit të harmonizuar, është e përshtatshme që ESMA të monitorojë zbatimin e kufijve të lejueshëm për pozicionet, dhe që autoritetet kompetente të vendosin në zbatim masa bashkëpunimi, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave përkatëse me njëri-tjetrin, si dhe lejinin e monitorimit dhe të zbatimit të kufijve përkatës.

128. Të gjitha vendet që ofrojnë tregtimin e derivateve të mallrave me përdorim të gjerë, kryejnë kontrollet e përshtatshme të administrimit të pozicioneve, të paktën duke siguruar kompetencat e nevojshme të monitorimit dhe të aksesit të informacionit në lidhje me pozicionet e derivateve të mallrave me përdorim të gjerë, për të kërkuar reduktimin ose mbylljen e këtyre pozicioneve, si dhe për të kërkuar kthimin e likuiditetit në treg, për zbutjen e efekteve të pozicioneve me volum të lartë ose atyre dominuese. ESMA duhet të ruajë dhe të botojë listën përmbledhëse, me përmbajtje të kufijve të lejueshëm për pozicionet dhe kontrollet e hyra në fuqi, në lidhje me administrimin e pozicioneve. Këto kufij dhe marrëveshje duhet të zbatohen në mënyrë konsistente dhe të marrin në konsideratë veçoritë specifike të tregun në fjalë. Ato duhet të përcaktohen qartësisht në lidhje me mënyrën e zbatimit dhe sipas pragjeve sasiore, të cilat përbëjnë kufijtë, ose të cilat aktivizojnë detyrime të tjera.

129. Vendet e tregtimit duhet të bëjnë publik, një herë në javë, kategorizimin e agreguar të pozicioneve të mbajtura nga kategoritë e ndryshme të personave, për kontrata të ndryshme të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë, kuotat e shkarkimeve, dhe derivatet e tyre, të cilat tregtohen në këto platforma. Autoritetit përgjegjës, të paktën një herë në ditë, duhet t'i vihet në dispozicion ndarja e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse e pozicioneve të mbajtura nga të gjithë personat. Masat e marra për raportimin sipas kësaj direktive duhet të marrin në konsideratë, aty ku është e zbatueshme, kërkesat raportuese tashmë të vendosura sipas nenit 8 të Rregullores (BE) nr. 1227/2011.

130. Gjatë përcaktimit të metodologjisë së llogaritjes së zhvillimit të derivateve të reja të mallrave me përdorim të gjerë, ESMA duhet të garantojë moskufizimin e regjimit të kufijve të lejueshëm për pozicionet, ndërkohë që metodologjia e përdorur në llogaritjen e kufijve të lejueshëm për pozicionet, nuk krijon barriera ndaj zhvillimit të derivateve të reja të mallrave me përdorim të gjerë.

131. Kufijtë e lejueshëm për pozicionet duhet të caktohen për çdo kontratë të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë. Për shmangien e anashkalimeve në regjimin e kufijve të lejueshëm për pozicionet, ESMA duhet të garantojë, përmes zhvillimit të vazhdueshëm të kontratave të reja të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë, parandalimin e çdo anashkalimi sipas kësaj metodologjie, duke marrë në konsideratë interesin e hapur dhe të përgjithshëm, për të njëjtat mallra bazë, të derivateve të tjera të mallrave me përdorim të gjerë.

132. Preferohet lehtësimi i aksesit të kapitalit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të), si dhe lehtësimi i mëtejshëm i zhvillimit të tregjeve të specializuara, të cilat synojnë mbulimin e nevojave të emetuesve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto tregje, të cilat

operohen si MTF sipas kësaj direktive, njihen zakonisht si tregje në rritje të SME-ve, tregje në rritje ose tregje të reja. Krijimi i një nënkategorie të re të tregjeve në rritje të SME-ve brenda kategorisë së MTF-së, dhe regjistrimi i këtyre tregjeve duhet të rrisë shikueshmërinë dhe profilin e tyre, dhe të ndihmojë në zhvillimin e standardeve rregullatore të përbashkëta në Bashkimin Evropian, në lidhje me këto tregje. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës së nxitjes dhe promovimit të mëtejshëm të përdorimit të tregut përmes rregullores së ardhshme, me qëllim tërheqjen e investitorëve dhe sigurimin e uljes së ngarkesave administrative dhe nxitjes së mëtejshme të aksesit të SME-ve në tregjet kapitale përmes tregjeve në rritje të SME-ve.

133. Kërkesat e zbatueshme për këtë kategori të re të tregjeve janë të nevojshme për sigurimin e fleksibilitetit të mjaftueshëm, në lidhje me konsiderimin e gamës aktuale të modeleve të suksesshme të tregjeve ekzistuese në mbarë Evropën. Ato gjithashtu duhet të arrijnë balancën e duhur ndërmjet ruajtjes së niveleve të larta të mbrojtjes së investitorit, si e nevojshme për nxitjen e besimit të investitorit mbi çështjet e lidhura me këto tregje, dhe për reduktimin e barrëve të panevojshme administrative për emetuesit e këtyre tregjeve. Propozohet përshkrimi i mëtejshëm për detaje të mëtejshme të akteve të deleguara ose të standardeve teknike, që lidhen me tregun në rritje të SME-ve, si ato të lidhura me kriteret e pranimi për tregtim në këto tregje.

134. Duke pasur parasysh rëndësinë e mosndikimit negativ në tregjet e suksesshme ekzistuese, operatorëve të tregjeve, të cilët synojnë emetuesit e vegjël dhe të mesëm, duhet t'i jepet mundësia e zgjedhjes për vazhdimin e operimit në këto tregje në përputhje me kërkesat sipas kësaj direktive, pa pasur nevojë të regjistrohen si një treg në rritje i SME-ve. Emetuesit, që janë SME, nuk detyrohen të aplikojnë për pranimin e instrumenteve të tyre financiare për tregtim në një treg në rritje të SME-ve.

135. Për të përfituar SME-të, 50% e emetuesve të kategorisë së re të tregjeve, instrumentet e të cilëve tregtohen në tregun në rritje të SME-ve, duhet të jenë SME. Ky vlerësim kryhen në bazë vjetore. Kriteri i 50% duhet të zbatohet në mënyrë të përshtatshme. Nëse ka mundësi të arsyeshme për arritjen e kriterit 50% për vitin pasardhës, mosarritja e përkohshme e kriterit nuk nënkupton çregjistrim të menjëhershëm ose refuzim të regjistrimit të vendit tregtar si treg në rritje i SME-ve. Vlerësimi i përcaktimit nëse emetuesi është një sipërmarrje SME, duhet të bazohet në kapitalizimin e tregut për tre vitet e mëparshme kalendarike. Kjo gjë garanton tranzicion më të butë të këtyre emetuesve nga tregjet e specializuara drejt tregjeve kryesore.

136. Çdo informacion konfidencial, i marrë nga pika e kontaktit e një shteti anëtar përmes pikës së kontaktit të një shteti tjetër anëtar, nuk duhet të konsiderohet me karakter thjesht dhe vetëm të brendshëm.

137. Është i nevojshëm përmirësimi i konvergencës së fuqive në dispozicion të autoriteteve kompetente, me qëllim lejimin e intensitetit të barasvlershëm të zbatimit në të gjithë tregun e integruar financiar. Efikasiteti mbikëqyrës duhet të garantohet përmes grupit minimal të përbashkët të kompetencave. Kështu, kjo direktivë duhet të sigurojë grupin minimal të kompetencave mbikëqyrëse dhe hetuese, të cilat u besohen autoriteteve kompetente të shteteve anëtare, në përputhje me të drejtën e brendshme. Këto kompetenca duhet të ushtrohen, aty ku ato lejohen sipas të drejtës së brendshme, përmes aplikimit pranë autoriteteve kompetente. Gjatë ushtrimit të kompetencave sipas kësaj direktive, autoritetet kompetente duhet të veprojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme, dhe të qëndrojnë të pavarur gjatë marrjes së vendimeve.

138. Ndërsa direktiva specifikon grupin minimal të kompetencave të autoriteteve kompetente, këto kompetenca ushtrohen brenda sistemit të plotë të së drejtës së brendshme, e cila garanton respektimin e të drejtave themelore, duke përfshirë të drejtën e privatësisë. Për ushtrimin e këtyre kompetencave, të cilat mund të rezultojnë në konflikte të rënda me të drejtën e respektimit të jetës private dhe atë familjare, të vendbanimit dhe të komunikimit, shtetet anëtare duhet të caktojnë masat e përshtatshme dhe efikase ndaj çdo abuzimi, për shembull aty ku duhet, autorizimin paraprak të autoriteteve gjyqësore për shtetin anëtar përkatës. Shtetet anëtare duhet t'i lejojnë autoriteteve kompetente mundësinë e ushtrimit të kompetencave të tilla ndërhyrëse, në masën e nevojshme për investigimin e duhur të rasteve serioze, në të cilat nuk disponohen mjete të barasvlershme për arritjen efikase të të njëjtit rezultat.

139. Asnjë veprim i marrë nga autoriteti përgjegjës ose ESMA gjatë zbatimit të detyrave të tyre nuk duhet të diskriminojë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi shtetin anëtar ose grupin e shteteve anëtare si një vend ofrues të shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit, si vendi i ofrimit, sipas çdo valute, të shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit.

140. Duke pasur parasysh ndikimin e rëndësishëm dhe pjesën e tregut të përvetësuar nga MTF të ndryshme, është me vend garantimi i caktimit të marrëveshjeve të përshtatshme të bashkëpunimit ndërmjet autoritetit përgjegjës të MTF-së dhe atij juridiksioni, në të cilin MTF-ja ofron shërbimet. Për të parashikuar zhvillimet e ngjashme, kjo duhet të shtrihet edhe në platformat e përbashkëta të tregtimit.

141. Për garantimin e përputhjes së shoqërive të investimit, operatorëve të tregut, të autorizuar për operimin e MTF-së ose të platformës së përbashkët të tregtimit, të skemave të publikimit të miratuar, të ofruesve të QSHKE-së, ose të Mekanizmave të Raportimit të Pavarur (MRP-ve), të atyre që kontrollojnë me efikasitet veprimtarinë e tyre, dhe të anëtarëve të shoqërive të investimit dhe të organit drejtues të tregjeve të rregulluara, me detyrimet rrjedhëse nga kjo direktivë dhe nga Rregullorja (BE) nr. 600/2014, si dhe për garantimin e nënshtrimit të tyre ndaj trajtimit të ngjashëm në të gjithë Bashkimin Evropian, shteteve anëtare u kërkohet sigurimi i sanksioneve dhe masave efikase, proporcionale dhe parandaluese. Sanksionet administrative dhe masat e përcaktuara nga shtetet anëtare duhet të përmbushin disa kërkesa thelbësore në lidhje me të adresuarit, kriteret e marra në konsideratë gjatë zbatimit të sanksionit ose masës, botimin, kompetencat bazë për vendosjen e sanksioneve dhe nivelet e gjobave administrative.

142. Në veçanti, autoriteteve kompetente duhet t'i jepet kompetenca e caktimit të gjobave mjaftueshmërisht të larta për reduktimin e përfitimeve të prishme dhe për parandalimin, duke përfshirë rastet e institucioneve të mëdha dhe të menaxherëve të tyre.

143. Është e nevojshme që autoritetet kompetente, në përputhje me të drejtën e brendshme dhe me Kartën, të kenë aftësinë e aksesit në ambientet e personave fizike ose juridike. Aksesi në këto ambiente është i nevojshëm në rastin kur ka dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e dokumenteve dhe të dhënave të tjera, që lidhen me çështjen në fjalë të investigimit, si të rëndësishme për të provuar një shkelje të kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014. Përveç kësaj, aksesi në këto ambiente është i nevojshëm në rastin kur personi, të cilit i është kërkuar informacioni, nuk arrin të veprojë në përputhje me këtë kërkesë, plotësisht ose pjesërisht; ose në rastin kur ka baza të arsyeshme për të besuar mospërputhjen e kërkesës së

mundshme, ose heqjen, abuzimin apo shkatërrimin e informacionit në lidhje me kërkesën për informacion. Nëse, në përputhje me të drejtën e brendshme, kërkohet autorizimi paraprak i autoritetit gjyqësor për shtetin anëtar përkatës, kjo kompetencë e aksesit të ambienteve duhet të përdoret pas marrjes paraprake të autorizimit gjyqësor.

144. Regjistrimet ekzistuese të bisedave telefonike dhe të qarkullimit të të dhënave për shoqëritë e investimit që ekzekutojnë dhe dokumentojnë ekzekutimin e transaksioneve, si dhe regjistrimet ekzistuese telefonike dhe qarkullimit të të dhënave për operatorët e telekomunikacionit, përbëjnë evidencën thelbësore dhe ndonjëherë të vetmen evidencë për zbulimin dhe për të provuar ekzistencën e abuzimeve në treg, si dhe për verifikimin e përputhjes së shoqërive me kërkesat e mbrojtjes së investitorit dhe me kërkesat e tjera të përcaktuara në këtë direktivë ose në Rregulloren (BE) nr. 600/2014. Kështu, autoritetet kompetente duhet të jenë të afta të kërkojnë regjistrime ose bisedat telefonike ekzistuese, komunikimet elektronike dhe qarkullimin e të dhënave të trafikut në dispozicion të shoqërive të investimit ose të institucioneve kredituese. Aksesit në të dhënat dhe regjistrimet telefonike është i nevojshëm për zbulimin dhe penalizimin e abuzimit të tregut ose të shkeljeve të kërkesave të përcaktuara në këtë direktivë ose në Rregulloren (BE) nr. 600/2014.

Për prezantimin e rregullave të barabarta në Bashkimin Evropian, në lidhje me aksesin në regjistrimet telefonike ose ato ekzistuese të trafikut të të dhënave në dispozicion të operatorit të telekomunikacionit ose regjistrimet ekzistuese telefonike ose të qarkullimit të të dhënave në dispozicion të shoqërisë së investimit, autoritetet kompetente duhet, në përputhje me të drejtën e brendshme, të kërkojnë regjistrime ekzistuese telefonike ose të të dhënave të trafikut që disponohen nga operatori i telekomunikacioneve, në masën e lejuar sipas të drejtës së brendshme dhe regjistrimet apo bisedat telefonike ekzistuese, si dhe qarkullimin e të dhënave në dispozicion të shoqërisë së investimit, në rastet e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, në lidhje me rëndësinë e çështjes në fjalë të inspektimit ose të investigimit, duke provuar sjelljen e ndaluar sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014 ose shkeljet e kërkesave sipas kësaj direktive ose sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014. Aksesit në regjistrimet telefonike dhe qarkullimin e të dhënave në dispozicion të operatorit të telekomunikacionit nuk duhet të përfshijë përmbajtjen e komunikimeve zanore me anë të telefonit.

145. Për garantimin e zbatimit konsistent të sanksioneve në të gjithë Bashkimin Evropian, shteteve anëtare u kërkohet të sigurojnë se autoritetet kompetente konsiderojnë të gjitha rrethanat përkatëse, gjatë përcaktimit të llojit të sanksioneve administrative ose të masave dhe të nivelit të gjobave administrative.

146. Për garantimin e efektit parandalues të vendimeve të marra nga autoritetet kompetente për publikun e gjerë, ato zakonisht duhet të publikohen. Publikimi i vendimeve gjithashtu shërben si mjet i rëndësishëm i autoriteteve kompetente për informimin e pjesëmarrësve në treg në lidhje me llojin e sjelljes, që konsiderohet si shkelje e kësaj direktive, si dhe për promovimin e gjerë të sjelljes pozitive të pjesëmarrësve në treg. Nëse publikimi shkakton dëme joproporcionale te personat e përfshirë, rrezikon stabilitetin e tregjeve financiare ose investimet e vazhdueshme, autoriteti përgjegjës publikon, në mënyrë anonime, sanksionet dhe masat në përputhje me të drejtën e brendshme ose vonon datën e publikimit të tyre.

Autoriteteve kompetente duhet t'i jepet mundësia e publikimit të sanksioneve, në rastin kur publikimi anonim ose i vonuar konsiderohet i pamjaftueshëm për garantimin e shmangies së rrezikut të mundshëm të stabilitetit të tregjeve financiare. Në rastin e publikimit joproportional, autoriteteve kompetente nuk i kërkohet publikimi i masave, të cilat konsiderohen të lehta. Është e përshtatshme që ESMA-s t'i sigurohet mekanizmi i raportimit të sanksioneve, në mënyrë që autoritetet kompetente t'i marrin në konsideratë gjatë mbikëqyrjes së vazhdueshme. Kjo direktivë nuk e kërkon, por duhet të parandalojë nxjerrjen e sanksioneve penale të vendosura në lidhje me shkeljet e kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

147. Për zbulimin e shkeljeve të mundshme, autoritetet kompetente duhet të zotërojnë kompetencat e nevojshme, si dhe të caktojnë mekanizmat efikase dhe të besueshme, për inkurajimin e raportimit të shkeljeve të mundshme ose aktuale, duke përfshirë mbrojtjen e punonjësve, të cilët raportojnë shkeljet në institucionet e tyre. Këto mekanizma nuk duhet të cenojnë masat mbrojtëse të mjaftueshme për personat e akuzuar. Për garantimin e mbrojtjes së përshtatshme të një personi të akuzuar, duhet të vendosen procedurat e përshtatshme, veçanërisht në lidhje me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të atij personi, si dhe procedurat e sigurimit të të drejtës së mbrojtjes dhe dëgjësës së personit të akuzuar, para miratimit të vendimit që lidhet me të, si dhe me të drejtën e kërkimit të zgjidhjes efektive para gjykatës kundër një vendimi të lidhur me të.

148. Kjo direktivë duhet t'i referohet sanksioneve dhe masave, me qëllim mbulimin e të gjitha veprimeve të zbatuara pas shkeljes, të cilat kanë qëllim parandalimin e shkeljeve të mëtejshme, pavarësisht të kualifikimit të tyre si sanksion ose masë kundër të drejtës së brendshme.

149. Kjo direktivë nuk cenon asnjë dispozitë ligjore të shtetit anëtar që lidhet me sanksionet penale.

150. Edhe pse asgjë nuk ndalon shtetet anëtare të përcaktojnë rregulla e sanksioneve administrative dhe penale për të njëjtat shkelje, shteteve anëtare nuk u kërkohet përcaktimi i rregullave të sanksioneve administrative, të cilat i nënshtrohen të drejtës kombëtare penale që lidhen me shkeljet e kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014. Në përputhje me të drejtën e brendshme, shtetet anëtare nuk detyrohen të vendosin njëkohësisht sanksione administrative dhe penale për të njëjtën shkelje, por kjo bëhet e mundur në rastin kur e drejta e brendshme e lejon këtë veprim. Megjithatë, mirëmbajtja e sanksioneve penale në vend të sanksioneve administrative, në lidhje me shkeljet e kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014, nuk ul ose nuk ndikon ndryshe aftësinë e autoriteteve kompetente ndaj bashkëpunimit, aksesit dhe shkëmbimit të informacionit në kohën e përshtatshme me autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare, sipas qëllimit të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014, duke përfshirë çdo referim të shkeljeve përkatëse pranë autoriteteve kompetente juridike.

151. Me synim mbrojtjen e klientëve dhe pa cenuar të drejtën e konsumatorëve për ndërmarrjen e veprimeve para gjykatave, është e përshtatshme që shtetet anëtare të garantojnë themelimin e organeve publike ose private, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatë, për bashkëpunimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkuftare, duke marrë në konsideratë Rekomandimin e Komisionit 98/257/KE dhe Rekomandimin e Komisionit 2001/310/KE. Gjatë zbatimit të dispozitave për mosmarrëveshjet dhe procedurat e ankimit për

zgjidhjet jashtë gjykatë, shtetet anëtare duhet të inkurajohen të përdorin mekanizma të bashkëpunimit ndërkuftar, në veçanti rrjetin për zgjidhjen gjyqësore të mosmarrëveshjeve ndërkuftare lidhur me shërbimet financiare (FIN-Net).

152. Çdo shkëmbim ose transmetim i informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente, autoriteteve të tjera, organeve ose personave, duhet të jetë në përputhje me rregullat e transferimit të të dhënave personale në vende të treta, të përcaktuara në Direktivën 95/46/KE. Çdo shkëmbim ose transmetim i të dhënave personale të ESMA-s në vendet e treta duhet të përputhet me rregullat për transferimit e të dhënave personale, të përcaktuara në Rregulloren (KE) nr. 45/2001.

153. Është e nevojshme që të përforcohen dispozitat mbi shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente kombëtare dhe të përmirësohen detyrat e dhënies së asistencës dhe të bashkëpunimit, si detyrim ndaj njëri-tjetrit. Për shkak të rritjes së aktivitetit ndërkuftar, autoritetet kompetente duhet t'i sigurojnë njëri-tjetrit informacionin në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre përkatëse, me qëllim garantimin e zbatimit efikas të kësaj direktive, duke përfshirë rrethanat, në të cilat shkeljet ose shkeljet e dyshuara mund t'i interesojnë autoriteteve në dy ose më shumë shtete anëtare. Gjatë shkëmbimit të informacionit kërkohet ruajta e sekretit profesional për të garantuar transmetimin e rregullt të informacionit dhe mbrojtjen e të drejtave të caktuara.

154. Nëse operimi në vendin e tregtimit që cakton marrëveshje me shtetin anëtar pritës, përbën tashmë rëndësi thelbësore për funksionimin e tregut të letrave me vlerë dhe për mbrojtjen e investitorëve në atë vend anëtar pritës, vendosja e marrëveshjeve proporcionale të bashkëpunimit gjen formën e përshtatshme ndër modalitetet e mundshme të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente të vendit të origjinës dhe shteteve anëtare pritëse, proporcionale ndaj nevojave për bashkëpunimin mbikëqyrëse ndërkuftar, veçanërisht si rrjedhojë e natyrës dhe shkallës së ndikimit të tregjet e letrave me vlerë dhe të mbrojtjes së investitorit në shtetin anëtar pritës, si ndarjet e posaçme ose periodike e informacionit, këshillimi dhe mbështetja.

155. Për arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë direktivë, kompetencat e miratimit të akteve në përputhje me nenin 290 të TFBE-së duhet t'i delegohen Komisionit, në lidhje me detajet e përjashtimeve, qartësimin e përkufizimeve, kriteret e vlerësimit të blerjeve të propozuara të shoqërive të investimit, kërkesat organizative ndaj shoqërive të investimit, ndaj skemave të publikimit të miratuar dhe ndaj ofruesve të QSHKE-ve, menaxhimin e konflikteve të interesit, detyrimet e ushtrimit të veprimtarive për ofrimin e shërbimeve të investimit, ekzekutimin e urdhrave sipas kushteve më të favorshme për klientin, trajtimin e urdhrave të klientit, transaksionet me kundërpalët e tjera të kualifikuara, rrethanat nxitëse të kërkesës për informacion të shoqërive të investimit ose të operatorëve të tregut, të cilët operojnë një MTF ose një platformë të përbashkët të tregtimit, dhe për operatorët e tregut të rregulluar. Këto kompetenca delegohen gjithashtu në lidhje me rrethanat e mundshme që cenojnë rëndë interesat e investitorit dhe funksionimin e rregullt të tregut, me qëllim pezullimin dhe çregjistrimin e instrumenteve financiare nga tregtimi në MTF, në platformën e përbashkët të tregtimit ose në tregun e rregulluar, të tregjeve në rritje të SME-ve, pragjet mbi të cilat zbatohet raportimi i detyrimeve dhe kriteret, sipas të cilave operacionet e vendit të tregtimit në shtetin anëtar pritës konsiderohen mjaft të rëndësishme për funksionimin e tregjeve të letrave me vlerë dhe për

mbrojtjen e investitorëve. Është shumë e rëndësishme që gjatë punës së tij përgatitore Komisioni të kryejë konsultimet e duhura, duke përfshirë ato në nivel ekspertësh. Komisioni, gjatë përgatitjes dhe hartimit të akteve të deleguara, duhet të sigurojë një transmetim të njëkohshëm, në kohën dhe mënyrën e duhur, të dokumenteve përkatëse pranë Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

156. Standardet teknike të shërbimeve financiare duhet të garantojnë harmonizimin konsistent dhe mbrojtjen e përshtatshme të investitorëve, duke përfshirë investimet në depozitat e strukturuar dhe konsumatorët e të gjithë Bashkimit Evropian. Si organ tepër i specializuar i ekspertizës, është efikase dhe e përshtatshme që ESMA-s t'i besohet përpunimi i projektit rregullator dhe zbatimi i standardeve teknike, të cilat nuk përfshijnë zgjedhjet e politikave, që i dërgohen Komisionit. Për garantimin e mbrojtjes konsistente të investitorit dhe të konsumatorit në sektorët e shërbimit financiar, ESMA duhet të kryejë detyrat e saj, për sa është e mundur, për bashkëpunim e ngushtë me Autoritetin mbikëqyrës Evropian (Autoriteti Bankar Evropian), të themeluar përmes Rregullores (KE) nr. 1093/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe me EIOPA-n.

157. Komisioni duhet të miratojë draft standardet teknike rregullatore që zhvillohen nga ESMA në lidhje me përjashtimet për: aktivitetet që konsiderohen si ndihmëse ndaj aktivitetit kryesor; informacionin e siguruar dhe kërkesat e caktuara në kontekstin procedural të dhënies dhe të refuzimit të kërkesave për autorizimin e shoqërive të investimit; blerjen e sipërmarrjes influencuese; tregtimin algoritmik; detyrimin ndaj ekzekutimit të urdhrave sipas kushteve më të favorshme për klientët; pezullimin dhe çregjistrimin e instrumenteve financiare nga tregtimi në tregun e rregulluar, në MTF-në ose në platformën e përbashkët të tregtimit; lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe të aktiviteteve të investimit; themelimin e një dege; fleksibilitetin e sistemeve, ndërprerësit e veprimtarisë së sigurimeve dhe tregtimin elektronik; çmimet e shprehura në njësi; sinkronizimin e orarit të ushtrimit të aktivitetit; pranimin e tregtimit të instrumenteve financiare; kufijtë e lejueshëm të pozicioneve dhe të kontrolleve të administrimit të pozicioneve për derivatet e mallrave me përdorim të gjerë; procedurat e dhënies dhe të refuzimit të kërkesave për autorizimin e ofruesve të shërbimeve të raportimit të të dhënave; kërkesat organizative të skemave të publikimit të miratuar, ofruesit e QSHKE-ve dhe të MRP-së, si dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente. Komisioni duhet të miratojë draft standardet teknike rregullatore, përmes akteve të deleguara sipas nenit 290 të TFBE-së, dhe në përputhje me nenin 10 deri 14 të Rregullores (BE) nr. 1093/2010.

158. Komisionit duhet gjithashtu t'i jepet kompetenca e miratimit të zbatimit të standardeve teknike përmes akteve zbatuese, sipas nenit 291 të TFBE-së dhe në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010. Projekti për zbatimin e standardeve teknike për t'ju dorëzuar Komisionit duhet t'i besohet ESMA-s lidhur me: procedurat e dhënies ose të refuzimit të kërkesave për autorizimin e shoqërive të investimit; blerjen e sipërmarrjes influencuese; procesin e tregtimit për finalizimin e transaksioneve me MTF-të dhe platformat e përbashkëta të tregtimit; pezullimin dhe çregjistrimin e instrumenteve financiare nga tregtimi; lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe të aktiviteteve; themelimin e një dege; raportimin e pozicioneve nga titullarët e pozicioneve; procedurat e dhënies dhe të refuzimit të autorizimit; procedurat dhe mënyrat për dorëzimin e informacionit lidhur me botimin e vendimeve; detyrimin e bashkëpunimit; bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve; shkëmbimin e informacionit dhe të këshillimeve përpara autorizimit nga shoqëria e investimit.

159. Komisioni duhet t'i dorëzojë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport mbi vlerësimin dhe funksionimin e platformave të përbashkëta të tregtimit, funksionimin e regjimit të tregjeve në rritje të SME-ve, mbi ndikimin e kërkesave në lidhje me tregtimin e automatizuar dhe me frekuencë të lartë, eksperiencën në lidhje me mekanizmin e përjashtimit të produkteve të caktuara ose të praktikave, dhe mbi ndikimin e masave në lidhje me tregjet e derivateve të mallrave me përdorim të gjerë.

160. Deri më 1 janar 2018, Komisioni duhet të përgatisë raportin vlerësues të ndikimit të mundshëm të çmimeve në sektorin e energjisë dhe të funksionimit të tregut të energjisë në lidhje me afatin e periudhës kalimtare të parashikuar, me qëllim zbatimin e detyrimit të klerimit dhe të kërkesave për marzhet, të përcaktuara sipas Rregullores (BE) nr. 648/2012. Nëse është e nevojshme, Komisioni duhet të dorëzojë propozimin ligjor të krijimit ose ndryshimit të ligjit përkatës, duke përfshirë legjislacionin specifik sipas sektorit, si Rregullorja (BE) nr. 1227/2011.

161. Direktiva 2011/61/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lejon shtetet anëtare të autorizojnë administruesit e fondeve alternative të investimit (AIFM-të) për ofrimin e shërbimeve të caktuara të investimit, duke përfshirë administrimin kolektiv të fondeve alternative të investimit (AIF-ve) dhe shërbimet e administrimit të portofolit për investimet, këshillat e investimit, ruajtjen dhe administrimin në lidhje me aksionet ose kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe për marrjen dhe transmetimin e urdhrave në lidhje me instrumentet financiare. Duke qenë se kërkesat që rregullojnë ofrimin e këtyre shërbimeve janë të harmonizuara brenda Bashkimit Evropian, AIFM-të e autorizuar nga autoritetet kompetente të shtetit të tyre, në lidhje me ofrimin e shërbimeve, nuk duhet t'i nënshtrohen autorizimeve shtesë të shteteve anëtare, apo ndonjë mase tjetër me efekt të njëjtë.

162. Sipas kuadrit ligjor aktual, AIFM-të e autorizuar për sigurimin e këtyre shërbimeve të investimit, dhe që synojnë ofrimin e tyre për shtetet anëtare, të ndryshme nga vendi i origjinës, duhet të përmbushin kërkesat e shtuara kombëtare, duke përfshirë caktimin veçmas të subjektit juridik. Për shmangien e pengesave ndërkufitare në ofrimin e shërbimeve të harmonizuara të investimit dhe për garantimin e rregullave të barabarta ndërmjet subjekteve që ofrojnë të njëjtat shërbime të investimit sipas të njëjtave kërkesa ligjore, AIFM-të e autorizuar për ofrimin e këtyre shërbimeve, që i nënshtrohen kërkesave për njoftim, duhet të jenë në gjendje t'i ofrojnë sipas shtrirjes ndërkufitare dhe autorizimit të dhënë nga autoritetet kompetente të vendit të tyre të origjinës.

163. Për rrjedhojë, Direktiva 2011/61/KE duhet të ndryshohet përkatësisht,

164. Duke qenë se objektivi i kësaj direktive, konkretisht krijimi i tregut të integruar financiar, në të cilin investitorët mbrohen me efikasitet dhe për mbrojtjen e efikasitetit dhe të integritetit të përgjithshëm të tregut, kërkon caktimin e kërkesave të përbashkëta rregullatore në lidhje me shoqëritë e investimit për çdo autorizim të tyre në Bashkimin Evropian, dhe që rregullojnë funksionimin e tregjeve të rregulluara dhe të sistemeve të tjera tregtare me qëllim parandalimin e opacitetit ose çrregullimeve të tregut, të cilat rrezikojnë operimin efikas të sistemit financiar të Bashkimit Evropian në tërësi dhe nuk arrihen mjaftueshëm nga shtetet anëtare, por për arsye të shkallës dhe të efekteve të kësaj direktive, arrihen më mirë në nivel Bashkimi Evropian, Bashkimi Evropian merr masat në përputhje me parimin e subsidiaritit siç përcaktohen në nenin 5 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Në përputhje me parimin e

proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objekti.

165. Duke konsideruar detyrat në rritje të përcaktuara për ESMA-n nga kjo direktivë dhe sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014, Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni duhet të garantojnë vënien në dispozicion të burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

166. Kjo direktivë respekton të drejtat themelore dhe parimet e njohura nga Karta e të Drejtave, në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, lirinë e ushtrimit të aktivitetit, të drejtën e mbrojtjes së konsumatorit, të drejtën e zgjidhjes efikase dhe për gjykim të drejtë, të drejtën për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë në një procedim penal për të njëjtën vepër penale, që zbatohet në përputhje me këto të drejta dhe parime.

167. Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale këshillohet në përputhje me nenin 28, paragrafi 2 të Rregullores (KE) nr. 45/2001, dhe shpreh mendimin e tij më 10 shkurt 2012.

168. Në përputhje me Deklaratën Politike të Përbashkët të Shteteve Anëtare dhe të Komisionit, datë 28 shtator 2011, "Për dokumentet shpjeguese", shtetet anëtare janë angazhuar të shoqërojnë, në raste të argumentuara, njoftimin për masat e tyre të transpozimit me një ose më shumë dokumente ku shpjegohet marrëdhënia ndërmjet komponentëve të një direktive dhe pjesëve përkatëse të instrumentit kombëtar të transpozimit. Në lidhje me këtë direktivë, ligjvënësi e konsideron transmetimin e këtyre dokumenteve si të justifikuar.

169. Detyrimi për transpozimin e kësaj direktive në legjislacionin e brendshëm duhet të kufizohet në ato dispozita që paraqesin ndryshime thelbësore krahasuar me direktiva të mëparshme. Detyrimi për transpozimin e dispozitave të pandryshuara, lind nga direktivat e mëparshme.

170. Kjo direktivë nuk duhet të cenojë detyrimet e shteteve anëtare për afatin kohor për transpozim në legjislacionin e brendshëm dhe zbatimin e direktivave të përcaktuara në shtojcën III, pjesa B.

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

TITULLI I

FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Kjo direktivë zbatohet për shoqëritë e investimit, operatorët e tregut, ofruesit e shërbimeve të raportimit të të dhënave dhe shoqëritë e vendeve të treta, të cilat ofrojnë shërbime investimi ose zhvillojnë aktivitete investimi përmes themelimit të degës brenda Bashkimit Evropian.

2. Kjo direktivë vendos kërkesat në lidhje me sa më poshtë:

a) kushtet e autorizimit dhe operimit të shoqërive të investimit;

b) ofrimin e shërbimeve ose aktiviteteve të investimit për shoqëritë e vendeve e treta, përmes themelimit të një dege;

c) autorizimin dhe operimin e tregjeve të rregulluara;

d) autorizimin dhe operimin e ofruesve të shërbimeve të raportimit të të dhënave; dhe

e) mbikëqyrja, bashkëpunimi dhe zbatimi nga autoritetet kompetente.

3. Dispozitat e mëposhtme zbatohen gjithashtu për institucionet kredituese, gjatë ofrimit të një ose më shumë shërbimeve të investimit dhe/ose kryerjen e aktiviteteve të investimit, të autorizuar sipas Direktivës 2013/36/BE:

a) Neni 2, paragrafi 2, neni 9, paragrafi 3 dhe nenet 14 dhe 16 deri 20,

b) Kapitulli II i titullit II, duke përjashtuar nënparagrafin e dytë të nenit 29, paragrafi 2,

c) Kapitulli III i titullit II, duke përjashtuar nenin 34, paragrafët 2 dhe 3, dhe nenin 35, paragrafët 2 deri në 6 dhe 9,

d) Nenet 67 deri 75 dhe nenet 80, 85 dhe 86.

4. Gjithashtu, dispozitat e mëposhtme zbatohen për shoqëritë e investimit dhe për institucionet kredituese, të autorizuar sipas Direktivës 2013/36/BE, gjatë shitjes ose këshillimit të klientëve në lidhje me depozitat e strukturuara:

a) Neni 9, paragrafi 3, neni 14 dhe neni 16, paragrafi 2, 3 dhe 6;

b) Nenet 23 deri në 26, neni 28 dhe neni 29, duke përjashtuar nënparagrafin e dytë të paragrafit 2 të tij, dhe neni 30; dhe

c) Nenet 67 deri në 75.

5. Neni 17, paragrafi 1 deri në 6 gjithashtu zbatohet për anëtarët ose pjesëmarrësit e tregjeve të rregulluara dhe MTF-të, të cilët nuk është e nevojshme të pajisen me autorizim sipas kësaj direktive, sipas nenit 2, paragrafi 1 germet "a", "e", "i" dhe "j".

6. Nenet 57 dhe 58 gjithashtu zbatohen për personat e përjashtuar sipas nenit 2.

7. Të gjithë sistemet e shumëfishta të instrumenteve financiare operojnë në përputhje, qoftë me dispozitat e titullit II të lidhura me MTF-të, me platformat e përbashkëta të tregimit, ose me dispozitat e titullit III, në lidhje me tregjet e rregulluara.

Çdo shoqëri e investimit që tregon për llogari të saj në mënyrë të organizuar, të shpeshtë, sistematike dhe të konsiderueshme gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit jashtë tregut të

rregulluar, MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregtimit, duhet të veprojë në përputhje me titullin III të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

Pa cenuar nenet 23 dhe 28 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, të gjitha transaksionet në instrumente financiare, të përmendura në nënparagrafin e parë dhe të dytë, të cilat nuk përfundohen në lidhje me sistemet e shumëfishta ose subjektet e brendshme sistematike, duhet të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të titullit III të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

Neni 2

Përfshirjet

1. Kjo direktivë nuk zbatohet për:

a) shoqëritë e sigurimit ose shoqëritë që ushtrojnë veprimtari risigurimi dhe të retrocesioni, të përmendura në Direktivën 2009/138/KE, gjatë ushtrimit së aktiviteteve të përmendura në këtë direktivë;

b) personat që ofrojnë shërbime ekskluzive të investimit për shoqëritë mëmë, për filialet e tyre, ose për filiale të tjera të shoqërive mëmë;

c) personat që ofrojnë shërbime të investimit, të cilat sigurohen në mënyrë rastësore gjatë zhvillimit të aktivitetit profesional, dhe aktivitete të rregulluara përmes dispozitave ligjore ose rregullatore, ose nga kodi i sjelljes që rregullon profesionin, i cili nuk përjashton ofrimin e këtij shërbimi;

d) personat që tregtojnë për llogari të tyre instrumente financiare të ndryshme nga derivatet e mallrave me përdorim të gjerë ose kuotat e shkarkimeve apo derivatet e tyre, të cilët nuk ofrojnë shërbime të tjera të investimit dhe nuk kryejnë aktivitete të tjera të investimit të instrumenteve financiare, të ndryshme nga derivatet e mallrave me përdorim të gjerë ose kuotat e tyre të shkarkimeve, përveç rastit kur ata:

I. janë krijues tregu;

II. janë anëtarë të ose pjesëmarrës në tregun e rregulluar ose në MTF, ose kanë akses të drejtpërdrejtë elektronik në vendin e tregtimit;

III. zbatojnë teknikën e tregtimit algoritmik me shpejtësi të lartë; ose

IV. tregtojnë për llogari të tyre gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit;

Personave të përjashtuar sipas germave "a", "i" ose "j" nuk u kërkohet përmbushja e kushteve të përcaktuara në këtë germë për t'u përjashtuar.

e) operatorët që duhet të përmbushin detyrimet sipas Direktivës 2003/87/KE, të cilët nuk ekzekutojnë urdhrat e klientit dhe nuk ofrojnë shërbime investimi ose aktivitete investimi të ndryshme nga tregtimi për llogari të tyre, gjatë shkëmbimit të kuotave të shkarkimeve, me kusht që të mos zbatohet teknika e tregtimit algoritmik me shpejtësi të lartë;

f) personat që ofrojnë shërbimet e investimit me përmbajtje ekskluzive të administrimit të skemave të pjesëmarrjes së punëmarrësit;

g) personat që ofrojnë shërbime të investimit, të cilat përfshijnë vetëm administrimin e skemave të pjesëmarrjes së punëmarrësit dhe ofrimin e shërbimeve ekskluzive të investimit për shoqëritë mëmë, për filialet e tyre, ose për filialet e tjera të shoqërive mëmë;

h) anëtarët e SEBQ-së dhe të organeve të tjera kombëtare që zbatojnë funksione të ngjashme në Bashkimin Evropian, organet e tjera publike të ngarkuara me, ose të cilat ndërhyjnë në administrimin e borxhit publik në Bashkimin Evropian, si dhe institucionet financiare ndërkombëtare, të themeluara nga një ose më shumë shtete anëtare, të cilat synojnë mobilizimin e fondeve dhe sigurimin e mbështetjes financiare në përfitim të anëtarëve të tyre, të cilët hasin ose kërcënohen nga problemet e rënda financiare;

i) sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe fondet e pensioneve, pavarësisht nëse koordinohen apo jo në nivel Bashkimi Evropian, dhe depozituesit dhe menaxherët e këtyre sipërmarrjeve;

j) personat:

I. që tregtojnë për llogari të tyre, duke përfshirë krijuesit e tregut, derivatet e mallrave me përdorim të gjerë ose kuotat e shkarkimeve, ose derivatet e tyre, duke përjashtuar personat që tregtojnë për llogari të tyre gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit; ose

II. ofrojnë shërbime të investimit, të ndryshme nga tregtimi për llogari të tyre, i derivateve të mallrave me përdorim të gjerë ose i kuotave të shkarkimeve, ose i derivateve të tyre, te konsumatorët ose furnizuesit e aktivitetit të tyre kryesor;

duke qenë se:

— për çdo rast në bazë individuale dhe agregate, ai përbën aktivitet ndihmës për aktivitetin e tyre kryesor, në rastin kur konsiderohet në bazë agregate dhe biznesi kryesor nuk përbën ofrim të shërbimeve të investimit brenda kuptimit të kësaj direktive ose aktiviteteve bankare sipas Direktivës 2013/36/BE, ose kur vepron si krijues tregu në lidhje me derivatet e mallrave me përdorim të gjerë,

— këta persona nuk zbatojnë teknikën e tregtimit algoritmik me shpejtësi të lartë; dhe

— këta persona njoftojnë një herë në vit autoritetin kompetent përkatës në lidhje me përdorimin e këtij përjashtimi dhe, sipas kërkesës, i raportojnë autoritetit kompetent bazën mbi të cilën ata konsiderojnë aktivitetin sipas pikave I dhe II ndihmës për aktivitetin e tyre kryesor;

k) personat që ofrojnë këshilla investimi gjatë ofrimit të një aktiviteti tjetër profesional, të pambuluar nga kjo direktivë, me kusht që ofrimi i këtij këshillimi të mos paguhet në mënyrë specifike;

l) shoqatat e ngritura nga fondet daneze dhe finlandeze të pensionit, me qëllim të vetëm administrimin e aktiveve të fondeve të pensionit për anëtarë të këtyre shoqatave;

m) "agenti di cambio", aktivitetet dhe funksionet e të cilëve rregullohen nga neni 201 i Dekretit Legjislativ Italian nr. 58, datë 24 shkurt 1998;

n) për operatorët e sistemit të transmetimit, të përkufizuar sipas nenit 2, paragrafi 4 të Direktivës 2009/72/KE ose nenit 2, paragrafi 4 të Direktivës 2009/73/KE, gjatë kryerjes së detyrave sipas këtyre direktivave, sipas Rregullores (KE) nr. 714/2009, sipas Rregullores (KE) nr. 715/2009, ose çdo kod apo udhëzimi të rrjetit, të miratuar në përputhje me këto rregullore, çdo person, ofrues i shërbimit në emër të tyre, për kryerjen e detyrave sipas këtyre akteve ligjore, ose sipas kodeve apo udhëzimeve të rrjetit, ose sipas udhëzimeve të miratuara në përputhje me këto rregullore, si dhe çdo operator ose administrues i mekanizmit të balancimit të energjisë, të rrjetit të tubacionit, ose sistemit të ruajtjes së balancës për furnizimet dhe përdorimet e energjisë gjatë kryerjes së këtyre detyrave.

Ky përjashtim zbatohet për personat e angazhuar në aktivitetet e përcaktuara sipas kësaj pike, vetëm në rastin kur ata kryejnë aktivitete ose ofrojnë shërbimeve të investimit në lidhje me derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, me qëllim kryerjen e këtyre aktiviteteve. Ky përjashtim nuk zbatohet në lidhje me operimin e tregut dytësor, duke përfshirë platformën e tregtimit sekondar të të drejtave të transmetimit për shërbimet financiare;

o) Depozitarët qendror për letrat me vlerë, që rregullohen nga ligji i Bashkimit Evropian, në masën që janë rregulluar nga ligji i Bashkimit Evropian.

2. Të drejtat e akorduara nga kjo direktivë nuk zbatohen për kundërpalët, të cilat ofrojnë shërbime të transaksioneve të kryera nga organet publike, që merren me borxhin publik, ose nga anëtarët e SEBQ-së që kryejnë detyrat e tyre siç parashikohet në TFBE dhe në Protokollin nr. 4 për Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, ose që kryejnë funksione të barasvlershme sipas dispozitave kombëtare.

3. Komisioni miraton aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për të sqaruar, për qëllime të gurmës "c" të paragrafit 1, se kur një aktivitet ushtrohet në mënyrë rastësore.

4. ESMA zhvillon draft standardet rregullatore teknike, për të specifikuar, për qëllime të gurmës "j" të paragrafit 1, kriteret sipas të cilave përcaktohet se kur një aktivitet është ndihmës i aktivitetit kryesor në nivel grupi.

Këto kriteret marrin në konsideratë të paktën elementet si më poshtë:

a) nevojën e aktiviteteve ndihmëse për të përbërë një pakicë në aktivitetet në nivel grupi;

b) madhësinë e aktivitetit të tyre tregtar krahasuar me aktivitetin e përgjithshëm në treg për këtë klasë të aktiveve.

Për përcaktimin e masës së mundshme, sipas të cilës aktivitetet ndihmëse në nivel grupi përbëjnë një pakicë, ESMA mund të përcaktojë marrjen në konsideratë të kapitalit të vënë në punë për ushtrimin e veprimtarisë ndihmëse kundrejt kapitalit të vënë në punë për ushtrimin e veprimtarisë kryesore. Megjithatë, ky faktor kurrsesi nuk mund mjaftojë për të provuar se aktiviteti është ndihmës ndaj aktivitetit kryesor të grupit.

Aktivitetet e përmendura në këtë paragraf konsiderohen në nivel grupi.

Elementet e përmendur në paragrafët e dytë dhe të tretë përjashtojnë:

a) transaksionet brenda grupit, siç përmenden në nenin 3 të Rregullores (BE) nr. 648/2012, me qëllim likuiditetin për të gjithë grupin ose për menaxhimin e rrezikut;

b) transaksionet në instrumente derivative, të cilat maten në mënyrë objektive në lidhje me uljen e rrezikut të lidhur drejtpërsëdrejti me aktivitetin tregtar ose me aktivitetin e financimit të thesarit;

c) transaksionet e derivateve të mallrave me përdorim të gjerë dhe kuotat e shkarkimeve, të kryera për përmbushjen e detyrimeve për sigurimin e likuiditetit në një vend tregtimi, në rastin kur këto detyrime kërkohen nga autoritetet rregullatore në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian ose të drejta e brendshme, rregulloret dhe dispozitat administrative, ose nga vendet e tregtimit.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 3

Përjashtime opsionale

1. Shtetet anëtare mund vendosin të mos zbatojnë këtë direktive për çdo person, për të cilët ato janë shteti anëtar i origjinës, me kusht që aktivitetet e këtyre personave të autorizohen dhe të rregullohen në nivel kombëtar dhe këta persona:

a) të mos lejohen të mbajnë fondet e klientit ose tituj të klientit, dhe të cilët, për këtë arsye, nuk lejohen asnjëherë të jenë në debi me klientët e tyre;

b) nuk lejohen të ofrojnë shërbime investimi, përveç marrjes dhe kalimit të urdhrave në titujt e transferueshëm dhe kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe/ose të ofrojnë këshilla investimi për këto instrumente financiare; dhe

c) gjatë ofrimit të këtij shërbimi, lejohen të transmetojnë urdhra vetëm te:

I. shoqëritë e investimit të autorizuar në përputhje me këtë direktivë;

II. institucionet kredituese të autorizuar në përputhje me direktivën 2013/36/BE;

III. degët e shoqërive të investimit ose të institucioneve kredituese, të autorizuar nga vende të treta, të cilat i nënshtrohen dhe përmbushin rregullat e kujdesshme të konsideruara nga

autoritetet kompetente të paktën po aq strikte sa ato të përcaktuara nga kjo direktivë, në Rregulloren (BE) nr. 575/2013 ose në Direktivën 2013/36/BE;

IV. sipërmarrjet e investimeve kolektive të autorizuar sipas ligjit të shtetit anëtar për kuotat e tregut, për publikun dhe për menaxherët e këtyre sipërmarrjeve; ose

V. shoqëritë e investimit me kapital fiks, siç përcaktohet në nenin 17, paragrafi 7 të Direktivës 2012/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, titujt e së cilës renditen ose trajtohen në tregun e rregulluar të shtetit anëtar; ose

d) ofrojnë shërbime ekskluzive të investimit në mallrat me përdorim të gjerë, të kuotave të shkarkimeve dhe/ose të derivateve të tyre, me qëllim të vetëm mbrojtjen e rrezikut tregtar të klientëve të tyre, në rastin kur këta klientë janë sipërmarrje lokale ekskluzive të energjisë elektrike siç përcaktohet në nenin 2, paragrafi 35 të Direktivës 2009/72/KE dhe/ose sipërmarrje të gazit natyror siç përcaktohet në nenin 2, paragrafi 1 të Direktivës 2009/73/KE dhe me kusht zotërimin e përbashkët të këtyre klientëve, me 100% pronësi në kapitalin ose të drejtën e votës, ushtrimin e kontrollit të përbashkët dhe përjashtimin sipas nenit 2, paragrafi 1, germa "j" të kësaj direktive, në rastin kur ata ofrojnë vetë shërbime të investimit; ose

d) ofrojnë shërbime ekskluzive të kuotave të shkarkimeve dhe/ose derivate të tyre vetëm për qëllimin e mbrojtjes së klientëve të tyre nga rreziku tregtar, në rastin kur këta klientë janë operatorë ekskluziv, sipas përcaktimit në nenin 3, germa "f" të Direktivës 2003/87/KE, me kusht zotërimin e përbashkët të këtyre klientëve, me 100% pronësi në kapitalin ose të drejtën e votës, ushtrimin e kontrollit të përbashkët dhe përjashtimin sipas nenit 2, paragrafi 1, germa "j" të kësaj direktive, në rastin kur ata ofrojnë vetë shërbime investimi.

2. Regjimet e shteteve anëtare vendosin për personat e përmendur në paragrafin 1 kërkesa, të cilat janë të paktën të ngjashme me kërkesat e mëposhtme sipas kësaj direktive:

a) kushtet dhe procedurat për autorizimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme, të vendosura nga neni 5, paragrafi 1 dhe 3, nenet 7 deri në 10, 21, 22 dhe 23 dhe nga aktet e deleguara korresponduese, të miratuara nga Komisioni në përputhje me nenin 89;

b) detyrimet për ushtrimin e aktivitetit, të vendosura nga neni 24 paragrafët 1, 3, 4, 5, 7 dhe 10, neni 25 paragrafët 2, 5 dhe 6, dhe, në rastin kur regjimi kombëtar lejon këta persona të emërojnë agjentë të lidhur, sipas nenit 29 dhe masave zbatuese përkatëse;

c) kërkesat organizative të përcaktuara në nenin 16, paragrafi 3, nënparagrafi i parë, i gjashtë dhe i shtatë dhe në nenin 16, paragrafi 6 dhe 7, dhe aktet e deleguara korresponduese të miratuara nga Komisioni në përputhje me nenin 89.

Shtetet anëtare, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, i kërkojnë personave të përjashtuar nga kjo direktivë mbulimin nga skema e kompensimit të investitorit, të njohur në përputhje me Direktivën 97/9/KE. Shtetet anëtare mund t'u lejojnë shoqërive të investimit, që nuk mbulohen nga këto skema, garantimin e mbrojtjes së barasvlershme të klientëve të tyre, në rastin kur ato zotërojnë sigurimin ndaj rreziqeve profesionale, duke marrë në konsideratë madhësinë, profilin e rrezikut dhe formën juridike të personave të përjashtuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Duke deroguar nga nënparagrafi i dytë i këtij paragrafi, shtetet anëtare që kanë në zbatim këto ligje, rregullore ose dispozita administrative para 2 korrikut 2014, mund të kërkojnë, deri më 3 korrik 2019, që kur personat e përjashtuar nga kjo Direktivë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, të ofrojnë shërbimet e investimit të marrjes dhe transferimit të urdhrave dhe ose ofrimin e këshillave të investimit për kuotat në sipërmarrje të investimeve kolektive, dhe të veprojnë si ndërmjetës për shoqëritë administruese siç përcaktohet në Direktivën 2009/65/KE, në rastin kur këta persona janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga klienti, në lidhje me këto shërbime.

3. Personat e përjashtuar nga kjo direktivë në përputhje me paragrafin 1, nuk përfitojnë nga liria e ofrimit të shërbimeve ose nga kryerja e aktiviteteve, ose krijimi i degëve siç parashikohet përkatësisht në nenet 34 dhe 35.

4. Për çdo autorizim të dhënë në përputhje me paragrafin 1, shtetet anëtare njoftojnë Komisionin dhe ESMA-n në lidhje me ushtrimin e opsionit sipas këtij neni, dhe garantojnë që në çdo autorizim të dhënë në përputhje me këtë paragraf 1, të përmendet se ai autorizim është dhënë në përputhje me këtë nen.

5. Shtetet anëtare i komunikojnë ESMA-s dispozitat e së drejtës së brendshme, analoge me kërkesat e kësaj direktive, të renditura në paragrafin 2.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj direktive përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. "shoqëri investimi" është çdo person juridik me profesion ose veprimtari të lidhura me ofrimin e një ose më shumë shërbimeve investimit për palët e treta dhe/ose me zbatimin e një ose më shumë shërbimeve investimit në mënyrë profesionale.

Shtetet anëtare mund të përfshijnë përkufizimin e shoqërive të investimit, që nuk janë persona juridikë, me kusht që:

a) statusi i tyre juridik garanton mbrojtjen e interesave të palëve të treta në nivel të barasvlershëm me atë të ofruar nga personat juridikë; dhe

b) t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme të barasvlershme dhe të përshtatshme për formën e tyre ligjore.

Megjithatë, në rastin kur personi fizik ofron shërbime, duke përfshirë zotërimin e fondeve ose titujve të transferueshëm të palëve të treta, ky person mund të konsiderohet si shoqëri e investimit për qëllime të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014, vetëm në rastin kur ai, pa cenuar kërkesat e tjera të vendosura nga kjo direktivë, nga Rregullorja (BE) nr. 600/2014 dhe Direktiva 2013/36/BE, është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) të drejtat pronësisë së palëve të treta në instrumente dhe fonde duhet të mbrohen, veçanërisht në rastet e falimentimit të shoqërisë ose të pronarëve të saj, konfiskimit, kompensimit, ose çdo veprimi tjetër të kreditorëve ose pronarëve të shoqërisë;

b) shoqëria duhet t'i nënshtrohet rregullave të hartuara për monitorimin e aftësisë paguese të shoqërisë dhe të pronarëve të saj;

c) raportet vjetore të shoqërisë duhet të vlerësohen nga një ose më shumë persona të autorizuar, sipas së drejtës së brendshme, për kontrollin e llogarive;

d) nëse shoqëria ka vetëm një pronar, ky person duhet të parashikojë mbrojtjen e investitorit, në rastet e ndalimit të veprimtarisë së shoqërisë për shkak të vdekjes ose paaftësisë fizike, apo çdo rrethane të ngjashme;

2. "shërbimet dhe aktivitetet e investimit" janë çdo shërbim ose aktivitet i renditur në seksionin A të shtojcës I, në lidhje me çdo instrument të renditur në seksionin C të shtojcës I.

Komisioni miraton aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, për të specifikuar:

a) kontratat derivative të përmendura në seksionin C.6 të shtojcës I me karakteristikat e produkteve të shitjes me shumicë të energjisë, që duhet të parashikojnë dorëzimin fizik" në tregun me shumicë, dhe kontratat e derivateve të energjisë C6;

b) kontratat e derivateve të përmendura në seksionin C.7 të shtojcës I me karakteristikat e derivateve të tjera të instrumenteve financiare;

c) kontratat e derivateve të përmendura në seksionin C.10 të shtojcës I me karakteristikat e derivateve të tjera të instrumenteve financiare, duke konsideruar, ndër të tjera, faktin në lidhje me tregtimin e mundshëm në tregun e rregulluar, në MTF, ose në platformat e përbashkëta të tregtimit;

3. "shërbime ndihmëse" është çdo shërbim i renditur në seksionin B të shtojcës I;

4. "këshillë investimi" është dhënia e rekomandimeve personale një klienti, qoftë sipas kërkesës, apo nismës së shoqërisë së investimit, në lidhje me një ose më shumë transaksione me instrumente financiare;

5. "ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve" është veprimi i lidhjes së marrëveshjeve për blerjen ose shitjen e një ose më shumë instrumenteve financiare në emër të klientëve, dhe përfshin lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e instrumenteve financiare të emetuara nga shoqëria e investimit ose institucioni kreditor në momentin e lëshimit të tyre;

6. "tregtimi për llogari të vet" është tregtimi kundër kapitalit të regjistruar që rezulton në mbylljen e transaksioneve të një ose më shumë instrumenteve financiare;

7. "krijues tregu" është personi i pranishëm vazhdimisht në tregjet financiare, sipas dëshirës për të tregtuar për llogari të tij në blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare kundër kapitalit të regjistruar të atij personi, me çmime të përcaktuara nga ai person;

8. "menaxhim i portofolit" është menaxhimi i portofolit në përputhje me mandatet e dhëna nga klientët, mbi baza diskrecioni ndërmjet klientëve, sipas të cilave portofolat përfshijnë një ose më shumë instrumente financiare;

9. "klient" është çdo person fizik ose juridik, të cilit shoqëria i ofron shërbime investimi ose shërbime ndihmëse;

10. "klient profesionist" është klienti që përmbush kriteret e përcaktuara në shtojcën II;

11. "klienti individ" është klienti që nuk bën pjesë në kategorinë profesionist;

12. "tregjet në rritje të SME-ve" është MTF-ja e regjistruar si treg në rritje i SME-ve, në përputhje me nenin 33;

13. "ndërmarrje të vogla dhe të mesme", për qëllime të kësaj direktive, janë shoqëritë me kapitalizim mesatar të tregut prej më pak se 200 000 000 euro në bazë të kuotimeve të fundvitit për tre vitet kalendarike të mëparshme;

14. "urdhër limit" është urdhri për blerjen ose shitjen e instrumentit financiar në çmimin kufi ose të favorshëm, të specifikuar, dhe sipas madhësisë së caktuar;

15. "instrument financiar" janë instrumentet e përcaktuara në seksionin C të shtojcës I;

16. "kontratat e derivateve të produkteve energjetike C6" janë kontratat e mundësisë (opsionet), kontratat e së ardhmes, kontratat e shkëmbimit, dhe çdo kontratë tjetër e derivateve, e përmendur në seksionin C, pika 6 të shtojcës I, në lidhje me qymyrin ose me naftën e tregtuar në platformën e përbashkët të tregimit, që parashikon dorëzimin fizik;

17. "instrumente të tregut të parasë" janë kategoritë e instrumenteve, që trajtohen zakonisht në tregun e parasë, si bonot e thesarit, certifikatat e depozitave dhe instrumentet e borxhit, dhe duke përjashtuar instrumentet e pagesës;

18. "operator i tregut" është personi ose personat, që menaxhojnë dhe/ose ushtrojnë veprimtarinë e tregut të rregulluar, dhe që mund të përfaqësojnë vetë tregun e rregulluar;

19. "sistem i shumëfishtë" është sistemi ose ambienti, në të cilin palë të treta të shumta që blejnë dhe shesin interesa tregtare në instrumente financiare mund të ndërveprojnë me sistemin;

20. "subjekt i brendshëm sistematik" është shoqëria e investimit, e cila mbi baza të organizuara, të shpeshta, sistematike dhe thelbësore, tregon për llogari të saj gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit jashtë tregut të rregulluar, MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregimit;

Baza e shpeshtë dhe sistematike duhet të matet nga numri i tregtimeve mbi banak (OTC) të instrumentit financiar të trajtuar nga shoqëria e investimit për llogari të saj gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit. Mënyra thelbësore duhet të matet ose përmes tregtimeve mbi banak (OTC) të shoqërisë së investimit në lidhje me tregtimet totale të instrumentit të caktuar financiar të shoqërisë së investimit, ose sipas madhësisë së tregtimeve mbi banak (OTC) të shoqërisë së investimit në lidhje me tregtimet totale të instrumentit të caktuar financiar në Bashkimin

Evropian. Përkufizimi i subjektit të brendshëm sistematik zbatohet vetëm në rastin e tejkalimit të kufijve të paracaktuar në mënyrë të shpeshtë dhe sistematike, si dhe thelbësore, ose në rastin kur shoqëria e investimit zgjedh të përfshihet në regjimin sistematik të subjektit të brendshëm;

21. "treg i rregulluar" është sistemi shumëpalësh i operuar dhe/ose i menaxhuar nga operatori i tregut, i cili bashkon ose lehtëson bashkimin e palëve të treta të shumta, që blejnë dhe shesin interesa të instrumenteve financiare – në sistem dhe në përputhje me rregullat e tij jodiskrecionale – në mënyrë të atillë që sjell lidhjen e kontratës, në lidhje me instrumentet financiare të pranuar për t'u tregtuar sipas rregullave dhe/ose sistemeve të tij, dhe i cili autorizohet dhe funksionon rregullisht dhe në përputhje me titullin III të kësaj direktive;

22. "Platformë shumëpalëshe e tregtimit" ose "MTF" është sistemi i shumëfishtë i operuar nga shoqëria e investimit ose nga operatori i tregut, e cila bashkon palë të ndryshme të treta për blerjen dhe shitjen e interesave të instrumenteve financiare – në këtë sistem dhe në përputhje me rregullat jodiskrecionale – në mënyrë të atillë, duke përfunduar lidhjen e kontratës në përputhje me titullin II të kësaj direktive;

23. "platformë e përbashkët tregtimi" është platforma shumëpalëshe, që nuk është treg i rregulluar ose MTF, dhe në të cilën disa palët të treta, të cilat blejnë ose shesin interesa mbi obligacionet, produktet e strukturuar financiare, kuotat e shkarkimeve ose instrumente derivative, mund të ndërveprojnë në sistem duke arritur lidhjen e kontratës, në përputhje me titullin II të kësaj direktive;

24. "vend tregtimi" është tregu i rregulluar, MTF-ja, ose platforma e përbashkët e tregtimit;

25. "tregu likuid" është tregu i instrumentit financiar ose kategorisë së instrumenteve financiare, ku ndodhen vazhdimisht blerësit dhe shitësit e gatshëm dhe në dispozicion, të vlerësuar në përputhje me kriteret e mëposhtme, duke marrë në konsideratë strukturat e tregut në lidhje me instrumentin e caktuar financiar ose me kategorinë e caktuar të instrumentit financiar:

a) frekuencën mesatare dhe përmasat e transaksioneve sipas gamës së kushteve të mundshme të tregut, duke marrë në konsideratë llojin dhe ciklin e jetës së produktit në kategorinë e instrumentit financiar;

b) numrin dhe llojin e pjesëmarrësve në treg, duke përfshirë raportin e pjesëmarrësve në treg ndaj instrumenteve të tregtuara në produktin e caktuar;

c) madhësinë mesatare të marzheve, aty ku është e mundur;

26. "autoriteti kompetent" është autoriteti, që caktohet nga çdo shtet anëtar në përputhje me nenin 67, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë direktivë;

27. "institucion kredie" është institucioni kreditor sipas përcaktimit në nenin 4, paragrafi 1, pika 1 të Rregullores (KE) nr. 575/2013;

28. "Shoqëria administruese e SIKTT-ve" është shoqëria administruese, siç përcaktohet në germen "b" të nenit 2, paragrafi 1 të Direktivës 2009/65/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

29. "agjent i lidhur" është personi fizik ose juridik, i cili, në përgjegjësinë e plotë dhe të pakushtëzuar të një shoqërie të vetme investimi të përfaqësuar prej tij, nxit shërbime investimi dhe/ose ndihmëse për klientët ose klientët e mundshëm, merr dhe dorëzon udhëzimet e klientit në lidhje me shërbimet e investimit ose me instrumentet financiare, vendos instrumentet financiare, ose ofron këshilla për klientët ose klientët e mundshëm në lidhje me këto instrumente financiare ose shërbime;

30. "degë" është vendi i regjistrimit të veprimtarisë, i ndryshëm nga selia qendrore, që bën pjesë në shoqërinë e investimit, e cila nuk ka personalitet juridik dhe ofron shërbime dhe/ose aktivitete të investimit, dhe gjithashtu mund të kryejë shërbime ndihmëse, për të cilat autorizohet shoqëria e investimit; të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit të ngritura në të njëjtin shtet anëtar nga shoqëria e investimit me zyrë qendrore në një shtet tjetër anëtar konsiderohen si një degë e vetme;

31. "pjesëmarrje influencuese" është pjesëmarrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në një shoqëri investimi, e cila përfaqëson 10% ose më shumë pronësi në kapitalin ose të drejtën e votës, siç përcaktohet në nenet 9 dhe 10 të Direktivës 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, duke marrë në konsideratë kushtet në lidhje me agregimin e tyre, të cilat përcaktohen në nenin 12, paragrafët 4 dhe 5 të kësaj direktive, ose që bën të mundur ushtrimin e një ndikimi dominues mbi administrimin e shoqërisë administruese në të cilën bën pjesë pjesëmarrja;

32. "shoqëri mëmë" është shoqëria mëmë në kuptim të nenit 2, paragrafi 9 dhe nenit 22 të Direktivës 2013/34/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

33. "filial" është filiali sipas përcaktimit në nenin 2, paragrafët 10 dhe 22 të Direktivës 2013/34/BE, duke përfshirë të gjitha filialet e një filiali të shoqërisë mëmë që është në krye;

34. "grup" është grupi, sipas përkufizimit në nenin 2, paragrafi 11 të Direktivës 2013/34/KE;

35. "lidhjet e ngushta" është situata në të cilën dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur përmes:

a) pjesëmarrjes në formën e zotërimit të drejtpërdrejtë ose përmes kontrollit të 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të një sipërmarrjeje; ose

b) "kontrollit", që është lidhja ndërmjet shoqërisë mëmë dhe filialit, për të gjitha rastet e përmendura në nenin 22, paragrafët 1 dhe 2 të Direktivës 2013/34/BE, ose lidhja e ngjashme ndërmjet çdo personi fizik ose juridik dhe shoqërisë, çdo filiali të një filiali, që konsiderohet gjithashtu filial i shoqërisë mëmë, që është në krye të këtyre filialeve;

c) lidhjes së përhershme të të dyve apo të të gjithëve me të njëjtin person, sipas marrëdhënies së kontrollit;

36. "organi drejtues" është organi ose organet e shoqërisë së investimit, të operatorit të tregut ose të ofruesit të shërbimit të raportimit të të dhënave, të cilët emërohen në përputhje me të drejtën e brendshme dhe autorizohen për ngritjen e strategjisë së subjektit, të objektivave dhe të drejtimit të përgjithshëm, si dhe mbikëqyrin dhe monitorojnë vendimmarrjen e drejtuesve dhe përfshijnë personat, që drejtojnë me efikasitet aktivitetin e subjektit.

Nëse direktiva i referohet organit drejtues dhe, në përputhje me të drejtën e brendshme, funksionet administruese dhe mbikëqyrëse të organit drejtues i caktohen organeve të ndryshme ose anëtarëve të ndryshëm të një organi, shteti anëtar identifikon organet ose anëtarët e organit drejtues përgjegjës, në përputhje me të drejtën e brendshme, përveçse kur përcaktohet ndryshe nga direktiva;

37. "drejtuesit e lartë" janë personat fizik, të cilët ushtrojnë funksione ekzekutive në shoqërinë e investimit, në operatorin e tregut ose në ofruesin e shërbimeve të raportimit të të dhënave, dhe janë përgjegjës dhe kanë llogaridhënie përpara organit drejtues, për administrimin ditor të subjektit, duke përfshirë zbatimin e politikave lidhur me shpërndarjen e shërbimeve dhe produkteve të klientët, nga shoqëria dhe personeli i saj;

38. "transaksion përkues për llogari të tij" është transaksioni, në të cilin ndërmjetësuesi vendoset midis shitësit dhe blerësit, në lidhje me transaksionet, në mënyrë që të mos i ekspozojë asnjëherë ndaj rrezikut të tregut, gjatë ekzekutimit të njëkohshëm të të dyja palëve, dhe në rastin e përfundimit të transaksionit sipas çmimit, për të cilin ndërmjetësi nuk fiton apo humbet, me përjashtim të nxjerrjes paraprake të komisionit, të tarifës, ose të faturimit të transaksionit;

39. "tregtimi algoritmik" është tregtimi i instrumenteve financiare, ku algoritmi kompjuterik përcakton automatikisht parametrat individuale të urdhrave, si nisja ose jo e urdhrat, planifikimi kohor, çmimi ose madhësia e urdhrat dhe mënyra e administrimit të urdhrave pas dorëzimit, me ndërhyrje të kufizuara ose pa ndërhyrje njerëzore, dhe pa përfshirë sistemet e përdorura për qëllime të përcaktimit të itinerareve të urdhrave për një ose më shumë vende të tregtimit, ose për përpunimin e urdhrave, në të cilat nuk përfshihet asnjë parametër tregtar i përcaktuar, ose për konfirmimin e urdhrave ose përpunimin e transaksioneve të ekzekutuara pas tregtimit;

40. "teknika e tregtimit algoritmik me shpejtësi të lartë" është teknika e tregtimit algoritmik, e karakterizuar nga:

a) infrastruktura e nevojshme për minimizimin e latencave të rrjetit dhe të tjera, të paktën duke përfshirë një nga ambientet e mëposhtme të regjistrimit algoritmik të urdhrave: kolokacioni, hostimi në afërsi fizike, ose aksesit i drejtpërdrejtë elektronik me shpejtësi të lartë;

b) përcaktimi i sistemit të nisjes së urdhrave, të gjenerimit, të përcaktimit të itinerarit ose të ekzekutimit, pa ndërhyrjen njerëzore për tregtimet ose urdhrat individuale; dhe

c) normat e larta ditore të mesazheve, që përbëhen nga urdhrat, kuotat ose anulimet;

41. "aksesi i drejtpërdrejtë elektronik" është marrëveshja, në të cilën anëtarit ose pjesëmarrësi ose klienti i vendit të tregtimit lejon një person të përdorë kodin e tij tregtar, në mënyrë që ky person të transmetojë, në mënyrë elektronike, urdhrat që lidhin drejtpërsëdrejti

instrumentin financiar me vendin e tregtimit, dhe përfshin marrëveshje në lidhje me përdorimin nga një person, të infrastrukturës së anëtarit ose pjesëmarrësit ose të klientit, ose çdo sistemi të lidhur, që sigurohet nga anëtari ose pjesëmarrësi ose klienti në lidhje me transmetimin e urdhrave (aksesi i drejtpërdrejtë i tregut) dhe marrëveshjet, për të cilat kjo infrastrukturë nuk përdoret nga një person (aksesi i sponsorizuar);

42. "praktikë e shitjes së ndërthurur" është ofrimi i shërbimit të investimit, së bashku me një shërbim ose produkt tjetër, si pjesë e paketës ose si kusht për të njëjtën marrëveshje ose paketë;

43. "depozitë e strukturuar" është depozita siç përcaktohet në germën "c" të nenit 2, paragrafi 1 të Direktivës 2014/49/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁴⁶ që ripaguhet plotësisht në afatin e maturimit në lidhje me kushtet, sipas të cilave interesi ose primi paguhet ose rrezikohet, sipas një formule, e cila përfshin faktorët si:

a) indeksi ose kombinimi i indekseve, duke përjashtuar normën variabël të depozitave me kthimin e lidhur drejtpërdrejtë me indeksin e normës së interesit, si Euribor ose Libor;

b) instrumenti financiar ose kombinimi i instrumenteve financiare;

c) mallrat ose kombinimi i mallrave, ose aktiveve të tjera të pazëvendësueshme fizike dhe jofizike; ose

d) kursi i këmbimit ose kombinimi i kurseve të këmbimit;

44. "tituj të transferueshëm" është kategoria e titujve që negociohen në tregun e kapitalit, me përjashtim të instrumenteve të pagesës, si:

a) aksione në shoqëri dhe letra të tjera me vlerë, të barasvlershme me aksionet e një shoqërie, në partneritete ose në subjekte të tjera, dhe faturat e depozitarëve në lidhje me aksionet;

b) obligacione ose lloje të tjera të borxhit të titullzuar, duke përfshirë faturat e depozitarit në lidhje me këto tituj;

c) çdo titull tjetër, që jep të drejtat e blerjes ose shitjes së çdo titulli të tillë të transferueshëm, ose që krijon transfertat e përcaktuara sipas referimit të titujve të transferueshëm, valutave, normave të interesit ose yield-eve, mallrave ose indekseve të tjera ose masave;

45. "faturat e depozitarit" janë tituj, që negociohen në tregun e kapitalit dhe përfaqësojnë pronësinë e letrave me vlerë nga emetuesi i huaj, ndërkohë që pranohen për t'u tregtuar në tregun e rregulluar dhe tregtohen pavarësisht letrave me vlerë të emetuesit të huaj;

46 "fond i tregtuar në bursë" është fondi, në të cilin të paktën një kuotë ose klasë e aksionit tregtohet gjatë ditës, në të paktën një vend të tregtimit dhe me të paktën një krijues tregu, i cili vepron për të garantuar se çmimi i kuotave ose aksioneve të tij në vendin e tregtimit nuk varion ndjeshëm nga vlera neto e aktiveve dhe, aty ku është e zbatueshme, nga vlera kontabël indikative;

47. "certifikata" janë certifikatat e përkufizuara në nenin 2, paragrafi 1 dhe 27 të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

48. "produkte financiare të strukturuar" janë produktet financiare të strukturuar, të përkufizuara në nenin 2, paragrafi 1 dhe 28 të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

49. "instrumentet derivative" janë instrumentet derivative, të përkufizuara në nenin 2, paragrafi 1 dhe 29 të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

50. "derivatet e mallrave me përdorim të gjerë" janë derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, të përkufizuar në nenin 2, paragrafi 1 dhe 30 të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

51. "kundërpalë qendrore" është kundërpala qendrore, siç përkufizohet në nenin 2, paragrafi 1 të Rregullores (BE) nr. 648/2012;

52. "skemë e publikimit të miratuar" është personi i autorizuar sipas kësaj direktive, për autorizimin e shërbimit të botimit të raporteve tregtare në emër të shoqërive të investimit, në përputhje me nenet 20 dhe 21 të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

53. "ofrues i qarkut të shiritit të kontrollit elektronik" ose "ofrues i QSHKE-së" është personi i autorizuar sipas kësaj direktive, për ofrimin e shërbimit të mbledhjes së raporteve tregtare ose instrumenteve financiare të renditura në nenet 6, 7, 10, 12 dhe 13, 20 dhe 21 të Rregullores (BE) nr. 600/2014 të tregjeve të rregulluara, MTF-ve, platformave të përbashkëta të tregtimit dhe skemave të publikimit të miratuar, dhe të cilat konsolidohen në komunikimin elektronik në kohë reale dhe të vazhdueshme, duke siguruar çmimin dhe të dhënat e volumeve për secilin instrument financiar;

54. "Mekanizëm i Raportimit të Pavarur" ose "MRP" është personi i autorizuar sipas kësaj direktive, për ofrimin e shërbimit të raportimit të detajeve në lidhje me transaksionet ndaj autoriteteve kompetente ose ESMA-s, në emër të shoqërive të investimit;

55. "shtet anëtar i origjinës" është:

a) në rastin e shoqërive të investimit:

I. nëse shoqëria e investimit është personi fizik, në shtetin anëtar të të cilit ndodhet zyra e tij qendrore;

II. nëse shoqëria e investimit është personi juridik, shteti anëtar në të cilin ndodhet selia e saj;

III. nëse shoqëria e investimit ka selinë sipas të drejtës së brendshme, shteti anëtar në të cilin ndodhet zyra e tij qendrore;

b) në rastin e tregut të rregulluar, shteti anëtar në të cilin është regjistruar tregu i rregulluar ose, në rastin kur, sipas ligjit të atij shteti anëtar ajo nuk ka seli, shteti anëtar, në të cilin ndodhet zyra qendrore e tregut të rregulluar;

c) në rastin e skemave të publikimit të miratuar, ofruesit të QSHKE-së ose MRP-së:

I. nëse skema e publikimit të miratuar, ofruesi i QSHKE-së ose MRP-ja është personi fizik, në shtetin anëtar të të cilit ndodhet zyra e tij qendrore;

II. nëse skema e publikimit të miratuar, ofruesi i QSHKE-së ose MRP-ja është personi juridik, në shtetin anëtar të të cilit ndodhet selia e tij;

III. nëse skema e publikimit të miratuar, ofruesi i QSHKE-së ose MRP-ja ka seli sipas të legjislacionit të brendshëm, në shtetin anëtar të të cilit ndodhet selia e tij;

56. "shtet anëtar pritës" është shteti anëtar, i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, në të cilin shoqëria e investimit ka degën ose ofron shërbime dhe/ose aktivitete të investimit, ose shteti anëtar, në të cilin tregu i rregulluar ofron rregullimet e përshtatshme, të cilat lehtësojnë aksesin e tregtimit në sistemin e tij nga anëtarët e distancuar ose pjesëmarrësit e themeluar në këtë shtet anëtar;

57. "shoqëri e vendeve të treta" është shoqëria, e cila ka natyrën e institucionit kreditor, që ofron shërbime të investimit ose kryen aktivitete të investimit, ose shoqëria e investimit, në rastin kur zyra qendrore ose selia ndodhen në Bashkimin Evropian;

58. "produktet energjetike të tregtuara me shumicë" janë produktet energjetike të tregtuara me shumicë, të përkufizuara në nenin 2, paragrafi 4 të Rregullores (BE) nr. 1227/2011;

59. "derivatet e mallrave bujqësore me përdorim të gjerë" janë kontratat e derivateve të lidhura me produktet e përmendura në nenin 1 dhe në shtojcën I, pjesa I deri XX dhe XXIV/1, të Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

60. "emetuesi sovran" janë të gjithë emetuesit e instrumenteve të borxhit, si më poshtë:

I. Bashkimi Evropian;

II. shteti anëtar, duke përfshirë departamentin qeveritar, agjencinë, ose një mjet, për qëllime të veçanta, të shtetit anëtar;

III. në rastin e shtetit anëtar federal, anëtari i federatës;

IV. mjete për qëllime të veçanta për disa nga shtetet anëtare;

V. institucioni financiar ndërkombëtar i themeluar nga dy ose më shumë shtete anëtare, me qëllim mobilizimin e fondeve dhe sigurimin e asistencës financiare në përfitim të anëtarëve të saj, të cilët përballen ose kërcënohen nga probleme të rënda financiare; ose

VI. Banka Evropiane e Investimeve;

61. "borxhi sovran" është instrumenti i borxhit i emetuar nga emetuesi sovran;

62. "mjete rezistente" është çdo instrument, i cili:

a) lejon klientin të ruajë informacionin që i drejtohet personalisht këtij klienti, në mënyrë të aksesueshme për t'iu referuar në të ardhmen dhe për periudhën e përshtatshme kohore, për qëllime informimi; dhe

b) lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;

63. "ofrues i shërbimit të raportimit të të dhënave" është skema e publikimit të miratuar, ofruesi i QSHKE-së, ose MRP-ja.

2. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për specifikimin e disa elementeve teknike të përkufizimeve të përcaktuara në paragrafin 1, për përshtatjen e tyre ndaj zhvillimeve të tregut, zhvillimeve teknologjike dhe eksperiencës së sjelljes, që ndalohet sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014 dhe për garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të kësaj direktive.

TITULLI II

AUTORIZIMI DHE KUSHTET E OPERIMIT TË SHOQËRIVE TË INVESTIMIT

KAPITULLI I

KUSHTET DHE PROCEDURAT E AUTORIZIMIT

Neni 5

Kërkesat për autorizim

1. Çdo shtet anëtar kërkon që ofrimi i shërbimeve të investimit dhe/ose kryerja e aktiviteteve të investimit si profesion i rregullt ose veprimtari tregtare në mënyrë profesionale, t'i nënshtrohet autorizimit paraprak në përputhje me këtë krye. Ky autorizim jepet nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, i caktuar në përputhje me nenin 67.

2. Duke deroguar nga paragrafi 1, shtetet anëtare autorizojnë çdo operator të tregut për operimin e MTF-së ose platformës së përbashkët të tregtimit, të cilat i nënshtrohen verifikimit paraprak të përputhjes me këtë krye.

3. Shtetet anëtare regjistrojnë të gjitha shoqëritë e investimit. Regjistri bëhet publik dhe përmban informacione në lidhje me shërbimet ose aktivitetet, për të cilat autorizohet shoqëria e investimit. Regjistri përditësohet rregullisht. Çdo autorizim i njoftohet ESMA-s.

ESMA krijon listën e të gjitha shoqërive të investimit në Bashkimin Evropian. Lista përmban informacionin mbi shërbimet ose aktivitetet, për të cilat autorizohet çdo shoqëri e investimit dhe përditësohet rregullisht. ESMA bën publike dhe përditëson listën në faqen e saj të internetit.

Nëse autoriteti kompetent heq autorizimin në përputhje me gërmat "b", "c" dhe "d" të nenit 8, ky veprim botohet në listë për një periudhë pesë vjeçare.

4. Çdo shtet anëtar kërkon që:

a) çdo shoqëri investimi, që është personi juridik, duhet të ketë zyrën qendrore në shtetin anëtar ku ka selinë;

b) çdo shoqëri investimi, që është person juridik ose çdo shoqëri investimit që është person juridik, por që sipas legjislacionit të tij të brendshëm nuk ka seli, duhet të ketë zyrën qendrore në shtetin anëtar, në të cilin ushtron veprimtarinë.

Neni 6

Fusha e zbatimit të autorizimit

1. Shteti anëtar i origjinës garanton që në autorizim të specifikohen shërbimet dhe aktivitetet e investimit, për të cilat autorizohet shoqëria e investimit. Autorizimi mund të mbulojë një ose më shumë shërbime ndihmëse të përcaktuara në seksionin B të shtojcës I. Autorizimi kurrsesi nuk jepet për ofrimin vetëm të shërbimeve ndihmëse.

2. Shoqëria e investimit që kërkon autorizimin për zgjerimin e veprimtarisë së shërbimeve shtesë të investimit ose të aktiviteteve ose të shërbimeve ndihmëse të paparashikuara në momentin e autorizimit fillestar, duhet të dorëzojë kërkesën për zgjerimin e autorizimit të saj.

3. Autorizimi vlen në të gjithë Bashkimin Evropian dhe lejon shoqëritë e investimit të ofrojnë shërbime ose të kryejnë aktivitete, për të cilat ajo autorizohet në të gjithë Bashkimin Evropian, qoftë përmes të drejtës së themelimit, duke përfshirë degët, ose përmes lirisë së ofrimit të shërbimeve.

Neni 7

Procedurat e dhënies dhe refuzimit të autorizimit

1. Autoriteti kompetent nuk jep autorizimin nëse nuk bindet dhe deri sa të bindet plotësisht se aplikanti përmbush të gjitha kërkesat sipas parashikimeve të kësaj direktive.

2. Shoqëria e investimit duhet të japë të gjithë informacionin e nevojshëm, duke përfshirë një program të operacioneve ku ndër të tjera specifikohen llojet e veprimtarive të parashikuara dhe struktura në mënyrë që autoriteti kompetent të bindet që shoqëria e investimit ka në zbatim të gjitha masat e nevojshme, në momentin e dhënies së autorizimit, për të përmbushur detyrimet e saj sipas këtij kapitulli.

3. Aplikanti informohet, brenda gjashtë muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë, nëse është dhënë ose jo autorizimi.

4. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, për të specifikuar:

a) informacionin që duhet t'u jepet autoriteteve kompetente sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke përfshirë programin e operacioneve;

b) kërkesat e zbatueshme për administrimin e shoqërive të investimit, sipas nenit 9, paragrafi 6 dhe informacioni për njoftime sipas nenit 9, paragrafi 5;

c) kërkesat e zbatueshme për aksionarët dhe anëtarët me pjesëmarrje influencuese dhe pengesat që parandalojnë ushtrimin efikas të funksioneve mbikëqyrëse të autoritetit kompetent, sipas nenit 10, paragrafët 1 dhe 2.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

5. ESMA zhvillon draft standardet teknike zbatuese për përcaktimin e formularëve standardë, të modeleve dhe procedurave për njoftimin ose dhënien e informacionit të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe në nenin 9, paragrafi 5.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 8

Heqja e autorizimit

Autoriteti kompetent mund të heqë autorizimin e nxjerrë për shoqërinë e investimit, në rastin kur shoqëria e investimit:

a) nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht atë, ose nuk ofron shërbime investimi ose nuk kryen aktivitete investimit gjatë gjashtë muajve të fundit, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar përkatës parashikon mbarimin e afateve të autorizimit për raste të tilla;

b) e ka marrë autorizimin duke bërë deklarata të rreme ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të parregullt;

c) nuk i përmbush më kushtet, sipas të cilave është dhënë autorizimi, si përmbushja e kushteve të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 575/2013;

d) ka kryer shkelje të rënda dhe sistematike të dispozitave të miratuara sipas kësaj direktive ose sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014, që rregullon kushtet operative të shoqërive të investimit;

e) është një nga rastet, për të cilat legjislacioni i brendshëm, për sa i përket çështjeve që nuk janë brenda objektivit të kësaj direktive, parashikon heqjen e autorizimit.

Çdo heqje e autorizimit i njoftohet ESMA-s.

Neni 9

Organi drejtues

1. Autoritetet kompetente, që japin autorizimin në përputhje me nenin 5 duhet të garantojnë që shoqëritë e investimit dhe organet e tyre administruese të përmbushin parashikimet e nenit 88 dhe nenit 91 të Direktivës 2013/36/BE.

ESMA dhe Autoriteti Bankar Evropian miratojnë bashkërisht udhëzimet për elementet e renditura në nenin 91, paragrafi 12 të Direktivës 2013/36/BE.

2. Kur japin autorizimin në përputhje me nenin 5, autoritetet kompetente mund të autorizojnë anëtarë të organit drejtues të mbajnë një post tjetër shtesë jo ekzekutiv, siç lejohet në përputhje me nenin 91, paragrafi 3 të Direktivës 2013/36/BE. Autoritetet kompetente njoftojnë rregullisht ESMA-n në lidhje me këto autorizime.

Autoriteti Bankar Evropian dhe ESMA koordinojnë mbledhjen e informacionit të siguruar sipas nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, dhe sipas nenit 91, paragrafi 6 të Direktivës 2013/36/BE, në lidhje me shoqëritë e investimit.

3. Shtetet anëtare garantojnë përkufizimin, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e organit drejtues të shoqërisë së investimit, për zbatimin e marrëveshjeve, që rregullojnë dhe garantojnë menaxhimin efikas dhe të kujdesshëm të shoqërisë së investimit, duke përfshirë ndarjen e detyrave të shoqërisë së investimit dhe parandalimin e konflikteve të interesit, me qëllim promovimin e integritetit të tregut dhe të interesit të klientëve.

Pa cenuar kërkesat e vendosura nga neni 88, paragrafi 1 i Direktivës 2013/36/BE, këto marrëveshje gjithashtu garantojnë se organi drejtues përkufizon, miraton dhe mbikëqyr:

a) organizimin e shoqërisë për ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit, dhe shërbimeve ndihmëse, duke përfshirë aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën e kërkuar nga personeli, burimet, procedurat dhe marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve dhe të aktiviteteve, duke marrë në konsideratë natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, dhe çdo kërkesë, përmes të cilave sigurohet përputhshmëria e shoqërisë;

b) politikën në lidhje me shërbimet, aktivitetet, produktet dhe operacionet e ofruara ose të siguruara në përputhje me tolerancën e shoqërisë ndaj rrezikut, dhe karakteristikat dhe nevojat e klientëve të shoqërisë, për të cilët ato ofrohen ose sigurohen, duke përfshirë zhvillimin e testit të stresit nëse është e përshtatshme;

c) politika e shpërblimit të personave, që përfshihen në sigurimin e shërbimeve për klientët, me synim nxitjen e ushtrimit të përgjegjshëm të aktivitetit tregtar, trajtimin e drejtë të klientëve, si dhe shmangien e konfliktit të interesit në marrëdhëniet me klientët.

Organi drejtues monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike, mjaftueshmërinë dhe zbatimin e objektivave strategjike të shoqërisë për ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të

investimit, dhe të shërbimeve ndihmëse, efikasitetin e marrëveshjeve rregullatore të shoqërisë dhe mjaftueshmërinë e politikave në lidhje me ofrimin e shërbimeve të klientët dhe marrjen e hapave të përshtatshme për trajtimin e çdo mangësie.

Anëtarët e organit drejtues kanë aksesin e duhur në informacionin dhe dokumentet e nevojshme për mbikëqyrjen dhe monitorimin e vendimmarrjes së drejtuesve.

4. Autoriteti kompetent refuzon autorizimin, në rastin kur nuk pajtohet me reputacionin e mirë të anëtarëve të organit drejtues të shoqërisë së investimit, zotërimin e njohurive të mjaftueshme, aftësive dhe përvojës, dhe në lidhje me dedikimin e kohës së mjaftueshme për kryerjen e funksioneve të tyre në shoqëritë e investimit, ose në rastin e arsyeve objektive dhe të vërtetueshme për të besuar mundësinë e rrezikimit të menaxhimit efikas, të mirë dhe të kujdesshëm, të organit drejtues, si dhe duke marrë parasysh sa duhet interesin e klientëve të tij dhe integritetin e tregut.

5. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit njoftimin e autoritetit kompetent për të gjithë anëtarët e organit të saj drejtues dhe për çdo ndryshim të anëtarësisë, së bashku me informacionin e nevojshëm për vlerësimin e përputhshmërisë së shoqërisë me paragrafët 1, 2 dhe 3.

6. Shtetet anëtare kërkojnë përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1, nga të paktën dy persona efikas në drejtim të veprimtarisë së shoqërisë së investimit aplikuese.

Duke deroguar nga nënparagrafi i parë, shtetet anëtare mund të autorizojnë shoqëritë e investimit në formën e personave fizikë, ose shoqëritë e investimit në formën e personave juridikë, të administruar nga një person i vetëm fizik, në përputhje me rregullat e tyre konstitucionale dhe legjislacionin e brendshëm. Megjithatë, shtetet anëtare kërkojnë që:

a) të ekzistojnë masa alternative për garantimin e menaxhimit të mirë dhe të kujdesshëm të këtyre shoqërive investimi dhe marrjen parasysh të interesave të klientit dhe të integritetit të tregut;

b) personat fizik të kenë reputacion mjaftueshëm të mirë, të kenë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e mjaftueshme dhe t'i kushtojnë kohën e nevojshme ushtrimit të detyrave të tyre.

Neni 10

Aksionarët dhe anëtarët e pjesëmarrjeve influencuese

1. Autoritetet kompetente nuk japin autorizim për ofrimin e shërbimeve të investimit ose kryerjen e aktiviteteve të investimit nga shoqëria e investimit, deri në momentin e informimit të tyre në lidhje me identitetin e aksionarëve ose të anëtarëve, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të personave fizik ose juridik, që zotërojnë pjesëmarrje kualifikuese, si dhe sasitë e këtyre pjesëmarrjeve.

Autoritetet kompetente e refuzojnë autorizimin nëse, duke marrë në konsideratë nevojën për të garantuar administrim të shëndoshë dhe të kujdesshëm të një shoqërie administruese, ata

nuk janë të kënaqur sa i përket përshtatshmërisë së aksionarëve ose të anëtarëve, të përmendur në nënparagrafin e parë.

Në rastet kur ekzistojnë lidhje të ngushta ndërmjet shoqërisë së investimit dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë, autoritetet kompetente duhet ta japin autorizimin vetëm nëse këto lidhje të ngushta nuk pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

2. Autoritetet kompetente e refuzojnë autorizimin edhe nëse ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të një vendi të tretë, të cilat rregullojnë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët shoqëria administruese ka lidhje të ngushta ose kur vështirësitë të cilat përfshihen në zbatimin e tyre, pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

3. Nëse ndikimi që ushtrohet nga personat e përmendur në nënparagrafin e parë të paragrafit 1, ka gjasa të cenojë menaxhimin e mirë dhe të kujdesshëm të shoqërisë së investimit, shtetet anëtare garantojnë marrjen e masave të përshtatshme nga autoriteti kompetent për t'i dhënë fund kësaj situate.

Këto masa mund të përfshijnë zbatimin e urdhrave gjyqësor ose vendosjen e sanksioneve kundër drejtorëve ose administratorëve, dhe atyre përgjegjës për administrimin ose pezullimin e ushtrimit të së drejtës së votës për aksione të zotëruara nga aksionarët ose anëtarët në fjalë.

Neni 11

Njoftimi për blerjet e propozuara

1. Shtetet anëtare i kërkojnë çdo personi fizik ose juridik, ose personave të tillë, që veprojnë bashkërisht ("blerësi i propozuar"), të cilët vendosin qoftë për të blerë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje influencuese në një shoqëri investimi, ose të rrisin më tej, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrjen influencuese në një shoqëri investimi, si rezultat i së cilës përqindja të drejtave të votës ose e kapitalit të zotëruar do të arrinte ose tejkalonte 20%, 30% ose 50%, ose që shoqëria e investimit do të bëhej filial i tij ("blerja e propozuar"), të njoftojë fillimisht me shkrim autoritetet mbikëqyrëse të shoqërisë së investimit, në të cilën ata kërkojnë të blejnë aksione ose të rrisin pjesëmarrjen influencuese, duke treguar përmasat e pjesëmarrjes së synuar dhe informacionin përkatës siç përmendet në nenin 13, paragrafi 4.

Shtetet anëtare i kërkojnë çdo personi fizik ose juridik që ka marrë një vendim për të likuiduar, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, një pjesëmarrje influencuese në një shoqëri investimi, që të njoftojë fillimisht me shkrim autoritetet kompetente, duke cilësuar përmasat e sipërmarrjes së synuar. Ky person njofton gjithashtu autoritetet kompetente nëse ai ka marrë një vendim për të ulur pjesëmarrjen influencuese në një masë që proporcioni i të drejtave të votës ose kapitalit të zotëruar do të binte nën 20%, 30% ose 50% ose në një masë që shoqëria e investimit nuk do të quhej më filial i tij.

Shtetet anëtare nuk kanë nevojë të zbatojnë kufirin prej 30% në rastin kur ato zbatojnë kufirin e një të tretës, në përputhje me nenin 9, paragrafi 3, germa "e" të Direktivës 2004/109/KE.

Për të përcaktuar nëse janë përmbushur kriteret për një pjesëmarrje influencuese, siç përmenden në nenin 10 dhe në këtë nen, shtetet anëtare nuk marrin në konsideratë të drejtat e votës ose aksionet të cilat shoqëritë e investimit ose institucionet kredituese mund t'i mbajnë si rezultat i ofrimit të nënshkrimit të instrumenteve financiare dhe/ose vendosjes së instrumenteve financiare sipas një angazhimi të përcaktuar, që përfshihet në pikën 6, seksioni A, shtojca I, me kusht që këto të drejta të mos ushtrohen, nga njëra anë, apo të mos përdoren për të ndërhyrë në drejtimin e emetuesit dhe, nga ana tjetër, të nxirren jashtë përdorimit brenda një viti nga blerja e tyre.

2. Autoritetet kompetente përkatëse punojnë në këshillim të plotë me njëri-tjetrin kur bëjnë vlerësimin e parashikuar në nenin 13, paragrafi 1 ("vlerësimi"), nëse blerësi i propozuar është një nga sa më poshtë:

a) institucion kredie, sipërmarrje e sigurimit të jetës, sipërmarrje e sigurimit, sipërmarrje e risigurimit, shoqëri investimi ose shoqëri e administrimit të SIKTT-së, e autorizuar në një tjetër shtet anëtar ose në sektorë të ndryshëm nga ai i propozimit të blerjes;

b) shoqëria mëmë e institucionit kreditor, sipërmarrjes së sigurimit të jetës, sipërmarrjes së sigurimit, sipërmarrjes së risigurimit, shoqërisë së investimit ose shoqërisë së administrimit të SIKTT-së, e autorizuar në një tjetër shtet anëtar ose në sektorë të ndryshëm nga ai i propozimit të blerjes; ose

c) personi fizik ose juridik që kontrollon institucionin kreditor, sipërmarrjen e sigurimit të jetës, sipërmarrjen e sigurimit, sipërmarrjen e risigurimit, shoqërinë e investimit ose shoqërinë e administrimit të SIKTT-së, i autorizuar në një tjetër shtet anëtar ose në sektorë të ndryshëm nga ai i propozimit të blerjes.

Autoritetet kompetente, pa vonesa të paarsyeshme, ofrojnë për njëri-tjetrin çdo informacion thelbësor ose të rëndësishëm në lidhje me vlerësimin. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente i komunikojnë njëri tjetrit, sipas kërkesës, të gjitha informacionet e rëndësishme dhe komunikojnë me nismën e vet të gjitha informacionet thelbësore. Vendimi i autoritetit kompetent për autorizimin e shoqërisë së investimit, në të cilën propozohet blerja, cilëson pikëpamjet ose rezervimet e shprehura të autoritetit kompetent përgjegjës për blerësin e propozuar.

3. Në rastin kur shoqëria e investimit ndërjegjësohet në lidhje me çdo blerje ose çlirim nga pjesëmarrjet e kapitalit të saj, që shkaktojnë tejkalimin ose rënien nën kufijtë e përmendur, të sipërmarrjeve, të përmendur në nënparagrafin e parë të paragrafit 1, shoqëria e investimit informon pa vonesë autoritetin kompetent.

Shoqëritë e investimit, të paktën një herë në vit, informojnë gjithashtu autoritetin kompetent në lidhje me emrat e aksionarëve dhe të anëtarëve, që zotërojnë pjesëmarrje kualifikuese, dhe mbi madhësinë e këtyre sipërmarrjeve, për shembull, siç tregohet në informacionin e marrë nga mbledhjet e përgjithshme vjetore të aksionarëve dhe të anëtarëve, ose si rezultat i përputhjes me rregulloret e zbatueshme për shoqëritë, të cilat pranojnë tituj të transferueshëm në tregun e rregulluar.

4. Shtetet anëtare u kërkojnë autoriteteve kompetente marrjen e masave të ngjashme me ato të përmendura në nenin 10, paragrafi 3, në lidhje me personat që nuk përmbushin detyrimet e

sigurimit të informacionit paraprak në lidhje me blerjen ose rritjen e pjesëmarrjes influencuese. Nëse pjesëmarrja blihet pavarësisht kundërshtimit të autoriteteve kompetente, atëherë shtetet anëtare, pavarësisht ndonjë sanksioni tjetër që pritet të miratohet, sigurojnë pezullimin e ushtrimit të të drejtave përkatëse të votave, pavlefshmërinë e votave të hedhura ose mundësinë e anulimit të tyre.

Neni 12

Periudha e vlerësimit

1. Autoritetet kompetente, brenda dy ditë pune nga marrja e njoftimit të kërkuar sipas nënparagrafit të parë të nenit 11, paragrafi 1, si dhe në vijim të marrjes së informacionit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, i konfirmojnë me shkrim blerësit të propozuar marrjen e informacionit.

Autoriteteve kompetente u jepet një maksimum prej gjashtëdhjetë dite pune nga data e konfirmimit me shkrim të marrjes së njoftimit dhe të gjitha dokumenteve të kërkuara nga shtetet anëtare, që duhet t'i bashkëngjiten njoftimit në bazë të listës së përmendur në nenin 13, paragrafi 4 ("periudha e vlerësimit"), për kryerjen e vlerësimit.

Autoritetet kompetente sapo bëjnë konfirmimin e marrjes informojnë blerësin e propozuar për datën e përfundimit të periudhës së shqyrtimit.

2. Autoritetet kompetente, nëse është e nevojshme, gjatë periudhës së shqyrtimit dhe jo më vonë se 50 ditë pune pas fillimit të periudhës së shqyrtimit, mund të kërkojnë informacione të mëtejshme që janë të nevojshme për të përfunduar shqyrtimin. Kërkesa bëhet me shkrim dhe specifikon informacionin shtesë që nevojitet.

Për periudhën ndërmjet datës së kërkesës për informacion nga autoritetet kompetente dhe marrjes së një përgjigjeje për këtë kërkesë nga blerësi i propozuar, periudha e shqyrtimit ndërpritet. Ndërprerja nuk tejkalon 20 ditë pune. Çdo kërkesë tjetër e autoriteteve kompetente për përfundimin ose qartësimin e informacionit i lihet gjyqimit të tyre, por kjo kërkesë nuk çon në ndërprerjen e periudhës së vlerësimit.

3. Autoritetet kompetente mund të zgjasin ndërprerjen e përmendur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 2 deri në 30 ditë pune, në rastin kur blerësi i propozuar është:

a) person fizik ose juridik, që ndodhet ose rregullohet jashtë Bashkimit Evropian;

b) person fizik ose juridik, që nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes së kësaj direktive ose Direktivave 2009/65/KE, 2009/138/KE ose 2013/36/BE.

4. Nëse pas përfundimit të vlerësimit, autoritetet kompetente vendosin të kundërshtojnë blerjen e propozuar, ato informojnë me shkrim blerësin e propozuar, brenda dy ditësh pune dhe pa tejkaluar periudhën e vlerësimit, duke dhënë arsyet e tyre për këtë vendim. Në zbatim të legjislacionit të brendshëm, një deklaratë e përshtatshme me arsyet e këtij vendimi mund të bëhet e aksesueshme për publikun me kërkesë të blerësit të propozuar. Kjo nuk e pengon një shtet

anëtar që, në mungesë të kërkesës së blerësit të propozuar, të lejojë autoritetin mbikëqyrës që të bëjë një publikim të tillë.

5. Nëse autoritetet kompetente nuk kundërshtojnë me shkrim blerjen e propozuar brenda periudhës së shqyrtimit, ajo konsiderohet si e miratuar.

6. Autoritetet kompetente mund të caktojnë një periudhë maksimale për të përfunduar blerjen e propozuar dhe mund ta zgjasin atë periudhë sipas rastit.

7. Në lidhje me njoftimin e blerjeve indirekte të të drejtave të votës ose kapitalit tek autoritetet kompetente dhe me miratimin e tyre nga ky i fundit, shtetet anëtare nuk vendosin kërkesa që janë më të rrepta se ato që përcaktohen në këtë direktivë.

8. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore për krijimin e listës shteruese të informacionit, të përmendur në nenin 13, paragrafi 4, për t'u përfshirë në njoftimin e tyre nga blerësit e propozuar, pa cenuar paragrafin 2 të këtij neni.

ESMA, jo më vonë se data 1 janar 2014, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

9. ESMA zhvillon draft standardet teknike zbatuese për të përcaktuar formularë standardë, modelet dhe të procedurat në lidhje me modalitetet e procesit të këshillimit ndërmjet autoriteteve kompetente përkatëse, të përmendura në nenin 11, paragrafi 2.

ESMA, jo më vonë se data 1 janar 2014, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuesve.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 13

Vlerësimi

1. Gjatë vlerësimit të njoftimit të parashikuar në nenin 11, paragrafi 1 dhe të informacionit të përmendur në nenin 12, paragrafi 2, me qëllim sigurimin e administrimit të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm të shoqërisë së investimit, në të cilën propozohet blerja dhe duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm të blerësit të propozuar në shoqërinë e investimit, autoritetet kompetente vlerësojnë përshtatshmërinë e blerësit të propozuar dhe stabilitetin financiar të blerjes së propozuar ndaj kritereve si më poshtë:

a) reputacionin e aksionerit të propozuar;

b) reputacionin dhe përvojën e çdo personi drejtues të veprimtarisë së shoqërisë së investimit, si rezultat i blerjes së propozuar;

c) stabilitetin financiar të blerësit të propozuar, veçanërisht në lidhje me llojin e veprimtarisë së ndjekur dhe të parashikuar të shoqërisë së investimit, sipas të cilës propozohet blerja;

d) nëse shoqëria e investimit do të jetë në gjendje të përmbushë vazhdimisht kërkesat për mbikëqyrje të kujdesshme në bazë të kësaj direktive dhe, sipas rastit, të direktivave të tjera, e sidomos të direktivave 2002/87/KE dhe 2013/36/BE, në veçanti, nëse grupi pjesë e së cilit ai do të bëhet ka një strukturë që i mundëson atij të ushtrojë mbikëqyrje efektive, të shkëmbejë me efikasitet informacione ndërmjet autoriteteve kompetente dhe të përcaktojë shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet autoriteteve kompetente;

e) nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se, në lidhje me blerjen e propozuar po kryhet, është kryer ose janë bërë përpjekje për të kryer pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 2005/60/KE, ose blerja e propozuar mund të rrisë një rrezik të tillë.

Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për rregullimin e kriterëve të përcaktuara në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi.

2. Autoritetet kompetente mund të kundërshtojnë blerjen e propozuar vetëm nëse ka baza të arsyeshme për ta bërë diçka të tillë bazuar në kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 ose nëse informacioni i dhënë nga blerësi i propozuar është jo i plotë.

3. Shtetet anëtare as nuk vendosin kushte paraprake në lidhje me nivelin e pjesëmarrjes që mund të blihet dhe as nuk i lejojnë autoriteteve të tyre kompetente që të shqyrtojnë blerjen e propozuar nga këndvështrimi i nevojave ekonomike të tregut.

4. Shtetet anëtare bëjnë publike listën ku specifikohet informacioni, i cili nevojitet për të kryer vlerësimin dhe që duhet t'u jepet autoriteteve kompetente në kohën e njoftimit të përmendur në nenin 11, paragrafi 1. Informacioni i kërkuar është proporcional dhe i përshtatur me natyrën e blerësit të propozuar dhe blerjes së propozuar. Shtetet anëtare nuk kërkojnë informacion që nuk është i rëndësishëm për vlerësimin e kujdesshëm.

5. Pavarësisht nenit 12, paragrafët 1, 2 dhe 3, kur autoriteti kompetent është njoftuar për dy ose më shumë propozime për të blerë ose për të rritur pjesëmarrjen influencuese në të njëjtën shoqëri investimi, ky autoritet i trajton blerësit e propozuar në mënyrë jodiskriminuese.

Neni 14

Anëtarësia e një investitori të autorizuar në skemën e kompensimit

Autoriteti kompetent verifikon nëse subjekti që kërkon autorizim si shoqëri investimi përmbush detyrimet e tij sipas Direktivës 97/9/KE, në kohën e autorizimit.

Detyrimi i përcaktuar në paragrafin e parë përmbushet në lidhje me depozitat e strukturuar, në rastin kur depozitat e strukturuar emetohen nga institucioni kreditor, që është anëtar i skemës së sigurimit të depozitave të njohur sipas Direktivës 2014/49/BE.

Neni 15

Fondi për kapitalin fillestar

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet kompetente të mos japin autorizim nëse shoqëria e investimit nuk ka kapital fillestar të mjaftueshëm në përputhje me kërkesat e Rregullores (BE) nr. 575/2013, duke marrë parasysh natyrën e shërbimit ose aktivitetit të investimit në fjalë.

Neni 16

Kërkesat organizative

1. Shteti anëtar kërkon përmbushjen e kërkesave organizative të shoqërisë së investimit, të përcaktuara në paragrafët 2 deri në 10 të këtij neni dhe në nenin 17.

2. Shoqëria e investimit vendos politikat e përshtatshme dhe procedurat e mjaftueshme për garantimin e përputhjes e shoqërisë, duke përfshirë drejtorët e saj, punëmarrësit dhe palët e lidhura, me detyrimet sipas kësaj direktive, si dhe rregullat e përshtatshme rregullatore të transaksioneve individuale të këtyre personave.

3. Shoqëria e investimit mirëmban dhe vë në përdorim marrëveshjet organizative dhe administruese, në lidhje me marrjen e hapave të arsyeshme, të hartuara për parandalimin e konflikteve të interesit, siç përcaktohen në nenin 23, të cilat ndikojnë në interesin e klientëve të saj.

Shoqëria e investimit, që prodhon instrumente financiare, të cilat ia shet klientit, duhet të mirëmbajë, të vërë në përdorim dhe të rishikojë procesin për miratimin e çdo instrumenti financiar dhe përshtatjeje të rëndësishme të instrumenteve ekzistuese financiare, përpara shënimit dhe shpërndarjes së tyre te klientët.

Procesi i miratimit të produktit specifikon tregun e synuar të identifikuar të klientëve fundor, sipas kategorisë përkatëse të klientëve për çdo instrument financiar, dhe garanton vlerësimin përkatës të të gjitha rreziqeve të tregut të synuar të identifikuar dhe konsistencën e strategjisë së shpërndarjes së planifikuar me tregun objektiv të identifikuar.

Shoqëria e investimit gjithashtu rishikon rregullisht instrumentet financiare të ofruara prej saj ose tregjet, duke marrë në konsideratë çdo rrethanë, që mund ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në rrezikun e mundshëm të tregut objektiv të identifikuar, për vlerësimin të paktën të rastit kur instrumenti financiar ruan konsistencën ndaj nevojave të tregut objektiv të identifikuar dhe kur strategjia e shpërndarjes së planifikuar mbetet e përshtatshme.

Shoqëria e investimit që prodhon instrumentet financiare, vë në dispozicion të çdo shpërndarësi të gjithë informacionin e përshtatshëm në lidhje me instrumentin financiar dhe

procesin e miratimit të produktit, duke përfshirë tregun objektiv të identifikuar për instrumentin financiar.

Nëse shoqëria e investimit ofron ose rekomandon instrumente financiare të jenë të prodhuara prej saj, ajo cakton marrëveshjet e përshtatshme për marrjen e informacionit të përmendur në nënparagrafin e pestë, dhe për kuptimin e karakteristikave dhe të tregut objektiv të identifikuar për çdo instrument financiar.

Politikat, proceset dhe marrëveshjet e përmendura në këtë paragraf nuk cenojnë kërkesat e tjera sipas kësaj direktive dhe sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014, duke përfshirë ato në lidhje me publikimin, përshtatshmërinë, identifikimin dhe administrimin e konflikteve të interesit, dhe stimujt.

4. Shoqëria e investimit merr hapat e arsyeshme për garantimin e vazhdimësisë dhe rregullsisë së performancës së shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit. Për këtë qëllim, shoqëria e investimit përdor sistemet, burimet, dhe procedurat e përshtatshme dhe proporcionale.

5. Në rastin kur shoqëria e investimit mbështetet në palë të treta për performancën e funksioneve operative, të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit të vazhdueshëm dhe të kënaqshme për klientët, dhe për performancën e aktiviteteve të investimit në baza të vazhdueshme dhe të kënaqshme, ajo garanton marrjen e hapave të arsyeshme për shmangien e rrezikut të shtuar dhe të paarsyeshëm operacional. Delegimi i funksioneve të rëndësishme operationale nuk mund të bëhet në mënyrë të atillë që dëmton cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe aftësinë e mbikëqyrësit për të monitoruar e përmbushjen e të gjitha detyrimeve nga shoqëria.

Shoqëria e investimit cakton procedurat e forta administrative dhe kontabël, mekanizmat e kontrollit të brendshëm, procedurat efikase për vlerësimin e rrezikut dhe masat mbrojtëse në lidhje me sistemet e përpunimit të të dhënave.

Pa cenuar aftësinë e autoriteteve kompetente për kërkimin e aksesin në komunikime elektronike në përputhje me këtë direktivë dhe me Rregulloren (BE) nr. 600/2014, shoqëria e investimit vendos mekanizma të qëndrueshme sigurie për garantimin e sigurisë dhe të autentikimit të mjeteve të transferimit të informacionit, minimizimin e riskut të dëmtimit të të dhënave dhe të aksesit të paautorizuar, dhe për parandalimin e rrjedhjes së informacionit me përmbajtje konfidenciale të të dhënave në çdo kohë.

6. Shoqëria e investimit organizon ruajtjen e regjistrave për të gjitha shërbimet, aktivitetet dhe transaksionet e kryera, të mjaftueshme për t'i lejuar autoritetit kompetent përmbushjen e detyrave mbikëqyrëse dhe kryerjen e veprimeve për zbatim sipas kësaj direktive, të Rregullores (BE) Nr. 600/2014, të Direktivës 2014/57/BE dhe të Rregullores (BE) Nr. 596/2014, dhe në veçanti për verifikimin e përmbushjes së të gjitha detyrimeve nga shoqëria e investimit, duke përfshirë ato në lidhje me klientët ose klientët e mundshëm dhe me integritetin e tregut.

7. Regjistrat përfshijnë bisedat e regjistruara ose telefonike, ose komunikimet elektronike, që lidhen të paktën me transaksionet e përfunduara gjatë tregtimit për llogari të tyre dhe me sigurimin e urdhrave të klientit për shërbime në lidhje me marrjen, transmetimit dhe ekzekutimit të urdhrave të tij.

Gjithashtu, këto biseda telefonike dhe komunikime elektronike përfshijnë ato me synim arritjen e përfundimit të transaksioneve gjatë tregtimit për llogari të tyre ose ofrimit të shërbimeve të urdhrave të klientëve në lidhje me marrjen, transmetimin dhe ekzekutimin e urdhrave të klientit, edhe në rastin kur bisedat ose komunikimet nuk sjellin përfundimin e këtyre transaksioneve ose ofrimin e shërbimeve të urdhrave të klientëve.

Për këto qëllime, shoqëria e investimit ndërmerr hapat e arsyeshme për regjistrimin e bisedave telefonike dhe komunikimeve elektronike përkatëse, të formuara, të dërguara ose të marra nga pajisjet e siguruara nga shoqëria e investimit për punëmarrësin ose kontraktorin, ose ka pranuar ose lejuar përdorimin e tyre nga punëmarrësi ose kontraktori.

Shoqëria e investimit njofton klientët e rinj dhe ekzistues në lidhje me komunikimet ose bisedat telefonike ndërmjet shoqërisë së investimit dhe klientëve të saj, të cilat sjellin ose mund të sjellin regjistrimin e transaksioneve.

Ky njoftim jepet vetëm një herë, përpara ofrimit të shërbimeve të investimit për klientët e rinj dhe ekzistues.

Shoqëria e investimit nuk ofron, përmes telefonit, shërbime dhe aktivitete të investimit për klientët e panjoftuar paraprakisht, në lidhje me regjistrimin e komunikimeve ose bisedave të tyre telefonike, për të cilat shërbimet ose aktivitetet e investimit lidhen me marrjen, transmetimin dhe ekzekutimin e urdhrave të klientit.

Urdhrat e klientëve jepen përmes kanaleve të tjera, megjithatë këto komunikime duhet të arrihen përmes mjeteve rezistente, si postat, fakset, emailt ose përmes mbajtjes së dokumentacionit të urdhrave të klientit të bëra gjatë takimeve. Në veçanti, përmbajtja e bisedave përballë me klientin mund të regjistrohen duke përdorur procesverbale me shkrim ose duke mbajtur shënime. Këto urdhra konsiderohen të barasvlershme me urdhrat e marra përmes telefonit.

Shoqëria e investimit merr hapat e arsyeshëm për parandalimin e punëmarrësit ose të kontraktorit nga bërja, dërgimi ose marrja e bisedave telefonike dhe komunikimeve elektronike përmes pajisjeve me pronësi private, të cilat nuk mund të regjistrohen ose kopjohen nga shoqëria e investimit.

Regjistrat e ruajtura në përputhje me këtë paragraf i sigurohen sipas kërkesës së klientit të përfshirë dhe ruhen për një periudhë deri në pesë vjet dhe, në rastin kur kërkohen nga autoriteti kompetent, për një periudhë deri në shtatë vjet.

8. Gjatë zotërimit të instrumenteve financiare që i përkasin klientëve, shoqëria e investimit merr masat e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë të klientëve, veçanërisht në rastin e falimentimit të shoqërisë, si dhe për parandalimin e përdorimit të instrumenteve financiare të klientit për llogari të tyre, përveç me miratimin e shprehur të klientit.

9. Gjatë zotërimit të instrumenteve financiare që i përkasin klientëve, shoqëria e investimit merr masat e përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave të klientëve dhe, vetëm në rastin e institucioneve kredituese, parandalon përdorimin e fondeve të klientëve për llogari të tyre.

10. Shoqëria e investimit nuk lidh marrëveshje të kolateralit për tituj të transferueshëm me klientët individë, me qëllim sigurimin ose mbulimin e detyrimeve të tashme ose të ardhshme, aktuale ose potenciale, ose prospektive të klientëve.

11. Në rastin e degëve të shoqërive të investimit, autoriteti kompetent i shtetit anëtar, në të cilin ndodhet dega, pa cenuar mundësinë e aksesit të drejtpërdrejtë në këto regjistra të autoritetit kompetent në shtetin anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit, zbaton detyrimin e përcaktuar në paragrafët 6 dhe 7 në lidhje me transaksionet e kryera nga degët.

Në rrethana të jashtëzakonshme, shtetet anëtare mund të vendosin kërkesa për shoqëritë e investimit në lidhje me mbrojtjen e aktiveve të klientit, që i shtohen dispozitave të përcaktuara në paragrafët 8, 9 dhe 10, dhe akteve të deleguara përkatëse siç përmenden në paragrafin 12. Në rastin kur shoqëria e investimit mbron aktivet dhe fondet e klientit, këto kërkesa duhet të justifikohen në mënyrë objektive dhe proporcionale, me qëllim adresimin e rreziqeve specifike ndaj mbrojtjes së investitorit ose ndaj integritetit të tregut, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në rrethanat e strukturës së tregut të këtij shteti anëtar.

Shteti anëtar njofton Komisionin, pa vonesa të paarsyeshme, në lidhje me synimin e caktimit të çdo kërkesë në përputhje me këtë paragraf dhe, të paktën dy muaj përpara datës së caktuar për hyrjen në fuqi të kësaj kërkesë. Njoftimi përfshin arsyet për vendosje e kësaj kërkesë. Çdo kërkesë e tillë shtesë nuk kufizon ose ndikon të drejtat e shoqërive të investimit sipas neneve 34 dhe 35.

Komisioni, brenda dy muajve nga njoftimi i përmendur në nënparagrafin e tretë, jep mendimin e tij mbi proporcionalitetin dhe arsyet për vendosjen e kërkesave shtesë.

Shtetet anëtare mund të mbajnë kërkesat shtesë, me kusht njoftimin e tyre te Komisioni në përputhje me nenin 4 të Direktivës 2006/73/KE, përpara datës 2 korrik 2014, dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Komisioni i komunikon shtetit anëtar kërkesat shtesë të caktuara në përputhje me këtë paragraf dhe i bën publike në faqen e tij të internetit.

12. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për specifikimin e kërkesave konkrete organizative të përcaktuara në paragrafët 2 deri në 10 të këtij neni, të zbatueshme për shoqëritë e investimit dhe degët e shoqërive të vendeve të treta, të autorizuara në përputhje me nenin 41, të cilat kryejnë shërbime dhe/ose aktivitete të ndryshme investimit dhe shërbime ndihmëse ose një kombinim të tyre.

Neni 17

Tregtimi algoritmik

1. Shoqëria e investimit që kryen tregtim algoritmik vendos sistemet efikase dhe kontrollet efikase të rrezikut, të përshtatshme për veprimtarinë e saj operative në lidhje me garantimin e sistemeve fleksibël dhe kapacitet të mjaftueshëm tregtar, që i nënshtrohen pragjeve dhe kufijve të përshtatshëm të tregtimit dhe parandalojnë dërgesën e urdhrave të gabuara ose sistemet me funksione të tjera, të cilat krijojnë ose kontribuojnë në parregullsitë e tregut. Për

garantimin e mospërdorimit të sistemeve të tregtimit, kjo shoqëri cakton sistemet efikase dhe kontrollet e rrezikut, për qëllime në kundërshtim me Rregulloren (BE) nr. 596/2014 ose me rregullat e vendit të tregtimit të lidhur me të. Shoqëria e investimit vendos marrëveshje efikase për vazhdimësinë e veprimtarisë, për t'u përballur me çdo dështim të sistemeve të saj të tregtimit dhe garanton testimin e plotë dhe monitorimin siç duhet të sistemeve të saj, për garantimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në këtë paragraf.

2. Shoqëria e investimit që zhvillon tregtimin algoritmik në një shtet anëtar njofton autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës dhe në lidhje me vendin e tregtimit, në të cilin shoqëria e investimit angazhohet në tregtimin algoritmik si anëtare ose si pjesëmarrëse në vendin e tregtimit.

Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës, në të cilin bën pjesë shoqëria e investimit mund t'i kërkojë asaj të ofrojë, rregullisht ose në mënyrë të posaçme, një përshkrim të natyrës së strategjive të saj të tregtimit algoritmik, detajet e parametrave tregtare ose kufijtë, të cilëve u nënshtrohet sistemi, përputhjet thelbësore dhe kontrollet e rrezikut të vendosura prej saj, me qëllim garantimin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe të detajeve në lidhje me testimin e sistemeve të saj. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë së investimit, në çdo kohë, kërkon nga shoqëria e investimit informacion të mëtejshëm në lidhje me tregtimin algoritmik dhe sistemet e përdorura për atë tregtim.

Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë së investimit, me kërkesë të autoritetit të vendit të tregtimit, në të cilin shoqëria e investimit kryen tregtimin algoritmik si anëtare ose pjesëmarrëse në vendin e tregtimit, duhet të japë, pa vonesa të paarsyeshme, informacionin e përmendur në nënparagrafin e dytë, që ka marrë nga shoqëria e investimit e përfshirë në tregtimin algoritmik.

Shoqëria e investimit organizon ruajtjen e regjistrave në lidhje me çështjet e përmendura në këtë paragraf dhe garanton mjaftueshmërinë e tyre për lejjimin e monitorimit të autoritetit kompetent në përputhje me kërkesat e kësaj direktive.

Shoqëria e investimit që zhvillon tregtimin algoritmik me frekuencë të lartë, duhet të ruajë regjistrat e renditura dhe të sakta sipas formularit të miratuar për të gjithë urdhrat e dhënë, duke përfshirë anulimet e urdhrave, urdhrat e ekzekutuar dhe kuotimet në vendin e tregtimit, dhe sipas kërkesës, i vë ato në dispozicion të autoritetit kompetent.

3. Shoqëria e investimit që zhvillon tregtimin algoritmik për ndjekjen e strategjisë së krijimit të tregut, duke marrë në konsideratë likuiditetin, përmasat dhe natyrën e tregut të caktuar, dhe karakteristikat e instrumentit të tregtuar:

a) zhvillon vazhdimisht këtë krijim të tregut, gjatë proporcioneve të caktuara të orëve së tregtimit në vendin e tregtimit, përveç rrethanave të jashtëzakonshme, duke rezultuar në ofrimin, në baza të rregullta dhe të parashikueshme, të likuiditetit në vendin e tregtimit;

b) lidh me shkrim marrëveshjen detyruese me vendin e tregtimit, e cila specifikon të paktën detyrimet e shoqërisë së investimit, në përputhje me germën "a"; dhe

c) vendos në çdo kohë sistemet dhe kontrollet efikase për garantimin e përmbushjes së detyrimeve, sipas marrëveshjes së përmendur në germën "b".

4. Për qëllime të këtij neni dhe nenit 48 të kësaj direktive, shoqëria e investimit që zhvillon tregtimin algoritmik, konsiderohet në ndjekje të strategjisë së krijimit të tregut, në rastin kur strategjia gjatë tregtimit për llogari të saj, si anëtare ose pjesëmarrëse e një ose më shumë vendeve të tregtimit, përfshin caktimin e kuotave të qëndrueshme, me drejtim të ndërsjellët, me madhësi të krahasueshme dhe me çmime konkurruese, në lidhje me një ose me shumë instrumente financiare në një treg të vetëm të tregtimit ose në tregje të ndryshme të tregtimit, që rezultojnë në ofrime të rregullta dhe të shpeshta të likuiditetit për të gjithë tregun.

5. Shoqëria e investimit, që siguron aksesin e drejtpërdrejtë elektronik në vendin e tregtimit duhet të ngrejë sistemet efikase dhe kontrollet, të cilat garantojnë vlerësimin e duhur dhe rishikimin e përshtatjes së klientëve me shërbimin e përdorur, parandalimin e tejkalimit të kufijve të paracaktuar të tregtimit dhe të kredisë, gjatë përdorimit të shërbimit nga klientët, monitorimin e përshtatshëm të tregtimit të klientëve dhe parandalimin, përmes kontrolleve të përshtatshme të riskut, të tregtimit që vë në rrezik vetë shoqërinë e investimit, ose që krijon apo kontribuon në parregullsitë e tregut, ose kur bie në kundërshtim me Rregulloren (BE) nr. 596/2014 ose rregullat e vendit të tregtimit. Ndalohet aksesin i drejtpërdrejtë elektronik pa këto kontrolle.

Shoqëria e investimit që siguron aksesin e drejtpërdrejtë elektronik përgjigjet për respektimin e kërkesave të kësaj direktive dhe të rregullave të vendit të tregtimit, nga klientët që përdorin shërbimin. Shoqëria e investimit monitoron transaksionet me qëllim identifikimin e shkeljeve të këtyre rregullave, të kushteve të parregullta të tregtimit, ose të sjelljes së mundshme abuzive në treg dhe i raporton autoritetit kompetent. Shoqëria e investimit garanton ekzistencën e lidhjes me shkrim të marrëveshjes ndërmjet shoqërisë së investimit dhe klientit, në lidhje me të drejtat themelore dhe detyrimet që rrjedhin nga ofrimi i shërbimit, dhe që në lidhje me këtë marrëveshje, shoqëria e investimit të mbajë përgjegjësi sipas kësaj direktive.

Shoqëria e investimit që siguron aksesin e drejtpërdrejtë elektronik në vendin e tregtimit, njofton autoritetet kompetente të shtetit të saj të origjinës dhe të vendit të tregtimit, në të cilin shoqëria e investimit siguron siç duhet aksesin e drejtpërdrejtë elektronik.

Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë së investimit mund t'i kërkojë shoqërisë së investimit të japë, rregullisht ose në mënyrë të posaçme, përshkrimin e sistemeve dhe kontrolleve të përmendura në nënparagrafin e parë dhe prova që ato janë zbatuar.

Me kërkesë të autoritetit kompetent në vendin e tregtimit, sipas të cilit shoqëria e investimit siguron aksesin e drejtpërdrejtë elektronik, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës i shoqërisë së investimit komunikon, pa vonesa të paarsyeshme, informacionin e përmendur në nënparagrafin e katërt, që ai merr nga shoqëria e investimit.

Shoqëria e investimit organizon ruajtjen e regjistrave në lidhje me çështjet e përmendura në këtë paragraf dhe garanton mjaftueshmërinë e tyre për lejimin e monitorimit të autoritetit kompetent në përputhje me kërkesat e kësaj direktive.

6. Shoqëria e investimit që vepron si anëtar i përgjithshëm klerimi për persona të tjerë, duhet të ngrejë sisteme efikase dhe kontrole për garantimit e zbatimit të shërbimeve të klerimit vetëm për personat e përshtatshëm dhe që përmbushin kriteret e qarta, si dhe për caktimin e kërkesave të përshtatshme për këta persona, me qëllim uljen e rreziqeve për shoqërinë e investimit dhe tregun. Shoqëria e investimit garanton lidhjen e marrëveshjes me shkrim ndërmjet shoqërisë së investimit dhe personit, në lidhje me të drejtat themelore dhe detyrimet që rrjedhin nga ofrimi i këtij shërbimi.

7. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, për të specifikuar si më poshtë:

a) detajet e kërkesave organizative të përcaktuara në paragrafët 1 deri në 6 zbatohen për shoqëritë e investimit, që ofrojnë shërbime të ndryshme dhe/ose aktivitete dhe shërbime ndihmëse të investimit, ose një kombinim të tyre, për të cilat, specifikimet në lidhje me kërkesat organizative të përcaktuara në paragrafin 5 përcaktojnë kërkesat specifike për aksesin e drejtpërdrejtë në treg dhe për aksesin e sponsorizuar me qëllim garantimin e zbatimit, të paktën të barasvlershëm, të kontroleve të zbatuara për aksesin e sponsorizuar krahasuar me ato të zbatuara për aksesin e drejtpërdrejtë në treg;

b) rrethanat, në të cilat shoqëria e investimit detyrohet të lidhë marrëveshjen e krijimit të tregut të përmendur në germën "b" të paragrafit 3 dhe përmbajtja e këtyre marrëveshjeve, duke përfshirë proporcionin e orëve të tregtimit në vendin e tregtimit të përcaktuar në paragrafin 3;

c) rrethanat që përfshijnë raste të jashtëzakonshme të përmendura në paragrafin 3, duke përfshirë rastet e luhatjeve ekstreme, çështjet politike dhe makroekonomike, çështjet e sistemit dhe ato operacionale dhe rastet, të cilat janë në kundërshtim me aftësinë e shoqërisë së investimit për ruajtjen e praktikave të kujdesshme të menaxhimit të rrezikut, siç përcaktohet në paragrafin 1;

d) përmbajtja dhe formati i formularit të miratuar, të përmendur në nënparagrafin e pestë të paragrafit 2 dhe kohëzgjatja gjatë së cilës shoqëria e investimit mban regjistra të tillë.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 18

Procesi i tregtimit dhe përfundimit të transaksioneve në një MTF dhe në platformën e përbashkët të tregtimit.

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë një MTF ose një platformë të përbashkët të tregtimit, që përveç përmbushjes së kërkesave organizative të përcaktuara në nenin 16, të vendosin në zbatim rregulla dhe procedura të qarta për tregtimin e drejtë dhe të rregullt, si dhe të vendosin kriteret objektive për ekzekutimin efikas të urdhrave. Ato duhet të kenë në zbatim masa për menaxhimin e mirë të operacioneve

teknike në ambientin e tyre, duke përfshirë vendosjen e masave për të përballuar rreziqet e ndërprerjeve në sistem.

2. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, që operojnë një MTF ose një platformë të përbashkët të tregtimit, vendosjen e rregullave të qarta në lidhje me kriteret e përcaktimit të instrumenteve financiare, që tregtohen brenda sistemeve të saj.

Shtetet anëtare, aty ku zbatohet, u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, ose që kanë akses në informacion e disponueshëm të bërë publik, që t'u lejojnë përdoruesve të saj të formojnë një gjykim investimi, duke marrë parasysh, si natyrën e përdoruesve, ashtu edhe llojet e instrumenteve të tregtuara.

3. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, botimin, mbajtjen dhe zbatimin e rregullave të qarta dhe jodiskriminuese, bazuar në kritere objektive, të cilat rregullojnë ambientin e shoqërive.

4. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, të vendosin masat për identifikimin e qartë dhe administrimin e pasojave të mundshme negative në lidhje me operimin e MTF-së ose të platformës së përbashkët të tregtimit, ose për anëtarët, pjesëmarrësit dhe përdoruesit, identifikimin e çdo konflikti interesit ndërmjet interesit të MTF-së, të platformës së përbashkët të tregtimit, të pronarëve të tyre, ose të shoqërisë së investimit ose operatorin e tregut, që operon në MTF ose në platformën e përbashkët të tregtimit, dhe funksionimit të mirë të MTF-së ose platformës së përbashkët të tregtimit.

5. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, përputhshmëri me nenet 48 dhe 49, dhe ngritjen e të gjitha sistemeve efikase, procedurave dhe marrëveshjeve të nevojshme për këtë qëllim.

6. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, të informojnë qartësisht anëtarët e saj ose pjesëmarrësit mbi përgjegjësitë përkatëse të tyre në lidhje me shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në këtë ambient. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, të kenë në zbatim masat e nevojshme për lehtësimin e shlyerjes efikase të transaksioneve sipas sistemeve të asaj MTF-je ose platforme të përbashkët të tregtimit.

7. Shtetet anëtare i kërkojnë MTF-së ose platformës së përbashkët të tregtimit mbajtjen e të paktën tre anëtarëve ose përdoruesve aktiv të rëndësishëm, ku secili ka mundësinë e ndërveprimit me të gjithë përdoruesit në lidhje me formimin e çmimeve.

8. Nëse titujt e transferueshëm, që pranohen për tregtim në tregun e rregulluar, tregtohen gjithashtu në një MTF ose në një platformë të përbashkët tregtimi, pa miratimin e emetuesit, emetuesi nuk i nënshtrohet asnjë detyrimi në lidhje dhënien fillestare, të vazhdueshme ose në

mënyrë të posaçme të informacionit financiar, në lidhje me atë MTF ose platformë të përbashkët tregtimi.

9. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, përputhjen e menjëhershme me çdo udhëzim të autoritetit kompetent në përputhje me nenin 69, paragrafi 2 për pezullimin ose çregjistrimin e tregtimit të instrumentit financiar.

10. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, sigurimin për autoritetin kompetent të përshkrimit të hollësishëm në lidhje me funksionimin e MTF-së ose të platformës së përbashkët të tregtimit, duke përfshirë, pa cenuar nenin 20, paragrafi 1, 4 dhe 5, çdo lidhje me ose pjesëmarrje në tregun e rregulluar, në MTF, në platformën e përbashkët të tregtimit ose në subjektin e brendshëm sistematik me pronësi të njëjtën shoqëri të investimit ose operator të tregut, dhe listën e anëtarëve dhe pjesëmarrësve të tyre dhe/ose përdoruesve. Autoritetet kompetente vënë këtë informacion në dispozicion të ESMA-s sipas kërkesës. ESMA-s i njoftohet çdo autorizim për shoqërinë e investimit ose për operatorin e tregut si një MTF ose platformë e përbashkët e tregtimit. ESMA krijon listën e të gjitha MTF-ve ose platformave të përbashkëta të tregtimit në Bashkimin Evropian. Lista përmban informacionin e shërbimeve të ofruara nga një MTF ose një platformë e përbashkët tregtimi dhe kërkon kodin unik të identifikimi të MTF-së dhe të platformës së përbashkët të tregtimit në lidhje me përdorimin e raporteve, në përputhje me nenet 6, 10 dhe 26 të Rregullores (BE) nr. 600/2014. Regjistri përditësohet rregullisht. ESMA bën publike dhe përditëson listën në faqen e saj të internetit.

11. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike për përcaktimin e përmbajtjes dhe formatit të përshkrimit dhe njoftimit të përmendur në paragrafin 10.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 19

Kërkesat specifike për MTF-të

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, që përveç përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në nenet 16 dhe 18, të vendosin dhe të zbatojnë rregulla jodiskrecionale për ekzekutimin e urdhrave në sistem.

2. Shtetet anëtare kërkojnë që rregullat e përmendura në nenin 18, paragrafi 3, të cilat rregullojnë aksesin në një MTF, të jenë në përputhje me kushtet e vendosura sipas nenit 53, paragrafi 3.

3. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë një MTF, vendosjen e masave:

a) për pajisjen në mënyrë të përshtatshme në lidhje me menaxhimin e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet për zbatimin e marrëveshjeve dhe sistemeve të përshtatshme për identifikimin e të gjitha rreziqeve me ndikim të konsiderueshëm për operimin e saj, dhe për caktimin e masave efikase për zbutjen e këtyre rreziqeve;

b) për vendosjen e masave efikase, që lehtësojnë përfundimin efikas dhe në kohë të transaksioneve të kryera brenda sistemeve të saj; dhe

c) për vënien në dispozicion, në momentin e autorizimit dhe në baza të vazhdueshme, burimet e mjaftueshme financiare për lehtësimin e funksionimit të rregullt të saj, duke marrë në konsideratë natyrën dhe përmasat e transaksionit të përfunduar në treg, si dhe gamën dhe shkallën e rreziqeve të shfaqura.

4. Shtetet anëtare garantojnë moszbatimin e neneve 24, 25, nenit 27 paragrafët 1, 2 dhe 4 deri në 10 dhe nenit 28 për transaksionet e përfunduara sipas rregullave që rregullojnë një MTF ndërmjet anëtarëve ose pjesëmarrësve të saj, ose ndërmjet një MTF-je dhe anëtarëve ose pjesëmarrësve në lidhje me përdorimin e MTF-së. Megjithatë, anëtarët ose pjesëmarrësit e një MTF-je përbushin detyrimet e parashikuara në nenet 24, 25, 27 dhe 28 në lidhje me klientët e tyre, në rastin kur ata, në emër të klientëve të tyre, ekzekutojnë urdhra përmes sistemeve të MTF-së.

5. Shtetet anëtare nuk u lejojnë shoqërive të investimit ose operatorëve të tregut, të cilët operojnë një MTF, ekzekutimin e urdhrave kundër kapitalit të regjistruar ose përfshirjen në transaksione përkuese për llogari të tyre.

Neni 20

Kërkesat specifike për platformat e përbashkëta të tregtimit

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorit të tregut, i cili operon një platformë të përbashkët të tregtimit, caktimin e masave për parandalimin e ekzekutimit të urdhrave të klientit në një platformë të përbashkët të tregtimit kundër kapitalit të regjistruar të shoqërisë së investimit ose të operatorit të tregut, të cilët operojnë një platformë të përbashkët të tregtimit, ose nga çdo subjekt që bën pjesë në të njëjtin grup ose person juridik, në të cilin bën pjesë shoqëria e investimit ose operatori i tregut.

2. Shtetet anëtare e lejojnë shoqërinë e investimit ose operatorin e tregut, që operon një platformë të përbashkët të tregtimit, të përfshihet në transaksionet përkuese për llogari të tyre, në lidhje me obligacionet, produktet e strukturuar financiare, kuotat e shkarkimeve dhe derivate të caktuara, vetëm në rastet e miratimit të procesit nga klienti.

Shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon një platformë të përbashkët të tregtimit, nuk përdor transaksione përkuese për llogari të tij, për ekzekutimin e urdhrave të klientit në platformën e përbashkët të tregtimit, në lidhje me derivatet përkatëse të klasës së derivateve, të cilat deklarohen se janë objekt i detyrimit të klerimit në përputhje me nenin 5 të Rregullores (BE) nr. 648/2012.

Shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon platformën e përbashkët të tregtimit, vendos masat për garantimin e pajtueshmërisë me përkufizimin e transaksioneve përkuese për llogari të tij në nenin 4, paragrafi 1, pika 38.

3. Shtetet anëtare i lejojnë shoqërisë së investimit ose operatorit të tregut, që operon platformën e përbashkët të tregtimit, zhvillimin e tregtimit për llogari të tij, me përjashtim të transaksioneve përkuese për llogari të tij, vetëm në lidhje me instrumentet e borxhit sovran, për të cilat nuk ekziston tregu likuid.

4. Shtetet anëtare nuk lejojnë që operimi i OTF-së dhe i subjektit të brendshëm sistematik të ndodhë brenda të njëjtit subjekt juridik. Platforma e përbashkët e tregtimit nuk lidhet me subjektin e brendshëm sistematik, në mënyrë të atillë që të lejojë ndërveprimin e urdhrave në platformën e përbashkët të tregtimit me urdhrat ose me kuotat e subjektit të brendshëm sistematik. Platforma e përbashkët e tregtimit nuk lidhet me një platformë tjetër të përbashkët të tregtimit, në mënyrë që të lejojë ndërveprimin e urdhrave në platforma të ndryshme të përbashkëta të tregtimit.

5. Shtetet anëtare nuk e pengojnë shoqërinë e investimit ose operatorin e tregut, që operon një platformë të përbashkët tregtimi, të përfshijë një shoqëri tjetër investimit për zhvillimin, në mënyrë të pavarur, të krijimit të tregut në këtë platformë të përbashkët të tregtimit.

Për qëllime të këtij neni, shoqëria e investimit nuk konsiderohet se kryen krijimin e tregut në një platformë të përbashkët të tregtimit ose në mënyrë të pavarur, nëse ajo ka lidhje të ngushta me shoqërinë e investimit ose operatorin e tregut, i cili operon platformën e përbashkët të tregtimit.

6. Shtetet anëtare kërkojnë ekzekutimin e urdhrave, mbi baza diskrecioni, në platformat e përbashkëta të tregtimit.

Një shoqëri investimi ose operator tregu, që operon një platformë të përbashkët tregtimi, ushtron lirinë e veprimit vetëm në një apo të dy rrethanat e mëposhtme:

a) në rastin kur vendosin ose tërheqin urdhra nga platforma e përbashkët e tregtimit, të operuar prej tyre;

b) në rastin e vendimit të mospërputhjes së urdhrat së caktuar të klientit me urdhrat e vëna në dispozicion në sistemeve në kohë të caktuara, me kusht përputhjen e saj me udhëzimet specifike të marra nga klienti dhe përmbushjen e detyrimeve në përputhje me nenin 27.

Për sistemin që kombinon urdhrat e klientit, shoqëria e investimit ose operatori i tregut, i cili operon një platformë të përbashkët tregtimi, mund të vendosë nëse, kur dhe sa prej dy ose më shumë urdhrave të mundshme, dëshiron të ndërthurura brenda sistemit. Në përputhje me paragrafët 1, 2, 4 dhe 5 dhe pa cenuar paragrafin 3, në lidhje me sistemin e sistemit të transaksioneve jokapitale, shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon një platformë të përbashkët të tregtimit, mund të lehtësojë negocimin ndërmjet klientëve, duke sjellë bashkë dy ose më shumë interesa të përputhshme tregtare në një transaksion.

Ky detyrim nuk cenon nenin 18 dhe 27.

7. Autoriteti kompetent mund të kërkojë justifikimin e detajuar, qoftë në rastin kur shoqëria e investimit ose operatori i tregut kërkon autorizimin për operimin e platformës së përbashkët të tregtimit ose në mënyrë të posaçme, në lidhje me arsyen pse sistemi nuk korrespondon me dhe nuk operon si treg i rregulluar, MTF, ose si subjekt i brendshëm sistematik, përshkrimin e hollësishëm mbi mënyrën e ushtrimit të lirisë së veprimit, veçanërisht në rastin kur urdhri për platformën e përbashkët të tregtimit tërhiqet, dhe sipas rastit dhe mënyrës sesi dy ose më shumë urdhra të klientëve përputhen brenda platformës së përbashkët të tregtimit. Gjithashtu, shoqëria e investimit ose operatori i tregut i platformës së përbashkët të tregtimit i siguron autoritetit kompetent informacionin shpjegues të përdorimit të transaksioneve përkuese për llogari të tij. Autoriteti kompetent monitoron përfshirjen e shoqërisë së investimit ose të operatorit të tregut në transaksionet përkuese për llogari të tij, për garantimin e zbatimit të vazhdueshëm brenda përkufizimit të këtij tregtimi, dhe për mosshkaktimin e konflikteve të interesit ndërmjet shoqërisë së investimit ose operatorit të tregut dhe klientëve të saj.

8. Shtetet anëtare garantojnë zbatimin e neneve 24, 25, 27 dhe 28 për transaksionet e përfunduara në platformën e përbashkët të tregtimit.

KAPITULLI II

KUSHTET OPERATIVE E SHOQËRITË E INVESTIMIT

SEKSIONI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 21

Shqyrtim i rregullt i kushteve në momentin e autorizimit

1. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërisë së investimit të autorizuar në territorin e tyre, përputhjen në çdo kohë me kushtet në momentin e autorizimit të përcaktuara në kapitullin I.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë autoriteteve kompetente vendosjen e metodave të përshtatshme për monitorimin e përputhshmërisë së shoqërive të investimit me detyrimet e tyre sipas paragrafit 1. Ato i kërkojnë shoqërive të investimit të njoftojnë autoritetet kompetente, në lidhje me çdo ndryshim të rëndësishëm të kushteve në momentin e autorizimit.

ESMA mund të japë udhëzime në lidhje me metodat e monitorimit të përmendura në këtë paragraf.

Neni 22

Detyrimi i përgjithshëm në lidhje me mbikëqyrjen e vazhdueshme

Shtetet anëtare garantojnë monitorimin e aktiviteteve të shoqërisë së investimit nga autoritetet kompetente, me qëllim vlerësimin e përputhjes së kushteve operative të parashikuara në këtë direktivë. Shtetet anëtare garantojnë vendosjen e masave të përshtatshme për t'i lejuar

autoritetet kompetente marrjen e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e përputhjes së shoqërive të investimit me këto detyrime.

Neni 23

Konfliktet e interesit

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit marrjen e hapave të përshtatshme për identifikimin dhe parandalimin ose menaxhimin e konflikteve të interesit ndërmjet tyre, duke përfshirë menaxherët, punëmarrësit dhe palët e lidhura, ose çdo person të lidhur drejtpërdrejtë ose tërthorazi sipas kontrollit të tyre, dhe klientët e tyre, ose ndërmjet klientëve, të cilat ndodhin gjatë ofrimit të çdo shërbimi të investimit apo ndihmës, ose një kombinim i tyre, duke përfshirë ato të shkaktuara nga marrja e stimujve nga palët e treta, ose përmes shpërblimit të vetë shoqërisë së investimit ose strukturave të tjera nxitëse.

2. Nëse masat organizative ose administrative që vendosen nga shoqëria e investimit në përputhje me nenin 16, paragrafi 3 për parandalimin e konflikteve të interesit në lidhje me ndikimin negativ në interesin e klientëve të saj, nuk mjaftojnë për garantimin me siguri të arsyeshme, të parandalimit të rreziqeve në dëm të interesave të klientëve, shoqëria e investimit i komunikon qartësisht natyrën e përgjithshme dhe/ose burimet e konfliktit të interesit, si dhe hapat e marra për zbutjen e këtyre rreziqeve përpara ushtrimit të veprimtarisë në emër të saj.

3. Komunikimi i përmendur në paragrafin 2:

a) realizohet me mjete të qëndrueshme; dhe

b) përfshin hollësi të mjaftueshme, duke marrë në konsideratë llojin e klientit, për t'i lejuar marrjen e vendimit të informuar në lidhje me shërbimin, në kontekstin, sipas të cilit shfaqet konflikti i interesit.

4. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për:

a) përcaktimin e hapave të mundshme dhe të arsyeshme, të marra nga shoqëria e investimit për identifikimin, parandalimin, menaxhimin dhe bërjen publike të konflikteve të interesit gjatë ofrimit të shërbimeve të ndryshme të investimit dhe ndihmëse, si dhe kombinimi i tyre;

b) caktimin e kritereve të përshtatshme për përcaktimin e llojeve të konfliktit të interesit, ekzistenca e të cilave mund të dëmtojë interesat e klientëve ose të klientëve të mundshëm të shoqërisë së investimit.

SEKSIONI 2

DISPOZITA PËR GARANTIMIN E MBROJTJES SË INVESTITORIT

Neni 24

Parime të përgjithshme dhe informacioni për klientët

1. Shtetet anëtare kërkojnë që shoqëria e investimit kur u ofron klientëve shërbime investimi ose, sipas rastit, shërbime ndihmëse, të veprojë me ndershmëri, me drejtësi dhe profesionalizëm, në përputhje me interesin më të lartë të klientëve, dhe veçanërisht në përputhjen me parimet e përcaktuara në këtë nen dhe në nenin 25.

2. Shoqëritë e investimit që prodhojnë instrumente financiare për t'i shitur te klientët, garantojnë qëllimin e instrumenteve financiare, të projektuara për plotësimin e nevojave të tregut objektiv të identifikuar për klientët fundor, sipas kategorive të klientëve, strategjinë e përputhshme të shpërndarjes së instrumenteve financiare me tregun objektiv të identifikuar, dhe marrjen e hapave të arsyeshme të shoqërisë së investimit për garantimin e shpërndarjes së instrumentit financiar në tregun objektiv të identifikuar.

Shoqëria e investimit kupton instrumentet financiare që ajo ofron ose rekomandon, vlerëson përputhjen e instrumenteve financiare me nevojat e klientit, të cilit i ofron shërbimet e investimit, gjithashtu duke marrë në konsideratë tregun e synuar të identifikuar të klientëve fundor, të përmendur në nenin 16, paragrafi 3, dhe garanton ofrimin ose rekomandimin e instrumenteve financiare, vetëm në rastin kur kjo i shërben interesit të klientit.

3. I gjithë informacioni, duke përfshirë komunikimet e drejta, të qarta dhe joçorientuese, të marketimit të adresuar nga shoqëria e investimit për klientët ose klientët e mundshëm. Të identifikohen qartësisht komunikimet e marketimit si të tilla.

4. Informacioni i përshtatshëm sigurohet në kohë të përshtatshme për klientët ose klientët e mundshëm, në lidhje me shoqërinë e investimit dhe shërbimet e saj, me instrumentet financiare dhe strategjitë e propozuara të investimit, me platformat e ekzekutimit të urdhrave, dhe të gjitha kostot dhe faturimet përkatëse. Kjo listë përfshin sa më poshtë:

a) në rastin kur ofron këshilla investimi, shoqëria e investimit, në kohën e përshtatshme dhe përpara ofrimit të këshillave të investimit, informon klientin:

I. nëse këshillimi ofrohet ose jo në mënyrë të pavarur;

II. nëse këshillimi ofrohet në baza të gjera ose më të kufizuara sipas analizave të llojeve të ndryshme të instrumenteve financiare, dhe veçanërisht nëse gama kufizohet në instrumente financiare të emetuara ose të ofruara nga subjektet e lidhura ngushtë me shoqërinë e investimit ose çdo lidhje tjetër juridike ose ekonomike, si marrëdhëniet kontraktuale, në masë të atillë, që rrezikon dëmtimin e bazës së pavarur të këshillës së ofruar;

III. nëse shoqëria e investimit i ofron klientit vlerësimin periodik për përshtatshmërinë e instrumenteve financiare të rekomanduara për këtë klient;

b) informacioni në lidhje me instrumentet financiare dhe strategjitë e propozuara të investimit duhet të përfshijë udhëzimet e përshtatshme dhe paralajmërimet lidhur me rreziqet, që shoqërojnë investimet në këto instrumente, ose në lidhje me strategjitë e caktuara të investimit dhe planifikimin e instrumentit që synohet për klientët individë ose klientët e kategorisë profesionist, duke marrë në konsideratë tregun objektiv të identifikuar në përputhje me paragrafin 2;

c) informacioni në lidhje me të gjitha kostot dhe faturimet përkatëse duhet të përfshijë informacionet, si në lidhje me shërbimet e investimit, ashtu dhe me ato ndihmëse, duke përfshirë koston e këshillimit dhe, sipas rastit, koston e instrumentit financiar të rekomanduar ose të marketuar për klientin, dhe mënyrën e pagesës së mundshme të klientit, për këshillat, gjithashtu me përfshirje të pagesave të palëve të treta.

Informacioni në lidhje me të gjitha kostot dhe faturimet, duke përfshirë kostot dhe faturimet në lidhje me shërbimin e investimit dhe instrumentin financiar, të cilat nuk shkaktohen nga shfaqja e rrezikut bazë të tregut, agregohen duke i lejuar klientit të kuptojë kostot e përgjithshme, si dhe efektin akumulues në lidhje me kthimin nga investimi, dhe sipas kërkesës së klientit, sigurimin e nënndarjeve sipas kategorive. Kur gjen zbatim, ky informacion i jepet rregullisht klientit, të paktën një herë në vit, gjatë kohëzgjatjes së investimit.

5. Informacioni i përmendur në paragrafët 4 deri në 9 sigurohet në formë gjithëpërfshirëse, në mënyrë që klientët ose klientët e mundshëm të kenë aftësinë e arsyeshme për të kuptuar natyrën e rreziqeve të shërbimit të investimit dhe të llojit të veçantë të instrumentit financiar të ofruar, dhe rrjedhimisht, për marrjen e vendimeve të investimit në mënyrë të informuar. Shtetet anëtare mund të lejojnë dhënien e informacionit sipas formularit të standardizuar.

6. Nëse shërbimi i investimit ofrohet si pjesë e produktit financiar që është objekt i dispozitave të ligjit të Bashkimit Evropian në lidhje me institucionet kredituese dhe kreditë konsumatore, në lidhje me kërkesat për informacion, ky shërbim nuk i nënshtrohet edhe detyrimeve të përcaktuara në paragrafët 3, 4 dhe 5.

7. Nëse shoqëria e investimit informon klientin se këshilla e investimi jepet në mënyrë të pavarur, shoqëria e investimit:

a) vlerëson gamën e mjaftueshme të instrumenteve financiare të vëna në dispozicion të tregut, të cilat kanë shumëllojshmërinë e mjaftueshme në lidhje me llojin e tyre dhe emetuesit ose ofruesit e produkteve, për garantimin e arritjes, në mënyrë të përshtatshme, të objektivave të investimit të klientit dhe pa u kufizuar në instrumentet financiare të emetuara ose të ofruara nga:

I. vetë shoqëria e investimit ose nga subjekte me lidhje të ngushta me shoqërinë e investimit; ose

II. subjekte të tjera, me të cilat shoqëria e investimit mban këto marrëdhënie të ngushta ligjore ose ekonomike, si marrëdhëniet kontraktuale, që rrezikon dëmtimin e bazës së pavarur të këshillës së ofruar;

b) nuk pranon apo mban tarifa, komisione apo çdo përfitim tjetër monetar ose jomonetar, të paguar ose të siguruar nga çdo palë e tretë apo person, që vepron në emër të palës së tretë në lidhje me ofrimin e shërbimit për klientët. Përfitimet e vogla jomonetare, që mund të risin cilësinë e shërbimit të ofruar për klientit, dhe që kanë shkallë dhe natyrë e cila nuk mund të gjykohet se dëmton përbushjen e detyrimit të shoqërisë investuese për të vepruar në interes të klientit, duhet të komunikohen qartësisht dhe përjashtohen nga kjo pikë.

8. Gjatë sigurimit të administrimit të portofolit, shoqëria e investimit nuk pranon apo mban tarifa, komisione apo çdo përfitim tjetër monetar ose jomonetar, të paguar ose të siguruar nga çdo palë e tretë apo person, që vepron në emër të palës së tretë në lidhje me ofrimin e shërbimit për klientët. Përfitimet e vogla jomonetare, që mund të rrisin cilësinë e shërbimit të ofruar për klientit, dhe që kanë shkallë dhe natyrë e cila nuk mund të gjykohet se dëmton përmbushjen e detyrimit të shoqërisë investuese për të vepruar në interes të klientit, duhet të komunikohen qartësisht dhe përjashtohen nga ky paragraf.

9. Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e investimit të konsiderohen si në mospërmbushje të detyrimeve të tyre sipas nenit 23 ose sipas paragrafit 1 të këtij neni, në rastin kur ato paguajnë ose marrin tarifa ose komisione, ose ofrojnë ose marrin përfitim jomonetar në lidhje me ofrimin e shërbimit të investimit ose të shërbimit ndihmës, nga ose përmes çdo pale, përveç klientit ose personit veprues në emër të klientit, të ndryshme nga pagesa ose përfitimi që:

a) është projektuar për të rritur cilësinë e shërbimit përkatës për klientin; dhe

b) nuk dëmton zbatimin e detyrimit nga shoqëria e investimit për veprimin e ndershëm, të drejtë dhe profesional, në përputhje me interesin më të lartë të klientëve të saj.

Ekzistenca, natyra dhe sasia e pagesës ose e përfitimit të përmendur në nënparagrafin e parë, ose në rastin kur sasia nuk mund të verifikohet, metoda e llogaritjes së sasisë duhet t'i komunikohet qartësisht klientit, në mënyrë gjithëpërfshirëse, të saktë dhe të kuptueshme, përpara ofrimit të shërbimit përkatës të investimit ose ndihmës. Kur gjen zbatim, shoqëria e investimit gjithashtu njofton klientin në lidhje me mekanizmat e transferimit të tarifës, komisionit, përfitime monetare ose jomonetare, të marra në lidhje me ofrimin e shërbimit të investimit ose ndihmës.

Pagesa ose përfitimi, i cili lejon ose është i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të investimit, si kostot e kujdestarit, komisionet e këmbimit dhe të shlyerjes, detyrimet rregulluese ose taksat ligjore, që sipas natyrës, nuk shkakton konflikte me detyrat e shoqërisë së investimit në lidhje me veprimin e ndershëm, të drejtë dhe profesional, në përputhje me interesin më të lartë të klientëve të saj, nuk i nënshtrohet kërkesave të përcaktuara në nënparagrafin e parë.

10. Shoqëria e investimit që ofron shërbime të investimit garanton shmangien e llogaritjes ose të vlerësimit të performancës së stafit të shoqërive të investimit, në mënyrë që të shmanget konflikti i detyrimit për të vepruar në interesin më të lartë të klientëve të saj. Në veçanti, ajo nuk bën marrëveshje në bazë të pagës, objektivave të shitjes ose të tjera, të cilat do të nxisnin stafit të saj t'i rekomandojë klientit individ vetëm një instrument të caktuar financiar, ndërkohë që shoqëria e investimit mund të ofrojë një instrument tjetër financiar, i cili plotëson më mirë nevojat e klientit.

11. Në rastin kur shërbimi i investimit ofrohet së bashku me një shërbim tjetër ose produkt, si pjesë e paketës ose si kusht për të njëjtën marrëveshje ose paketë, shoqëria e investimit njofton klientin në lidhje me mundësinë e blerjes veçmas të komponentëve të ndryshëm dhe siguron evidenca të veçanta lidhur me kostot dhe faturimet e secilit komponent.

Nëse ka gjasa që rreziqet rezultuese nga këto marrëveshje ose nga paketat e ofruara për klientin individ, të ndryshojnë nga rreziqet që shoqërojnë komponentët individualisht, shoqëria e

investimit siguron përshkrimin e përshtatshëm të komponentëve të ndryshëm të marrëveshjes ose të paketës, si dhe mënyrën e ndryshimit të rreziqeve përmes ndërveprimit të saj.

ESMA, në bashkëpunim me Autoritetin Bankar Evropian dhe EIOPA-n, jo më vonë se 3 janari 2016, zhvillon dhe përditëson në mënyrë periodike, udhëzimet për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e praktikave të shitjeve të ndërthurura, veçanërisht duke treguar rrethanat, në të cilat praktikatat e shitjeve të ndërthurura nuk përputhen me detyrimet e përcaktuara në paragrafin 1.

12. Në raste të jashtëzakonshme, shtetet anëtare mund të vendosin kërkesa shtesë për shoqëritë e investimit, në lidhje me çështjet e mbuluara nga ky nen. Këto kërkesa duhet të justifikohen në mënyrë objektive dhe proporcionale, për adresimin e rreziqeve specifike ndaj mbrojtjes së investitorit ose ndaj integritetit të tregut, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në rrethanat e strukturës së tregut të këtij shteti anëtar.

Shteti anëtar njofton Komisionin në lidhje me synimin e caktimit të çdo kërkesë në përputhje me këtë paragraf, pa vonesa të paarsyeshme dhe të paktën dy muaj përpara datës së caktuar për hyrjen në fuqi të kësaj kërkesë. Njoftimi përfshin arsyet për vendosje e kësaj kërkesë. Çdo kërkesë e tillë shtesë nuk kufizon ose ndikon të drejtat e shoqërive të investimit sipas neneve 34 dhe 35 të kësaj direktive.

Komisioni, brenda dy muajve nga njoftimi i përmendur në nënparagrafin e dytë, jep mendimin e tij mbi proporcionalitetin dhe arsyet për vendosjen e kërkesave shtesë.

Komisioni i komunikon shtetit anëtar kërkesat shtesë të caktuara në përputhje me këtë paragraf dhe i bën publike në faqen e tij të internetit.

Shtetet anëtare mund të mbajnë kërkesat që i janë njoftuar Komisionit, në përputhje me nenin 4 të Direktivës 2006/73/KE, përpara datës 2 korrik 2014, me kusht që të përmbushen kushtet e përcaktuara në këtë nen.

13. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për garantimin e përputhjes së shoqërisë së investimit me parimet e përcaktuara në këtë nen, në rastin kur ofrohen shërbime të investimit ose ndihmëse për klientët e tyre, duke përfshirë:

a) kushtet që duhet të përmbushë informacioni për të qenë i saktë, i qartë dhe joçorientues;

b) detajet në lidhje me përmbajtjen dhe formatin e informacionit për klientët, në lidhje me kategorizimin e klientëve, shoqërive të investimit dhe të shërbimeve të tyre, instrumenteve financiare, kostove dhe tarifave;

c) kriteret e vlerësimit të gamës së instrumenteve financiare të vëna në dispozicion në treg;

d) kriteret e vlerësimit të përputhshmërisë së shoqërive që marrin stimuj, me detyrimin për të vepruar me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm, në përputhje me interesin më të lartë të klientit.

Gjatë formulimit të kërkesave për informacion mbi instrumentet financiare në lidhje me germën "b" të paragrafit 4, informacioni i strukturës së produktit përfshihet, aty ku zbatohet, duke marrë në konsideratë çdo informacion standard përkatës të kërkuar sipas ligjit të Bashkimit Evropian.

14. Aktet e deleguara, të cilat përmenden në paragrafin 13, marrin në konsideratë:

a) natyrën e shërbimeve të ofruara ose të siguruara për klientin ose klientin e mundshëm, duke marrë në konsideratë natyrën, objektin, madhësinë dhe shpeshtësinë e transaksioneve;

b) natyrën dhe gamën e produkteve të ofruara ose të konsideruara, duke përfshirë llojet e ndryshme të instrumenteve financiare;

c) natyrën e klientit ose të klientëve të mundshëm, nëse është individ apo profesionist, ose, në rastin e paragrafëve 4 dhe 5, klasifikimin e tyre si kundërpalë të kualifikuara.

Neni 25

Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe raportimi të klientët

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit garantimin dhe vërtetimin, në bazë të kërkesës, sipas të cilës personat fizikë, që ofrojnë këshilla investimi ose informacion në lidhje me instrumentet financiare, me shërbimet e investimit ose me shërbimet ndihmëse për klientët në emër të shoqërisë së investimit, zotërojnë njohuritë dhe kompetencën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas nenit 24 dhe këtij neni. Shtetet anëtare bëjnë publike kriteret që do të përdoren për vlerësimin e këtyre njohurive dhe kompetencave.

2. Gjatë dhënies së këshillave të investimit ose të administrimit të portofolit, shoqëria e investimit siguron të gjithë informacionin e nevojshëm, në lidhje me njohurinë dhe eksperiencën e klientit ose të klientit të mundshëm në fushën e investimit me rëndësi në llojin e caktuar të produktit ose të shërbimit, gjendjen financiare të këtij personi, duke përfshirë aftësinë e tij për përballimin e humbjeve, dhe objektivat e tij investuese, duke përfshirë tolerancën e tij ndaj rrezikut me qëllim lejimin e rekomandimit, nga shoqëria e investimit, të shërbimeve dhe instrumenteve financiare të përshtatshme për klientin, dhe në veçanti përputhjen e tyre me tolerancën ndaj rrezikut dhe aftësinë për përballimin e humbjeve.

Nëse shoqëria e investimit ofron këshilla për shërbime të investimit, përmes rekomandimit të paketës së shërbimeve ose produkteve të grupuara sipas nenit 24, paragrafi 11, shtetet anëtare garantojnë përshtatshmërinë e paketës së grupuar.

3. Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e investimit, kur ofrojnë shërbime investimit të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 2, t'i kërkojnë klientit ose klientit të mundshëm të japë informacion në lidhje me njohjen ose përvojën e atij personi në fushën e investimit, lidhur me llojin specifik të produktit ose shërbimit që ofrohet ose kërkohet, në mënyrë që shoqëria e investimit të mund të vlerësojë nëse shërbimi apo produkti i investimit i parashikuar, është i përshtatshëm për klientin. Nëse grupi i shërbimeve ose i produkteve parashikohet sipas nenit 24, paragrafi 11, vlerësimi merr në konsideratë përshtatshmërinë e paketës së përgjithshme të grupuar.

Nëse shoqëria e investimit gjykon, në bazë të informacionit të marrë sipas nënparagrafit të parë, papërshtatshmërinë e produktit ose të shërbimit për klientin ose klientin e mundshëm, shoqëria e investimit paralajmëron klientin ose klientin e mundshëm. Ky paralajmërim mund të jepet përmes formularit standard.

Nëse klientët ose klientët e mundshëm nuk japin informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë, ose nëse japin informacion të pamjaftueshëm lidhur me njohjen dhe përvojën e tyre, shoqëria e investimit i paralajmëron ata se ajo nuk është në gjendje të përcaktojë nëse shërbimi apo produkti i parashikuar është i përshtatshëm për ta. Ky paralajmërim mund të jepet përmes formularit standard.

4. Shtetet anëtare i lejojnë shoqëritë e investimit që kur ofrojnë shërbime investimi që konsistojnë vetëm në ekzekutimin apo marrjen e urdhrave nga klientë me ose pa shërbime ndihmëse, duke përjashtuar dhënien e huave apo të kredive, të specifikuara në seksionin B.1 të shtojcës I, të cilat nuk përfshijnë kufijtë ekzistues të kredive ose huave, llogaritë rrjedhëse dhe overdraftet e klientëve, të ofrojnë këto shërbime investimi për klientët e tyre, pa qenë e nevojshme të marrin informacionin ose të dalin në përfundime, siç parashikohet në paragrafin 3, në rastin kur përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) shërbimet kanë lidhje me secilin nga instrumentet financiarë si më poshtë:

I. aksione të pranuar për tregtim në tregun e rregulluar ose në tregun e barasvlershëm të vendeve të treta, ose në MTF, në rastin kur ato janë aksione të shoqërive, dhe duke përjashtuar aksionet në sipërmarrje jashtë SIKTT të investimeve kolektive dhe aksione që përfshijnë një instrument derivativ;

II. obligacione ose forma të tjera të borxhit të titullzuar, të pranuar për tregtim në tregun e rregulluar ose në tregun e barasvlershëm të shtetit të tretë, ose në MTF, duke përjashtuar ato me përfshirje të instrumenteve derivative ose të strukturës, e cila e bën të vështirë për klientin të kuptojë rrezikun e përfshirë;

III. instrumente të tregut monetar, duke përjashtuar ato me përfshirje të instrumenteve derivative ose të strukturës, e cila e bën të vështirë për klientin të kuptojë rrezikun e përfshirë;

IV. aksionet ose kuotat e SIKTT-ve, duke përjashtuar SIKTT të strukturuar siç përmenden në nënparagrafin e dytë të nenit 36, paragrafi 1 të Rregullores (BE) Nr. 583/2010;

V. depozita të strukturuar, duke përjashtuar ato me përfshirje të strukturës, e cila e bën të vështirë për klientin të kuptojë rrezikun e kthimit ose kostove të daljes për klientin, përpara afatit të produktit;

VI. të tjera instrumente financiare jokomplekse sipas qëllimit të këtij paragrafi.

Për qëllime të kësaj pike, në rastin e plotësimit të kërkesave dhe të procedurave të përcaktuara sipas nënparagrafëve të tretë dhe të katërt të nenit 4, paragrafi 1 të Direktivës 2003/71/KE, tregu i vendit të tretë konsiderohet i barasvlershëm me tregun e rregulluar.

b) shërbimi ofrohet sipas nismës së klientit ose klientit të mundshëm;

c) klienti ose klienti i mundshëm informohet qartësisht se, për ofrimin e këtij shërbimi, shoqërisë së investimit nuk i kërkohet vlerësimi i përshtatshmërisë së instrumentit financiar ose të shërbimit të siguruar ose të ofruar, dhe se kështu ai nuk përfiton nga mbrojtja korresponduese e rregullave përkatëse të ushtrimit të veprimtarisë. Ky paralajmërim mund të jepet përmes formularit standard;

d) shoqëria e investimit është në përputhje me detyrimet e saj sipas nenit 23.

5. Shoqëria e investimit krijon regjistrin, që përfshin dokumentin ose dokumentet e rena dakord ndërmjet shoqërisë së investimit dhe klientit, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe kushte të tjera, sipas të cilave shoqëria e investimit ofron shërbimet për klientin. Të drejtat dhe detyrimet e palëve të kontratës mund të përfshihen, sipas referencës, në dokumente të tjera ose tekste ligjore.

6. Shoqëria e investimit i jep klientit raportet e përshtatshme, në lidhje me shërbimin e ofruar, përmes mjeteve rezistente. Këto raporte përfshijnë komunikime periodike për klientët, duke marrë në konsideratë llojin dhe kompleksitetin e instrumenteve financiare të përfshira dhe natyrën e shërbimit të ofruar për klientin, dhe përfshijnë, aty ku zbatohet, kostot e lidhura me transaksionet dhe shërbimet e kryera në emër të klientit.

Gjatë dhënies së këshillave të investimit, përpara kryerjes së transaksionit, shoqëria e investimit i jep klientit, përmes mjeteve rezistente, deklaratën e përshtatshmërisë, e cila specifikon këshillën që jepet dhe sesi kjo këshillë përmbush preferencat, objektivat dhe karakteristika të tjera të klientit individ.

Nëse marrëveshja për blerjen ose shitjen e instrumentit financiar lidhet përmes mjeteve të komunikimit në distancë, të cilat pengojnë dorëzimin paraprak të deklaratës së përputhshmërisë, shoqëria e investimit mund të ofrojë me shkrim, në mjete rezistente, deklaratën e përputhshmërisë, menjëherë pas lidhjes së çdo marrëveshjeje të klientit, me kusht që të përmbushen të dyja kushtet si më poshtë:

a) klienti jep miratimin e tij, pa vonesa të paarsyeshme, në lidhje me marrjen e deklaratës së përshtatshmërisë, pas përfundimit të transaksionit; dhe

b) shoqëria e investimit i ka dhënë klientit mundësinë e vonesës në transaksione, me qëllim marrjen paraprake të deklaratës së përshtatshmërisë.

Nëse shoqëria e investimit ofron administrimin e portofolit ose informon klientin se do të kryejë një vlerësim periodik të përshtatshmërisë, raporti periodik duhet të përmbajë një deklaratë të përditësuar, ku thuhet nëse investimi përmbush preferencat, objektivat dhe karakteristika të tjera të klientit individ.

7. Në rastin kur marrëveshja e kredisë, në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përdorura për banim, i nënshtrohet dispozitave përkatëse për vlerësimin e besueshmërisë së kredisë konsumatore, të përcaktuar në Direktivën 2014/17/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ka parakusht sigurimin e shërbimit të investimit për të njëjtin konsumator, në lidhje me kredinë hipotekare të lëshuar posaçërisht për sigurimin e financimit dhe të kushteve identike me marrëveshjen e kredisë lidhur me pasuritë e paluajtshme të banimit, me qëllim pagesën,

rifinancimin ose shlyerjen e huas, atëherë ky shërbim nuk i nënshtrohet detyrimeve të përcaktuara në këtë nen.

8. Gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve të investimit ose atyre ndihmëse për klientët e tij, Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, për garantimin e përputhjes së shoqërisë së investimit me parimet e përcaktuara në paragrafët 2 deri në 6 të këtij neni, duke përfshirë informacionin e marrë gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së shërbimeve dhe të instrumenteve financiare të klientëve të tyre, kriteret e vlerësimit të instrumenteve financiare jokomplekse për qëllime të paragrafit 4, germa "a", nënparagrafi VI. të këtij neni, përmbajtjen dhe formatin e regjistrave dhe të marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve për klientin, si dhe raportet periodike për klientët në lidhje me shërbimet e ofruara. Aktet e deleguara marrin në konsideratë:

a) natyrën e shërbimeve të ofruara ose të siguruara për klientin ose klientin e mundshëm, duke marrë në konsideratë llojin, objektin, madhësinë dhe shpeshtësinë e transaksioneve;

b) natyrën e produkteve të ofruara ose të konsideruara, duke përfshirë llojet e ndryshme të instrumenteve financiare;

c) natyrën e klientit ose të klientit të mundshëm, nëse është individ apo profesionist, ose në rastin e paragrafit 6, klasifikimin e tyre si kundërpalë të kualifikuara.

9. ESMA miraton, jo më vonë se 3 janari 2016, udhëzimet përcaktuese të kriterëve për vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të kërkuara sipas paragrafit 1.

10. ESMA zhvillon, jo më vonë se 3 janari 2016, si dhe përditëson rregullisht, udhëzimet për vlerësimin e:

a) instrumenteve financiare që përfshijnë strukturën, e cila e bën të vështirë për klientin të kuptojë rrezikun e përfshirë, në përputhje me pikat I dhe II të germës "a" të paragrafit 4;

b) depozita të strukturuar që përshijnë strukturën, e cila e bën të vështirë për klientin të kuptojë rrezikun e kthimit ose kostos së daljes përpara afatit të produktit, në përputhje me paragrafin 4, germa "a", nënparagrafi V.

11. ESMA zhvillon udhëzimet dhe i përditëson në mënyrë periodike, për vlerësimin e instrumenteve financiare të klasifikuara si jokomplekse, për qëllimet e paragrafit 4, germa "a", nënparagrafi VI, duke marrë në konsideratë aktet e deleguara sipas paragrafit 8.

Neni 26

Ofrimi i shërbimeve përmes mjeteve të një shoqërie tjetër investimi

Shtetet anëtare e lejojnë një shoqëri investimi që merr një udhëzim për të ofruar shërbime investimi ose shërbime ndihmëse në emër të klientit, përmes mjeteve të një shoqërie tjetër investimi, që të mbështetet në informacionin për klientin të transmetuar nga ajo shoqëri investimi. Shoqëria e investimit që ndërmjetëson udhëzimet është përgjegjëse që informacioni i transmetuar të jetë i plotë dhe i saktë.

Shoqëria e investimit që merr udhëzimet për kryerjen e shërbimeve në emër të klientit, sipas kësaj mënyre, mundet gjithashtu të mbështetet në çdo rekomandim, në lidhje me shërbimin ose transaksionin e ofruar për klientin nga një tjetër shoqëri investimi. Shoqëria e investimit që ndërmjetëson udhëzimet është përgjegjëse që rekomandimet ose këshillat e dhëna të jenë të përshtatshme për klientin.

Shoqëria e investimit, që merr udhëzimet ose urdhrat e klientit përmes mjeteve të shoqërive të tjera të investimit, mbetet përgjegjëse për përfundimin e shërbimit ose të transaksionit, në bazë të çdo informacioni ose rekomandimi të tillë, në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse të këtij titulli.

Neni 27

Detyrimi për ekzekutimin e urdhrave sipas kushteve më të favorshme për klientin

1. Gjatë ekzekutimit të urdhrave, shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit ndërmarrjen e hapave të mjaftueshme për arritjen e rezultatit më të mirë të mundshëm për klientët e tyre, duke marrë në konsideratë çmimin, kostot, shpejtësinë, mundësinë e ekzekutimit dhe të shlyerjes, madhësinë, natyrën, ose çdo faktor tjetër me rëndësi për ekzekutimin e urdhrave. Megjithatë, nëse ka udhëzime specifike të klientit, shoqëria e investimit ekzekuton urdhra sipas udhëzimit specifik.

Nëse shoqëria e investimit ekzekuton urdhra në emër të klientit individ, rezultati më i mirë i mundshëm përcaktohet në lidhje me konsiderimin e përgjithshëm, përfaqësimin e çmimit të instrumentit financiar dhe kostot në lidhje me zbatimin, që përfshijnë çdo shpenzim të kryer nga klienti, të cilat lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e urdhrave, duke përfshirë tarifën e vendit të ekzekutimit, tarifën e klerimit dhe të shlyerjes, si dhe çdo tarifë tjetër që u paguhet palëve të treta të përfshira në ekzekutimin e urdhrat.

Për qëllime të arritjes së rezultatit më të mirë të mundshëm në përputhje me nënparagrafin e parë, për më shumë se një platformë konkurruese në lidhje me ekzekutimin e urdhrat për instrumentin financiar, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e rezultateve të klientit, të cilat mund të arrihen përmes ekzekutimit të urdhrave në secilën platformë të ekzekutimit të urdhrave, që renditet në politikën e ekzekutimit të urdhrave të shoqërisë së aftë për ekzekutimin e këtij urdhri, komisionet e vetë shoqërisë së investimit dhe kostot e ekzekutimit të urdhrave për secilën platformë të kualifikuar për ekzekutimin e urdhrave, merren në konsideratë në këtë vlerësim.

2. Shoqëria e investimit nuk merr asnjë shpërblim, zbritje, ose përfitim jomonetar, në lidhje me përcaktimin e itinerareve të urdhrave të klientit për vende të caktuara të tregtimit ose platforma të caktuara të ekzekutimit të urdhrave, të cilat mund të shkelin kërkesat për konfliktet e interesit ose për stimujt, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij nenin dhe në nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 23 dhe 24.

3. Për instrumentet financiare që u nënshtrohen detyrimeve tregtare të neneve 23 dhe 28 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, shtetet anëtare kërkojnë që çdo vend i tregtimit dhe subjekt i brendshëm sistematik, si dhe çdo instrument tjetër financiar, të vërë në dispozicion të publikut dhe pa pagesë, të dhënat lidhur me cilësinë e ekzekutimit të transaksioneve në këtë vend

tregtimit, të paktën çdo vit, dhe në vijim të ekzekutimit të transaksionit në emër të një klienti, shoqëria e investimit të vërë në dijeni klientin, në rastet kur urdhri ekzekutohet. Raportet periodike përfshijnë hollësi në lidhje me çmimin, kostot, shpejtësinë dhe mundësinë e ekzekutimit të instrumenteve financiarë individualë.

4. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit vendosjen dhe zbatimin e masave efikase, me qëllim përputhjen me paragrafin 1. Në veçanti, shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit vendosjen dhe zbatimin e politikës së ekzekutimit të urdhrave, me qëllim arritjen, në lidhje me urdhrat e klientëve të tyre, të rezultatit më të mirë të mundshëm në përputhje me paragrafin 1.

5. Politika e ekzekutimit të urdhrave përfshin, në lidhje me çdo kategori të instrumenteve financiare, informacion mbi platformat e ndryshme të ekzekutimit të urdhrave të shoqërisë së investimit për klientët, dhe faktorët ndikues në zgjedhjen e platformës së ekzekutimit të urdhrave. Ajo përfshin të paktën platformat që i lejojnë shoqërisë së investimit arritjen, në baza konsistente, të rezultatit më të mirë për ekzekutimin e urdhrave të klientit.

Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit që t'u japin klientëve të tyre informacion të përshtatshëm, në lidhje me politikën e ekzekutimit të urdhrave të tyre. Ky informacion shpjegon në mënyrë të qartë, me hollësi të mjaftueshme, dhe në mënyrë që të kuptohet lehtësisht nga klientët, mënyrën e ekzekutimit të urdhrave të shoqërisë së investimit për klientët. Shtetet anëtare kërkojnë që shoqëritë e investimit të marrin miratimin paraprak të klientëve të tyre, në lidhje me politikën e ekzekutimit të urdhrave.

Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit, në rastin kur politika e ekzekutimit të urdhrave siguron mundësinë për ekzekutimin e urdhrave të klientit jashtë vendit të tregtimit, informimin, në veçanti, të klientëve të tyre mbi këtë mundësi. Përpara procedimit për ekzekutimin e urdhrave jashtë vendit të tregtimit, shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit marrjen paraprake të miratimit të shprehur të klientëve të tyre. Shoqëritë e investimit mund të marrin këtë miratim, qoftë në formën e marrëveshjes së përgjithshme, ose në lidhje me transaksionet individuale.

6. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit, që ekzekutojnë urdhrat e klientit për përmbledhjen dhe bërjen publike në bazë vjetore, për çdo kategori të instrumenteve financiare, të pesë vendeve kryesore të ekzekutimit të urdhrave, në lidhje me volumet tregtare, në të cilat një vit më parë, ato ekzekutuan urdhrat e klientit dhe informacionin mbi cilësinë e zbatimit të arritur.

7. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit, që ekzekutojnë urdhrat e klientit për monitorimin e efikasitetit të marrëveshjeve për ekzekutimin e urdhrave dhe të politikave të ekzekutimit, në mënyrë që të identifikohen dhe, kur është e përshtatshme, të korrigjohen të gjitha mangësitë. Në veçanti, ato vlerësojnë rregullisht, rastet kur vendet e ekzekutimit të urdhrave, të përfshira në politikën e ekzekutimit, sigurojnë rezultatin më të mirë të mundshëm për klientin, ose rastet kur është e nevojshme të bëhen ndryshime në masat e ekzekutimit, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, informacionin e botuar sipas paragrafëve 3 dhe 6. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit të njoftojnë klientët, me të cilët kanë marrëdhënie të vazhdueshme, për çdo ndryshim të rëndësishëm në masat e tyre të ekzekutimit të urdhrave ose të politikave të ekzekutimit.

8. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit që të jenë në gjendje t'u vërtetojnë klientëve të tyre, me kërkesë të tyre, se i kanë ekzekutuar urdhrat e tyre në përputhje me politikën ekzekutive të shoqërisë së investimit, si dhe t'i provojnë autoritetit kompetent, me kërkesë të tij, se e kanë zbatuar këtë nen.

9. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për:

a) kriteret përcaktuese të rëndësisë përkatëse për faktorë të ndryshëm, të cilët në përputhje me paragrafin 1, mund të merren në konsideratë gjatë përcaktimit të rezultatit më të mirë të mundshëm, duke marrë në konsideratë madhësinë dhe llojin e urdhrat, dhe natyrën e klientit, nëse është individ apo klient i kategorisë profesionistë;

b) faktorët që shoqëria e investimit mund të marrë në konsideratë gjatë rishikimit të masave të saj ekzekutive dhe rrethanave në të cilat mund të nevojiten ndryshime të këtyre masave. Në veçanti, faktorët për përcaktimin e vendeve që u lejojnë shoqërive të investimit arritjen e vazhdueshme të rezultatit më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrave të klientit;

c) natyra dhe përmasa e informacionit të siguruar për klientit, në lidhje me politikat e tyre ekzekutive sipas paragrafit 5.

10. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, që përcaktojnë:

a) përmbajtjen specifike, formatin dhe periodicitetin e të dhënave në lidhje me cilësinë e zbatimit, të cilat botohen në përputhje me paragrafin 3, duke marrë në konsideratë llojin e platformës së ekzekutimit të urdhrave dhe instrumentin financiar përkatës;

b) përmbajtjen dhe formatin e informacionit për t'u publikuar nga shoqëritë e investimit, në përputhje me paragrafin 6.

ESMA, jo më vonë se 3 korriku 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 28

Rregullat e trajtimit të urdhrave të klientit

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit, të autorizuar për ekzekutimin e urdhrave në emër të klientëve, zbatimin e procedurave dhe masave, të cilat sigurojnë ekzekutimin e përpiktë, të drejtë dhe të shpejtë të urdhrave të klientit, në raport me urdhrat e klientit ose interesat tregtare të shoqërisë së investimit.

Këto procedura ose masa lejojnë ekzekutimin e urdhrave të ngjashme të klientit, në përputhje me kohën e marrjes së tyre nga shoqëria e investimit.

2. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive, në rastin e urdhrimit limit të klientit, në lidhje me aksionet e pranuar për t'u tregtuar në tregun e rregulluar ose të treguara në vendin e tregtimit, të cilat nuk zbatohen menjëherë në kushte mbizotëruese të tregut, përveçse kur klienti shprehimisht udhëzohet ndryshe, marrjen e masave për lehtësimin, kur është e mundur, të ekzekutimit të këtij urdhri, duke e bërë publik menjëherë atë, në mënyrë që të lehtësojë aksesin në treg për pjesëmarrësit e tjerë. Shtetet anëtare mund të vendosin që shoqëritë e investimit të përmbushin këtë detyrim duke i përcjellë urdhrat limit të klientit në një vend tregtimi. Shtetet anëtare parashikojnë që autoritetet kompetente të mund të heqin dorë nga detyrimi për bërjen publike të urdhrave limit të cilat kanë përmasa të mëdha në krahasim me madhësinë normale të tregut, të përcaktuar sipas nenit 4 të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

3. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, të cilat vendosin:

a) kushtet dhe natyrën e procedurave dhe masave, të cilat rezultojnë në ekzekutimin e përpiktë, të drejtë dhe të shpejtë të urdhrave të klientit, dhe rrethanat, në të cilat, ose transaksionet për të cilat, shoqëritë e investimit devijojnë, në mënyrë të arsyeshme, nga ekzekutimi i përpiktë, me qëllim arritjen e kushteve më të favorshme për klientët;

b) metodat e ndryshme, përmes të cilave shoqëria e investimit konsiderohet në përmbushje të detyrimeve për nxjerrjen në treg të urdhrave limit të klientit, jo menjëherë të ekzekutueshme.

Neni 29

Detyrimet e shoqërive të investimit gjatë emërimit të palëve të lidhura

1. Shtetet anëtare i lejojnë shoqërisë së investimit caktimin e palëve të lidhura, me qëllim nxitjen e shërbimeve të shoqërisë së investimit, sigurimin e konsumatorëve ose marrjen e urdhrave të klientëve ose klientëve të mundshëm dhe transmetimin e tyre, vendosjen e instrumenteve financiare dhe ofrimin e këshillave në lidhje me këto instrumente dhe me shërbimet financiare të ofruara nga shoqëria e investimit.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërisë së investimit, në rastin kur ajo vendos të caktojë palën e lidhur, të mbetet plotësisht dhe në mënyrë të pakushtëzuar përgjegjëse për çdo veprim apo mosveprim të agjentit të lidhur, gjatë kohës që vepron në emër të shoqërisë së investimit. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërisë së investimit garantimin e komunikimit të kapacitetit veprues të palës së lidhur, sipas të cilit ai vepron, dhe shoqërinë e investimit, të përfaqësuar prej tij gjatë kontaktimit ose përpara marrëveshjeve me çdo klient ose klient të mundshëm.

Shtetet anëtare mund të lejojnë agjentët e lidhur, në përputhje me nenin 16, paragrafi 6, 8 dhe 9, që regjistrohen në territorin e tyre, të zotërojnë para dhe/ose instrumente financiare të klientëve, në emër dhe sipas përgjegjësisë së shoqërive të investimit, për të cilat ata veprojnë në territorin e tyre ose, në rastin e operimeve ndërkufitare, në territorin e shtetit anëtar, i cili i lejon agjentit të lidhur të mbajë paratë e klientit.

Shtete anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit monitorimin e aktiviteteve të palëve të tyre të lidhura, me qëllim garantimin e vazhdueshëm të përputhjes me këtë direktivë, ndërsa ato veprojnë përmes agjentëve të lidhur.

3. Agjentët e lidhur regjistrohen në regjistrin publik të shtetit anëtar ku ato janë themeluar. ESMA bën publik, në faqen e internetit, referencat ose hiperlidhjet e regjistrave publik që krijohen sipas këtij neni nga shtetet anëtare, të cilat vendosin të lejojnë shoqëritë e investimit të emërojnë agjentë të lidhur.

Shtetet anëtare garantojnë pranimin e palëve të lidhura vetëm në regjistrin publik, nëse konstatohet që ato kanë reputacion mjaftueshëm të mirë dhe zotërojnë njohuri të përgjithshme, tregtare dhe profesionale të përshtatshme, si dhe kompetencën për ofrimin e shërbimit të investimit ose shërbimeve ndihmëse, dhe për t'i komunikuar me saktësi klientit ose klientit të mundshëm, të gjithë informacionin përkatës në lidhje me shërbimin e propozuar.

Shtetet anëtare mund të vendosin që, në ushtrim të kontrolleve të përshtatshme, shoqëritë e investimit mund të verifikojnë nëse agjentët e lidhur të emëruar prej tyre kanë reputacion mjaftueshëm të mirë dhe zotërojnë njohuritë dhe kompetencat e përmendura në nënparagrafin e dytë.

Regjistri përditësohet rregullisht. Ai bëhet publikisht i disponueshëm për konsultim.

4. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit, që emërojnë agjentë të lidhur, marrjen e masave të përshtatshme, me qëllim shmangien e të gjitha ndikimeve negative, të agjentëve të lidhur që nuk mbulojnë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, në lidhje me veprimtaritë e ushtruara nga agjenti i lidhur në emër të shoqërisë së investimit.

Shtetet anëtare mund t'u lejojnë autoriteteve kompetente bashkëpunimin me shoqëritë e investimit dhe institucionet kredituese, shoqatat e tyre dhe subjekte të tjera, për regjistrimin e palëve të lidhura dhe monitorimin e përputhjes së palëve të lidhura me kërkesat e paragrafit 3. Në veçanti, palët e lidhura mund të regjistrohen nga shoqëria e investimit, institucioni kreditor ose shoqatat e tyre dhe subjekte të tjera nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent.

5. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit emërimin vetëm të palëve të lidhura, të cilat regjistrohen në regjistrat publikë të përmendur në paragrafin 3.

6. Shtetet anëtare mund të miratojnë ose të ruajnë dispozita më strikte se ato që përcaktohen në këtë nen, ose të shtojnë kërkesa të mëtejshme për palët e lidhura, të regjistruara në juridiksionin e tyre.

Neni 30

Transaksionet e kryera me kundërpalë të kualifikuara

1. Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e investimit të autorizuar për të ekzekutuar garantojnë arritjen ose hyrjen në transaksione të shoqërive të investimit, të autorizuar për ekzekutimin e urdhrave në emër të klientëve dhe/ose tregtimin për llogari të tyre dhe transmetimin e urdhrave, ose nisjen e transaksioneve me kundërpalët e kualifikuara, pa detyrimin

e përputhjes me nenin 24, me përjashtim të paragrafëve 4 dhe 5, neni 25, me përjashtim të paragrafit 6, nenit 27 dhe nenit 28, paragrafi 1, në lidhje me ato transaksione ose çdo shërbim ndihmës lidhur me këto transaksione.

Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë e investimit, në marrëdhënien e tyre me kundërpalët e kualifikuara, të veprojnë me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm dhe të komunikojnë në mënyrë të drejtë, të qartë dhe joorientuese, duke marrë në konsideratë natyrën e kundërpalës së kualifikuar dhe të veprimtarisë së saj.

2. Për qëllime të këtij neni, shtetet anëtare njohim si kundërpalë të kualifikuara shoqëritë e investimit, institucionet kredituese, shoqëritë e sigurimit, SIKTT-të dhe shoqëritë e tyre administruese, fondet e pensionit dhe shoqëritë e tyre administruese, institucione të tjera të autorizuar ose të rregulluara sipas ligjit të Bashkimit Evropian ose sipas të drejtës së brendshme të një shteti anëtar, qeveritë kombëtare dhe selitë e tyre korresponduese, duke përfshirë organet publike, që trajtojnë borxhin publik në nivel kombëtar, bankat qendrore dhe organizatat multinacionale.

Klasifikimi si kundërpalë e kualifikuar sipas nënparagrafit të parë nuk cenon të drejtën e këtyre entiteteve për kërkimin, qoftë përmes formularit të përgjithshëm, ose në bazë të tregtive individuale, të trajtimit të klientëve, veprimtaria tregtare e të cilëve kundrejt shoqërisë së investimit i nënshtrohet neneve 24, 25, 27 dhe 28.

3. Shtetet anëtare mund të njohin gjithashtu si kundërpalë të kualifikuara, sipërmarrjet e tjera që përmbushin kërkesat proporcionale të paracaktuara, duke përfshirë kufijtë sasior. Në rastin e transaksionit, në të cilin kundërpalët prospektive ndodhen në juridiksione të ndryshme, shoqëria e investimit merr parasysh statusin e sipërmarrjeve të tjera, siç përcaktohet nga ligji ose masat e shtetit anëtar, të themelimit të kësaj sipërmarrjeve.

Shtetet anëtare sigurohen që shoqëria e investimit, kur ekzekuton transaksione me këto sipërmarrje, në përputhje me paragrafin 1, të marrë konfirmimin e shprehur nga kundërpala prospektive, se ajo bie dakord të trajtohet si kundërpalë e kualifikuar. Shtetet anëtare mund t'i lejojnë shoqërisë së investimit marrjen e konfirmimit, qoftë në formën e marrëveshjes së përgjithshme, ose në lidhje me transaksione individuale.

4. Shtetet anëtare mund të njohin si kundërpalë të kualifikuara, ato subjekte të vendeve të treta të barasvlershme me ato kategori subjektësh të përmendura në paragrafin 2.

Shtetet anëtare mundet gjithashtu të njohin si kundërpalë të kualifikuara sipërmarrje të vendeve të treta, siç janë ato të përmendura në paragrafin 3, sipas të njëjtave kushte dhe në zbatim të të njëjtave kërkesa me ato që përcaktohen në paragrafin 3.

5. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, për të specifikuar:

a) procedurat për të kërkuar trajtim si klient, sipas paragrafit 2;

b) procedurat për marrjen e konfirmimit të shprehur nga kundërpalët e mundshme, sipas paragrafit 3;

c) kërkesat proporcionale të paracaktuara, duke përfshirë pragjet sasiore, të cilat mund të lejojnë konsiderimin e sipërmarrjes si kundërpalë e kualifikuar sipas paragrafit 3.

SEKSIONI 3

TRANSPARENCA E TREGUT DHE INTEGRITETI

Neni 31

Monitorimi i respektimit të rregullave të MTF-së ose të platformës së përbashkët të tregtimit, si dhe i detyrimeve të tjera ligjore

1. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, të cilët operojnë një MTF ose një platformë të përbashkët tregtimi, të vendosin e zbatojnë masa dhe procedura efikase në lidhje me MTF-në ose platformë e përbashkët të tregtimit, me qëllim monitorimin e rregullt të respektimit të rregullave të saj nga anëtarët, pjesëmarrësit ose përdoruesit e saj. Shoqëritë e investimit dhe operatorët e tregut që operojnë MTF-në ose në platformën e organizuar të tregtimit, monitorojnë urdhrat e dërguar, duke përfshirë anulimet dhe transaksionet e ndërmarra nga anëtarët, pjesëmarrësit ose përdoruesit e tyre, për të identifikuar shkeljet e këtyre rregullave, të kushteve të parregullta të tregtimit, të sjelljeve të cilësuar të ndaluara sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014, ose të parregullsive të sistemit në lidhje me instrumentin financiar, si dhe për vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme për garantimin e efikasitetit monitorues.

2. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, që operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, të informojnë menjëherë autoritetin kompetent për shkeljet e rëndësishme në rregullat e saj, ose për kushtet e parregullta të tregtimit, ose për sjelljen e cilësuar të ndaluar sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014, ose për parregullsitë lidhur me instrumentin financiar.

Autoritetet kompetente të shoqërive të investimit dhe operatorët e tregut, që operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, i komunikojnë ESMA-s dhe autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë.

Në lidhje me sjelljen e cilësuar të ndaluar sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014, autoriteti kompetent duhet të jetë i bindur që kjo sjellje është kryer ose kryhet, përpara se të njoftojë autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare dhe ESMA-n.

3. Shtetet anëtare gjithashtu u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, që operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, t'i japin autoritetit kompetent, pa vonesa, informacionin e përmendur në paragrafin 2, për hetimin dhe ndjekjen penale të abuzimeve në treg dhe t'i japin mbështetje të plotë këtij të fundit në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të abuzimit në treg, që ndodhin në, ose përmes sistemeve të tij.

4. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, për përcaktimin e rrethanave që japin shkasë për kërkesën për informacion, siç përmendet në paragrafin 2 të këtij neni.

Pezullimi dhe çregjistrimi i instrumenteve financiare nga tregtimi në MTF ose në platformën e përbashkët të tregtimit.

1. Pa cenuar të drejtën e autoritetit kompetent sipas nenit 69, paragrafi 2, për të kërkuar pezullimin ose nxjerrjen e instrumentit financiar nga tregtimi, shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, mund të pezullojë ose të nxjerrë nga tregtimi, instrumentin financiar, që nuk përmbush më rregullat e MTF-së ose të platformës së përbashkët të tregtimit, përveçse kur ky pezullim ose nxjerrje nga tregtimi do të shkaktonte dëme të konsiderueshme në interesat e investitorit ose në funksionimin e rregullt të tregut.

2. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, që operojnë MTF-në ose platformën e përbashkët të tregtimit, të cilët pezullojnë ose nxjerrin nga tregtimi instrumentin financiar, që gjithashtu të pezullojnë ose të nxjerrin nga tregtimi derivativët e përmendur në pikat 4 deri në 10 të seksionit C, të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar, aty ku është e nevojshme, për mbështetjen e objektivave për pezullimin ose nxjerrjen nga tregtimi të instrumentit financiar. Shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon një MTF ose një platformë të përbashkët tregtimi, bën publik vendimin e saj për pezullimin ose nxjerrjen nga tregtimi të instrumentit financiar dhe të çdo derivativi dhe ia komunikon vendimet autoritetit të tij kompetent.

Autoriteti kompetent, në juridiksionin e të cilit ka origjinë pezullimi ose nxjerrja nga tregtimi, kërkon nga tregjet e rregulluara, MTF-ve të tjera, platformat e tjera të përbashkëta të tregtimit dhe subjektet e brendshme sistematike që ndodhen në juridiksionin e tij dhe tregtojnë të njëjtat instrumente financiare apo derivativët e përmendur në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I të kësaj direktive, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar, që gjithashtu të pezullojnë ose të nxjerrin nga tregtimi instrumentit financiar ose derivativin, në rastin kur pezullimi ose nxjerrja nga tregu është bërë për shkak të dyshimeve për abuzim në treg, abuzim me një tender publik, ose moszbulimin e informacionit të brendshëm rreth emetuesit ose instrumentit financiar, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Rregullores (BE) nr. 596/2014, përveçse kur ky pezullim ose nxjerrje nga tregu do të shkaktonte dëme të konsiderueshme në interesat e investitorit ose në funksionimin e rregullt të tregut.

Autoriteti kompetent menjëherë bën publik dhe i komunikon këtë vendim ESMA-s dhe autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare.

Autoritetet kompetente të njoftuara të shteteve të tjera anëtare u kërkojnë tregjeve të rregulluara, MTF-ve të tjera, platformave të tjera të përbashkëta të tregtimit dhe subjekteve të brendshme sistematike që ndodhen në juridiksionin e tyre dhe që tregtojnë të njëjtat instrumente financiare ose derivativë, me ato të përmendura në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar, që gjithashtu të pezullojnë ose të nxjerrin nga tregtimi instrumentin financiar ose derivativin, në rastin kur pezullimi ose nxjerrja nga tregtimi është bërë për shkak të dyshimeve për abuzim në treg, abuzim me një tender publik, ose moszbulimin e informacionit të brendshëm rreth emetuesit ose instrumentit financiar, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Rregullores (BE) nr. 596/2014, përveçse kur ky pezullim ose nxjerrje nga

tregu do të shkaktoje dëme të konsiderueshme në interesat e investitorit ose në funksionimin e rregullt të tregut.

Secili autoritet kompetent i njoftuar komunikon vendimin të ESMA dhe autoritetet e tjera kompetente duke përfshirë justifikimin, në rastin kur vendimi nuk pezullon ose çregjistron tregtimin e instrumentit financiar ose derivativ, të përmendura në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar.

Ky paragraf gjithashtu zbatohet në rastin e heqjes së pezullimit të tregtimit të instrumentit financiar ose derivativ, të përmendura në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar.

Procedura e njoftimit të përmendur në këtë paragraf gjithashtu zbatohet në rastin kur vendimi i pezullimit ose nxjerrjes nga tregtimi të instrumentit financiar ose derivativit të përmendur në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar, merret nga autoriteti kompetent sipas nenit 69, paragrafi 2, germat "m" dhe "n".

Për të garantuar zbatimin proporcional të detyrimit për pezullimin ose nxjerrjen nga tregtimi të këtyre derivativëve, ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, për të specifikuar më tej rastet, në të cilave lidhja ndërmjet një derivativi, të përmendur në pikat 4 dhe 10 të seksionit C të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen një instrumenti financiar të pezulluar ose të nxjerrë nga tregtimi dhe instrumentit financiar autentik gjithashtu nënkupton që edhe derivativi duhet të pezullohet e të nxirret nga tregtimi, në mënyrë që të arrihet objektivi i pezullimit ose nxjerrjes nga tregtimi të instrumenti financiar.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. ESMA zhvillon draft standardet teknike zbatuese për përcaktimin e formateve dhe afateve kohore të komunikimeve dhe të publikimit të përmendur në paragrafin 2.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

4. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për renditjen e situatave, të cilat dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme interesat e investitorit dhe funksionimin e rregullt të tregut të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

SEKSIONI 4

TREGJET NË RRIJJE TË SME-VE

Neni 33

Tregjet në rritje të SME-ve

1. Shtetet anëtare parashikojnë që operatori i MTF-së mund të aplikojë në autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, për regjistrimin e MTF-së si treg në rritje i SME-ve.

2. Shtetet anëtare parashikojnë që autoritetin kompetent mund të regjistrojë MTF-në si treg në rritje i SME-ve, nëse autoriteti kompetent merr aplikimin e përmendur në paragrafin 1 dhe bindet se janë përmbushur kërkesat e paragrafit 3 në lidhje me MTF-në.

3. Shtetet anëtare garantojnë nënshkrimin e MTF-ve ndaj rregullave, sistemeve dhe procedurave efikase, të cilat garantojnë përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

a) të paktën 50% e emetuesve, instrumentet financiare të të cilëve pranohen për t'u tregtuar në MTF, janë SME në momentin e regjistrimit të MTF-së si treg në rritje i SME-ve dhe për çdo viti tjetër kalendarik në vijim;

b) të jenë caktuar kriteret për pranimin fillestar dhe në vazhdim për tregtimin e instrumenteve financiare të emetuesve në treg;

c) në momentin e pranimit fillestar për tregtimin në treg të instrumenteve financiare, ekziston informacion i mjaftueshëm, i bërë publik, për t'i lejuar investitorëve të marrjen e vendimeve të informuar për të investuar ose jo në instrumente financiare, qoftë një dokument i përshtatshëm pranimit ose një prospekt, nëse janë të zbatueshme kërkesat e përcaktuara në Direktivën 2003/71/KE në lidhje me ofertën publike që bëhet në lidhje me pranimin fillestar për tregtim të instrumentit fillestar në MTF;

d) ekzistojnë raporte të përshtatshme në lidhje me raportimin financiar, të vazhdueshëm dhe periodik, nga ose në emër të emetuesit në treg, për shembull raportet vjetore të audituara;

e) emetuesit në treg, të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 1, pika 21 të Rregullores (BE) nr. 596/2014, personat me përgjegjësi administruese siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 1, pika 25 të Rregullores (BE) nr. 596/2014 dhe personat e lidhur ngushtë me ta, të përkufizuar në nenin 3, paragrafi 1, pika 26 të Rregullores (BE) nr. 596/2014, përmbushin kërkesat përkatëse, të zbatueshme për ta sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014;

f) informacioni rregullator, në lidhje me emetuesit në treg, ruhet dhe i shpërndahet publikut;

g) ekzistojnë sisteme dhe kontrolle efikas, të cilat synojnë parandalimin dhe zbulimin e abuzimit në treg, siç kërkohet sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014.

4. Kriteret e paragrafit 3 nuk cenojnë përmbushjen nga shoqëria e investimit ose nga operatori i tregut, që operon një MTF, të detyrimeve sipas kësaj direktive, në lidhje me operimin e MTF-ve. Gjithashtu, ato nuk i parandalojnë shoqëritë e investimit ose operatorët e tregut, që operojnë një MTF, të vendosin kërkesa shtesë, përveç atyre të specifikuara në atë paragraf.

5. Shtetet anëtare parashikojnë që autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, të mund të çregjistrojë MTF-në si treg në rritje i SME-ve, në secilin nga rastet e mëposhtme:

a) shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon tregun, aplikon për çregjistrimin e saj;

b) nuk përmbushen më kërkesat e paragrafit 3 në lidhje me MTF-në.

6. Shtetet anëtare i kërkojnë autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës, që në rastin e regjistrimit ose çregjistrimit të MTF-së si treg në rritje i SME-ve sipas këtij neni, të njoftojë ESMA-n, sa më shpejt të jetë e mundur, në lidhje me këtë regjistrim ose çregjistrim. ESMA boton në faqen e saj të internetit listën e tregjeve në rritje të SME-ve dhe e përditëson atë.

7. Në rastin kur instrumenti financiar i emetuesit pranohet për t'u tregtuar në tregun në rritje të SME-ve, shtetet anëtare gjithashtu kërkojnë tregtimin e tij në një tjetër treg në rritje të SME-ve, vetëm në rastin kur emetuesi njoftohet dhe nuk ka kundërshtime. Megjithatë, në këtë rast, emetuesi nuk i nënshtrohet asnjë detyrimi, që lidhet me qeverisjen e korporatave ose me nxjerrjen fillestare, të vazhdueshme ose të posaçme të informacionit, në lidhje me tregun në rritje të SME-ve.

8. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për përcaktimin e kërkesave të mëtejshme të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni. Masat marrin në konsideratë nevojën që kërkesat të ruajnë nivele të larta të mbrojtjes së investitorit, me qëllim nxitjen e besimit të investitorit për këto tregje, duke minimizuar barrët administrative për emetuesit në treg, dhe se çregjistrimet nuk ndodhin, dhe as regjistrimet nuk refuzohet thjesht si rezultat i dështimit të përkohshëm, në lidhje me përmbushjen e kushteve të përcaktuara në germën "a" të paragrafit 3 të këtij neni.

KAPITULLI III

TË DREJTAT E SHOQËRIVE TË INVESTIMIT

Neni 34

Liria e ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit

1. Shtetet anëtare garantojnë, për çdo shoqëri të investimit të autorizuar dhe të mbikëqyrur nga autoritetet kompetente të një shteti tjetër anëtar, në përputhje me këtë direktivë dhe në lidhje me institucionet kredituese, në përputhje me Direktivën 2013/36/BE, mundësinë e ofrimit lirisht të shërbimeve të investimit dhe/ose të kryerjes së aktiviteteve të investimit, si dhe të shërbimeve ndihmëse brenda territorit të tyre, me kusht mbulimin e këtyre shërbimeve dhe aktiviteteve nga autorizimi i saj. Shërbimet ndihmëse mund të ofrohen së bashku me shërbimin dhe/ose aktivitetin e investimit.

Shtetet anëtare nuk vendosin kërkesa shtesë për këtë shoqëri investimi ose institucion kreditor, në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo direktivë.

2. Shoqëria e investimit, e cila për herë të parë, dëshiron të ofrojë shërbime ose aktivitete brenda territorit të një shteti tjetër anëtar, ose e cila dëshiron të ndryshojë gamën e shërbimeve ose aktiviteteve të ofruara në këtë mënyrë, i komunikon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës informacionin si më poshtë:

a) shtetin anëtar, në të cilin synon të operojë;

b) programin e operimeve ku përmenden në veçanti shërbimet dhe/ose veprimtaritë e investimit si dhe shërbimet ndihmëse që ajo synon të ofrojë në territorin e atij shteti anëtar dhe nëse ajo synon ta bëjë këtë përmes agjentëve të lidhur, të themeluar në shtetin e saj anëtar të origjinës. Nëse shoqëria e investimit synon të përdorë agjentë të lidhur, ajo i komunikon autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së saj identitetin e këtyre agjentëve të lidhur.

Nëse shoqëria e investimit synon të përdorë agjentët e lidhur, të themeluar në shtetin e saj të origjinës, në territorin e shtetit anëtar, ku synon ofrimin e shërbimeve për autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit, brenda një muaji nga marrja e të gjithë informacionit, ajo i komunikon autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës, të caktuar si pikë kontakti në përputhje me nenin 79, paragrafi 1, identitetin e agjentëve të lidhur që shoqëria e investimit synon t'i përdorë për ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit në atë shtet anëtar. Shteti anëtar pritës bën publik këtë informacion. ESMA mund të kërkojë akses në këtë informacion, në përputhje me procedurën dhe sipas kushteve të përcaktuara në nenin 35 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, brenda një muaji nga marrja e informacionit, ia përcjell atë autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës, të caktuar si pikë kontakti në përputhje me nenin 79, paragrafi 1. Shoqëria e investimit më pas mund të nisë ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të investimit në shtetin anëtar pritës.

4. Në rastin e ndryshimit të ndonjë detaji të komunikuar në përputhje me paragrafin 2, shoqëria e investimit ia njofton me shkrim këtë ndryshim autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës, të paktën një muaj përpara zbatimit të ndryshimit. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës njofton autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës lidhur me këtë ndryshim.

5. Çdo institucion kreditor që dëshiron të ofrojë shërbime ose aktivitete investimi, si dhe shërbime ndihmëse në përputhje me paragrafin 1, përmes agjentëve të lidhura, njofton autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës mbi identitetin e këtyre agjentëve të lidhur.

Nëse institucioni kreditor synon që agjentët e lidhur, të themeluar në shtetin e tij anëtar të origjinës, t'i përdorë në territorin e shteteve anëtare në të cilat ai synon të ofrojë shërbime, atëherë autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës së institucionit kreditor, brenda një muaji nga marrja e të gjithë informacionit, i komunikon autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës, të caktuar si pikë kontakti në përputhje me nenin 79, paragrafi 1, identitetin e agjentëve të lidhur, që institucioni kreditor synon t'i përdorë për ofrimin e shërbimeve në atë shtet anëtar. Shteti anëtar pritës bën publik këtë informacion.

6. Shtetet anëtare, pa kërkesa të mëtejshme ligjore ose administrative, u lejojnë shoqërive të investimit dhe operatorëve të tregut, që operojnë MTF-të ose platformat e përbashkëta të tregtimit, nga shtete të tjera anëtare, që të sigurojnë masat e duhura në territorin e tyre, me qëllim lehtësimin e aksesit dhe tregtimin nga distanca në këto tregje, nga përdoruesit, anëtarët, ose pjesëmarrësit e themeluar në territorin e tyre.

7. Shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon një MTF ose një platformë të përbashkët tregtimi, i komunikon autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së tij, shtetin anëtar, në të cilin synon të vendosë këto masa. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës i komunikon këtë informacion, brenda një muaji, autoritetit kompetent të shtetit anëtar, në të cilin MTF-ja ose platforma e përbashkët e tregtimit synon të vendosë këto masa.

Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës të MTF-së komunikon, sipas kërkesës të autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës të MTF-së, dhe pa vonesa të paarsyeshme, identitetin e anëtarëve ose pjesëmarrësve të MTF-së, të themeluar në këtë shtet anëtar.

8. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore për të specifikuar informacionin që do të njoftohet në përputhje me paragrafët 2, 4, 5 dhe 7.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

9. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike për caktimin e formularëve standard, të modeleve, dhe të procedurave për transmetimin e informacionit në përputhje me paragrafët 3, 4, 5 dhe 7.

ESMA, jo më vonë se data 31 dhjetor 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 35

Themelimi i degës

1. Shtetet anëtare garantojnë sigurimin e mundshëm të shërbimeve dhe/ose aktiviteteve të investimit brenda territoreve të tyre, në përputhje me këtë direktive dhe me Direktivën 2013/36/BE, përmes të drejtës së themelimit, qoftë përmes themelimit të degës ose përdorimit të agjentit të lidhur, të themeluar në shtetin anëtar jashtë shtetit anëtar të origjinës, me kusht që këto shërbime dhe aktivitete të mbulohen nga autorizimi i dhënë për shoqërinë e investimit ose për institucionin kreditor në shtetin anëtar të origjinës. Shërbimet ndihmëse mund të ofrohen së bashku me shërbimin dhe/ose aktivitetin e investimit.

Shtetet anëtare nuk vendosin kërkesa shtesë, përveç atyre të lejuara sipas paragrafit 8, për organizimin dhe operimin e degës, në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo direktivë.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë çdo shoqërie investimi që dëshiron të themelojë degë brenda territorit të një shteti tjetër anëtar, ose të përdorë agjentë të lidhur, të themeluar në një shtet tjetër anëtar, në të cilin nuk ka themeluar degë, të njoftojë fillimisht autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës së tij, dhe t'i japë informacionin si më poshtë:

a) shtetet anëtare, brenda territorit të të cilave synon të themelojë degën ose shtetet anëtare në të cilat nuk ka themeluar degën, por synon të përdorë agjentë të lidhur, të themeluara në atë territor;

b) një program të operimeve që përcakton, ndër të tjera, shërbimet dhe/ose aktivitetet e investimit, si dhe të shërbimeve ndihmëse që do të ofrohen;

c) nëse themelohet, strukturën organizative të degës, ku tregohet nëse dega synon të përdorë agjentë të lidhur dhe identiteti i tyre;

d) nëse do të përdoren agjentë të lidhur në shtetin anëtar, në të cilin shoqëria e investimit nuk ka themeluar degën, një përshkrim të përdorimit të synuar të agjentëve të lidhur dhe strukturën organizative, duke përfshirë linjat e raportimit, ku tregohet pozicioni i agjentëve të lidhur në strukturën korporative të shoqërisë së investimit;

e) adresën në shtetin anëtar pritës nga ku mund të merren dokumentet;

f) emrat e personave përgjegjës për administrimin e degës ose të agjentit të lidhur.

Nëse shoqëria e investimit përdor agjentë të lidhur, të themeluar në një shtet anëtar jashtë shtetit anëtar të origjinës, ky agjent i lidhur bëhet pjesë e degës, nëse është e themeluar, dhe në çdo rast i nënshtrohet dispozitave të kësaj direktive në lidhje me degët.

3. Përveç rasteve kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës kanë arsye të vënë në dyshim përshtatshmërinë e strukturës administrative ose situatën financiare të shoqërisë së investimit, duke marrë parasysh veprimtaritë e parashikuara, ato, brenda tre muajve nga marrja e të gjithë informacionit, ia komunikojnë këtë informacion autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës, të caktuar si pikë kontakti në përputhje me nenin 79, paragrafi 1, si dhe informojnë përkatësisht shoqërinë e investimit.

4. Përveç informacionit të përmendur në paragrafin 2, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës i komunikon autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës detajet e skemës së akredituar të kompensimit, në të cilën shoqëria e investimit është anëtare në përputhje me Direktivën 97/9/KE. Në rast të ndryshimeve në informacion, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës informon përkatësisht autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës.

5. Nëse autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës refuzon t'i komunikojë informacionin autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës, ai, brenda tre muajve nga marrja e të gjithë informacionit, i paraqet shoqërisë së investimit arsyet e refuzimit.

6. Me marrjen e komunikimit nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës, ose nëse ky i fundit nuk e bën këtë komunikim, maksimumi pas dy muajsh nga data e transmetimit të komunikimit nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, dega mund të themelohet dhe të fillojë veprimtarinë.

7. Çdo institucion kreditor, i cili dëshiron të përdorë agjent të lidhur, të themeluar në shtetin anëtar jashtë shtetit anëtar të origjinës, për ofrimin e shërbimeve ose/dhe aktiviteteve të investimit, si dhe të shërbimeve ndihmëse, në përputhje me këtë direktivë, njofton autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës së tij, dhe i jep atij informacionin e përmendur në paragrafin 2.

Përveç rasteve kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës kanë arsye të vënë në dyshim përshtatshmërinë e strukturës administrative ose situatën financiare të institucionit kredites, ato, brenda tre muajve nga marrja e të gjithë informacionit, ia komunikojnë këtë informacion autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës, të caktuar si pikë kontakti në përputhje me nenin 79, paragrafi 1, si dhe informojnë përkatësisht institucionin kredites.

Nëse autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës refuzon t'i komunikojë informacionin autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës, ai, brenda tre muajve nga marrja e të gjithë informacionit, i paraqet institucionit kredites arsyet e refuzimit.

Me marrjen e komunikimit nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës, ose nëse ky i fundit nuk e bën këtë komunikim, maksimumi pas dy muajsh nga data e transmetimit të komunikimit nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, agjenti i lidhur mund të fillojë veprimtarinë. Ky agjent i lidhur i nënshtrohet dispozitave të kësaj direktive, në lidhje me degët.

8. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar, në të cilin ndodhet dega, merr përgjegjësinë për garantimin që shërbimet e ofruara nga dega, në territorin e tij, të përmbushin detyrimet e përcaktuar anë nenet 24, 25, 27, 28 të kësaj direktive dhe nenet 14 deri në 26 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, si dhe masat e miratuara sipas tyre, nga shteti anëtar pritës, nëse lejohet sipas nenit 24, paragrafi 12.

Autoriteti kompetent i shtetit anëtar, në të cilin ndodhet dega, ka të drejtën e shqyrtimit të marrëveshjeve të degës dhe të kërkojë këto ndryshime, vërtet të nevojshme për t'i lejuar autoritetit kompetent zbatimin e detyrimeve sipas neneve 24, 25, 27, 28 të kësaj direktive dhe neneve 14 deri në 26 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, si dhe masat e miratuara në përputhje me to, në lidhje me shërbimet dhe/ose aktivitetet e ofruara nga dega, brenda territorit të tij.

9. Çdo shtet anëtar parashikon që, kur një shoqëri investimi e autorizuar në një tjetër shtet anëtar ka themeluar degë në territorin e tij, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë së investimit, në ushtrim të përgjegjësisive të tij dhe pasi të informojë autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, mund të kryejë kontrolle në terren në atë degë.

10. Në rastin e ndryshimit të ndonjë informacioni të komunikuar në përputhje me paragrafin 2, shoqëria e investimit ia njofton me shkrim këtë ndryshim autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës, të paktën një muaj përpara zbatimit të ndryshimit. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës gjithashtu informohet mbi këtë ndryshim nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës.

11. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore për të specifikuar informacionin që do të njoftohet në përputhje me paragrafët 2, 4, 7 dhe 10.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

12. ESMA zhvillon draft standardet teknike zbatuese për caktimin e formularëve standard, të modeleve, dhe të procedurave për transmetimin e informacionit në përputhje me paragrafët 3, 4, 7 dhe 10.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 36

Aksesi në tregjet e rregulluara

1. Shtetet anëtare u kërkojnë shoqërive të investimit të shteteve të tjera anëtare, të cilat autorizohen për ekzekutimin e urdhrave të klientit, ose për tregtimin për llogari të tyre, të drejtën e anëtarësimit ose dhënien e aksesit në tregjet e rregulluara, të themeluara në territorin e tyre, me anë të secilës prej masave të mëposhtme:

a) drejtpërdrejt, përmes themelimit të degëve në shtetet anëtare pritëse;

b) duke u bërë anëtarë nga distanca ose duke pasur akses nga distanca, në tregjet e rregulluara, pa qenë nevoja për të themeluar tregun e rregulluar në shtetin anëtar të origjinës, në rastin kur procedurat dhe sistemet e tregut në fjalë, nuk kërkojnë praninë fizike për ekzekutimin e transaksioneve në treg.

2. Shtetet anëtare nuk vendosin kërkesa shtesë rregullatore ose administrative, në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo direktivë, për shoqëritë e investimit që ushtrojnë të drejtat e akorduara nga paragrafi 1.

Neni 37

Aksesi në kundërpalët qendrore, sistemet e klerimit dhe të shlyerjes, dhe e drejta e përcaktimit të sistemit të shlyerjes

1. Pa cenuar titujt III, IV ose V të Rregullores (BE) nr. 648/2012, shtetet anëtare i kërkojnë shoqërive të investimit zotërimin e të drejtës së aksesit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë

në kundëpalët qendrore, në sistemet e klerimit dhe të shlyerjes në territorin e tyre, me qëllim ekzekutimin ose organizimin e ekzekutimit të transaksioneve në instrumente financiare.

Shtetet anëtare kërkojnë që aksesit i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i këtyre shoqërive investimi në këto ambiente, t'i nënshtrohet të njëjtave kritere jodiskriminuese, transparente dhe objektive, që zbatohen për anëtarët ose pjesëmarrësit vendas. Shtetet anëtare nuk kufizojnë përdorimin e këtyre ambienteve për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve në instrumente financiare, të ndërmarra në vendin e tregimit të territorit të tyre.

2. Shtetet anëtare kërkojnë që tregjet e rregulluara në territorin e tyre, t'u ofrojnë të gjithë anëtarëve dhe pjesëmarrësve të tyre të drejtën për të caktuar sistemin për shlyerjen e transaksioneve në instrumente financiare, të ndërmarrë në atë treg të rregulluar, në zbatim të kushteve të mëposhtme:

a) këto lidhje dhe marrëveshje ndërmjet sistemit të caktuar të shlyerjes dhe çdo sistemi tjetër ose ambienti tjetër, të nevojshëm për garantimin e shlyerjes efikase dhe ekonomike të transaksionit në fjalë;

b) marrëveshja e autoritetit kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të rregulluar, që kushtet teknike për shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në tregun e rregulluar përmes sistemit të shlyerjes, të ndryshëm nga ai i caktuar nga tregu i rregulluar, të jenë të tilla që të lejojnë funksionimin normal dhe të rregullt të tregjeve financiare.

Vlerësimi i tregut të rregulluar nga autoriteti kompetent, nuk duhet të cenojë kompetencat e bankave qendrore kombëtare si mbikëqyrëse të sistemeve të shlyerjes ose të autoriteteve të tjera mbikëqyrëse që kanë kompetenca në lidhje me këto sisteme. Autoriteti kompetent merr në konsideratë mbikëqyrjen tashmë të ushtruar nga këto institucione, me qëllim shmangien e dublikimit të paarsyeshëm të kontrollit.

Neni 38

Dispozitat në lidhje kundërpalët qendrore, marrëveshjet e klerimit dhe të shlyerjes, në lidhje me MTF-të

1. Shtetet anëtare nuk i ndalojnë shoqëritë të investimit dhe operatorët e tregut, të cilët operojnë një MTF, që të lidhin marrëveshje të përshtatshme me një kundërpalë qendrore ose shtëpi klerimi, dhe me një sistem shlyerjeje të një shteti tjetër anëtar, me synimin për të parashikuar klerimin dhe/ose shlyerjen e disave apo të gjitha tregtimeve, të përfunduara në sistemet e tyre, nga anëtarët ose pjesëmarrësit.

2. Autoriteti kompetent i shoqërive të investimit dhe operatorët e tregut, që operojnë një MTF, nuk mund të kundërshtojnë përdorimin e kundërpalëve qendrore, të shtëpive të klerimit, dhe/ose të sistemeve të shlyerjes në një shtet tjetër anëtar, përveçse kur shihet qartësisht si e nevojshme për ruajtjen dhe funksionimin e rregullt të kësaj MTF-je, si dhe duke marrë në konsideratë kushtet e sistemeve të shlyerjes, të krijuara sipas nenit 37, paragrafi 2.

Për shmangien e dublikimit të paarsyeshëm të kontrollit, autoriteti kompetent merr në konsideratë mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve të klerimit dhe të shlyerjes, tashmë të

ushtruara nga bankat qendrore, si mbikëqyrëse të sistemeve të klerimit dhe të shlyerjes, ose nga autoritete të tjera mbikëqyrëse me kompetenca në lidhje me këto sisteme.

KAPITULLI IV

OFRIMI I SHËRBIMEVE DHE AKTIVITETEVE TË INVESTIMIT NGA SHOQËRITË E VENDEVE TË TRETË

SEKSIONI 1

OFRIMI I SHËRBIMEVE OSE KRYERJA E AKTIVITETEVE PËRMES THEMELIMIT TË DEGËS

Neni 39

Themelimi i degës

1. Shteti anëtar mund t'i kërkojë shoqërisë së vendit të tretë, që synon të ofrojë shërbime investimi ose të kryejë aktivitete investimit, me ose pa ndonjë shërbim ndihmës për klientët individë ose për klientët profesionistë, brenda kuptimit të seksionit II të shtojcës II, themelimin e degës në territorin e këtij shteti anëtar.

2. Nëse shteti anëtar i kërkon shoqërisë së vendit të tretë, që synon të ofrojë shërbime investimi ose të kryejë aktivitete investimit, me ose pa ndonjë shërbim ndihmës, të themelojë degë në territorin e saj, e cila merr autorizimin paraprak nga autoritetet kompetente të këtij shteti anëtar, në përputhje me kushtet si më poshtë:

a) ofrimin e shërbimeve, për të cilat shoqëria e vendit të tretë kërkon autorizimin, i nënshtrohet autorizimit dhe mbikëqyrjes në vendin e tretë, në të cilin shoqëria themelohet dhe shoqëria kërkuese autorizohet siç duhet, për të cilin autoriteti kompetent i kushton vëmendjen e duhur çdo rekomandimi të Task Forcës së Veprimit Financiar, në kontekstin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) marrëveshjet e bashkëpunimit që përfshijnë dispozita që rregullojnë shkëmbimin e informacionit, me qëllim ruajtjen e integritetit të tregut dhe mbrojtjen e investitorëve, të ekzistojnë ndërmjet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar, në të cilin themelohet dega, dhe autoriteteve kompetente mbikëqyrëse të vendit të tretë, në të cilin themelohet shoqëria;

c) kapitalin e mjaftueshëm fillestar në dispozicion të pakushtëzuar të degës;

d) emërimin e një ose më shumë personave përgjegjës për administrimin e degës, dhe të cilët përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 9, paragrafi 1;

e) vendi i tretë, në të cilin themelohet shoqëria e vendit të tretë, ka firmosur marrëveshje me shtetin anëtar, në të cilin themelohet dega, e cila përmbush plotësisht standardet e përcaktuara në nenin 26 të Konventës Tatimore Model të OECD-së për të Ardhurat dhe Kapitalin, dhe garanton shkëmbimin efikas të informacionit, në lidhje me çështjet tatimore, duke përfshirë, nëse ka, marrëveshje tatimore shumëpalëshe;

f) shoqëria bën pjesë në skemën e kompensimit të investitorit, të autorizuar ose të njohur në përputhje me Direktivën 97/9/KE.

3. Shoqëria e vendit të tretë, e përmendur në paragrafin 1, dorëzon aplikimin e saj te autoriteti kompetent i shtetit anëtar, në të cilin synon të themelojë degën.

Neni 40

Detyrimi për të dhënë informacion

Shoqëria e vendit të tretë, që synon të marrë autorizimin për ofrimin e çdo shërbimi investimit ose kryerjen e aktiviteteve të investimit, me ose pa ndonjë shërbim ndihmës në territorin e shtetit anëtar, përmes një dege, i jep autoritetit kompetent të atij shteti anëtar informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e saj, në vendin e tretë përkatës. Nëse ka më shumë se një autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen, jepen hollësitë e fushave përkatëse të kompetencës;

b) të gjitha hollësitë përkatëse (emri, forma ligjore, selia dhe adresa, anëtarët e organit drejtues, aksionarët përkatës) dhe një program të operimeve, që përcakton ofrimin e shërbimeve dhe/ose të aktiviteteve të investimit, si dhe të shërbimeve ndihmëse, dhe strukturën organizative të degës, duke përfshirë përshkrimin e çdo delegimi të funksioneve thelbësore operative te palët e treta;

c) emrin e personave përgjegjës për administrimin e degës dhe dokumentet përkatëse, për vërtetimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në nenin 9, paragrafi 1;

d) informacion mbi kapitalin fillestar në dispozicion të pakushtëzuar të degës.

Neni 41

Dhënia e autorizimit

1. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar, në të cilin shoqëria e vendit të tretë ka themeluar ose synon të themelojë degën, jep autorizimin vetëm në rastin kur autoriteti kompetent bindet se:

a) janë përmbushur kushtet nenit 39; dhe

b) dega e shoqërisë së vendit të tretë do të mund të respektojë dispozitat e përmendura në paragrafin 2.

Autoritetet kompetente e njoftojnë shoqërinë e vendit të tretë, brenda gjashtë muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë, nëse është dhënë ose jo autorizimi.

2. Dega e shoqërisë së vendit të tretë, e autorizuar në përputhje me paragrafin 1, duhet të përmbush detyrimet e përcaktuara në nenet 16 deri në 20, nenin 23, 24, 25 dhe 27, nenin 28, paragrafi 1, dhe nenet 30, 31 dhe 32 të kësaj direktive dhe në nenet 3 deri në 26 të Rregullores

(BE) nr. 600/2014, si dhe masat e miratuara sipas tyre, dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së autoritetit kompetent, në shtetin anëtar, në të cilin jepet autorizimi.

Shtetet anëtare nuk vendosin kërkesa shtesë për organizimin dhe operimin e degës, në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo direktivë, dhe nuk trajtojnë asnjë degë të shoqërive të vendeve të treta, në mënyrë më të favorshme se shoqëritë e Bashkimit Evropian.

Neni 42

Ofrimi i shërbimeve, sipas nismës ekskluzive të klientit

Shtetet anëtare sigurohen që kur një klient individ ose klient profesionist, brenda kuptimit të seksionit II të shtojcës II, i themeluar ose i vendosur në Bashkimin Evropian, fillon me nismën e tij ekskluzive ofrimin e shërbimit ose të aktivitetit të investimit nga një shoqëri e vendit të tretë, kërkesa për autorizim sipas nenit 39, që mos zbatohet për ofrimin e atij shërbimi ose aktiviteti nga shoqëria e vendit të tretë për këtë person, veçanërisht në lidhje me ofrimin e atij shërbimi ose aktiviteti. Nisma e këtyre klientëve nuk i jep të drejtën shoqërive të vendeve të treta për marketimin, përveçse përmes degës, kur një e tillë kërkohet sipas legjislacionit të brendshëm, të kategorive të reja të produkteve ose shërbimeve të investimit, të kërkuara në përputhje me të drejtën e brendshme për ata klientë.

SEKSIONI 2

HEQJA E AUTORIZIMIT

Neni 43

Heqja e autorizimit

Autoriteti kompetent që jep autorizimin sipas nenit 41, mund të heqë autorizimin që i është dhënë shoqërisë së vendit të tretë, në rastin kur shoqëria:

a) nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht atë, ose nuk ofron shërbime investimi ose nuk kryen aktivitete investimit gjatë gjashtë muajve të fundit, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar përkatës parashikon mbarimin e afateve të autorizimit për këto raste;

b) e ka marrë autorizimin duke bërë deklaratë të rreme ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të parregullt;

c) nuk i përmbush më kushtet në bazë të të cilave është dhënë autorizimi;

d) ka kryer shkelje të rënda dhe sistematike të dispozitave të miratuar sipas kësaj direktive, që rregullon kushtet operative të shoqërive të investimit, dhe të zbatueshme për shoqëritë e vendeve të treta;

e) është një nga rastet, për të cilat legjislacioni i brendshëm, për sa i përket çështjeve që nuk janë brenda objektivit të kësaj Direktive, parashikon heqjen e autorizimit.

TITULLI III

TREGJET E RREGULLUARA

Neni 44

Autorizimi dhe ligji i zbatueshëm

1. Shtetet anëtare rezervojnë autorizimin si treg i rregulluar për ato sisteme, të cilat përputhen me këtë titull.

Autorizimi si treg i rregulluar jepet vetëm në rastin kur autoriteti kompetent bindet se operatori i tregut dhe sistemet e tregut të rregulluar përmbushin të paktën kërkesat e përcaktuara në këtë titull.

Në rastin e tregut të rregulluar, që është person juridik dhe administrohet ose operohet nga operatori i tregut i ndryshëm nga vetë tregu i rregulluar, shtetet anëtare caktojnë mënyrën e alokimit, ndërmjet tregut të rregulluar dhe operatorit të tregut, të detyrimeve të ndryshme të vendosura për operatorin e tregut sipas kësaj direktive.

Shoqëria e investimit jep të gjithë informacionin, duke përfshirë programin e operacioneve, ku përcaktohen, ndër të tjera, llojet e veprimtarive të parashikuara dhe struktura organizative, të nevojshme që autoriteti kompetent të bindet se tregu i rregulluar ka në zbatim të gjitha masat e nevojshme, në kohën e lëshimit të autorizimit fillestar, për të përmbushur detyrimet e tij sipas këtij titulli.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë operatorit të tregut kryerjen e detyrave, në lidhje me organizimin dhe operimin e tregut të rregulluar, nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet kompetente të mbajnë nën mbikëqyrje të rregullt respektimin e këtij titulli nga tregjet e rregulluara. Ato gjithashtu sigurohen që autoritetet kompetente të respektimin në çdo kohë, nga tregjet e rregulluara, të kushteve për autorizimin fillestar, të përcaktuara në këtë titull.

3. Shtetet anëtare sigurohen që operatori i tregut të mbajë përgjegjësi për garantimin që tregu i rregulluar i administruar prej tij të respektojë kërkesat e përcaktuara në këtë titull.

Shtetet anëtare gjithashtu sigurohen që operatori i tregut të gëzojë të drejtën të ushtrojë të drejtat që i takojnë tregut të rregulluar të administruar prej tij, sipas kësaj direktive.

4. Pa cenuar dispozitat përkatëse të Rregullores (BE) nr. 596/2014 ose të Direktivën 2014/57/BE, e drejta publike që rregullon tregtimin nga sistemet e tregut të rregulluar, duhet të jetë ajo e shtetit anëtar të origjinës të tregut të rregulluar.

5. Autoritetet kompetente mund të heqin autorizimin që i është dhënë tregut të rregulluar, në rastin kur ai:

a) nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht atë, ose nuk ka operuar për gjashtë muajt e fundit, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar përkatës parashikon mbarimin e afateve të autorizimit për këto raste;

b) e ka marrë autorizimin duke bërë deklarata të rreme ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të parregullt;

c) nuk i përmbush më kushtet në bazë të të cilave është dhënë autorizimi;

d) ka shkelur rëndë dhe rregullisht dispozitat e miratuara sipas kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

është një prej atyre rasteve në të cilat legjislacioni i brendshëm parashikon tërheqje.

6. ESMA njoftohet për çdo heqje të autorizimit.

Neni 45

Kërkesat për organin drejtues të operatorit të tregut

1. Shtetet anëtare kërkojnë që të gjithë anëtarët e organit drejtues të operatorit të tregut, të kenë në çdo kohë reputacion mjaftueshëm të mirë, të zotërojnë njohuritë e mjaftueshme, aftësitë dhe përvojën për kryerjen e detyrave të tyre. Përbërja e organit drejtues pasqyron gamën e gjerë dhe të mjaftueshme të përvojës.

2. Në veçanti, anëtarët e organit drejtues përmbushin kërkesat si më poshtë:

a) të gjithë anëtarët e organit drejtues i kushtojnë kohën e mjaftueshme ushtrimit të funksioneve të tyre në operatorin e tregut. Numri i roleve drejtuese të mbajtura nga anëtari i organit drejtues, në çdo subjekt juridik, merr njëkohësisht në konsideratë rrethanat individuale dhe natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të operatorit të tregut.

Përveç rasteve kur përfaqësojnë shtetin anëtar, anëtarët e organit drejtues të operatorëve të tregut, që janë të konsiderueshëm, për sa i përket madhësisë, organizimit të brendshëm dhe natyrës, objektit dhe kompleksitetit të aktiviteteve të tyre, nuk duhet të mbajnë në të njëjtën kohë pozicione që tejkalojnë më shumë se një prej kombinimeve si më poshtë:

I. një rol drejtues ekzekutiv me dy role drejtuese joekzekutive;

II. katër role drejtuese joekzekutive.

Rolet drejtuese ekzekutive ose joekzekutive, të mbajtura brenda të njëjtit grup ose sipërmarrjeje, në të cilat operatori i tregut zotëron një pjesëmarrje influencuese, konsiderohen si një rol i vetëm drejtues.

Autoritetet kompetente mund të autorizojnë anëtarët e organit drejtues që të mbajnë një post drejtues joekzekutiv shtesë. Autoritetet kompetente njoftojnë rregullisht ESMA-n në lidhje me këto autorizime.

Rolet drejtuese të organizatave që nuk ndjekin objektiva kryesisht tregtare, përjashtohen nga kushtëzimet e numrit të roleve drejtuese, të zotëruara nga një anëtar i organit drejtues.

b) Organi drejtues gjithashtu zotëron njohuritë e mjaftueshme, aftësitë dhe përvojën, në mënyrë që të kuptojë aktivitetet e shoqërisë, duke përfshirë rreziqet kryesore.

c) Secili anëtar i organit drejtues vepron me ndershmëri, integritet dhe pavarësi për të vlerësuar dhe kundërshtuar, kur është e nevojshme, vendimet e drejtuesve të lartë, si dhe për mbikëqyrjen efikase dhe monitorimin e vendimmarrjes.

3. Operatorët e tregut i kushtojnë burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare prezantimit dhe trajnimit të anëtarëve të organit drejtues.

4. Shtetet anëtare sigurohen që operatorët e tregut që janë të konsiderueshëm, për sa i përket përmasave, organizimit të brendshëm dhe natyrës, objektit dhe kompleksitetit të aktiviteteve të tyre, të krijojnë një komitet emërues, të përbërë nga anëtarët e organit drejtues që nuk ushtrojnë funksione ekzekutive në operatorin e tregut.

Komiteti emërues kryen detyrat e mëposhtme:

a) identifikon dhe rekomandon për miratim te organi drejtues, ose për miratim në mbledhjen e përgjithshme, kandidatët për vendet vakante në organin drejtues. Për këtë qëllim, komiteti emërues vlerëson nivelin e njohurive, të aftësive, diversitetit dhe përvojës së organit drejtues. Për më tepër, komiteti përgatit përshkrimin e roleve dhe aftësive të emërimit të caktuar dhe vlerëson kohën që i kushtohet ushtrimit të detyrave. Gjithashtu, komiteti emërues vendos mbi objektivin, në lidhje me gjininë e përfaqësuar ose të nënpërfaqësuar në organin administrues, dhe përgatit politikën për mënyrën e rritjes së numrit të gjinisë së nënpërfaqësuar në organin administrues, me qëllim arritjen e këtij objekti;

b) vlerëson në mënyrë periodike, dhe të paktën një herë në vit, strukturën, madhësinë, përbërjen dhe performancën e organit drejtues, si dhe i jep rekomandime për ndryshime organit drejtues;

c) në mënyrë periodike dhe të paktën një herë në vit, vlerëson njohuritë, aftësitë dhe përvojën e anëtarëve individualë të organit drejtues dhe të organit drejtues në mënyrë kolektive dhe i raporton organit drejtues për sa më lart;

d) në mënyrë periodike, rishikon politikën që ka organi drejtues për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtuesve të lartë dhe i jep rekomandime organit drejtues.

Gjatë ushtrimit të detyrave, komiteti emërues, aty ku është e mundur dhe në mënyrë të vazhdueshme, merr parasysh nevojën për të garantuar që vendimmarrja e organit drejtues të mos ndikohet nga asnjë person apo grup personash në mënyrë të tillë që do të dëmtonte interesat e operatorit të tregut në përgjithësi.

Gjatë ushtrimit të detyrave të tij, komiteti emërues duhet të jetë në gjendje të përdorë çdo lloj burimi që e gjykon të përshtatshëm, duke përfshirë këshillimin nga jashtë.

Në rastet kur, në zbatim të legjislacionit të brendshëm, organi drejtues nuk ka asnjë kompetencë në procesin e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të tij, ky paragraf nuk gjen zbatim.

5. Shtetet anëtare ose autoritetet kompetente u kërkojnë operatorëve të tregut dhe komiteteve të tyre përkatëse të emërimit që, gjatë rekrutimit të anëtarëve të organit drejtues, të përfshijnë një gamë të gjerë cilësish dhe kompetencash dhe për këtë qëllim të përgatisin një politikë që nxit larminë në organin drejtues.

6. Shtetet anëtare garantojnë përkufizimin, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e organit drejtues të operatorit të tregut për zbatimin e marrëveshjeve, që rregullojnë dhe garantojnë menaxhimin efikas dhe të kujdesshëm të një organizate, duke përfshirë ndarjen e detyrave të organizatës dhe parandalimin e konflikteve të interesit, me qëllim promovimin e integritetit të tregut.

Shtetet anëtare sigurohen që organi drejtues monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike efikasitetin e masave të qeverisjes në operatorin e tregut dhe ndërmer hapat e duhur për të trajtuar çdo mangësi.

Anëtarët e organit drejtues kanë aksesin e duhur në informacionin dhe dokumentet e nevojshme për mbikëqyrjen dhe monitorimin e vendimmarrjes së drejtuesve.

7. Autoriteti kompetent refuzon autorizimin, nëse nuk bindet që anëtarët e organit drejtues të operatorit të tregut kanë reputacion mjaftueshëm të mirë, njohuri të mjaftueshme dhe aftësitë e përvojën, si dhe kohën e mjaftueshme në dispozicion për të ushtruar funksionet e tyre, ose nëse ka arsye objektive dhe të qarta për të besuar se organi drejtues i operatorit të tregut mund të përbëjë rrezik për administrimin efektiv dhe të kujdesshëm si dhe për dhënien e rëndësisë së duhur integritetit të tregut.

Shtetet anëtare sigurohen që, gjatë procesit të autorizimit të tregut të rregulluar, personi ose personat që drejtojnë aktivitetin dhe operacionet e një tregu të rregulluar të autorizuar, në përputhje me këtë direktivë, përmbushin kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1.

8. Shtetet anëtare i kërkojnë operatorit të tregut të njoftojë autoritetin kompetent për identitetin e të gjithë anëtarëve të organit drejtues dhe për çdo ndryshim në anëtarësinë e tij, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse operatori i tregut është në përputhje me paragrafët 1 deri në 5.

9. ESMA nxjerr udhëzimet si më poshtë:

a) nocionin e kohës së mjaftueshme që një anëtar i organit drejtues i kushton ushtrimit të funksioneve të tij, në lidhje me rrethanat individuale dhe natyrën, shkallën e kompleksitetin e aktiviteve të operatorit të tregut;

b) nocionin e njohurive, i aftësive dhe i përvojës së mjaftueshme të organit drejtues, siç përmendet në germën "b" të paragrafit 2;

c) nocionin e ndershmërisë, integritetit dhe pavarësisë së anëtarit të organit drejtues, siç përmendet në germën "c" të paragrafin 2;

d) nocionin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare të përcaktuara për vendosjen dhe trajnimin e anëtarëve të organit drejtues, siç përmendet në paragrafin 3;

e) nocionin e diversitetit që duhet të merret parasysh për përzgjedhjen e anëtarëve të organit drejtues, siç përmendet në paragrafin 5.

ESMA nxjerr këto udhëzime, jo më vonë se 3 janari 2016.

Neni 46

Kërkesat në lidhje me personat që ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm mbi administrimin e tregut të rregulluar.

1. Shtetet anëtare kërkojnë ushtrimin e përshtatshëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të personave në gjendje për të ndikuar konsiderueshëm mbi aftësinë e tyre të administrimit të tregut të rregulluar.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë operatorit të tregut të rregulluar:

a) t'i ofrojë autoritetit kompetent, dhe të bëjë publik, informacionin në lidhje me pronësinë e tregut të rregulluar dhe/ose të operatorit të tregut, dhe veçanërisht në lidhje me identitetin dhe shkallën e interesave të çdo pale në gjendje për të ndikuar konsiderueshëm mbi administrimin;

b) të informojë autoritetin kompetent për, dhe të bëjë publike çdo transferim të pronësisë, e cila sjell ndryshim të identitetit të personave që ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm mbi operimin e tregut të rregulluar.

3. Autoriteti kompetent refuzon miratimin e ndryshimeve të miratuara për interesat kontrolluese të tregut të rregulluar dhe/ose të operatorit të tregut, kur ka arsye objektive dhe të vërtetueshme për të besuar se ato mund të përbëjnë rrezik për administrimin e mirë dhe të kujdesshëm të tregut të rregulluar.

Neni 47

Kërkesat organizative

1. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar:

a) të ketë në zbatim masat për të identifikuar qartë dhe për të administruar pasojat e mundshme negative, për operimet të tregut të rregulluar ose për anëtarët apo pjesëmarrësit e tij, të çdo konflikti interesi ndërmjet interesit të tregut të rregulluar, pronarëve të tij ose operatorit të tregut, dhe funksionimin e mirë të tregut të rregulluar, dhe veçanërisht në rastin kur këto konflikte mund të rezultojnë të dëmshme për ushtrimin e funksioneve që i janë deleguar tregut të rregulluar nga autoriteti kompetent;

b) të jetë i pajisur siç duhet për administrimin e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet, të ketë në zbatim masat dhe sistemet e duhura për të identifikuar rreziqet e konsiderueshme ndaj operimit të tij dhe të ketë në zbatim masat efektive për zbutjen e këtyre rreziqeve;

c) të ketë në zbatim masa për menaxhimin e mirë të operacioneve teknike në sistemin e tyre, duke përfshirë vendosjen e masave për të përballuar rreziqet e ndërprerjeve në sistem;

d) vendosjen e rregullave dhe procedurave transparente dhe jodiskrecionale, që parashikojnë tregtimin e drejtë dhe të rregullt, si dhe vendosin kritere objektive për ekzekutimin efikas të porosive;

e) të ketë në zbatim masa efikase, që lehtësojnë përfundimin efikas dhe në kohë të transaksioneve të kryera brenda sistemeve të tij;

f) të ketë në dispozicion, në momentin e autorizimit dhe në baza të vazhdueshme, burimet e mjaftueshme financiare për lehtësimin e funksionimit të rregullt të tij, duke marrë në konsideratë natyrën dhe përmasat e transaksionit të përfunduar në treg, si dhe gamën dhe shkallën e rreziqeve të shfaqura..

2. Shtetet anëtare nuk i lejojnë operatorëve të tregut ekzekutimin e urdhrave të klientëve kundër kapitalit të regjistruar, ose përfshirjen në transaksione përkuese për llogari të tyre, për të gjitha tregjet e rregulluara, që operohen prej tyre.

Neni 48

Fleksibiliteti i sistemeve, ndërprerësit e veprimtarisë së sigurimeve dhe tregtimi elektronik.

1. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar caktimin e sistemeve efikase, të procedurave dhe të marrëveshjeve për garantimin e fleksibilitetit të sistemeve të tyre tregtare, të kapacitetit për trajtimin e volumeve pik të urdhrave dhe mesazheve, mundësinë që të garantojë testimin e plotë të tregtimit të rregullt, sipas kushteve tepër të tensionuara të tregut, që garantojnë përmbushjen e këtyre kushteve dhe i nënshtrojnë ato ndaj marrëveshjeve efikase për vazhdimësinë e veprimtarisë tregtare, me qëllim garantimin e shërbimeve të vazhdueshme në çdo rast avarie në sistemet e tij.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar caktimin e:

a) masave me shkrim, me të gjitha shoqëritë e investimit, që ndjekin strategjinë e krijimit të tregut në tregun e rregulluar;

b) skemave për garantimin e pjesëmarrjes në këto marrëveshje, të numrit të mjaftueshëm të shoqërive të investimit, që kërkojnë nga to nxjerrjen e kuotave të shoqërisë në çmime konkurruese, duke rezultuar në ofrimin, në baza të rregullta dhe të parashikueshme, të likuiditetit në treg, në rastin kur kjo kërkesë i përshtatet natyrës dhe shkallës së tregtimit në këtë treg të rregulluar.

3. Marrëveshja me shkrim e përmendur në paragrafin 2 specifikon së paku:

a) detyrimet e shoqërisë së investimit në lidhje me ofrimin e likuiditetit, dhe aty ku zbatohet çdo detyrim, që rrjedh nga pjesëmarrja në skemën e përmendur në paragrafin 2, germa "b";

b) çdo nxitje në lidhje me zbritjet, ose të ofruara ndryshe për tregun e rregulluar nga shoqëria e investimit, me qëllim ofrimin e likuiditetit në treg, në baza të rregullta dhe të parashikueshme, dhe aty ku zbatohet, çdo të drejtë tjetër rrjedhëse për shoqërinë e investimit, si rezultat i pjesëmarrjes në skemën e përmendur në paragrafin 2, germa "b".

Tregu i rregulluar monitoron dhe imponojë respektimin nga ana e shoqërisë së investimit, të kërkesave të këtyre marrëveshjeve të lidhura me shkrim. Tregu i rregulluar informon autoritetin kompetent, në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes së lidhur me shkrim dhe, sipas kërkesës, i jep atij të gjithë informacionin e mëtejshëm, të nevojshëm për t'i lejuar, përmes tregut të rregulluar, plotësimin e përputhshmërisë me këtë paragraf.

4. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar ngritjen e sistemeve efikase, procedurave dhe marrëveshjeve, në lidhje me refuzimin e urdhrave që tejkalojnë volumin e parashikuar dhe kufijtë e çmimeve, ose në rastin kur përmbajnë gabime të qarta.

5. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar ndalimin e përkohshëm ose kufizimin e tregtimit, në rastin e ndryshimeve të konsiderueshme në çmimin e instrumentit financiar në këtë treg, ose në tregun e lidhur, për një periudhë të shkurtër kohore dhe, në raste të jashtëzakonshme, anulimin e mundshëm, ndryshimin ose korrigjimin e çdo transaksioni. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar garantimin e kalibrimit të përshtatshëm të parametrave për ndalimin e tregtimit, në mënyrë që të marrë në konsideratë likuiditetin e kategorive dhe nënkategorive të ndryshme të aktiveve, natyrën e modelit të tregut dhe llojet e përdoruesve, si dhe të mjaftueshme për shmangien e ndërprerjeve në rregullsinë e tregtimit.

Shtetet anëtare garantojnë raportimin e parametrave të tregut të rregulluar, në lidhje me ndalimin e tregtimit dhe çdo ndryshim tjetër të rëndësishëm të këtyre parametrave të autoriteti kompetent, në mënyrë konsistente dhe të krahasueshme, dhe raportimin e tyre në vijim nga autoriteti kompetent të ESMA. Shtetet anëtare kërkojnë caktimin e sistemeve të nevojshme dhe të procedurave të vendit të tregtimit, në rastin kur tregu i rregulluar me natyrë materiale në lidhje me likuiditetin e këtij instrumenti financiar, ndalon tregtimin në çdo shtet anëtar, për garantimin e njoftimit të tij të autoritetet kompetente, me qëllim koordinimin e përgjigjes të mbarë tregut dhe përcaktimin në lidhje me përshtatshmërinë e ndalimit të tregtimit në vende të tjera, në të cilat tregtohet instrumenti financiar, deri në momentin e rifillimit të tregtimit në tregun autentik.

6. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar caktimin e sistemeve, procedurave dhe marrëveshjeve efikase, duke përfshirë kërkesën për zhvillimin e testimit të përshtatshëm algoritmik nga anëtarët ose pjesëmarrësit, dhe sigurimin e ambienteve për lehtësimin e realizimit të këtij testimi, për garantimin e moskrijimit dhe moskontribimit të sistemeve të tregtimit algoritmik në kushtet e çrregullta të tregut dhe për menaxhimin e çdo kushti të çrregullt tregtar, që rrjedh nga këto sisteme të tregtimit algoritmik, duke përfshirë sistemet e kufizimit të raportit të urdhrave të paekzekutuara ndaj transaksioneve, të cilat mund të futen në sistem nga anëtari ose pjesëmarrësi, në mënyrë që të ngadalësojë fluksin e urdhrave, në rastin kur haset rreziku i

plotësimin të kapacitetit në sistem dhe me qëllim kufizimin dhe zbatimin e njësive minimale për t'u ekzekutuar në treg, të çmimit të shprehur në njësi.

7. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar, që lejon aksesin e drejtpërdrejtë elektronik, caktimin e procedurave lidhur me sistemet efikase dhe marrëveshjet, për t'i garantuar anëtarët ose pjesëmarrësit të lejojnë ofrimin e këtyre shërbimeve, nëse janë shoqëri të investimit, që autorizohen sipas Direktivës 2013/36/BE, caktimin dhe zbatimin e kritereve të përshtatshme lidhur me përshtatshmërinë e personave, për të cilët sigurohet ky akses, dhe mbajtjen e përgjegjësisë së urdhrave dhe tregtimeve e ekzekutuara gjatë përdorimit të shërbimit të këtij anëtari ose pjesëmarrësi, në lidhje me kërkesat e kësaj direktive.

Shtetet anëtare gjithashtu i kërkojnë tregut të rregulluar caktimin e standardeve të përshtatshme në lidhje me kontrollin e rrezikut dhe kufijtë e tregtimit përmes këtij aksesit, dhe aftësinë e dallimit, dhe kur është e nevojshme, ndalimin e urdhrave ose të tregtimit të personit, që përdor aksesin e drejtpërdrejtë elektronik, të veçuar nga urdhrat e tjerë ose nga tregtimi i anëtarit ose i pjesëmarrësit.

Tregu i rregulluar cakton marrëveshjet e pezullimit ose ndërprerjes së sigurimit të aksesit të drejtpërdrejtë elektronik nga anëtari ose pjesëmarrësit, për klientin në mospërputhje me këtë paragraf.

8. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar garantimin e rregullave të qarta, të drejta dhe jodiskriminuese, në lidhje me shërbimet e kolokacionit.

9. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar garantimin e strukturave tatimore të qarta, të drejta dhe jodiskriminuese, duke përfshirë tarifën e ekzekutimit, tarifën ndihmëse dhe çdo rabat, dhe moskrijimin e nxitjeve në lidhje me caktimin, ndryshimin ose anulimin e urdhrave, ose për ekzekutimin e transaksioneve, në mënyrë të atillë që kontribuon në kushtet e çrregullta të tregtimit ose abuzimit në treg. Në veçanti, shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar vendosjen e detyrimeve të krijimit të tregut në lidhje me aksionet individuale ose shportën e përshtatshme të aksioneve, në këmbim të çdo rabati të dhënë.

Shtetet anëtare lejojnë tregun e rregulluar të përshtatet ndaj tarifave të tyre të anulimit të urdhrave sipas afatit kohor të ruajtjes së urdhrat, si dhe për kalibrimin e tarifave në çdo instrument financiar, në të cilin ato zbatohen.

Shtetet anëtare mund t'i lejojnë tregut të rregulluar vendosjen e tarifave më të larta, në lidhje me caktimin e urdhrave që më pas anulohen, në krahasim me urdhrat e ekzekutuara, dhe vendosjen e tarifave më të larta për pjesëmarrësit me raport të lartë të urdhrave të anuluar ndaj atyre të ekzekutuara, dhe për operatorët e teknikës së tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë, me qëllim pasqyrimin e ngarkesës së shtuar mbi kapacitetin e sistemit.

10. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar mundësinë e identifikimit, përmes mënyrave të shënimit të anëtarëve ose pjesëmarrësve, të urdhrave që gjenerohen përmes tregtimit algoritmik, të algoritmeve të ndryshme, të përdorura për krijimin e urdhrave dhe të personave përkatës, që nisin këto urdhra. Informacioni vihet në dispozicion të autoriteteve kompetente sipas kërkesës të tyre.

11. Sipas kërkesës së autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës të tregut të rregulluar, shtetet anëtare i kërkojnë tregjeve të rregulluara vënien në dispozicion të autoritetit kompetent, të të dhënave në lidhje me librin e urdhrave, ose dhënien e aksesit në librin e urdhrave, për autoritetin kompetent, në lidhje me monitorimin e mundshëm të tregtimit.

12. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, për të specifikuar më tej:

a) kërkesat për garantimin e fleksibilitetit dhe kapacitetin e mjaftueshëm të tregjeve të rregulluara në sistemet tregtare;

b) raportin e përmendur në paragrafin 6, duke marrë në konsideratë faktorët si vlera e urdhrave të paekzekutuar, në krahasim me vlerën e transaksioneve të kryera;

c) kontrollet në lidhje me aksesin e drejtpërdrejtë elektronik, në mënyrë të atillë që garanton zbatimin e kontrolleve në aksesin e sponsorizuar, të paktën të barasvlershme me ato të zbatuara në aksesin e drejtpërdrejtë në treg;

d) kërkesat për garantimin e shërbimeve të kolokacionit dhe të strukturave tarifore, të drejta dhe jodiskriminuese, dhe se strukturat tarifore nuk nxisin kushte të parregullta apo abuzimin në treg;

e) përcaktimin e rastit kur tregu i rregulluar ka formë materiale në lidhje me likuiditetin e këtij instrumenti financiar;

f) kërkesat për garantimin e skemave të drejta dhe jodiskriminuese të krijimit të tregut, dhe për caktimin e detyrimeve minimale të krijimit të tregut, që tregjet e rregulluara sigurojnë gjatë hartimit të skemës së krijimit të tregut dhe të kushteve, sipas të cilave kërkesa e vendosjes së skemës së krijimit të tregut nuk është e përshtatshme, duke marrë në konsideratë natyrën dhe shkallën e tregtimit në këtë treg të rregulluar, përfshirë këtu rastin kur tregu i rregulluar lejon ose bën të mundur përfshirjen e tregtimit algoritmik përmes sistemeve të tij;

g) kërkesat për garantimin e testeve të përshtatshme të algoritmeve, në mënyrë që sistemet e tregtimit algoritmik, duke përfshirë sistemet e tregtimit algoritmik me frekuencë të lartë, të mos krijojnë apo kontribuojnë në kushtet e parregullta të tregut.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

13. ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2016, zhvillon udhëzimet lidhur me kalibrimin e përshtatshëm të ndalimeve të tregtimit sipas paragrafit 5, duke marrë në konsideratë faktorët e përmendur në këtë paragraf.

Neni 49

Çmimet e shprehura në njësi

1. Shtetet anëtare u kërkojnë tregjeve të rregulluara miratimin e regjimeve të çmimit të shprehur në njësi, në lidhje me aksionet, faturat e depozitarëve, fondet e tregtuara në bursë, certifikatat dhe instrumente të tjerë financiarë, si dhe çdo instrument tjetër financiar, për të cilin zhvillohen standardet teknike rregullatore, në përputhje me paragrafin 4.

2. Regjimet e çmimeve të shprehura në njësi, të përmendura në paragrafin 1:

a) kalibrohen me qëllim pasqyrimin e profilit të likuiditetit të instrumentit financiar në tregje të ndryshme, dhe të marzhit mesatar midis çmimit të ofruar dhe të kërkuar, duke marrë në konsideratë lejimin e dëshirueshëm të çmimeve të arsyeshme dhe të qëndrueshme pa kufizuar, në mënyrë të paarsyeshme, ngushtimin e mëtejshëm të marzheve;

b) përshtaten siç duhet ndaj çmimit të shprehur në njësi, për çdo instrument financiar.

3. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore për specifikimin e çmimit të shprehur në njësi minimale ose regjimet e çmimit të shprehur në njësi, për aksione të caktuara, fatura të depozitarëve, fonde të tregtuara në bursë, certifikata dhe instrumente të tjerë financiare të ngjashëm, aty ku është e nevojshme, për garantimin e funksionimit të rregullt të tregjeve, në përputhje me faktorët e paragrafit 2, si dhe çmimin, marzhet dhe nivelin e likuiditetit të instrumenteve financiare.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

4. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore për specifikimin e çmimit të shprehur në njësi minimale ose regjimet e çmimit të shprehur në njësi për instrumente financiare specifike, të ndryshme nga ato të renditura në paragrafin 3, aty ku është e nevojshme për garantimin e funksionimit të rregullt të tregjeve, në përputhje me faktorët e paragrafit 2, si dhe çmimin, marzhet dhe nivelin e likuiditetit të instrumenteve financiare.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit të gjitha draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 50

Sinkronizimi i orareve të ushtrimit të aktivitetit

1. Shtetet anëtare kërkojnë sinkronizimin e orarit të ushtrimit të aktivitetit nga të gjitha vendet e tregtimit dhe anëtarët ose pjesëmarrësit e tyre, që përdoren për regjistrimin e datës dhe kohës së çdo ngjarjeje të raportueshme.

2. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullore për specifikimin e nivelit të saktësisë të sinkronizimit të orëve në përputhje me standardet ndërkombëtare.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 51

Pranimi për tregtim i instrumenteve financiare

1. Shtetet anëtare u kërkojnë tregjeve të rregulluara vendosjen e rregullave të qarta dhe transparente, në lidhje me pranimin e tregtimit të instrumenteve financiare.

Këto rregulla garantojnë aftësinë e çdo instrumenti financiar të pranuar në treg, për t'u tregtuar në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe efikase dhe, në rastin e titujve të transferueshëm, për t'u negociuar lirisht.

2. Në rastin e instrumenteve derivative, rregullat e përmendura në paragrafin 1 garantojnë në mënyrë të veçantë që qëllimi i kontratës derivative, të lejojë vendosjen e rregullt të çmimeve, si dhe ekzistencën e kushteve efikase të shlyerjes.

3. Përveç detyrimeve të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2, shtete anëtare u kërkojnë tregjeve të rregulluar vendosjen dhe ruajtjen e masave efikase për verifikimin e përputhjes së pranimi për tregtimin e emetuesve të titujve të transferueshëm në tregun e rregulluar, me detyrimet sipas ligjit të Bashkimit Evropian, në lidhje me detyrimet për informimin fillestar, të vazhdueshëm ose të posaçme.

Shtetet anëtare sigurohen që tregu i rregulluar të vendosë masat, të cilat lehtësojnë sigurimin e aksesit të anëtarëve ose të pjesëmarrësve në informacionin e bërë publik sipas ligjit të Bashkimit Evropian.

4. Shtetet anëtare sigurohen që tregjet e rregulluara të vendosin masat e nevojshme për monitoruar rregullisht respektimin e kërkesave të pranimi të instrumenteve financiare, që ato pranojnë për tregtim.

5. Titujt e transferueshëm që pranohen për t'u tregtuar në tregun e rregulluar, mund të pranohen më pas për t'u tregtuar në tregje të tjera të rregulluar, qoftë dhe pa miratimin e emetuesit dhe në përputhje me dispozitat përkatës të Direktivës 2003/71/KE. Tregu i rregulluar informon emetuesin për faktin që titujt janë tregtuar në tregun e rregulluar. Emetuesi nuk ka

detyrimin t'i japë informacionin e kërkuar sipas paragrafit 3, drejtpërdrejtë tregut të rregulluar që ka pranuar titujt e emetuesit për tregtim, pa miratimin e tij.

6. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, të cilat:

a) specifikojnë karakteristikat e kategorive të ndryshme të instrumenteve financiare, të cilat merren në konsideratë nga tregu i rregulluar, gjatë vlerësimit lidhur me emetimit e mundshëm të instrumentit financiar, në mënyrë konsistente me kushtet e përcaktuara në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1, për pranimin për tregtim në segmente të ndryshme të tregut, në të cilin ajo operon;

b) qartëson masat e kërkuara nga tregu i rregulluar për zbatimin, në mënyrë që të konsiderohet në përmbushje me detyrimin për verifikimin e përputhjes së emetuesit të titujve me detyrimet sipas ligjit të Bashkimit Evropian, në lidhje me detyrimet për informimin fillestar, të vazhdueshëm ose të posaçëm;

c) qartëson masat që duhen caktuar nga tregjet e rregulluara në përputhje me paragrafi 3, me qëllim lehtësimin e sigurimit të aksesit të anëtarëve ose të pjesëmarrësve në informacionin e bërë publik sipas ligjit të Bashkimit Evropian.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 52

Pezullimi dhe çregjistrimi i instrumenteve financiare nga tregtimi në tregun e rregulluar.

1. Pa cenuar të drejtën e autoritetit kompetent sipas nenit 69, paragrafi 2 për kërkimin e pezullimit ose çregjistrimit të tregtimit të instrumentit financiar, operatori i tregut mund të pezullojë ose të çregjistrojë tregtimin e instrumentit financiar, që nuk siguron më përputhshmërinë e rregullave tregut të rregulluar, përveçse kur ky pezullim ose çregjistrim ka gjasa të shkaktojë dëme të konsiderueshme në interesat e investitorit ose në funksionimin e rregullt të tregut.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë operatorëve të tregut, të cilët pezullojnë ose çregjistrojnë instrumentin financiar, gjithashtu pezullimin ose çregjistrimit të instrumenteve derivative të përmendura në pikat 4 dhe 10 të seksionit C të shtojcës I, në lidhje ose me referencë instrumentin financiar, aty ku është e nevojshme, për mbështetjen e objektivave për pezullimin ose çregjistrimin e instrumentit financiar themelor. Operatori i tregut bën publik vendimin e tij në lidhje me pezullimin ose çregjistrimin e instrumentit financiar, dhe për çdo instrument derivativ në lidhje me to, dhe i komunikon autoritetit kompetent vendimet përkatëse.

Autoriteti kompetent, në juridiksionin e të cilit ka origjinë pezullimi ose çregjistrimi, i kërkon tregjeve të rregulluara, MTF-ve, platformave të përbashkëta të tregtimit dhe subjekteve të

brendshme sistematike që ndodhen në juridiksionin e tij dhe tregtojnë të njëjtat instrumente financiare ose derivate, me ato të përmendura në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I të kësaj direktive, në lidhje ose në referencë me këtë instrument financiar, gjithashtu pezullimin ose çregjistrimin e tregtimit të instrumentit financiar ose derivativ, në rastin kur pezullimi ose çregjistrimi vjen për shkak të abuzimit të dyshuar në treg, të tenderit, ose të moszbulimit të informacionit të brendshëm në lidhje me emetuesin ose instrumentin financiar, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Rregullores (BE) nr. 596/2014, përveçse kur ky pezullim ose çregjistrim shkakton dëme të konsiderueshme në interesat e investitorit ose në funksionimin e rregullt të tregut.

Secili autoritet kompetent i njoftuar komunikon vendimin të ESMA dhe autoritetet e tjera kompetente duke përfshirë justifikimin, në rastin kur vendimi nuk pezullon ose çregjistron tregtimin e instrumentit financiar ose derivativ, të përmendura në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I, të lidhura ose me referencë këtë instrument financiar.

Autoriteti kompetent menjëherë bën publik dhe i komunikon këtë vendim ESMA-s dhe autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare.

Autoritetet kompetente të njoftuara të shteteve të tjera anëtare i kërkojnë tregjeve të rregulluara, MTF-ve të tjera, platformave të tjera të përbashkëta të tregtimit dhe subjekte të brendshme sistematike që ndodhen në juridiksionin e tyre dhe tregtojnë të njëjtat instrumente financiare ose derivate, me ato të përmendura në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I të kësaj direktive, në lidhje me ose në referencë me këtë instrument financiar, gjithashtu pezullimin ose çregjistrimin e tregtimit të instrumentit financiar ose derivativ nga tregtimi, në rastin kur pezullimi ose çregjistrimi vjen për shkak të abuzimit të dyshuar në treg, të tenderit, ose të moszbulimit të informacionit të brendshëm në lidhje me emetuesin ose instrumentin financiar, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Rregullores (BE) nr. 596/2014, përveçse kur ky pezullim ose çregjistrim shkakton dëme të konsiderueshme në interesat e investitorit ose në funksionimin e rregullt të tregut.

Ky paragraf gjithashtu zbatohet në rastin e heqjes së pezullimit të tregtimit të instrumentit financiar ose derivativ, të përmendura në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar.

Procedura e njoftimit e përmendur në këtë paragraf gjithashtu zbatohet në rastin kur vendimi i pezullimit ose nxjerrjes nga tregtimi të instrumentit financiar ose derivativit të përmendur në pikat 4 deri në 10 të seksionit C të shtojcës I, që lidhen me ose i referohen atij instrumenti financiar, merret nga autoriteti kompetent sipas nenit 69, paragrafi 2, germat "m" dhe "n".

Për të garantuar zbatimin proporcional të detyrimit për pezullimin ose nxjerrjen nga tregtimi të këtyre derivativëve, ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, për të specifikuar më tej rastet, në të cilave lidhja ndërmjet një derivativi, që lidhen me ose i referohen një instrumenti financiar të pezulluar ose të nxjerrë nga tregtimi dhe instrumentit financiar autentik gjithashtu nënkupton që edhe derivativi duhet të pezullohet e të nxirret nga tregtimi, në mënyrë që të arrihet objektivi i pezullimit ose nxjerrjes nga tregtimi të instrumentit financiar.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike për përcaktimin e formateve dhe afateve kohore të komunikimeve dhe të botimeve të përmendur në paragrafin 2.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

4. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për specifikimin e listës së rrethanave, të cilat dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme interesat e investitorit dhe funksionimin e rregullit të tregut të tregut të përmendur në paragrafët 1 dhe 2.

Neni 53

Aksesi në tregun e rregulluar

1. Shtetet anëtare i kërkojnë tregut të rregulluar vendosjen, zbatimin dhe ruajtjen e rregullave të qarta dhe jodiskriminuese, bazuar në kritere objektive, të cilat rregullojnë aksesin ose anëtarësinë e tregut të rregulluar.

2. Rregullat e përmendura në paragrafin 1 specifikojnë çdo detyrim të anëtarëve ose pjesëmarrësve, që rrjedh nga:

- a) përbërja dhe administrimi i tregut të rregulluar;
- b) rregullat e lidhura me transaksionet në treg;
- c) standardet profesionale, të vendosura për stafin e shoqërive të investimit ose për institucionet kredituese, të cilat operojnë në treg;
- d) kushtet e vendosura për anëtarët ose pjesëmarrësit, të ndryshëm nga shoqëritë e investimit dhe institucionet kredituese, sipas paragrafit 3;
- e) rregullat dhe procedurat e klerimit dhe të shlyerjes të transaksioneve, të zhvilluara në tregun e rregulluar.

3. Tregjet e rregulluara mund të pranojnë, si anëtarë ose pjesëmarrës, shoqëritë e investimit, institucionet kredituese, të autorizuara sipas Direktivës 2013/36/BE dhe personat që:

- a) kanë reputacion të mjaftueshëm të mirë;

b) kanë nivel të mjaftueshëm të aftësisë tregtare, të kompetencës dhe të eksperiencës;

c) kanë, aty ku zbatohet, marrëveshje të përshtatshme organizative;

d) kanë burime të mjaftueshme, sipas rolit të ushtruar, duke marrë në konsideratë marrëveshjet e ndryshme financiare, që tregu i rregulluar mund të vendosë me qëllim garantimin e shlyerjes së përshtatshme të transaksioneve.

4. Shtetet anëtare garantojnë mosdetyrimin e anëtarëve dhe pjesëmarrësve, në lidhje me transaksionet e përfunduara në tregun e rregulluar, për zbatimin ndaj njëri-tjetrit, të detyrimeve të përcaktuara në nenet 24, 25, 27 dhe 28. Megjithatë, anëtarët ose pjesëmarrësit e tregut të rregulluar, zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenet 24, 25, 27 dhe 28 në lidhje me klientët e tyre, në rastin kur ata, në emër të klientëve të tyre, ekzekutojnë urdhrat në tregun e rregulluar.

5. Shtetet anëtare garantojnë parashikimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të distancuar të shoqërive të investimit dhe të institucioneve kredituese, sipas rregullave të aksesit ose anëtarësisë, ose pjesëmarrjes në tregun e rregulluar.

6. Shtetet anëtare, pa kërkesa të mëtejshme ligjore ose administrative, i lejon tregjeve të rregulluara nga shtete të tjera anëtare, sigurimin e marrëveshjeve të përshtatshme në territorin e tyre, me qëllim lehtësimin e aksesin dhe tregtimin në këto tregje, përmes anëtarëve ose pjesëmarrësve të distancuar, të vendosur në territorin e tyre.

Tregu i rregulluar i komunikon autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së tij, shtetin anëtar, në të cilin synon të ofrojë këto marrëveshje. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës i komunikon informacionin shtetit anëtar, në të cilin tregu i rregulluar synon të ofrojë këto marrëveshje brenda 1 muaji. ESMA mund të kërkojë akses në këtë informacion, në përputhje me procedurën dhe sipas kushteve të përcaktuara në nenin 35 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës të tregut të rregulluar i komunikon, sipas kërkesës të autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës, dhe pa vonesa të paarsyeshme, identitetin e anëtarëve ose pjesëmarrësve të tregut të rregulluar, të vendosur në këtë shtet anëtar.

7. Shtetet anëtare i kërkojnë operatorit të tregut komunikimin, në baza të rregullta, të listës së anëtarëve ose pjesëmarrësve të tregut të rregulluar, te autoriteti kompetent i tregut të rregulluar.

Neni 54

Monitorimi i përputhjes me rregullat e tregut të rregulluar dhe me detyrime të tjera ligjore

1. Shtetet anëtare i kërkojnë tregjeve të rregulluara caktimin e marrëveshjeve dhe të procedurave efikase, duke përfshirë burimet e nevojshme për monitorimin e rregullt të përputhshmërisë së anëtarëve ose pjesëmarrësve me rregullat e saj. Tregjet e rregulluara monitorojnë urdhrat e dërguar, duke përfshirë anulimet dhe transaksionet e kryera nga anëtarët ose pjesëmarrësit e sistemeve të tyre, me qëllim identifikimin e shkeljeve të këtyre rregullave, të

kushteve të parregullta të tregtimit, të sjelljeve të cilësuara të ndaluara sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014, ose të parregullsive të sistemit në lidhje me instrumentin financiar.

2. Shtetet anëtare u kërkojnë operatorëve të tregut, të informojnë menjëherë autoritetin kompetent për shkeljet e rëndësishme në rregullat e saj, ose për kushtet e parregullta të tregtimit, ose për sjelljen e cilësuar të ndaluar sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014, ose për parregullsitë në lidhje me instrumentin financiar.

Autoritetet kompetente i komunikojnë ESMA-s dhe autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë.

Në lidhje me sjelljen e cilësuar të ndaluar sipas Rregullores (BE) nr. 596/2014, autoriteti kompetent duhet të bindet lidhur me njoftimin e kësaj sjelljeje, në zhvillim ose të zhvilluar, te autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare dhe te ESMA.

3. Shtetet anëtare i kërkojnë operatorit të tregut, pa vonesa të paarsyeshme, furnizimin e autoritetit kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të abuzimeve në treg me informacionin përkatës dhe sigurimin e mbështetjes së plotë për këtë të fundit, në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të abuzimit në treg, të ndodhur në, ose përmes sistemeve të tregut të rregulluar.

4. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, për përcaktimin e rrethanave që japin shkasë për kërkesën për informacion, siç përmendet në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 55

Dispozitat në lidhje me kundërpalët qendrore, dhe marrëveshjet e klerimit dhe të shlyerjes

1. Pa cenuar titujt III, IV ose V të Rregullores (BE) nr. 648/2012, shtetet anëtare nuk u ndalojnë tregjeve të rregulluara, lidhjen e marrëveshjeve të përshtatshme me një kundërpalë qendrore ose shtëpi klerimi dhe sistem shlyerjeje të një shteti tjetër anëtar, në lidhje me ofrimin e klerimit dhe/ose shlyerjes për disa ose të gjitha tregtimet e kryera në sistemet e tyre nga pjesëmarrësit e tregut.

Comment [t1]: ?

2. Pa cenuar titujt III, IV ose V të Rregullores (BE) nr. 648/2012, autoriteti kompetent nuk kundërshton përdorimin e kundërpalës qendrore ose shtëpinë e klerimit, dhe/ose sistemet e shlyerjes të një shteti tjetër anëtar, përveçse kur shihet qartësisht si e nevojshme për ruajtjen dhe funksionimin e rregullt të tregut të rregulluar, si dhe duke marrë në konsideratë kushtet e sistemeve të shlyerjes, të krijuara sipas nenit 37, paragrafi 2 të kësaj direktive.

Comment [t2]: ?

Për shmangien e dublikimit të paarsyeshëm të kontrollit, autoriteti kompetent merr në konsideratë mbikëqyrjen/monitorimin e sistemit të klerimit dhe të shlyerjes, tashmë të ushtruara nga bankat qendrore, si mbikëqyrëse të sistemeve të klerimit dhe të shlyerjes, ose nga autoritete të tjera mbikëqyrëse me kompetenca në lidhje me këto sisteme.

Neni 56

Lista e tregjeve të rregulluara

Çdo shtet anëtar harton listën e tregjeve të rregulluar, për të cilat ai është shtet anëtar i origjinës, dhe i përcjell listën shteteve të tjera anëtare dhe ESMA-s. Një komunikim i ngjashëm zbatohet në lidhje me çdo ndryshim në këtë listë. ESMA bën publike dhe përditëson listën e të gjitha tregjeve të rregulluara në faqen e saj të internetit. Kjo listë përmban kodin unik, të përcaktuar nga ESMA në përputhje me nenin 65, paragrafi 6, identifikues të tregjeve të rregulluara, për t'u përdorur në raporte, në përputhje me nenin 65, paragrafi 1, germa "g" dhe me nenin 65, paragrafi 2 të kësaj direktive, dhe me nenet 6, 10 dhe 26 të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

TITULLI IV

KUFIJTË E LEJUESHËM PËR POZICIONET DHE KONTROLLET E ADMINISTRIMIT TË POZICIONEVE PËR DERIVATET E MALLRAVE ME PËRDORIM TË GJERË DHE PËR RAPORTIMIN

Neni 57

Kufijtë e lejueshëm për pozicionet dhe kontrollet e administrimit të pozicioneve për derivatet e mallrave me përdorim të gjerë

1. Shtetet anëtare garantojnë vendosjen dhe zbatimin e kufijve të pozicioneve nga autoritetet kompetente, në përputhje me metodologjinë e llogaritjes të përcaktuar nga ESMA, në lidhje me madhësinë e pozicioneve neto, të mbajtur në çdo kohë nga një person, për derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, që tregtohen në vendet e tregtimit, dhe për kontrata të barasvlershme ekonomike të tregjeve mbi banak (OTC). Kufijtë caktohen në bazë të të gjitha pozicioneve të mbajtura nga një person, dhe ato të mbajtura në emër të tij, në nivel grupi, me qëllim:

a) parandalimin e abuzimit në treg;

b) mbështetjen e vendosjes së rregullt të çmimeve dhe të kushteve të shlyerjes, duke përfshirë parandalimin e pozicioneve që deformojnë tregun, dhe veçanërisht garantimin e konvergjencës ndërmjet çmimeve të derivateve gjatë muajit të dorëzimit, dhe çmimeve të kursit të këmbimit të menjëhershëm për artikullin në fjalë, pa cenuar zbulimin e çmimit të tregut për mallrat bazë.

Kufijtë e pozicioneve nuk zbatohen për pozicionet e mbajtura ose në emër të subjektit jofinanciar, dhe të cilat janë objektiviisht të matshme në lidhje me reduktimin e rreziqeve të lidhura drejtpërsëdrejti me aktivitetin tregtar të subjektit jofinanciar.

2. Kufijtë e pozicioneve specifikojnë qartësisht kufijtë sasiar, sasitë maksimale të pozicionit në derivatin e mallrave me përdorim të gjerë, të mbajtur nga këta persona.

3. ESMA zhvillon draft standardet e rregullimeve teknike për përcaktimin e metodologjisë së llogaritjes, që autoritetet kompetente zbatojnë për përcaktimin e kufijve mujor të pozicioneve të kursit aktual dhe të kufijve të pozicioneve për muajt e tjerë, në lidhje me derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, që parashikojnë dorëzimin fizik ose në kesh, në bazë të

karakteristikave të instrumentit derivativ në fjalë. Metodologjia e llogaritjes merr në konsideratë të paktën elementet si më poshtë:

- a) afatin e maturimit të kontratave të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë;
- b) rezultatin i furnizimit të dorëzuar në lidhje me mallrat bazë;
- c) interesin e hapur dhe i përgjithshëm për këtë kontratë, dhe interesi i hapur dhe i përgjithshëm për instrumente të tjera financiare, për të njëjtin mall bazë;
- d) luhatshmërinë e tregjeve përkatëse, duke përfshirë derivatet e zëvendësueshme dhe tregjet e mallrave bazë;
- e) numrin dhe madhësinë e pjesëmarrësve të tregut;
- f) karakteristikat e tregut të mallrave bazë, duke përfshirë sjelljen e tregut në fushën e prodhimit, të konsumit dhe të transportit;
- g) zhvillimin e kontratave të reja.

ESMA merr në konsideratë eksperiencën lidhur me kufijtë e pozicioneve për shoqëritë e investimit ose operatorët e tregut, që operojnë një vend të tregimit dhe juridiksione të tjera.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore, të përmendura në nënparagrafin e parë.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

4. Autoriteti kompetent cakton kufijtë e çdo kontrate të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë në vendet e tregimit, bazuar mbi metodologjinë e llogaritjes, të përcaktuar nga ESMA në përputhje me paragrafin 3. Ky kufi i pozicioneve përfshin kontrata të barasvlershme ekonomike të tregjeve mbi banak (OTC).

Autoriteti kompetent rishikon kufijtë e pozicioneve, në rastin e ndryshimeve të rëndësishme, në lidhje me furnizimin e dorëzuar ose interesin e hapur, ose çdo ndryshim tjetër të rëndësishëm në treg, të bazuar në përcaktimin e ofertës së dorëzuar dhe në interesin e hapur, dhe rivendos kufirin e pozicioneve në përputhje me metodologjinë e llogaritjes të përgatitura nga ESMA.

5. Autoritetet kompetente i njoftojnë ESMA-s kufijtë ekzakt të pozicioneve, për të cilat synojnë të caktojnë përputhjen metodologjike të llogaritjes së krijuar nga ESMA sipas paragrafit 3. Dy muaj nga marrja e faturës njoftuese, ESMA i jep mendimin autoritetit kompetent të interesuar, në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë së kufijve të pozicioneve me objektivat e paragrafit 1 dhe me metodologjinë e llogaritjes të përcaktuar nga ESMA sipas paragrafit 3. ESMA boton opinionin në faqen e saj të internetit. Autoriteti kompetent i interesuar, ndryshon kufijtë e pozicioneve në përputhje me opinionin e ESMA-s, ose i siguron asaj justifikimin mbi

arsyen e konsiderimit të ndryshimit si të panevojshëm. Nëse autoriteti kompetent vendos kufij në kundërshtim me mendimin e ESMA-s, ai menjëherë e bën publik në faqen e tij të internetit, duke shpjeguar plotësisht arsyet për këtë veprim.

Nëse ESMA përcakton mospërputhjen e kufirin të pozicioneve me metodologjinë e llogaritjes në paragrafin 3, ajo vepron në përputhje me kompetencat e saj, sipas nenit 17 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

6. Kur i njëjti derivat i mallrave me përdorim të gjerë, tregtohet me volume të konsiderueshme në vendet e tregtimit, në më shumë se një juridiksionit, autoriteti kompetent i vendit të tregtimit, në të cilin ndodh volumi më i lartë i tregtimeve (autoriteti qendror kompetent), vendos kufirin e vetëm të pozicioneve, të zbatueshëm për të gjitha tregtimet e kësaj kontrate. Autoriteti qendror kompetent këshillohet me autoritetet kompetente të vendeve të tjera të tregtimit, në lidhje me instrumentin derivativ të tregtuar sipas volumeve të konsiderueshme, për zbatimin e kufirit të vetëm të pozicioneve dhe çdo rishikimi të këtij kufiri të vetëm të pozicioneve. Nëse autoritetet kompetente nuk bien dakord, ato japin me shkrim justifikimin e plotë dhe të hollësishëm, në rastin kur konsiderojnë mospërmbushjen e kërkesave, të përcaktuara në paragrafin 1. ESMA zgjidh çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet autoriteteve kompetente në përputhje me kompetencat e saj, sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Autoritetet kompetente të vendeve të tregtimit, në të cilat tregtohet i njëjti derivat i mallrave me përdorim të gjerë, dhe autoritetet kompetente të mbajtësve të pozicioneve në këtë derivat të mallrave me përdorim të gjerë, caktojnë marrëveshje bashkëpunimi, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave përkatëse me njëri-tjetrin, si dhe lejimin e monitorimit dhe të zbatimit kufirit të vetëm të pozicioneve.

7. ESMA monitoron, të paktën një herë në vit, mënyrën e zbatimit të kufijve të pozicioneve të autoriteteve kompetente, të vendosura në përputhje me metodologjinë e llogaritjes, të përcaktuar nga ESMA sipas paragrafit 3. Gjatë këtij veprimi, ESMA garanton zbatimin efikas të kufirit të pozicioneve për të njëjtën kontratë, pavarësisht vendit të tregtimit, në përputhje me paragrafin 6.

8. Shtetet anëtare garantojnë zbatimin e kontroleve të administrimit të pozicioneve për shoqërinë e investimit ose operatorin e tregut, që operon në vendin e tregtimit dhe tregton derivate të mallrave me përdorim të gjerë. Këto kontrole duhet të paktën të përfshijnë kompetencat e vendit të tregtimit në lidhje me:

a) monitorimin e interesit të hapur të pozicioneve të personave;

b) aksesin e informacionit, duke përfshirë dokumentimet përkatëse, të personave në lidhje me përmasat dhe qëllimin e pozicionit ose të ekspozimit të hasur, informacionet në lidhje me pronarët e dobishëm ose ekzistues, çdo marrëveshje në grup, si dhe çdo aktiv apo detyrim përkatës të tregut themelor;

c) kërkimin e mbylljes ose reduktimit të pozicionit të një personi, në bazë të përkohshme ose të përhershme, sipas kërkesave specifike të çështjes dhe marrjen e veprimeve të njëanshme për garantimin e mbylljes ose të reduktimit, në rastin e mospërputhjeve të personit; dhe

d) aty ku duhet, t'i kërkojnë personit sigurimin e kthimit të likuiditetit në treg, sipas çmimit të rënë dakord dhe volumit, në bazë të përkohshme, dhe sipas qëllimit të shprehur për zbutjen e efekteve të pozicioneve të mëdha dhe dominuese.

9. Kufijtë e lejueshëm për pozicionet dhe kontrollet e administrimit të pozicioneve janë të qarta dhe jodiskriminuese, duke specifikuar mënyrën e zbatimit të tyre tek personat, dhe duke marrë në konsideratë natyrën dhe përbërjen e pjesëmarrësve në treg, si dhe përdorimin e kontratave të tregtuara prej tyre.

10. Shoqëritë e investimi ose operatorët e tregut, të cilët operojnë një vend të tregtimit, informojnë autoritetin kompetent në lidhje me detajet e kontrolleve të administrimit të pozicioneve.

Autoriteti kompetent i komunikon ESMA-s të njëjtin informacion, si dhe detajet e kufijve të lejueshëm për pozicionet e caktuara prej tij, të cilat bëhen publike dhe ruhen në faqen e internetit përmes një databaze, së bashku me përmbledhjet e kufijve të lejueshëm për pozicionet dhe kontrollet e administrimit të pozicioneve.

11. Kufijtë e pozicioneve të paragrafit 1 zbatohen nga autoritetet kompetente sipas nenit 69, paragrafi 2, germa "p".

12. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, që përcaktojnë:

a) kriteret dhe metodat e përcaktimit, në lidhje me kualifikimin e pozicionit për pakësimin e rreziqeve të lidhura drejtpërsëdrejti me veprimtaritë tregtare;

b) metodat e përcaktimit në rastet e agregimit të pozicioneve të personit brenda grupit;

c) kriteret e përcaktimit në lidhje me barasvlerën ekonomike të kontratës së tregut mbi banak (OTC) që tregtohet në vendin e tregtimit, të përmendur në paragrafin 1, në mënyrë që të lehtësohet raportimi i pozicioneve të marra në kontrata të tregjeve mbi banak (OTC) të barasvlershme me autoritetin kompetent përkatës, siç përcaktohen në nenin 58, paragrafi 2;

d) përkufizimin e asaj çka përbën të njëjtin derivat të mallrave me përdorim të gjerë dhe volume të konsiderueshme sipas paragrafit 6 të këtij neni;

e) metodologjinë e agregimit dhe të netimit (kompensimit) të tregtimeve mbi banak dhe të pozicioneve të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë në treg, për vendosjen e pozicionit mesatar me qëllim vlerësimin e përputhjes sipas kufijve. Këto metodologji caktojnë kriteret e përcaktimit të pozicioneve të mundshme të konsoliduara kundrejt njëra-tjetrës dhe nuk lehtëson ndërtimin e pozicioneve që nuk përputhen me objektivat e caktuara në paragrafin 1 të këtij neni;

f) procedura e caktimit të mënyrës së lejimit të përjashtimit për personat sipas nënparagrafit të dytë të paragrafit 1 të këtij neni, dhe mënyra e miratimit të këtyre zbatimeve nga autoriteti kompetent;

g) metodën e llogaritjes për përcaktimin e vendit, në të cilin ndodh volumi më i madh tregtar, në lidhje me derivatin e mallrave me përdorim të gjerë dhe me volumet e konsiderueshme sipas paragrafit 6 të këtij neni.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore, të përmendura në nënparagrafin e parë.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e standardeve të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

13. Autoritetet kompetente nuk caktojnë kufij më kufizues se ato të miratuara sipas paragrafit 1, përveç rasteve të jashtëzakonshme që justifikohen, në mënyrë objektive dhe proporcionale, duke marrë në konsideratë likuiditetin e tregut specifik dhe funksionimin e rregullt të tregut. Autoritetet kompetente bëjnë publik në faqen e tyre të internetit, detajet në lidhje me vendimin e tyre për caktimin e kufijve më strikt të lejueshëm për pozicionet, të vlefshëm për periudhën fillestare, që nuk tejkalon gjashtë muaj nga data e botimit në faqen e internetit. Kufijtë e lejuar për pozicione më të kufizuara mund të rinovohen për periudha të mëtejshme, pa tejkaluar gjashtë muaj për çdo kohë, në rastin kur bazat e kufizimit mbeten të zbatueshme. Në rast të mosrinovimit pas periudhës gjashtë mujore, ato skadojnë automatikisht.

Nëse autoritetet kompetente vendosin caktimin e kufijve të lejuar për pozicione më të kufizuara, ato njoftojnë ESMA-n. Njoftimi përfshin justifikimin e kufijve të lejuar për pozicione më të kufizuara. ESMA, brenda 24 orëve, jep mendimin në lidhje me mundësinë e konsiderimit të nevojshëm të kufijve të lejuar për pozicione më të kufizuara, me qëllim adresimin e rastit të veçantë. Opinioni botohet në faqen e internetit të ESMA-s.

Nëse autoriteti kompetent vendos kufij në kundërshtim me mendimin e ESMA-s, ai menjëherë e bën publik në faqen e tij të internetit, duke shpjeguar plotësisht arsyet për këtë veprim.

14. Shtetet anëtare u japin autoriteteve kompetente mundësinë e zbatimit të kompetencave për vendosjen e sanksioneve sipas kësaj direktive, në lidhje me shkeljet e kufijve të pozicioneve, të vendosura në përputhje me këtë nen për:

a) pozicionet e mbajtura nga personat e ndodhur ose operues në territorin e tij ose jashtë shtetit, të cilat tejkalojnë kufijtë e kontratave të derivate të mallrave me përdorim të gjerë, të caktuara nga autoritetit kompetent në lidhje me kontratat e vendit të tregtimit, të ndodhura ose operuese në territorin e tij, ose me kontratat e barasvlershme ekonomike të tregjeve mbi banak (OTC);

b) pozicionet e mbajtura nga personat e ndodhur ose operues në territorin e tij, të cilat tejkalojnë kufijtë e kontratave të derivate të mallrave me përdorim të gjerë, të caktuara nga autoritetit kompetent në shtetet e tjera anëtare.

1. Shtetet anëtare garantojnë se, shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon një vend të tregtimit, e cila tregon derivatet e mallrave me përdorim të gjerë ose kuotat e shkarkimeve, ose derivatet e tyre:

a) boton raportin javor, së bashku me pozicionet agregate të mbajtura nga kategoritë e ndryshme të personave në lidhje me derivatet e ndryshme të mallrave me përdorim të gjerë ose me kuotat e shkarkimeve, ose me derivatet e tyre, që tregtohen në vendin e tyre të tregtimit, duke specifikuar numrin e pozicioneve të gjata dhe të shkurtra për këto kategori, ndryshimet e tyre që nga vlerësimi i fundit, përqindjen e interesit të hapur të përgjithshëm të përfaqësuar nga secila kategori dhe numrin e personave, që mbajnë pozicione në secilën kategori, në përputhje me paragrafin 4, dhe i komunikon këtë raport autoritetit kompetent dhe ESMA-s; ESMA vazhdon me botimin e qendëruar të informacionit të përfshirë në këto raporte;

b) i dorëzon autoritetit kompetent, të paktën çdo ditë, ndarjen në zëra të pozicioneve të mbajtura nga çdo person, duke përfshirë anëtarët ose pjesëmarrësit dhe klientët e tyre në vendin e tregtimit.

Detyrimet e përcaktuara në germën "a" zbatohen vetëm në rastin kur, si numri i personave, ashtu dhe pozicionet e tyre të hapura, tejkalojnë kufijtë minimal të lejuar.

2. Shtetet anëtare garantojnë sigurimin e autoritetit kompetent të vendit të tregtimit, në të cilin tregtohen derivatet e mallrave me përdorim të gjerë ose kuotat e shkarkimit ose derivatet e tyre, ose të autoritetit të kundërpalës qendrore, në të cilin tregtohen derivatet e mallrave me përdorim të gjerë ose kuotat e shkarkimit ose derivatet e tyre, të cilat tregtohen në volume të konsiderueshme në vendin e tregtimit dhe sipas më shumë se një juridiksioni, të paktën një herë në ditë, me ndarjen e hollësishme të shoqërive të investimit në derivate të mallrave me përdorim të gjerë ose në kuota të shkarkimeve ose derivate të tyre, jashtë vendit të tregtimit, në lidhje me pozicionet e tyre të mbajtura në derivate të mallrave me përdorim të gjerë ose në kuota të shkarkimeve ose derivate të tyre, të tregtuara në vendin e tregtimit dhe në kontrata të barasvlershme ekonomike të tregjeve mbi banak (OTC), si dhe ato në lidhje me klientët e tyre dhe klientët e këtyre klientëve, deri në klientin fundor, në përputhje me nenin 26 të Rregullores nr. 600/2014 dhe, aty ku zbatohet, me nenin 8 të Rregullores (BE) nr. 1227/2011.

3. Me qëllim lejitim e monitorimit të përputhjes me nenin 57, paragrafi 1, shtetet anëtare i kërkojnë anëtarëve ose pjesëmarrësve të tregjeve të rregulluara, MTF-ve dhe klientëve të platformave të përbashkëta të tregtimit, raportimin te shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon këtë vend të tregtimit, në lidhje me detajet e pozicioneve të mbajtura prej tyre, përmes kontratave të tregtuara në këtë vend të tregtimit, të paktën një herë në ditë, si dhe me ato të klientëve të tyre dhe të klientëve të këtyre klientëve, deri në klientin fundor.

4. Personat që mbajnë pozicione në derivate të mallrave me përdorim të gjerë ose në kuota të shkarkimeve ose derivate të tyre, klasifikohen nga shoqëria e investimit ose operatori i tregut, që operon këtë vend të tregtimit në përputhje me natyrën e aktivitetit të tyre kryesor, duke marrë në konsideratë çdo autorizim të zbatueshëm, si:

a) shoqëri të investimit ose institucione kredituese;

b) fonde të investimit, qoftë të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive në Tituj të Transferueshëm (SIKTT) siç përcaktohet në Direktivën 2009/65/KE, ose të menaxherit të fondeve alternative të investimit siç përcaktohet në Direktivën 2011/61/KE;

c) institucione të tjera financiare, duke përfshirë sipërmarrjet e sigurimit dhe të risigurimit siç përcaktohet në Direktivën 2009/138/KE, dhe institucionet ofruese të pensioneve profesionale siç përcaktohet në Direktivën 2003/41/KE;

d) shoqëri tregtare;

e) në rastin e kuotave të shkarkimeve ose derivateve të tyre, operatorët në përputhje me detyrimet sipas Direktivës 2003/87/KE.

Raporti i përmendur në germën "a" të paragrafit 1 specifikon numrin e pozicioneve të gjata dhe të shkurtra për kategoritë e personave, çdo ndryshim të tyre që nga raporti i fundit, përqindjen e interesit të hapur të përgjithshëm, të përfaqësuar nga secila kategori dhe numrin e personave në secilën kategori.

Raportet e përmendura në germën "a" të paragrafit 1 dhe kategoritë e përmendura në paragrafin 2, diferencojnë ndërmjet:

a) pozicioneve të identifikuara si të tilla, të cilat në mënyrë objektive dhe të matshme, pakësojnë rreziqet e lidhura drejtpërsëdrejti me veprimtaritë tregtare; dhe

b) pozicioneve të tjera.

5. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike për përcaktimin e formatit të raporteve të përmendur në germën "a" të paragrafit 1 dhe të kategorive të përmendura në paragrafin 2.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Në rastin e kuotave të shkarkimeve ose derivateve të tyre, raportimi nuk cenon përputhjen e detyrimeve sipas Direktivës 2003/87/KE.

6. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për caktimin e kufijve të përmendur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë numrin total të pozicioneve të hapura, dhe madhësinë dhe numrin total të titullarëve të pozicioneve.

7. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike për specifikimin e masave për të kërkuar dërgimin e të gjitha raporteve e përmendura në germën "a" të paragrafit 1, te ESMA sipas afatit të përcaktuar javor, me qëllim bërjen publike në mënyrë qendrore nga kjo e fundit.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

TITULLI V

SHËRBIMET E RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE

SEKSIONI 1

PROCEDURAT E AUTORIZIMIT DHE OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE

Neni 59

Kërkesat për autorizim

1. Shtetet anëtare kërkojnë që shërbimet e raportimit të të dhënave, të përshkruara në shtojcën I, seksioni D, si profesion i rregullt ose veprimtari, t'i nënshtrohen autorizimit paraprak në përputhje me këtë seksion. Ky autorizim jepet nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, i caktuar në përputhje me nenin 67.

2. Duke deroguar nga paragrafi 1, shtetet anëtare i lejojnë shoqërisë së investimit ose operatorit të tregut, që operon në vendin e tregtimit për operimin e shërbimeve të raportimit të të dhënave të skemës së publikimit të miratuar, të ofruesit të QSHKE-së, ose të MRP-së. Ky shërbim përfshihet në autorizimin e tyre.

3. Shtetet anëtare regjistrojnë të gjithë ofruesit e shërbimeve të raportimit të të dhënave. Regjistri bëhet publik dhe përmban informacionin mbi shërbimet, për të cilat autorizohet ofruesi i shërbimit të raportimit të të dhënave. Regjistri përditësohet rregullisht. Çdo autorizim i njoftohet ESMA-s.

ESMA krijon listën e të gjithë ofruesve të shërbimeve të raportimit të të dhënave në Bashkimin Evropian. Lista përmban informacionin mbi shërbimet, për të cilat autorizohet ofruesi i shërbimit të raportimit të të dhënave dhe përditësohet rregullisht. ESMA bën publike dhe përditëson listën në faqen e saj të internetit.

Nëse autoriteti kompetent heq autorizimin në përputhje me nenin 62, ky veprim bëhet publik në listë për një periudhë 5 vjeçare.

4. Shtetet anëtare u kërkojnë ofruesve të shërbimit të raportimit të të dhënave, të ofrojnë shërbimet e tyre nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent. Shtetet anëtare garantojnë që autoritetet kompetente të mbajnë nën mbikëqyrje të rregullt respektimin e këtij titulli nga ofruesit e shërbimeve të raportimit të të dhënave. Ato gjithashtu sigurohen që autoritetet kompetente të monitorojnë respektimin në çdo kohë nga ofruesit e shërbimeve të raportimit të të dhënave, të kushteve për autorizimin fillestar, të përcaktuara në këtë titull.

Neni 60

Fusha e zbatimit të autorizimit

1. Shteti anëtar i origjinës garanton specifikimin, sipas autorizimit, të shërbimeve të raportimit të të dhënave, të cilat ofrohen nga ofruesi i autorizuar i shërbimit të raportimit të të dhënave. Ofruesi i shërbimit të raportimi të të dhënave, i cili kërkon të zgjerojë veprimtarinë e shërbimeve shtesë të raportimit të të dhënave, dorëzon kërkesën për zgjerimin e autorizimit të tij.

2. Autorizimi është i vlefshëm për të gjithë Bashkimin Evropian, dhe i lejon ofruesin e shërbimeve të raportimit të të dhënave të ofrojë shërbime, për të cilat autorizohet, në të gjithë Bashkimin Evropian.

Neni 61

Procedurat e dhënies dhe refuzimit të autorizimit

1. Autoriteti kompetent nuk jep autorizimin nëse nuk bindet dhe deri sa të bindet plotësisht se aplikanti përmbush të gjitha kërkesat sipas parashikimeve të kësaj direktive.

2. Ofruesi i shërbimit të raportimit të të dhënave siguron të gjithë informacionin, duke përfshirë programin e operimeve, që përcaktojnë, ndër të tjera, llojet e shërbimeve të parashikuara dhe strukturën organizative, të nevojshme për plotësimin, që në momentin e autorizimit, të çdo rregullimi të nevojshëm të ofruesit të shërbimeve të raportimit të të dhënave, me qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas këtij kapitulli.

3. Aplikanti informohet, brenda gjashtë muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë, nëse është dhënë ose jo autorizimi.

4. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, që përcaktojnë:

a) informacionin e siguruar për autoritetet kompetente sipas paragrafit 2, duke përfshirë programin e operacioneve;

b) informacionin e përfshirë në njoftimet sipas nenit 63, paragrafi 3.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore, të përmendura në nënparagrafin e parë.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

5. ESMA zhvillon draft standardet teknike zbatuese për përcaktimin e formularëve standardë, të modeleve dhe procedurave për njoftimin ose dhënien e informacionit të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe në nenin 63, paragrafi 4.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 62

Heqja e autorizimit

Autoritetet kompetente mund t'i heqin autorizimin e lëshuar ofruesit të shërbimeve të raportimit të të dhënave, në rastin kur ofruesi:

a) nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht autorizimin ose nuk ofron të dhëna mbi shërbimin e raportimit për gjashtë muajt e fundit, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar i interesuar parashikon mbarimin e afateve të autorizimit për këto raste;

b) e ka marrë autorizimin duke bërë deklarata të rreme ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të parregullt;

c) nuk i përmbush më kushtet në bazë të të cilave është dhënë autorizimi;

d) ka shkelur rëndë dhe rregullisht dispozitat e kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

Neni 63

Kërkesat për organin e administrimit të ofruesve të shërbimeve të raportimi të të dhënave

1. Shtetet anëtare i kërkojnë të gjithë anëtarëve të organit të administrimit të ofruesve të shërbimeve të raportimit të të dhënave, në çdo kohë, reputacionin dhe njohuritë e mjaftueshme, aftësitë dhe përvojën, si dhe dedikimin e kohës së mjaftueshme për kryerjen e detyrave të tyre.

Organi administrues gjithashtu zotëron njohuritë e mjaftueshme kolektiv, aftësitë dhe eksperiencën, në mënyrë që të kuptojë aktivitetet e ofruesit të shërbimit të raportimit të të dhënave. Çdo anëtar i organit administrues vepron me ndershmëri, integritet dhe pavarësi mendore për të sfiduar me efikasitet, aty ku është e nevojshme, vendimet e menaxhimit të nivelit të lartë, si dhe për mbikëqyrjen efikase dhe monitorimin, aty ku është e nevojshme, të vendimmarrjes administruese.

Nëse operatori i tregut kërkon autorizimin për operimin e skemës së publikimit të miratuar, të ofruesit të QSHKE-së ose të MRP-së, dhe anëtarët e organit administrues të skemës së publikimit të miratuar, të ofruesit të QSHKE-së ose të MRP-së, janë të njëjtë me ata të organit administrues të tregut të rregulluar, këta persona konsiderohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nënparagrafin e parë.

2. ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2016, zhvillon udhëzimet lidhur me vlerësimin e përshtatshmërisë së anëtarëve të organit administrues, të përshkruar në paragrafin 1, duke marrë

në konsideratë rolet dhe funksionet e ndryshme të kryera prej tyre, dhe nevojën për shmangien e konflikteve të interesit ndërmjet anëtarëve të organit administrues dhe përdoruesve të skemës së publikimit të miratuar, të ofruesit të QSHKE-së ose të MRP-së.

3. Shtetet anëtare i kërkojnë shërbimeve të raportimit të të dhënave të njoftojnë autoritetin kompetent të të gjithë anëtarëve të organit të saj administrues dhe mbi çdo ndryshim të anëtarësive, së bashku me informacionin e nevojshëm për vlerësimin e përputhjes së shoqërisë me paragrafin 1.

4. Shtetet anëtare garantojnë përkufizimin, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e organit administrues të ofruesit të shërbimeve të raportimit të të dhënave për zbatimin e marrëveshjeve, që rregullojnë dhe garantojnë menaxhimin efikas dhe të kujdesshëm të një organizate, duke përfshirë ndarjen e detyrave të organizatës dhe parandalimin e konflikteve të interesit, me qëllim promovimin e integritetit të tregut dhe të interesit të klientëve të saj.

5. Autoriteti kompetent e refuzon autorizimin nëse nuk pajtohet me reputacionin e mjaftueshëm të mirë të këtij personi ose të personave, të cilët drejtojnë me efikasitet aktivitetin e ofruesit të shërbimit të raportimit të të dhënave, ose në rastin e arsyeve objektive dhe të vërtetueshme për të besuar se ndryshimet e propozuara mund të cenojnë menaxhimin e mirë dhe të kujdesshëm, dhe konsideratën e mjaftueshme ndaj interesit të klientëve të tij dhe integritetit të tregut.

SEKSIONI 2

KUSHTET E SKEMAVE TË PUBLIKIMIT TË MIRATUAR

Neni 64

Kërkesat organizative

1. Shteti anëtar i kërkon skemës së publikimit të miratuar vendosjen e politikave dhe marrëveshjeve të përshtatshme për bërjen publike të informacionit sipas neneve 20 dhe 21 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, në kohën teknike më të afërt të mundshme me atë reale dhe mbi baza të arsyeshme tregtare. Informacioni vihet në dispozicion pa pagesë, 15 minuta pas publikimit nga skema e publikimit të miratuar. Shteti anëtar i kërkon skemës së publikimit të miratuar aftësinë për shpërndarjen, në mënyrë efikase dhe konsistente, të këtij informacioni, me qëllim garantimin e aksesit të shpejtë të informacionit, mbi baza jodiskriminuese dhe në formate, në lidhje me konsolidimin e lehtë të informacionit me të dhëna të ngjashme të burimeve të tjera.

2. Informacioni i bërë publik nga skema e publikimit të miratuar në përputhje me paragrafin 1, duhet të paktën të përfshijë detajet si më poshtë:

- a) identifikuesin e instrumentit financiar;
- b) çmimin, në të cilin përfundohet transaksioni;
- c) volumin e transaksionit;

d) kohën e transaksionit;

e) kohën e raportimit të transaksionit;

f) shënimin e çmimit të transaksionit;

g) kodin e vendit të tregtimit, në të cilin kryhet transaksioni, ose në rastin kur transaksioni kryhet përmes subjektit të brendshëm sistematik, kodi "SI", ose ndryshe kodi "OTC";

h) kur është e zbatueshme, treguesin në lidhje me nënshtrimin e transaksioneve ndaj kushteve të caktuara.

3. Shteti anëtar i origjinës i kërkon skemës së publikimit të miratuar operimin dhe ruajtjen e marrëveshjeve efikase administrative, të hartuara për parandalimin e konflikteve të interesit me klientët e saj. Në veçanti, skema e publikimit të miratuar, që është gjithashtu operator i tregut ose shoqëri e investimit, trajton të gjithë informacionin e mbledhur në mënyrë jodiskriminuese dhe operon dhe ruan marrëveshjet e përshtatshme për ndarjen e funksioneve të ndryshme të aktiviteteve.

4. Shteti anëtar i kërkon skemës së publikimit të miratuar vendosjen e mekanizmave të qëndrueshëm të sigurisë, të dizajnuara për garantimin e sigurisë së mjeteve të transferimit të informacionit, për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të të dhënave dhe aksesin e paautorizuar, si dhe për parandalimin e rrjedhjes së informacionit përpara momentit të publikimit. Skema e publikimit të miratuar ruan burimet e përshtatshme dhe krijon ambientet rezervë, me qëllim ofrimin dhe ruajtjen e shërbimeve në çdo kohë.

5. Shteti anëtar i origjinës i kërkon skemës së publikimit të miratuar vendosjen e sistemeve për kontrollin efikas të raporteve tregtare në lidhje me plotësinë, identifikimin e pjesëve të hequra dhe gabimeve të dukshme, si dhe kërkon ritransmetimin e çdo raporti me gabime të tilla.

6. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore për përcaktimin e formateve të përbashkëta, standardet e të dhënave dhe marrëveshjet teknike, që lehtësojnë konsolidimin e informacionit siç përmendet në paragrafin 1.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore, të përmendura në nënparagrafin e parë.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

7. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, duke qartësuar atë çka përbën bazë të arsyeshme tregtare për bërjen publike të informacionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

8. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, duke specifikuar:

a) mjetet, përmes të cilave skema e publikimit të miratuar përputhet me detyrimin për informacion, të përmendur në paragrafin 1;

b) përmbajtja e bërjes publike të informacionit sipas paragrafit 1, duke përfshirë të paktën informacionin e përmendur në paragrafin 2, në mënyrë që të lejojë botimin e informacionit të kërkuar sipas nenit 64;

c) kërkesat konkrete organizative të përcaktuara në paragrafët 3, 4 dhe 5.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

SEKSIONI 3

KUSHTET E OFRUESVE TË QSHKE-VE

Neni 65

Kërkesat organizative

1. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të QSHKE-së vendosjen e politikave dhe marrëveshjeve të përshtatshme për mbledhjen e informacionit të bërës publik në përputhje me nenet 6 dhe 20 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, konsolidimin e tij në komunikimin elektronik në kohë reale dhe të vazhdueshme, të vënë në dispozicion të publikut mbi baza të arsyeshme tregtare, në kohën teknike më të afërt të mundshme me atë reale.

Informacioni përfshin të paktën detajet si më poshtë:

a) identifikuesin e instrumentit financiar;

b) çmimin, në të cilin përfundohet transaksioni;

c) volumin e transaksionit;

d) kohën e transaksionit;

e) kohën e raportimit të transaksionit;

f) shënimin e çmimit të transaksionit;

g) kodin e vendit të tregtimit, në të cilin kryhet transaksioni, ose në rastin kur transaksioni kryhet përmes subjektit të brendshëm sistematik, kodi "SI", ose ndryshe kodi "OTC";

h) kur gjen zbatim, faktin në lidhje me përgjegjësinë e algoritmit kompjuterik në shoqërinë e investimit, për vendimin e investimit dhe ekzekutimin e transaksionit;

i) nëse gjen zbatim, treguesin e nënshtrimit të transaksionit ndaj kushteve specifike;

j) nëse detyrimi për bërjen publike të informacionit të përmendur në nenin 3, paragrafi 1 të Rregullores (BE) nr. 600/2014 shmanget në përputhje me nenin 4, paragrafi 1 germa "a" ose "b" të kësaj Rregulloreje, shënimi tregues i akteve të dorëheqjes, të cilave i nënshtrohet transaksioni.

Informacioni vihet në dispozicion pa pagesë, 15 minuta pas publikimit nga ofruesi i QSHKE-së. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të QSHKE-së aftësinë për shpërndarjen, në mënyrë efikase dhe konsistente, të këtij informacioni, me qëllim garantimin e aksesit të shpejtë të informacionit, mbi baza jodiskriminuese dhe në formate lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme nga pjesëmarrësit në treg.

2. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të QSHKE-së vendosjen e politikave dhe marrëveshjeve të përshtatshme për mbledhjen e informacionit të bërë publik në përputhje me nenet 10 dhe 21 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, konsolidimin e tij në komunikimin elektronik në kohë reale dhe të vazhdueshme, të vënë në dispozicion të publikut mbi baza të arsyeshme tregtare, në kohën teknike më të afërt të mundshme me atë reale, të paktën detajet si më poshtë:

a) identifikuesin ose cilësitë identifikuese të instrumentit financiar;

b) çmimin, në të cilin përfundohet transaksioni;

c) volumin e transaksionit;

d) kohën e transaksionit;

e) kohën e raportimit të transaksionit;

f) shënimin e çmimit të transaksionit;

g) kodin e vendit të tregtimit, në të cilin kryhet transaksioni, ose në rastin kur transaksioni kryhet përmes subjektit të brendshëm sistematik, kodi "SI", ose ndryshe kodi "OTC";

h) kur është e zbatueshme, treguesin në lidhje me nënshkrimin e transaksioneve ndaj kushteve të caktuara.

Informacioni vihet në dispozicion pa pagesë, 15 minuta pas publikimit nga ofruesi i QSHKE-së. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të QSHKE-së aftësinë për shpërndarjen, në mënyrë efikase dhe konsistente, të këtij informacioni, me qëllim garantimin e aksesit të shpejtë të informacionit, mbi baza jodiskriminuese dhe në formate përgjithësisht të pranueshme, me ndërveprim, dhe lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme nga pjesëmarrësit në treg.

3. Shteti anëtar i origjinës i kërkon ofruesit të QSHKE-së garantimin e konsolidimit të të dhënave të siguruar nga të gjitha tregjet e rregulluara, MTF-të, platformat e përbashkëta të tregtimit dhe skemat e publikimit të miratuar, dhe për instrumentet financiare të specifikuar nga standardet teknike rregullatore, sipas germës "c" të paragrafit 8.

4. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të QSHKE-së operimin dhe ruajtjen e marrëveshjeve efikase administrative, të hartuara për parandalimin e konflikteve të interesit. Në veçanti, operatori i tregut ose skema e publikimit të miratuar, që operon gjithashtu QSHKE-në, trajton në mënyrë jodiskriminuese të gjithë informacionin e mbledhur, dhe operon dhe ruan marrëveshjet e përshtatshme për ndarjen e funksioneve të ndryshme të aktiviteteve.

5. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të QSHKE-së vendosjen e mekanizmave të qëndrueshëm të sigurisë, të dizajnuara për garantimin e sigurisë së mjeteve të transferimit të informacionit, dhe për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të të dhënave dhe të aksesit të paautorizuar. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të QSHKE-së ruajtjen e burimeve të përshtatshme dhe krijimin e ambienteve rezervë, me qëllim ofrimin dhe ruajtjen e shërbimeve në çdo kohë.

6. ESMA zhvillon standardet teknike rregullatore për të përcaktuar standardet e të dhënave dhe formatet e informacionit për t'u publikuar në përputhje me nenet 6, 10, 20 dhe 21 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, duke përfshirë identifikuesin e instrumentit financiar, çmimin, sasinë, kohën, shënimin e çmimit, identifikuesin e vendit të tregimit, dhe treguesit e kushteve specifike të nënshtrimit të transaksionit ndaj, si dhe marrëveshjet teknike të, promovimit të përhapjes efikase dhe konsistente të informacionit, me qëllim garantimin lehtësisht të aksesit dhe përdorimit të tij nga pjesëmarrësit në treg, siç përmendet në paragrafët 1 dhe 2, duke përfshirë identifikimin e shërbimeve shtesë, që mund të kryejë ofruesi i QSHKE-së për rritjen e efikasitetit të tregut.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore, në lidhje me informacionin e publikuar në përputhje me nenet 6 dhe 20 të Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe, deri më 3 korrik 2015, në lidhje me informacionin e publikuar në përputhje me nenet 10 dhe 21 të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

7. Komisioni miraton aktet e deleguara në përputhje me nenin 89, duke qartësuar atë çka përbën bazë të arsyeshme tregtare për sigurimin e aksesit të të dhënave në kohë reale dhe të vazhdueshme, siç përmendet në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

8. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, duke specifikuar:

a) mjetet, përmes të cilave ofruesi i QSHKE-së përputhet me detyrimin për informacion, të përmendur në paragrafët 1 dhe 2;

b) përmbajtjen e informacionit të botuar sipas paragrafëve 1 dhe 2;

c) të dhënat e instrumenteve financiare, për të cilat duhet të sigurohen sipas të dhënave në kohë reale dhe të vazhdueshme, dhe për instrumentet jokapitale, vendet e tregimit dhe skemat e publikimit të miratuar, të cilat duhet të përfshihen;

d) mjete të tjera për garantimin e publikimit të të dhënave nga ofrues të ndryshëm të QSHKE-ve, duke lejuar çiftimin e plotë dhe me kryqëzim, ndaj të dhënave të ngjashme nga burime të tjera, si dhe të afta për t'u agreguar në nivel Bashkimi Evropian;

c) kërkesat konkrete organizative të përcaktuara në paragrafët 4 dhe 5.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

SEKSIONI 4

KUSHTET E MRP-SË

Neni 66

Kërkesat organizative

1. Shteti anëtar i kërkon MRP-së caktimin e politikave dhe marrëveshjeve të përshtatshme për raportimin e informacionit të kërkuar sipas nenit 26 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, sa më shpejtë të jetë e mundur, dhe jo më vonë se fundi i ditës së punës, pas ditës, gjatë të cilës u krye transaksioni. Ky informacion duhet të raportohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 26 të Rregullores nr. 600/2014.

2. Shteti anëtar i kërkon MRP-së operimin dhe ruajtjen e marrëveshjeve efikase administrative, të hartuara për parandalimin e konflikteve të interesit me klientët e saj. Në veçanti, MRP-ja që është gjithashtu operator i tregut ose shoqëri e investimit, trajton të gjithë informacionin e mbledhur në mënyrë jodiskriminuese, dhe operon dhe ruan marrëveshjet e përshtatshme për ndarjen e funksioneve të ndryshme të biznesit.

3. Shteti anëtar i kërkon MRP-së vendosjen e mekanizmave të qëndrueshëm të sigurisë, të dizajnuar për garantimin e sigurisë dhe autentikimit të mjeteve të transferimit të informacionit, minimizimin e rrezikut të dëmtimit të të dhënave dhe aksesin e paautorizuar, si dhe parandalimin e rrjedhjes së informacionit, duke ruajtur në çdo kohë konfidencialitetin e të dhënave. Shteti anëtar i kërkon ofruesit të MRP-së ruajtjen e burimeve të përshtatshme dhe krijimin e ambienteve rezervë, me qëllim ofrimin dhe ruajtjen e shërbimeve në çdo kohë.

4. Shteti anëtar i origjinës i kërkon MRP-së vendosjen e sistemeve për kontrollin efikas të raporteve të transaksioneve në lidhje me plotësinë, identifikimin e pjesëve të hequra dhe gabimeve të shkaktuara nga shoqëria e investimit, si dhe në rastin kur ndodhin gabime ose heqje pjesësh të tilla, komunikimin të shoqëria e investimit, të detajeve në lidhje me gabimin ose heqjen, dhe kërkimin e rritjes së ritimit të çdo raporti me gabime të tilla.

Shteti anëtar i origjinës i kërkon MRP-së vendosjen e sistemeve për t'i lejuar dallimin e gabimeve ose heqjeve të shkaktuara nga vetë MRP-ja, dhe për t'i lejuar korrigjimin dhe

transmetimin, ose ritransmetimin sipas rastit, të raporteve të transaksioneve të korrigjuar dhe të plotë te autoriteti kompetent.

5. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore, duke specifikuar:

a) mjetet, përmes të cilave MRP-ja përputhet me detyrimin për informacion, të përmendur në paragrafin 1; dhe

b) kërkesat konkrete organizative të përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohet kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

TITULLI VI

AUTORITETI KOMPETENT

KAPITULLI I

PËRCAKTIMI, KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT E ANKIMIT

Neni 67

Caktimi i autoriteteve kompetente

1. Çdo shtet anëtar cakton autoritetet kompetente, të cilat zhvillojnë detyrat e siguruara sipas dispozitave të ndryshme të Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe kësaj direktive. Shtetet anëtare informojnë Komisionin, ESMA-n dhe autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare, në lidhje me identitetin e autoriteteve kompetente përgjegjëse për zbatimin e secilës detyrë, dhe me ndarjen e këtyre detyrave.

2. Autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 1 kanë formë publike, pa cenuar mundësinë e delegimit të detyrave te subjektet të tjera, nëse sigurohet shprehimisht në nenin 29, paragrafi 4.

Çdo detyrë e deleguar te subjektet, të ndryshme nga autoritetet e përmendura në paragrafin 1, nuk mund të përfshijë, as ushtrimin e autoritetit publik, dhe as përdorimin e gjykimit me liri veprimi. Përpara delegimit, shtetet anëtare i kërkojnë autoriteteve kompetente marrjen e hapave të arsyeshme për garantimin e kapacitetit dhe burimeve të subjektit, për të cilin delegohen detyrat për zbatimin efikas të detyrave, dhe caktimin e delegimit, vetëm sipas ngritjes së kuadrit të përcaktuar dhe të dokumentuar, në lidhje me shtrimin e çdo detyre të deleguar, që përmend detyrat e ndërmarra dhe kushtet, sipas të cilave ato zhvillohen. Këto kushte përfshijnë një klauzolë që detyron subjektin në fjalë të veprojë dhe të organizohet në mënyrë të tillë që të shmangë konfliktet e interesit dhe që informacioni i marrë gjatë ushtrimit të detyrave të

deleguara të mos përdoret padrejtësisht apo për të penguar konkurrencën. Përgjegjësia fundore për mbikëqyrjen e përputhshmërinë me këtë direktivë dhe me masat e saj zbatuese i takon autoritetit/autoriteteve kompetente të caktuara sipas paragrafit 1.

Shtetet anëtare informojnë Komisionin dhe autoritet kompetente të shteteve të tjera anëtare për çdo marrëveshje të bërë në lidhje me delegimin e detyrave, përfshirë edhe kushtet precize që rregullojnë këtë delegim.

3. ESMA bën publike dhe përditëson në faqen e saj të internetit, listën e autoriteteve kompetente, të përmendur në paragrafët 1 dhe 2.

Neni 68

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve në të njëjtin shtet anëtar

Nëse shteti anëtar cakton më shumë se një autoritet kompetent për zbatimin e dispozitës së kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014, rolet përkatëse të tyre përcaktohen qartësisht dhe ata bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin.

Çdo shtet anëtar kërkon një bashkëpunim të tillë, ndërmjet autoriteteve kompetente, për qëllime të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe autoriteteve kompetente përgjegjëse për mbikëqyrjen e institucioneve kredituese dhe financiare të tjera, fondeve të pensionit, SIKTT-ve, ndërmjetësve të sigurimit dhe të risigurimit, dhe të sipërmarrjeve të sigurimit.

Shtetet anëtare i kërkojnë autoriteteve kompetente shkëmbimin e çdo informacioni thelbësor apo të rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tyre.

Neni 69

Kompetencat mbikëqyrëse

1. Autoriteteve kompetente u jepen të gjitha kompetencat mbikëqyrëse, duke përfshirë kompetencat hetuese dhe kompetencat e caktimit të rikuperimeve të nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre sipas kësaj direktive dhe sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014.

2. Kompetencat e përmendura në paragrafin 1 përfshin të paktën kompetencat si më poshtë:

a) akses në çdo dokument ose të dhënë të çdo forme tjetër, të konsideruar si të rëndësishme nga autoriteti kompetent, në lidhje me zhvillimin e detyrave të tij, duke marrë, nëse kërkohet ose jepet, kopjen të tij;

b) të kërkojnë informacion nga cilido person, nëse është e nevojshme, të thërrasin persona dhe t'i marrin në pyetje për qëllime të marrjes së informacioneve;

c) për të kryer kontrolle ose hetime në terren;

d) të kërkojë regjistrimet ekzistuese të bisedave telefonike ose komunikimet elektronike ose regjistrime të tjera të qarkullimit të të dhënave në zotërim nga shoqëritë e investimit, institucioni kreditor ose çdo subjekt tjetër që rregullohet nga kjo direktivë ose nga Rregullorja (BE) nr. 600/2014;

e) të kërkojnë bllokimin ose sekuestrimin e aktiveve, ose të dyja bashkë;

f) të kërkojnë ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë profesionale;

g) t'i kërkojë shoqërive të autorizuara të investimit, tregjeve të rregulluara dhe ofruesve të shërbimeve të raportimit të të dhënave, sigurimin e informacionit;

h) të paraqesë çështje për ndjekje penale;

i) të lejojnë kryerjen e verifikimeve ose investigimeve nga ekspertë kontabël ose vlerësues.

j) të kërkojë dhënien e informacionit, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin përkatës, nga çdo person në lidhje me përmasat dhe qëllimin e pozicionit ose të ekspozimit, të hyrë në fuqi përmes derivatit të mallrave me përdorim të gjerë, dhe çdo aktivi ose detyrimi në tregun në fjalë;

k) të kërkojë ndalimin, e përkohshëm ose të përhershëm, të çdo praktike ose sjelljeje, që autoriteti kompetent e konsideron në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe dispozitat e miratuara në zbatimin e kësaj direktive, si dhe parandalimin e çdo përsëritjeje të këtyre praktikave ose sjelljeve;

l) të miratojë çdo lloj mase për garantimin e vazhimit të përmbushjes së kërkesave ligjore të shoqërive të investimit, të tregjeve të rregulluara dhe personave të tjerë, sipas kësaj direktive ose sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014;

m) të kërkojë pezullimin e tregtimit të instrumentit financiar;

n) të kërkojë çregjistrimin e tregtimit të instrumentit financiar, qoftë në tregun e rregulluar, ose sipas marrëveshjeve të tjera tregtare;

o) t'i kërkojë çdo personi marrjen e hapave për pakësimin e madhësisë së pozicionit ose të ekspozimit;

p) t'i kufizojë aftësinë e lidhjes së kontratës së derivateve të mallrave me përdorim të gjerë çdo personi, duke përfshirë prezantimin e kufijve për pozicionet, të mbajtura nga çdo person, në çdo kohë, në përputhje me nenin 57 të kësaj direktive;

q) të nxjerrë njoftime publike;

r) të kërkojë regjistrimet ekzistuese të qarkullimit të të dhënave, për aq kohë sa lejohet nga e drejta e brendshme, të cilat ruhen nga operatori i tregut, në rastin kur ka dyshime të arsyeshme për shkelje, dhe në rastin kur këto regjistra kanë rëndësi për hetimin lidhur me shkeljet e kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

s) të pezullojë marketimin ose shitjen e instrumenteve financiare ose depozitave të strukturuar, në rastin e përmbushjes së kushteve të neneve 40, 41 ose 42 të Rregullores (BE) nr. 600/2014;

t) të pezullojë tregtimin ose shitjen e instrumenteve financiare ose depozitave të strukturuar, në rastin kur shoqëria e investimit nuk zhvillon ose zbaton procesin e miratimit të produktit, ose në rastin e mospërputhjes me nenin 16, paragrafi 3 të kësaj direktive;

u) të kërkojë heqjen e personit fizik nga organi drejtues i shoqërisë së investimit ose i operatorit të tregut.

Përpara datës 3 korrik 2016, shtetet anëtare njoftojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative, që transpozojnë paragrafët 1 dhe 2 për Komisionin dhe ESMA-n. Ato i njoftojnë Komisionit dhe ESMA-s, pa vonesa të paarsyeshme, çdo ndryshim të mëtejshëm për ta.

Shtetet anëtare garantojnë caktimin e mekanizmave, me qëllim garantimin e mbulimit të kompensimit ose veprimeve të tjera rikuperuese, të ndërmarra në përputhje me të drejtën e brendshme, në lidhje me çdo humbje financiare ose dëmtim të shkaktuar si pasojë e shkeljes së kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

Neni 70

Sanksione për shkeljet

1. Pa cenuar kompetencat mbikëqyrëse, duke përfshirë kompetencat hetimore dhe ato të rikuperimit për autoritetet kompetente në përputhje me nenin 69, dhe të drejtën e shteteve anëtare për sigurimin dhe caktimin e sanksioneve penale, shtetet anëtare hartojnë rregullat, dhe garantojnë caktimin e sanksioneve administrative dhe masave të zbatueshme, nga autoritetet kompetente, për çdo shkelje të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe të dispozitave të miratuara në zbatimin e kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014, dhe marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të tyre. Këto sanksione dhe masa duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese, dhe duhet të zbatohen për shkeljet, edhe në rastin kur ato në përmenden specifikisht në paragrafët 3, 4 dhe 5.

Shtetet anëtare mund të vendosin moshartimin e rregullave të sanksioneve administrative për shkeljet, të cilat i nënshtrohen sanksioneve penale sipas të drejtës së tyre të brendshme. Në këtë rast, shteti anëtar i komunikon Komisionit dispozitat përkatëse të legjislacionit penal.

Përpara datës 3 korrik 2016, shtetet anëtare i njoftojnë Komisionit dhe ESMA-s, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative, duke përfshirë çdo dispozitë përkatëse të legjislacionit penal. Shtetet anëtare i njoftojnë Komisionit dhe ESMA-s, pa vonesa të paarsyeshme, çdo ndryshim të mëtejshëm për ta.

2. Shtetet anëtare garantojnë zbatimin e detyrimeve për shoqëritë e investimit, operatorët e tregut, ofruesit e shërbimit të raportimit të të dhënave, institucionet kredituese në lidhje me shërbimet ose aktivitetet e investimit dhe ato ndihmëse, dhe degët e shoqërive të vendeve të treta, në rastet e shkeljeve, sanksioneve dhe masave të zbatueshme, të cilat i nënshtrohen kushteve të përcaktuara në të drejtën e brendshme për zonat e paharmonizuara nga kjo direktivë, në lidhje me

anëtarët e organit administrues të shoqërive të investimit dhe të operatorëve të tregut, që sipas të drejtës së brendshme, përgjigjen për shkeljet e mundshme.

3. Shtetet anëtare garantojnë konsiderimin si shkelje të kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014, të paktën të shkeljeve të dispozitave të kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014 si më poshtë:

a) sipas kësaj direktive:

I. germa "b" e nenit 8;

II. neni 9, paragrafët 1 deri në 6

III. neni 11 paragrafët 1 dhe 3;

IV. neni 16, paragrafët 1 deri në 11

V. neni 17, paragrafët 1 deri në 6

VI. neni 18, paragrafët 1 deri në 9 dhe fjalia e parë e nenit 18, paragrafi 10;

VII. nenet 19 dhe 20;

VIII. neni 21, paragrafi 1;

IX. neni 23, paragrafët 1, 2 dhe 3

X. neni 24, paragrafët 1 deri në 5 dhe 7 deri në 10 dhe fjalia e parë dhe e dytë e nenit 24, paragrafi 11;

XI. neni 25, paragrafët 1 deri në 6

XII. fjalia e dytë e nenit 26, paragrafi 1, 2 dhe 3;

XIII. neni 27, paragrafët 1 deri në 8;

XIV. neni 28, paragrafët 1 dhe 2;

XV. nënparagrafi i parë i nenit 29, paragrafi 2, nënparagrafi i tretë i nenit 29, paragrafi 2, fjalia e parë e nenit 29, paragrafi 3, nënparagrafi i parë i nenit 29, paragrafi 4, dhe neni 29, paragrafi 5;

XVI. nënparagrafi i dytë i nenit 30, paragrafi 1, fjalia e parë e nënparagrafit të dytë të nenit 30, paragrafi 3;

XVII. neni 31, paragrafi 1, nënparagrafi i parë dhe neni 31, paragrafi 2 dhe 3;

XVIII. neni 32, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, i dytë dhe i katërt i nenit 32, paragrafi 2;

XIX. neni 33, paragrafi 3;

XX. neni 34, paragrafi 2; fjalia e parë e nenit 34, paragrafi 4; fjalia e parë e nenit 34, paragrafi 5; fjalia e parë e nenit 34, paragrafi 7;

XXI. neni 35, paragrafi 2, neni 35, paragrafi 7, fjalia e parë e nenit 35, paragrafi 10;

XXII. neni 36, paragrafi 1;

XXIII. nënparagrafi i parë dhe fjalia e parë e nënparagrafit të dytë të nenit 37, paragrafi 1, dhe nënparagrafi i parë i nenit 37, paragrafi 2;

XXIV. nënparagrafi i katër i nenit 44, paragrafi 1, fjalia e parë e nenit 44, paragrafi 2, nënparagrafi i parë i nenit 44, paragrafi 3, dhe germa "b" e nenit 44, paragrafi 5;

XXV. Neni 45, paragrafët 1 deri në 6 dhe paragrafi 8;

XXVI. neni 46, paragrafi 1, gjerat "a" dhe "b" dhe neni 46, paragrafi 2

XXVII. neni 47;

XXVIII. neni 48, paragrafët 1 deri në 11;

XXIX. neni 49, paragrafi 1;

XXX. neni 50, paragrafi 1;

XXXI. neni 51, paragrafët 1 deri në 4 dhe fjalia e parë e nenit 51, paragrafi 5;

XXXII. neni 52, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë dhe i pestë i nenit 52, paragrafi 2;

XXXIII. neni 53, paragrafi 1, 2 dhe 3, dhe fjalia e parë e nënparagrafit të dytë të nenit 53, paragrafi 6, neni 53, paragrafi 7;

XXXIV. neni 54, paragrafi 1, nënparagrafi i parë i nenit 54, paragrafi 2 dhe neni 54, paragrafi 3;

XXXV. neni 57, paragrafët 1 dhe 2, neni 57, paragrafi 8 dhe nënparagrafi i parë i nenit 57, paragrafi 10;

XXXVI. neni 58, paragrafët 1 deri në 4;

XXXVII. neni 63, paragrafët 1, 3 dhe 4;

XXXVIII. neni 64, paragrafët 1 deri në 5;

XXXIX. neni 65, paragrafët 1 deri në 5;

XXXX. neni 66, paragrafët 1 deri në 4; dhe

b) në lidhje me Rregulloren (BE) nr. 600/2014:

I. neni 3, paragrafi 1 dhe 3;

II. nënparagrafi i parë i nenit 4, paragrafi 3;

III. neni 6;

IV. fjalia e parë e nënparagrafit të tretë të nenit 7, paragrafi 1;

V. neni 8, paragrafët 1, 3 dhe 4

VI. neni 10;

VII. fjalia e parë e nënparagrafit të tretë të nenit 11, paragrafi 1, dhe nënparagrafi i tretë i nenit 11, paragrafi 3;

VIII. neni 12, paragrafi 1;

IX. neni 13, paragrafi 1

X. neni 14, paragrafi 1, fjalia e parë e nenit 14, paragrafi 2 dhe fjalia e dytë, e tretë dhe e katërt e nenit 14, paragrafi 3;

XI. nënparagrafi i parë dhe fjalia e parë dhe e tretë e nënparagrafit të dytë të nenit 15, paragrafi 1, neni 15, paragrafi 2 dhe fjalia e dytë nenit 15, paragrafi 4;

XII. fjalia e parë e nenit 17, paragrafi 1;

XIII. neni 18, paragrafi 1 dhe 2, fjalia e parë e nenit 18, paragrafi 4, fjalia e parë e nenit 18, paragrafi 5, nënparagrafi i parë i nenit 18, paragrafi 6, neni 18, paragrafi 8 dhe 9;

XIV. neni 20, paragrafi 1 dhe fjalia e parë e nenit 20, paragrafi 2;

XV. neni 21, paragrafët 1, 2 dhe 3;

XVI. neni 22, paragrafi 2;

XVII. neni 23, paragrafët 1 dhe 2;

XVIII. neni 25, paragrafët 1 dhe 2;

XIX. nënparagrafi i parë i nenit 26, paragrafi 1, neni 26, paragrafi 2 deri në 5, nënparagrafi i parë i nenit 26, paragrafi 6, nënparagrafët e parë deri në të pestë dhe nënparagrafi i tetë i nenit 26, paragrafi 7;

XX. neni 27, paragrafi 1

XXI. neni 28, paragrafi 1 dhe nënparagrafi i parë i nenit 28, paragrafi 2;

XXII. neni 29, paragrafët 1 dhe 2;

XXIII. neni 30, paragrafi 1;

XXIV. neni 31, paragrafët 2 dhe 3;

XXV. neni 35, paragrafët 1, 2 dhe 3;

XXVI. neni 36, paragrafët 1, 2 dhe 3;

XXVII. neni 37, paragrafët 1 dhe 3;

XXVIII. nenet 40, 41 dhe 42.

4. Gjithashtu, konsiderohet shkelje e kësaj direktive ose e Rregullores (BE) nr. 600/2014, ofrimi i shërbimeve të investimit ose kryerja e aktiviteteve të investimit pa autorizimin e kërkuar ose miratimin në përputhje dispozitat e kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014 si më poshtë:

a) neni 5 ose neni 6, paragrafi 2 ose nenet 34, 35, 39, 44 ose 59 të kësaj direktive; ose

b) fjalia e dytë e nenit 7, paragrafi 1 ose neni 11, paragrafi 1 i Rregullores (BE) nr. 600/2014.

5. Mungesa e bashkëpunimit ose mospërputhja, në lidhje me hetimit, ose me kërkesën për hetim të mbuluar nga neni 69, gjithashtu konsiderohen si shkelje të kësaj direktive.

6. Në rastet e shkeljeve të përmendura në paragrafët 3, 4 dhe 5, shtetet anëtare, sipas të drejtës së brendshme, sigurojnë kompetencat e autoriteteve kompetente për marrjen dhe vendosjen, e të paktën sanksioneve dhe masave administrative si më poshtë:

a) deklaratën publike, e cila tregon personin fizik ose juridik, dhe natyrën e shkeljes në përputhje me nenin 71;

b) urdhrin që kërkon pushimin e sjelljes së personit fizik ose juridik, dhe mospërsëritjen e kësaj sjelljeje;

c) në rastin e shoqërisë së investimit, operatori i tregut, i autorizuar për operimin e MTF-së ose platformës së përbashkët të tregimit, të tregut të rregulluar, të skemave të publikimit të miratuar, të ofruesit të QSHKE-së, dhe të MRP-së, heqjen ose çregjistrimin e autorizimit të institucionit në përputhje me nenet 8, 43 dhe 65;

d) ndalimin e përkohshëm ose, për shkeljet e rënda të përsëritura, të përhershëm, për çdo anëtar të organit të administrimit të shoqërisë së investimit ose për çdo person tjetër fizik, i cili përgjigjet për ushtrimin e funksioneve administruese të shoqërive të investimit;

e) ndalimin e përkohshëm për çdo shoqëri të investimit, që është anëtare ose pjesëmarrëse në tregjet e rregulluara ose MTF-të, ose për çdo klient të platformave të përbashkëta të tregimit;

f) në rastin e personit juridik, gjobat maksimale administrative prej të paktën 5 000 000 euro, ose në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014, ose deri në 10% të totalit të xhiros vjetore të personit juridik sipas llogarive financiare të disponueshme më së fundmi, që miratohen nga organi administrues; në rastin kur personi juridik është ndërmarrje mëmë ose filial i ndërmarrjes mëmë, i cili duhet të përgatisë pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me Direktivën 2013/34/BE, totali përkatës i xhiros vjetore është xhiro vjetore ose lloji i të ardhurave korresponduese, në përputhje me aktet përkatëse të ligjit për kontabilitetin, sipas pasqyrave të konsoliduara të disponuara më së fundmi, që miratohen nga organi administrues i shoqërisë mëmë që është në krye;

g) në rastin e personi fizik, gjobat maksimale administrative prej të paktën 5 000 000 euro, ose në shtetet anëtare me monedha të ndryshme nga euro, vlerën korresponduese në monedhën kombëtare më 2 korrik 2014;

h) gjobat maksimale administrative prej të paktën dyfishin e sasisë së përfitimeve që rrjedhin nga shkelja, në rastin e përcaktimit të përfitimit, edhe nëse tejkalohen sasi të maksimale të germave "f" dhe "g".

7. Shtetet anëtare mund të autorizojnë autoritetet kompetente për caktimin e llojeve të sanksioneve, duke përfshirë ato të përmendura në paragrafin 6 ose për caktimin e gjobave, që tejkalojnë sasi të përmendura në germa "f", "g", dhe "h" të paragrafit 6.

Neni 71

Botimi i vendimeve

1. Shtetet anëtare i sigurojnë autoriteteve kompetente botimin e çdo vendimi për caktimin e sanksionit administrative ose të masës ndaj shkeljeve të Rregullores (BE) nr. 600/2014, ose të dispozitave kombëtare të miratuara për zbatimin, pa vonesa të paarsyeshme, të kësaj direktive në faqet e tyre zyrtare të internetit, pasi personi, për të cilin caktohet shkelja, informohet në lidhje me këtë vendim. Botimi përfshin të paktën informacionin në lidhje me llojin dhe natyrën e shkeljes, dhe identitetin e personave përgjegjës. Ky detyrim nuk zbatohet për masat e caktimit të vendimeve, që kanë natyrë hetimore.

Megjithatë, nëse autoriteti kompetent konsideron si joproporcionale bërjen publike të identitetit të personave juridik ose të të dhënave personale të personave fizik, duke ndjekur vlerësimin rast pas rasti, të zhvilluar në lidhje me proporcionalitetin e botimit të këtyre të dhënave, ose në rastin kur botimi rrezikon qëndrueshmërinë e tregjeve financiare ose vazhdimësinë e hetimit, shtetet anëtare garantojnë, në lidhje me shtetet anëtare:

a) shtyrjen e botimit të vendimit për caktimin e sanksionit ose të masës, deri në momentin kur arsyet e mosbotimit pushojnë së ekzistuari;

b) botimin e vendimit për caktimin e sanksionit ose të masës, në baza anonime dhe në mënyrë të përputhshme në të drejtën e brendshme, nëse ky botim anonim garanton mbrojtjen efikase të të dhënave personale përkatëse;

c) mosbotimin e asnjë vendimi për caktimin e sanksionit ose të masës, në rastin kur opsionet e përcaktuara në germat "a" dhe "b" konsiderohen të pamjaftueshme për të garantuar:

I mosvënien në rrezik të stabilitetit së tregjeve financiare;

II proporcionalitetin e botimit të këtyre vendimeve, në lidhje me masat, që konsiderohen të papërfillshme.

Në rastin e vendimit për bërjen publike të sanksioneve ose masave në bazë anonime, bërja publike e të dhënave përkatëse mund të shtyhet për një periudhë të arsyeshme, në rastin kur parashikohet mosekzistenca e arsyeve, brenda kësaj periudhe, për bërjen publike në mënyrë anonime.

2. Nëse vendimi për caktimin e sanksionit ose të masës i nënshtrohet apelimit përpara autoriteteve përkatëse gjyqësore ose të tjera, autoritetet kompetente gjithashtu botojnë menjëherë këtë informacion në faqen e tyre zyrtare të internetit, si dhe çdo informacion të mëtejshëm që lidhet me rezultatin e këtij apelimi. Përveç kësaj, botohet çdo vendim që anulon vendimin e mëparshëm për caktimin e sanksionit ose të masës.

3. Autoritetet kompetente garantojnë mbajtjen në faqen e tyre të internetit, të bërjeve publike në përputhje me këtë nen, për periudhën të paktën pesë vjet pas kohës së bërjes publike. Të dhënat personale të përfshira në botim ruhen vetëm në faqen zyrtare të internetit të autoritetit kompetent, për periudhën kohore të nevojshme në përputhje me rregullat e mbrojtjes së zbatimit të të dhënave.

Autoritetet kompetente njoftojnë ESMA-n në lidhje me sanksionet administrative të vendosura, por të papublikuara në përputhje me germën "c" të paragrafit 1, duke përfshirë çdo apelim në lidhje me to dhe pasojën për to. Shtetet anëtare garantojnë marrjen e informacionit nga autoritetet kompetente dhe gjykimin e tyre përfundimtar, në lidhje me çdo sanksion penal të vendosur, dhe ia dorëzojnë ESMA-s. ESMA ruan databazën qendrore të sanksioneve që i komunikohen vetëm për qëllimet e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente. Databaza aksesohet vetëm nga autoritetet kompetente dhe përditësohet në bazë të informacionit të dhënë nga autoritetet kompetente.

4. Shtetet anëtare i sigurojnë ESMA-s, një herë në vit, informacionin e agreguar në lidhje me çdo sanksion dhe masë të caktuar në përputhje me paragrafët 1 dhe 2. Ky detyrim nuk zbatohet për masat me natyrë hetimore. ESMA boton informacionin në raportin vjetor.

Nëse shtetet anëtare, në përputhje me nenin 70, zgjedhin përcaktimin e sanksioneve legislative në lidhje me shkeljet ose dispozitat e përmendura në këtë nen, autoritetet kompetente i sigurojnë ESMA-s, në bazë vjetore, të dhënat anonime dhe të agreguara, në lidhje me kryerjen e të gjitha hetimeve penale dhe vendosjen e sanksioneve penale. ESMA boton të dhënat në lidhje me sanksionet penale të vendosura në raportin vjetor.

5. Nëse autoriteti kompetent nxjerr masën administrative, sanksionin ose sanksionin penal për publikun, ai njëkohësisht i raporton këtë fakt ESMA-s.

6. Nëse sanksioni i botuar penal ose administrative lidhet me shoqërinë e investimit, operatorin e tregu, ofruesin e shërbimit të raportimit të të dhënave, institucionin kreditor, në lidhje me shërbimet dhe aktivitetet e investimit ose me shërbimet ndihmëse, ose nëse dega e shoqërive të vendeve të treta autorizohet në përputhje me këtë direktive, ESMA i shton një referencë regjistrimit përkatës të sanksionit të botuar.

7. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike në lidhje me procedurat dhe formularët e dorëzimit të informacionit siç përmendet në këtë nen.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 72

Ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe kompetencave për vendosjen e sanksioneve

1. Autoritetet kompetente ushtrojnë kompetencat mbikëqyrëse, duke përfshirë kompetencat hetimore dhe ato të rikuperimit, të përmendura në nenin 69, dhe kompetencat për vendosjen e sanksioneve të përmendura në nenin 70, në përputhje me kuadrin e tyre të së drejtës së brendshme:

- a) drejtpërsëdrejti;
- b) në bashkëpunim me autoritete të tjera;
- c) nën përgjegjësinë e tyre, përmes delegimit të subjektet, detyrat e të cilave janë deleguar në përputhje me nenin 67, paragrafi 2; ose
- d) duke aplikuar tek autoritetet kompetente gjyqësore.

2. Gjatë përcaktimit të llojit dhe shkallës së sanksioneve administrative ose caktimit të masës sipas ushtrimit të kompetencave për vendosjen e sanksioneve të nenit 70, shtetet anëtare garantojnë marrjen në konsideratë nga autoritetet kompetente të çdo rrethane përkatëse, duke përfshirë, kur është e përshtatshme:

- a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
- b) shkallën e përgjegjësisë së personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen;
- c) kapacitetin financiar të personit fizik ose juridik përgjegjës, veçanërisht të cilësuar përmes xhiros totale të personit juridik të përgjegjshëm ose përmes të ardhurave vjetore dhe vlerës kontabël të personit fizik të përgjegjshëm;
- d) rëndësinë e të ardhurave të fituara ose humbjeve të shmangura nga personi fizik ose juridik i përgjegjshëm, për aq kohë sa përcaktohet;

e) humbjet e palëve të treta që shkaktohen nga shkelja, për aq kohë sa mund të përcaktohen;

f) nivelin e bashkëpunimit me autoritetin kompetent, të personave fizik ose juridik të përgjegjshme, pa cenuar nevojën për garantimin e të ardhurave të fituara ose humbjeve të shmangura nga ky person;

g) shkelje të mëparshme nga persona fizikë ose juridikë përgjegjës.

Autoritetet kompetente gjithashtu mund të marrin në konsideratë faktorët që i shtohen, gjatë përcaktimit të llojit dhe nivelit të sanksioneve dhe masave administrative, atyre të përmendur në nënparagrafin e parë.

Neni 73

Raportimi i shkeljeve

1. Shtetet anëtare garantojnë ngritjen e mekanizmave efikase nga autoritetet kompetente, në mënyrë që t'i lejojë raportimin e shkeljeve të mundshme ose aktuale, të dispozitave të Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe të dispozitave kombëtare të miratuara për zbatimin e kësaj direktive.

Mekanizmat e përmendura në nënparagrafin e parë përshtajnë të paktën:

a) procedurat specifike për marrjen e raporteve në lidhje me shkeljet e mundshme ose aktuale dhe ndjekjen e tyre, duke përfshirë vendosjen e kanaleve të sigurta të komunikimit për këto raporte;

b) mbrojtjen e përshtatshme të punonjësve të institucioneve financiare, të cilët raportojnë shkelje të kryera brenda institucionit financiar, të paktën ndaj hakmarrjes, diskriminimit, ose llojeve të tjera të trajtimit të padrejtë;

c) mbrojtjen e identitetit, si për personin raportues të shkeljeve, ashtu dhe për personin fizik, i cili pretendohet se përgjigjet për shkeljen, në të gjitha fazat procedurale, përveçse kur ky zbulim kërkohet sipas të drejtës së brendshme, sipas kontekstit të investigimit të mëtejshëm ose sipas procedimeve të mëtejshme administrative ose penale.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërive të investimit, operatorëve të tregut, ofruesve të shërbimit të raportimit të të dhënave, institucioneve kredituese në lidhje me shërbimet ose aktivitetet e investimit dhe shërbimet ndihmëse, dhe degëve të shoqërive të vendeve të treta, caktimin e procedurave të përshtatshme për punonjësit e tyre, në lidhje me raportimin e shkeljeve të mundshme ose aktuale, përmes kanaleve të brendshme, specifike, të pavarura dhe autonome.

Neni 74

E drejta për apelim

1. Shtetet anëtare garantojnë justifikimin e përshtatshëm dhe nënshtrimin ndaj të drejtës së apelimit përpara trupit gjykues, të çdo vendimi të marrë sipas dispozitave të Rregullores (BE) nr. 600/2014 ose sipas ligjeve, rregulloreve ose dispozitave administrative të miratuara në përputhje me këtë direktivë. E drejta e apelimit përpara trupit gjykues zbatohet gjithashtu në lidhje me zbatimin e autorizimit, që siguron të gjithë informacionin e kërkuar, në rastin kur nuk merret asnjë vendim brenda gjashtë muajve nga dorëzimi i tij.

2. Shtetet anëtare parashikojnë që një ose më shumë nga organet e mëposhtme, të caktuara sipas legjislacionit të brendshëm, mundën gjithashtu, në interes të konsumatorëve dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm, të nisnin procedura përpara gjykatave ose organeve administrative kompetente për të garantuar zbatimin e Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe të dispozitave kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj rregulloreje:

- a) organet publike ose përfaqësues të tyre;
- b) organizatat e konsumatorëve me interesa legjitime në mbrojtjen e konsumatorëve; ose
- c) organizatat e profesionale me interesa legjitime në mbrojtjen e anëtarëve të tyre.

Neni 75

Mekanizmi ekstra-gjyqësor për ankimin e konsumatorëve

1. Shtetet anëtare garantojnë ngritjen e procedurave efikase dhe efektive të ankimit dhe të shqyrtimit për zgjidhjet jashtë gjykate, të mosmarrëveshjeve të konsumatorit në lidhje me ofrimin e shërbimeve të investimit dhe atyre ndihmëse, që sigurohen, kur është e përshtatshme, përmes organeve ekzistuese të shoqërive të investimit. Shtetet anëtare garantojnë më tej përkatësinë e të gjitha shoqërive të investimit në një ose më shumë organe zbatuese të këtyre procedurave të ankimit dhe të dëmshpërblimit.

2. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndër-kufitare, shtetet anëtare garantojnë bashkëpunimin aktiv të këtyre organeve me kundërpalët e tyre në shtete të tjera anëtare.

3. Autoritetet kompetente njoftojnë ESMA-n në lidhje me procedurat e ankimit dhe të dëmshpërblimit, të përmendura në paragrafin 1, të cilat disponohen sipas juridiksioneve të saj.

ESMA bën publike dhe përditëson listën e të gjithë mekanizmave ekstra-gjyqësore në faqen e saj të internetit.

Neni 76

Sekreti profesional

1. Shtetet anëtare garantojnë që të gjithë autoritetet kompetente, personat që punojnë ose kanë punuar për autoritetet kompetente, ose subjektet, për të cilat detyrat delegohen në përputhje me nenin 67, paragrafi 2, si dhe ekspertët kontabël dhe vlerësuesit e udhëzuar nga këto autoritete, të respektojnë detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional. Ato nuk zbulojnë asnjë informacion konfidencial, të cilin e marrin gjatë ushtrimit të detyrave, përveçse përmbledhjes ose formës së

agreguar, në mënyrë që të mos identifikohen shoqëritë individuale të investimit, operatorët e tregut, tregjet e rregulluara, ose çdo person tjetër, pa cenuar kërkesat e legjislacionit penal ose të ligjit të taksave, ose çdo dispozitë tjetër të kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

2. Nëse shoqëria e investimit, operatori i tregut, ose tregu i rregulluar ka deklaruar falimentimin ose është në likuidim të detyrueshëm, informacioni konfidencial, që nuk lidhet me palë të treta, mund të nxirret në procedimet civile ose tregtare, nëse është i nevojshëm zhvillimi i këtyre procedimeve.

3. Pa cenuar kërkesat e legjislacionit penal ose të ligjit të taksave, autoritetet kompetente, organet ose personat fizik ose juridik, të ndryshëm nga autoritetet kompetente, të cilët marrin informacionin konfidencial në përputhje me këtë direktivë ose me Rregulloren (BE) nr. 600/2014, mund ta përdorin vetëm në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre, në rastin e autoriteteve kompetente, brenda fushës së veprimit të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014 ose, në rastin e autoriteteve, organeve, ose subjekteve fizike ose juridike të tjera, me qëllimin, sipas të cilit ky informacion sigurohet për ta dhe/ose sipas kontekstit të procedurave administrative ose gjyqësore të lidhura veçanërisht me ushtrimin e këtyre funksioneve. Megjithatë, në rastin kur autoriteti kompetent ose autoritetet, organet ose persona të tjerë, që i komunikojnë autoritetit marrës të informacionit, që lidhet me miratimin e tyre, autoritetit marrës i informacionit mund ta përdori atë për qëllime të tjera.

4. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar sipas kësaj direktive ose sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014 i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuara në këtë nen. Gjithsesi, ky nen nuk i ndalon autoritetet kompetente të shkëmbejnë ose të transmetojnë informacionin konfidencial, në përputhje me këtë direktivë ose Rregulloren (BE) nr. 600/2014 dhe me direktivat ose rregulloret e tjera, që zbatohen për shoqëritë e investimit, institucionet kredituese, fondet e pensionit, SIKTT-ve, AIF-të, ndërmjetësit e sigurimit dhe të risigurimit, sipërmarrjet e sigurimit, tregjet e rregulluara ose operatorët e tregut, kundërpalët qendrorë, Depozitarët Qendrorë për letrat me vlerë, ose ndryshe përmes miratimit të autoriteteve kompetente, ose autoriteteve ose organeve të tjera, ose personave fizik ose juridik, të cilët komunikuan informacionin.

5. Ky nen nuk i ndalon autoritetet kompetente të shkëmbejnë ose të transmetojnë, në përputhje me të drejtën e brendshme, informacion konfidencial, që nuk është marrë nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër anëtar.

Neni 77

Marrëdhëniet me audituesit

1. Shtetet anëtar minimalisht parashikojnë, për çdo person të autorizuar brenda kuptimit të Direktivës 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁴⁹, që ushtron aktivitet në një shoqëri të investimit, në tregun e rregulluar, ose në ofruesin e shërbimit të raportimit të të dhënave, detyrën e përshkruar në nenin 34 të Direktivës 2013/34/KE ose në nenin 73 të Direktivës 2009/65/KE, ose çdo detyrë tjetër të përcaktuar sipas ligjit, për raportimin e menjëhershëm te autoritetet kompetente, mbi çdo fakt ose vendim të lidhur me sipërmarrjen, për të cilën ka marrë dëgjime gjatë kryerjes së kësaj detyre, e cila:

a) përbën shkelje të rëndë të ligjeve, rregulloreve ose dispozitave administrative, që përcaktojnë kushtet për rregullimin e autorizimit ose që rregullojnë konkretisht ushtrimin e aktiviteteve të shoqërive të investimit;

b) ndikon në funksionimin e vazhdueshëm të shoqërisë së investimit;

c) sjell refuzim ose shprehje të rezervave për të vërtetuar llogaritë.

Ky person gjithashtu ka për detyrë raportimin e çdo fakti dhe vendimi, për të cilin ndërgjegjësohet gjatë kryerjes së një prej detyrave të përmendura në nënparagrafin e parë, në sipërmarrjen me lidhje të ngushta me shoqërinë e investimit, brenda të cilës ai kryen këtë detyrë.

2. Dhënia në mirëbesim e ndonjë fakti apo vendimi, të përmendur në paragrafin 1, autoriteteve kompetente, nga persona të autorizuar brenda kuptimit të Direktivës 2006/43/KE, nuk përbën shkelje të kufizimeve kontraktuale ose ligjore për nxjerrjen e informacionit, dhe nuk përfshin këta persona në asnjë lloj detyrimi.

Neni 78

Mbrojtja e të dhënave

Përpunimi i të dhënave personale të grumbulluara, ose për ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse, duke përfshirë kompetencat e hetimit në pajtim me këtë Direktivë, kryhet në përputhje me të drejtën e brendshme për zbatimin e Direktivës 95/46/KE dhe të Rregullores (KE) nr. 45/2001, aty ku zbatohet.

KAPITULLI II

BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE TË SHTETEVE ANËTARE DHE ESMA-S

Neni 79

Detyrimi i bashkëpunimit

1. Autoritetet kompetente të shteteve të ndryshme anëtare, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për qëllime të kryerjes së detyrave të tyre sipas kësaj direktive ose sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014, duke ushtruar kompetencat e tyre të përcaktuara në këtë direktivë ose në Rregulloren (BE) nr. 600/2014 ose në të drejtën e brendshme.

Nëse shtetet anëtare zgjedhin, në përputhje me nenin 70, përcaktimin e sanksionet penale për shkeljet e dispozitave të përmendura në këtë nen, ato garantojnë caktimin e masave të përshtatshme, në mënyrë që autoritetet kompetente të kenë kompetencat e nevojshme të bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore brenda juridiksionit të tyre për marrjen e informacionit specifik në lidhje me hetimet penale ose procedimet e nisura për shkeljet e mundshme të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014, dhe i sigurojnë po këtë informacion ESMA-s, me qëllim përmbushjen e detyrimit të tyre për bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe ESMA-n, për qëllime të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014.

Autoritetet kompetente u ofrojnë ndihmën e tyre autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare. Në veçanti, ato shkëmbejnë informacion dhe bashkëpunojnë në veprimtari hetimore.

Autoritetet kompetente gjithashtu mund të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare, në lidhje me rikuperimin më të lehtë të gjobave.

Për të lehtësuar dhe përshpejtuar bashkëpunimi, dhe në veçanti shkëmbimin e informacionit, shtetet anëtare caktojnë si pikë kontakti, një autoritet të vetëm kompetent, për qëllime të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit, ESMA-s, dhe shteteve të tjera anëtare, emrat e autoriteteve të caktuara për marrjen e kërkesave për shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunimin sipas këtij paragrafi. ESMA bën publike dhe përditëson listën e këtyre autoriteteve në faqen e saj të internetit.

2. Nëse, gjatë marrjes në konsideratë të rrethanave të lidhura me tregjet e letrave me vlerë në shtetin anëtar pritës, operimet e vendit të tregtimit, që ka caktuar marrëveshje në shtetin anëtar pritës, kanë tashmë rëndësi të konsiderueshme për funksionimin e tregjeve të letrave me vlerë dhe për mbrojtjen e investitorëve të këtij shteti anëtar pritës, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës dhe atij pritës, të vendit të tregtimit, caktojnë marrëveshje proporcionale të bashkëpunimit.

3. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme administrative dhe organizative për të lehtësuar bashkëpunimin e parashikuar në këtë paragrafin 1.

Autoritetet kompetente i përdorin kompetencat e tyre për qëllime të bashkëpunimit edhe në rastet kur vepra nën hetim nuk përbën shkelje të ndonjë rregulloreje në fuqi në shtetin anëtar të tyre.

4. Nëse autoriteti kompetent ka arsye të forta për të dyshuar në lidhje me aktet, në kundërshtim me dispozitat e kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014, të cilat kryhen nga subjekte të panënshtuara ndaj mbikëqyrjes së tij, në zhvillim ose të zhvilluara në territorin e një shteti tjetër anëtar, ai njofton autoritetin kompetent të shtetit tjetër anëtar dhe ESMA-n, në mënyrën më specifike të mundshme. Autoriteti kompetent i njoftuar ndërmerr veprimin e përshtatshëm. Ai informon autoritetin kompetent njoftues dhe ESMA-n për rezultatin e veprimit dhe, në masën e mundshme, edhe për zhvillimet e rëndësishme të përkohshme. Ky paragraf nuk cenon kompetencat e autoritetit kompetent njoftues.

5. Pa cenuar paragrafët 1 dhe 4, autoritetet kompetente njoftojnë ESMA-n dhe autoritetet e tjera kompetente në lidhje me hollësitë e:

a) çdo kërkesë për reduktimin e madhësisë të pozicionit ose të ekspozimit sipas nenit 69, paragrafi 2, germa "o";

b) çdo kufizim në aftësinë e personave për t'u marrë me derivatet e mallrave me përdorim të gjerë sipas nenit 69, paragrafi 2, germa "p".

Njoftimi përfshin, sipas rastit, detajet e kërkesës ose të kërkesës sipas nenit 69, paragrafi 2, germa "j", duke përfshirë identitetin e personit ose të personave marrës dhe arsyet përkatëse, si

dhe fushën e zbatimit të kufijve të paraqitur sipas nenit 69, paragrafi 2, germa "p", duke përfshirë personin e interesuar, instrumentet financiare të zbatueshme, çdo kufizim mbi madhësinë e pozicioneve të mbajtura në çdo kohë nga ky person, çdo përjashtim për të, i dhënë në përputhje me nenit 57, dhe arsyet për të.

Njoftimet paraqiten jo më pak se 24 orë para hyrjes në fuqi të veprimeve ose masave të synuara. Në rrethana të jashtëzakonshme, autoriteti kompetent mund të paraqesë njoftimin në më pak se 24 orë nga hyrja në fuqi e masës së synuar, në rastin e pamundësisë së dhënies së njoftimit 24 orësh.

Autoriteti kompetent i shtetit anëtar, i cili merr njoftimin sipas këtij paragrafi, merr masat në përputhje me nenin 69, paragrafi 2, germa "o" ose "p", në rastin e pajtimit me masën e nevojshme për arritjen e objektivit të autoritetit kompetent. Autoriteti kompetent gjithashtu mund të paraqesë njoftimin në përputhje me këtë paragraf, në rastin kur propozon marrjen e masave.

Nëse veprimi sipas germave "a" ose "b" të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi lidhet me produktet energjetike të tregtuara me shumicë, autoriteti kompetent gjithashtu njofton Agjencinë e Komisionit të Rregullatorëve të Energjisë (ACER), të themeluar sipas rregulluar (KE) nr. 713/2009.

6. Në lidhje me kuotat e shkarkimeve, autoritetet kompetente bashkëpunojnë me organet publike kompetente të mbikëqyrjes së tregjeve të kursit aktual dhe të ankandit, dhe me autoritetet kompetente, administratorët e regjistrave dhe organet e tjera publike, të ngarkuara me mbikëqyrjen e përputhjes sipas Direktivës 2003/87/KE, me qëllim garantimin e përshkrimit të konsoliduar të tregjeve të kuotave të shkarkimeve.

7. Në lidhje me derivatet e mallrave me përdorim bujqësor, autoritetet kompetent raportojnë te, dhe bashkëpunojnë me organet publike kompetente të mbikëqyrjes, administrimit dhe rregullimit të tregjeve të prodhimeve bujqësore sipas Rregullores (BE) nr. 1308/2013.

8. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 për vendosjen e kriteve, sipas të cilave, operimet e vendit të tregtimit të shtetit anëtar pritës konsiderohen me rëndësi të konsiderueshme në lidhje me funksionimin e tregjeve të letrave me vlerë dhe mbrojtjen e investitorëve të këtij vendi anëtar pritës.

9. ESMA zhvillon draft standardet teknike zbatuese për caktimin e formularëve standard, të modeleve, dhe të procedurave për marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në paragrafin 2.

ESMA, jo më vonë se 3 janari 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente në detyra mbikëqyrëse, për verifikimet ose hetimet në terren

1. Autoriteti kompetent i një shteti anëtar mund të kërkojë bashkëpunimin e autoritetit kompetent të një shteti tjetër anëtar në veprimtari mbikëqyrëse ose për verifikime në terren, ose hetime. Në rastin e shoqërive të investimit të distancuara, anëtare ose pjesëmarrëse në tregun e rregulluar, autoriteti kompetent i tregut të rregulluar mund të zgjedhë adresimin e tyre drejtpërsëdrejti. Në këtë rast ai njofton autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, përkatësisht të anëtarit ose pjesëmarrësit të distancuar.

Kur një autoritet kompetent merr kërkesë në lidhje me verifikimin ose hetimin në terren, ai, brenda kuadrit të kompetencave të tij:

- a) kryen vetë verifikimin ose hetimin;
- b) lejon kryerjen e verifikimit apo hetimit nga autoriteti kërkuar; ose
- c) lejon kryerjen e verifikimit ose hetimit nga ekspertë kontabël ose vlerësues.

2. Në bazë të objektivit të konvergencës së praktikave mbikëqyrëse, ESMA mund të marrë pjesë në aktivitetet e kolegjeve mbikëqyrëse, duke përfshirë verifikimet ose hetimet në terren, të ndërmarra bashkërisht nga dy ose më shumë autoritete kompetente, në përputhje me nenin 21 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. ESMA zhvillon draft standardet teknike rregullatore për specifikimin e informacionit të shkëmbyer ndërmjet autoriteteve kompetente gjatë bashkëpunimit në aktivitetet mbikëqyrëse, verifikimet në terren dhe investigimet.

ESMA, jo më vonë se data 3 korrik 2015, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike rregullatore.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e standardeve të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 10 deri 14 të Rregullores. (BE) nr. 1095/2010.

4. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike për caktimin e formularëve standarde, të modeleve, dhe të procedurave të autoriteteve kompetente për bashkëpunim në aktivitete mbikëqyrëse, verifikime në terren, dhe hetime.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 81

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare, të cilat caktohen si pika kontakti për qëllime të kësaj direktive dhe të Rregullores (BE) nr. 600/2014 në përputhje me nenin 79, paragrafi 1 të kësaj direktive, i ofron menjëherë njëri-tjetrit informacionin e kërkuar për qëllime të zhvillimit të detyrave të autoriteteve kompetente, të caktuara në përputhje me nenin 67, paragrafi 1 i kësaj direktive, i përcaktuar në dispozitat e miratuara sipas kësaj direktive ose sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014.

Autoritetet kompetente që shkëmbejnë informacion me autoritete të tjera kompetente sipas kësaj direktive ose Rregullores (BE) nr. 600/2014, mund të bëjnë të ditur në momentin e komunikimit, që ky informacion nuk duhet të nxirret pa miratimin e shprehur të tyre, rast në të cilin, ky informacion mund të jepet vetëm për qëllimet e miratuara nga autoritetet.

2. Autoriteti kompetent që caktohet si pikë kontakti në përputhje me nenin 79, paragrafi 1, mund t'i transmetojë autoriteteve të përmendura në nenin 67, paragrafi 1, informacionin e marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe sipas neneve 77 dhe 88. Ato nuk ia transmetojnë atë organeve të tjera ose personave fizik ose juridik, pa miratimin e shprehur të autoriteteve kompetente dhënëse, dhe vetëm për qëllimet, për të cilat këto autoritete dhanë miratimin e tyre, përveç rrethanave të justifikuara siç duhet. Në këtë rast të fundit, pika e kontakti informon menjëherë pikën e kontaktit që ka dërguar informacionin.

3. Autoritetet siç përmenden në nenin 71, si dhe organe të tjera ose persona fizik ose juridik, që marrin informacion konfidencial sipas paragrafit 1 të këtij neni ose sipas neneve 77 dhe 88, mund ta përdorin vetëm gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, në veçanti:

a) për kontrollin e përmbushjes së kushteve që rregullojnë ngritjen e veprimtarisë së shoqërive të investimit dhe për lehtësimin e monitorimit, në bazë të konsoliduar ose jo, të sjelljes së kësaj veprimtarie, në veçanti lidhur me kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit, të caktuara nga Direktiva 2013/36/BE, me procedurat administrative dhe ato kontabël, si dhe me mekanizmat e kontrollit të brendshëm;

b) për monitorimin e funksionimit të duhur të vendeve tregtare;

c) për vendosjen e sanksioneve;

d) apelimet administrative kundër vendimeve të marra nga autoritetet kompetente;

e) në proceset gjyqësore të nisura sipas nenit 74;

f) në mekanizmin ekstra-gjyqësor lidhur me ankesat e investitorëve të parashikuara në nenin 75.

4. ESMA zhvillon draft standardet teknike zbatuese për caktimin e formularëve standard, të modeleve, dhe të procedurave për shkëmbimin e informacionit.

ESMA, jo më vonë se 3 janari 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

5. As ky nen dhe as nenet 76 ose 88 nuk ndalojnë autoritetin kompetent t'i transmetojë ESMA-s, Bordit Evropian të rrezikut sistematik, SEBQ-së dhe BQE-së, në cilësinë e tyre si autoritete monetare, dhe kur është e përshtatshme, autoriteteve të tjera publike përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemeve rregullatore dhe të pagesave, informacionin konfidencial me synim performancën e detyrave të tyre. Në mënyrë të ngjashme, këtyre autoriteteve ose organeve nuk i ndalohet komunikimi i këtij informacioni te autoritetet kompetente, që mund t'iu nevojitet për qëllimet e zbatimit të funksioneve të tyre, të parashikuara në këtë direktivë ose në Rregulloren (BE) nr. 600/2014.

Neni 82

Ndërmjetësimi detyruës

1. Autoritetet kompetente mund t'i referojnë ESMA-s rrethanat, në të cilat kërkesa refuzohet ose nuk reagohe brenda një kohe të arsyeshme, në lidhje me të mëposhtmet:

a) zhvillimin e aktivitetit mbikëqyrës, dhe verifikimin në terren, ose hetimit, siç përmendet në nenin 80; ose

b) shkëmbimin e informacionit, siç parashikohet në nenin 81.

2. Për rastet e përmendura në paragrafin 1, ESMA mund të veprojë në përputhje me nenin 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, pa cenuar mundësitë e refuzimit të veprimit lidhur me kërkesën për informacion, të parashikuar në nenin 83 të kësaj direktive dhe mundësinë e veprimit të ESMA-s, në përputhje me nenin 17 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 83

Refuzimi i bashkëpunimit

Autoriteti kompetent mund të refuzojë veprimin sipas kërkesës së bashkëpunimit, në lidhje me zhvillimin e hetimit, të verifikimit në terren ose të aktivitetit mbikëqyrës, siç parashikohet në nenin 84, ose për shkëmbimin e informacionit, siç parashikohet në nenin 81, vetëm kur:

a) është nisur tashmë një proces gjyqësor të lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtëve persona përpara autoriteteve të shtetit anëtar të cilit i drejtohet, ose

b) vendimi përfundimtar i dorëzohet tashmë shtetit anëtar, të cilit i drejtohet në lidhje me të njëjtët persona dhe të njëjtat veprime.

Në rastin e një refuzimi të tillë, autoriteti kompetent njofton përkatësisht autoritetin kompetent kërkues dhe ESMA-n, duke siguruar informacion sa më të hollësishëm.

Neni 84

Këshillimi para autorizimit

1. Autoritetet kompetente të shtetit tjetër anëtar të përfshirë duhet të këshillohen përpara autorizimit të shoqërisë së investimit, që mund të jetë një nga të mëposhtmet:

a) filial i shoqërisë së investimit ose të operatorit të tregut, ose të institucionit kreditor të autorizuar në një shtet tjetër anëtar;

b) filial i shoqërisë mëmë të një shoqërie të investimit, ose të institucion kreditor të autorizuar në një shtet tjetër anëtar;

c) e kontrolluar nga të njëjtët persona fizikë ose juridikë që kontrollojnë një shoqëri të investimeve ose institucion kreditor të autorizuar në një shtet tjetër anëtar.

2. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve kredituese ose të sipërmarrjeve të sigurimit, këshillohet para dhënies së autorizimit për shoqërinë e investimit ose operatorin e tregut, që ka formën e mëposhtme:

a) filial i institucionit kreditor ose i sipërmarrjes së sigurimit, të autorizuar në Bashkimin Evropian;

b) filial i shoqërisë mëmë të institucionit kreditor ose të sipërmarrjes së sigurimit, të autorizuar në Bashkimin Evropian;

c) të kontrolluara nga i njëjti person, qoftë fizik ose juridik, i cili kontrollon institucionin kreditor ose sipërmarrjen e sigurimit, të autorizuar në Bashkimin Evropian.

3. Autoritetet kompetente përkatëse të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 këshillohen, në mënyrë të veçantë me njëri-tjetrin, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së aksionarëve ose anëtarëve, dhe të reputacionit dhe eksperiencës së personave, të cilët drejojnë me efikasitet veprimtarinë e përfshirë, për të njëjtin grup, në lidhje me administrimin e subjektit tjetër. Ata shkëmbejnë të gjithë informacionin në lidhje me përshtatshmërinë e aksionarëve ose anëtarëve, dhe me reputacionin dhe eksperiencën e personave që drejojnë me efikasitet veprimtarinë përkatëse, në lidhje me përfshirjen e autoriteteve të tjera kompetente, në lidhje me autorizimin, si dhe për vlerësimin e vazhdueshëm të përputhjes me kushtet operative.

4. ESMA zhvillon draft standardet e zbatimeve teknike për caktimin e formularëve standard, të modeleve, dhe të procedurave për këshillimin me autoritetet e tjera kompetente përpara dhënies së autorizimit.

ESMA, jo më vonë se data 3 janar 2016, i dorëzon Komisionit draft standardet teknike zbatuese.

I jepet Komisionit kompetenca për të miratuar standardet teknike zbatuese që përmenden në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 85

Kompetencat e shteteve anëtare pritëse

1. Shtetet anëtare pritëse i sigurojnë autoritetit kompetent, për qëllime statistikore, mundësinë që t'i kërkojë të gjitha shoqërive të investimit, me degë brenda territorit të tyre, raportimin periodik në lidhje me aktivitetet e këtyre degëve.

2. Gjatë shkarkimit të përgjegjësive të tyre sipas kësaj direktive, shtetet anëtare pritëse i sigurojnë autoritetit kompetent, mundësinë e sigurimit të informacionit të nevojshëm për monitorimin e përputhjes së degëve të shoqërive të investimit me standardet e përcaktuara nga shteti anëtar pritës, që zbatohen për to, në rastet e parashikuara në nenin 35, paragrafi 8. Këto kërkesa nuk duhet të jenë më të rrepta se sa ato që po ky shtet anëtar vendos për shoqëritë e themeluara, në lidhje me monitorimin e përputhjes së tyre së tyre me të njëjtat standarde.

Neni 86

Masat parandaluese që ndërmerren nga shtetet anëtare pritëse

1. Nëse autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës ka arsye të qarta dhe të vërtetueshme për të besuar se shoqëria e investimit, që vepron brenda territorit të tij sipas lirisë për ofrimin e shërbimeve, shkel detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e miratuara në përputhje me këtë direktivë, ose shoqëria e investimit, që ka degë në territorin e tij, shkel detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e miratuara në përputhje me këtë direktivë, të cilat nuk i akordojnë kompetenca autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës, ai referon gjetjet te autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës.

Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, ose për shkak të masave, që rezultojnë të papërshtatshme, shoqëria e investimit vazhdon të veprojë në një mënyrë që cenon dukshëm interesat e investitorëve të shtetit anëtar pritës ose funksionimin e rregullt të tregjeve, zbatohen ato si më poshtë:

a) pas informimit të autoritetit kompetent të shteti anëtar të origjinës, autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës merr të gjithë masat e përshtatshme dhe të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve dhe për funksionimin e duhur të tregjeve, të cilat përfshijnë mundësinë e parandalimit të nisjes së transaksioneve të shoqërive të investimit, në rastin e shkeljeve ligjore brenda territoreve të tyre. Komisioni dhe ESMA informohen në lidhje me këto masa, pa vonesa të paarsyeshme; dhe

b) autoriteti kompetent i shteti anëtar pritës mund t'i referojë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat, që i akordohen sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

2. Nëse autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës konstaton se shoqëria e investimit, që ka degë brenda territorit të tij, shkel dispozitat ligjore ose rregullatore, të miratuara në këtë shtet

anëtar në përputhje me ato dispozita të kësaj direktive, të cilat i akordojnë kompetenca autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës, ato i kërkojnë shoqërisë përkatëse të investimit t'i japi fund situatës së çrregullt.

Nëse shoqëria përkatëse e investimit nuk arrin të marrë hapat e nevojshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës marrin masat e përshtatshme për t'i garantuar shoqërisë së investimit dhënien fund të situatës së çrregullt. Natyra e këtyre masave i komunikohet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese.

Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës, shoqëria e investimit vazhdon shkeljen e dispozitave ligjore ose rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, të cilat hyjnë në fuqi në shtetin anëtar pritës, autoriteti kompetent i shteti anëtar pritës, pasi informon autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, merr masat e përshtatshme dhe të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve dhe për funksionimin e duhur të tregjeve. Komisioni dhe ESMA informohen në lidhje me këto masa, pa vonesa të paarsyeshme.

Gjithashtu, autoriteti kompetent i shteti anëtar pritës mund t'i referojë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat, që i akordohen sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. Nëse autoriteti kompetent ose shteti anëtar pritës i tregut të rregulluar, MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregtimit ka arsye të qarta dhe të vërtetueshme për të besuar se ky treg i rregulluar, MTF, ose platformë e përbashkët e tregtimit shkel detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e miratuara sipas kësaj direktive, ai i referon këto gjetje te autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës të tregut të rregulluar ose MTF-së, ose platformës së përbashkët të tregtimit.

Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, ose për shkak të masave, që rezultojnë të papërshtatshme, tregu i rregulluar ose MTF-ja, ose platforma e përbashkët e tregtimit, vazhdon të veprojë në një mënyrë që cenon dukshëm interesat e investitorëve të shteti anëtar pritës ose funksionimin e rregullt të tregjeve, autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës, pasi informon autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, merr masat e përshtatshme dhe të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve dhe për funksionimin e duhur të tregjeve, të cilat përfshijnë mundësinë e parandalimit të marrëveshjeve të zhvilluara nga tregu i rregulluar ose MTF-ja, ose platforma e përbashkët e tregtimit, që vihen në dispozicion të anëtarëve ose pjesëmarrësve me vendndodhje në shtetin anëtar pritës. Komisioni dhe ESMA informohen në lidhje me këto masa, pa vonesa të paarsyeshme.

Gjithashtu, autoriteti kompetent i shteti anëtar pritës mund t'i referojë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat, që i akordohen sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

4. Çdo masë e miratuar sipas paragrafëve 1, 2 ose 3 që përfshin sanksione ose kufizime mbi aktivitetet e shoqërisë së investimit ose të tregut të rregulluar, justifikohet siç duhet dhe i komunikohet shoqërisë së investimit ose tregut të rregulluar përkatës.

Neni 87

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me ESMA-n

1. Për qëllime të kësaj direktive, autoritetet kompetente bashkëpunojnë me ESMA-n në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1095/2010.

2. Autoritetet kompetente, pa vonesa të paarsyeshme, i sigurojnë ESMA-s të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të saj, sipas kësaj direktive dhe sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014 dhe në përputhje me nenet 35 dhe 36 të Rregullores (E) nr. 1095/2010.

KAPITULLI III

BASHKËPUNIMI ME VENDET E TRETA

Neni 88

Shkëmbimi i informacionit me vendet e treta

1. Shtetet anëtare dhe, në përputhje me nenin 33 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, ESMA, mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi që parashikojnë shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente të vendeve të treta, vetëm nëse informacioni i dhënë u nënshtrohet garancive të sekretit profesional, të paktën të barasvlershme me ato të kërkuara sipas nenit 76. Shkëmbimi i këtij informacioni kryhet me qëllim të performancës së detyrës së këtyre autoriteteve kompetente.

Transferimi i të dhënave në vendet e treta përmes një shteti anëtar, zhvillohet në përputhje me kapitullin IV të Direktivës 95/46/KE.

Transferimi i të dhënave në vendet e treta përmes ESMA-s, zhvillohet në përputhje me nenin 9 të Rregullores (BE) nr. 45/2001.

Shtetet anëtare dhe ESMA mund të lidhin marrëveshje të bashkëpunimit për sigurimin e shkëmbimit të informacionit me autoritetet kompetente të vendeve të treta, me organet dhe personat fizik ose juridik përgjegjës për një ose disa të mëposhtmet:

a) mbikëqyrjen e institucioneve kredituese, institucioneve të tjera financiare, sipërmarrjeve të sigurimit, dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare;

b) likuidimin dhe falimentimin e shoqërive të investimit dhe procedura të tjera të ngjashme;

c) zhvillimin e auditimeve statusore të llogarive të shoqërive të investimit dhe të institucioneve të tjera financiare, të institucioneve kredituese dhe sipërmarrjeve të sigurimit, për kryerjen e funksioneve mbikëqyrëse, ose të cilat administrojnë skemat e kompensimit, për performancën e funksioneve të tyre;

d) mbikëqyrjen e organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e shoqërive të investimit, dhe në procedura të tjera të ngjashme;

e) mbikëqyrjen e personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve statusore të llogarive të sipërmarrjeve të sigurimit, institucioneve kredituese, shoqërive të investimit ose institucioneve të tjera financiare;

f) mbikëqyrjen e personave aktiv në tregjet e kuotave të shkarkimeve, me qëllim garantimin e përshkrimit të konsoliduar të tregjeve financiare dhe të kursit aktual;

g) mbikëqyrjen e personave aktiv në tregjet e derivate të mallrave me përdorim bujqësor, me qëllim garantimin e përshkrimit të konsoliduar të tregjeve financiare dhe të kursit aktual.

Marrëveshja e bashkëpunimit, që përmendet në nënparagrafin e tretë, mund të lidhet vetëm në rastin kur informacioni i nxjerrë i nënshtrohet garancive të sekretit profesional, të paktën të barasvlershme me ato të kërkuara sipas nenit 76. Shkëmbimi i këtij informacioni kryhet me qëllim performancën e detyrës së këtyre autoriteteve ose organeve, ose të personave fizik ose juridik. Nëse marrëveshja e bashkëpunimit përfshin transferimin e të dhënave personale nga një shtet anëtar, ky i fundit përputhet me kapitullin IV të Direktivës 95/46/ KE dhe me Rregulloren (KE) nr. 45/2001, në rastin kur ESMA përfshihet në këtë transfertë.

2. Kur informacioni vjen nga një tjetër shtet anëtar, ai nuk nxirret pa miratimin e shprehur të autoriteteve kompetente dhënëse dhe në rast se nxirret, kjo bëhet vetëm për qëllimet e miratuara prej këtyre të fundit. E njëjta dispozitë zbatohet për informacionin e siguruar nga autoritetet kompetente të vendeve të treta.

TITULLI VII

AKTET E DELEGUARA

Neni 89

Ushtrimi i delegimit

1. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara i delegohen Komisionit sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Delegimi i kompetencës, i përmendur në nenin 2, paragrafi 3, nënparagrafin e dytë të nenit 4, paragrafi 1 dhe 2, nenin 4, paragrafi 2, nenin 13, paragrafi 1, nenin 16, paragrafi 12, nenin 23, paragrafi 4, nenin 24, paragrafi 13, nenin 25, paragrafi 8, nenin 27, paragrafi 9, nenin 28, paragrafi 3, nenin 30, paragrafi 5, nenin 31, paragrafi 4, nenin 32, paragrafi 4, nenin 33, paragrafi 8, nenin 52, paragrafi 4, nenin 54, paragrafi 4, nenin 58, paragrafi 6, nenin 64, paragrafi 7, nenin 65, paragrafi 7 dhe nenin 79, paragrafi 8 i akordohen Komisionit për një periudhë të pacaktuar kohore, duke nisur nga 2 korriku 2014.

3. Delegimi i kompetencave, i përmendur në nenin 2, paragrafi 3, nënparagrafi i dytë i nenit 4, paragrafi 1 dhe 2, nenin 4, paragrafi 2, nenin 13, paragrafi 1, nenin 16, paragrafi 12, nenin 23, paragrafi 4, nenin 24, paragrafi 13, nenin 25, paragrafi 8, nenin 27, paragrafi 9, nenin 28, paragrafi 3, nenin 30, paragrafi 5, nenin 31, paragrafi 4, nenin 32, paragrafi 4, nenin 33, paragrafi 8, nenin 52, paragrafi 4, nenin 54, paragrafi 4, nenin 58, paragrafi 6, nenin 64, paragrafi 7, nenin 65, paragrafi 7 dhe nenin 79, paragrafi 8 mund të revokohen në çdo kohë nga Parlamenti

Evropian ose nga Këshilli. Vendimi i revokimit i jep fund delegimit të kompetencave të specifikuar në atë vendim. Ai hyn në fuqi një ditë pas botimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme që specifikohet në vendim. Ai nuk cenon vlefshmërinë e ndonjë akti të deleguar të hyrë tashmë në fuqi.

4. Kur miraton një akt të deleguar, Komisioni njofton për këtë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

5. Një akt i deleguar, i miratuar sipas nenit 2, paragrafi 3, nenit 4, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2, nenit 4, paragrafi 2, nenit 13, paragrafi 1, nenit 16, paragrafi 12, nenit 23, paragrafi 4, nenit 24, paragrafi 13, nenit 25, paragrafi 8, nenit 27, paragrafi 9, nenit 28, paragrafi 3, nenit 30, paragrafi 5, nenit 31, paragrafi 4, nenit 32, paragrafi 4, nenit 33, paragrafi 8, nenit 52, paragrafi 4, nenit 54, paragrafi 4, nenit 58, paragrafi 6, nenit 64, paragrafi 7, nenit 65, paragrafi 7 dhe nenit 79, paragrafi 8, hyn në fuqi vetëm nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim as nga Parlamenti Evropian as nga Këshilli, brenda një periudhe tremujore pasi Parlamenti Evropian ose Këshilli është njoftuar për këtë akt, ose nëse, përpara përfundimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë shtyhet me dy muaj me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 90

Raportimi dhe rishikimi

1. Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian dhe Këshillit, para datës 3 mars 2019, një raport për:

a) funksionimin e platformave të përbashkëta të tregtimit, duke përfshirë përdorimin e transaksioneve përkuese për llogari të tij, duke marrë në konsideratë eksperiencën mbikëqyrëse, të fituar nga autoritetet kompetente, numrin e platformave të përbashkëta të tregtimit, të autorizuara në Bashkimin Evropian, dhe pjesën e tyre të tregu, dhe veçanërisht ruajtjen e përshtatshmërisë, në lidhje me shqyrtimin e rregullimeve të nevojshme për përkufizimin e platformës së përbashkët të tregtimit dhe me gamën e instrumenteve financiare të mbuluara nga kategoria e platformës së përbashkët e tregtimit;

b) funksionimin e regjimit të tregjeve në rritje të SME-ve, duke marrë në konsideratë numrin e MTF-ve të regjistruara si tregje në rritje të SME-ve, numrin e emetuesve prezent në to, dhe volumet tregtare përkatëse;

Në veçanti, raporti vlerëson mundësinë e ruajtjes së minimumit të përshtatshëm, të kufirit në nenin 33, paragrafi 3, germa "a", me qëllim ndjekjen e objektivave të tregjeve në rritje të SME-ve, të caktuara në këtë direktivë;

c) ndikimin e kërkesave në lidhje me tregtimin algoritmik, duke përfshirë tregtimin algoritmik me frekuencë të lartë;

d) eksperiencën lidhur me mekanizmin e ndalimit të produkteve ose praktikave të caktuara, duke marrë në konsideratë numrin e mekanizmave të nxitur në kohë, dhe efektet e tyre;

e) zbatimin e sanksioneve administrative dhe legjislativë, dhe në veçanti nevojën për harmonizimin e mëtejshëm të sanksioneve administrative, të përcaktuara në lidhje me shkeljet e kërkesave të përcaktuara nga kjo direktivë dhe Rregullorja (BE) nr. 600/2014;

f) ndikimin e zbatimit të kufijve të pozicioneve dhe menaxhimit të pozicioneve, në lidhje me likuiditetin, abuzimin në treg, dhe vendosjen e rregullt të çmimit dhe kushtet të shlyerjes në tregjeve të derivateve të mallrave me përdorim të gjerë;

g) zhvillimi i çmimeve të të dhënave të transparencës para dhe pas tregtimit, për MTF-të, platformat e përbashkëta të tregtimit, dhe skemat e publikimit të miratuar;

h) ndikimin e kërkesës për shpalljen e tarifave, komisioneve dhe përfitimeve jomonetare, në lidhje me ofrimin e shërbimit të investimit ose shërbimit ndihmës për klientin, në përputhje me nenin 24, paragrafi 9, duke përfshirë ndikimin e tij mbi funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, në lidhje me këshillat e investimit ndërkufitare.

2. Komisioni, pasi këshillohet me ESMA-n, prezanton raportet te Parlamenti Evropian dhe Këshilli, në lidhje me funksionimin e QSHKE-së, të caktuar në përputhje me titullin V. Raporti në lidhje me nenin 65, paragrafi 1 prezantohet jo më vonë se data 3 shtator 2018. Raporti lidhur me nenin 65, paragrafi 2 prezantohet jo më vonë se data 3 shtator 2020.

Raportet e përmendura në nënparagrafin e parë vlerësojnë funksionimin e QSHKE ndaj kritereve si më poshtë:

a) disponueshmërinë dhe kohën e informacionit pas tregtimit, sipas formularit të konsoliduar, duke përfshirë të gjithë transaksionet, pavarësisht nëse ato zhvillohen ose jo në vendin e tregtimit;

b) disponueshmërinë dhe kohën informacionit të plotë dhe të pjesshëm pas tregtimit, i cili ka cilësi të lartë, në formate lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme për pjesëmarrësit në treg, dhe të disponueshme mbi baza të arsyeshme tregtare.

Nëse Komisioni del në përfundimin se ofruesit e QSHKE-ve nuk kanë siguruar informacionin, në mënyrë që të plotësojë kriteret e përcaktuara në nënparagrafin e dytë, komisioni shoqëron raportin e tij me kërkesën e ESMA-s, në lidhje me nxjerrjen e procedurës së negociuar, në lidhje me emërimin, përmes procedurës së prokurimit publik, të drejtuar nga ESMA, të subjektit tregtar, që operon një QSHKE. ESMA nis procedurën, pas marrjes së kërkesës nga Komisioni, në lidhje me kushtet e specifikuar në kërkesën e Komisionit dhe në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit⁵⁰.

3. Në rastin e nisjes së procedurës së përshkruar në paragrafin 2, Komisioni ka kompetencën e miratimit të akteve të deleguara në përputhje me nenin 89, për ndryshimin e neneve 59 deri në 65 dhe seksionin D të shtojcës I të kësaj direktive, dhe nenin 2, paragrafi 1, pika 19 të Rregullores (BE) nr. 600/2014, duke specifikuar masat për:

a) sigurimin e kohëzgjatjes së kontratës së subjektit tregtar, që operon QSHKE-në, dhe procesin dhe kushtet e rishikimit të kontratës dhe nxjerrjen e prokurimit të ri publik;

b) sigurimin e operimit të QSHKE-së nga subjekti tregtar, në baza ekskluzive, dhe se asnjë subjekt tjetër nuk autorizohet si ofrues i QSHKE-ve në përputhje me nenin 59;

c) autorizimin e ESMA-s për garantimin e pajtueshmërisë me kushtet e buta, të subjektit tregtar që operon QSHKE-në, i cili emërohet përmes prokurimit publik;

d) garantimi i informacionit pas tregtimit, të ofruar nga subjekti tregtar, që operon QSHKE-në, me cilësi të lartë, në formate lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme nga pjesëmarrësit e tregut, dhe sipas formatit të konsoliduar, i cili përfshin të gjithë tregun;

e) garantimi i sigurimit të informacionit pas tregtimit, të ofruar në baza të arsyeshme tregtare, si për bazat e konsoliduara, ashtu dhe ato të pakonsoliduara, dhe i plotësimit të nevojave për këtë informacion, për përdoruesit në të gjithë Bashkimin Evropian;

f) garantimi i dorëzimit të të dhënave tregtare, nga vendet e tregtimit dhe skemat e publikimit të miratuar, në lidhje me subjektin tregtar që operon QSHKE-në, i cili emërohet përmes procesit të prokurimit publik, të drejtuar nga ESMA me kosto të arsyeshme;

g) specifikimi i marrëveshjeve të zbatueshme, në rastin kur subjekti tregtar, që operon QSHKE-në, i cili emërohet përmes procesit të prokurimit publik, nuk plotëson kushtet e buta;

h) specifikimi i marrëveshjeve, sipas të cilave ofruesi i QSHKE-ve, që autorizohet sipas nenit 59, mund të vazhdojë operimin e QSHKE-së në rastin e mospërdorimit të autorizimit të siguruar në germën "b" të këtij paragrafi, ose në rastin e emërimit të subjektit përmes prokurimit publik, deri në afatin e përfundimit të prokurimit të ri publik dhe emërimin e subjektit, në lidhje me operimin e QSHKE-së.

4. Komisioni përgatit një raport përpara 1 janarit 2018, pasi këshillohet me ESMA-n dhe Agjencinë e Komisionit të Rregullatorëve të Energjisë për vlerësimin e ndikimit të mundshëm në çmimet e energjisë dhe për funksionimin e tregjeve të energjisë, si dhe rentabilitetin dhe përfitimet në lidhje me reduktimin e riskut kundra-parti dhe sistematik, dhe nënshtrimin e kostove të drejtpërdrejta të kontratave të derivateve të produkteve energjetike C6 ndaj detyrimit të klerimit të përcaktuar në nenin 4 të Rregullores (BE) nr. 648/2012, teknikat e zbutjes së riskut të përcaktuara në nenin 11, paragrafi 3 të saj dhe përfshirjen e tyre në llogaritjen e kufirit të kliringut sipas nenit 10 të saj.

Nëse Komisioni konsideron si të përealizueshme dhe të padobishme përfshirjen e këtyre kontratave, kur është e përshtatshme, ai i dorëzon propozimin ligjor Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 89 të kësaj direktive për zgjatjen e periudhës 42-mujore të përmendur në nenin 95, paragrafi 1 të kësaj direktive, një herë në dy vjet dhe një periudhë të zgjatur me një vit.

Neni 91

Ndryshimet e Direktivës 2002/92/KE

Direktiva 2002/92/KE ndryshohet si më poshtë:

1. Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

a) në paragrafin 3 fjalia e dytë zëvendësohet me sa më poshtë:

"Me përjashtim të kapitullit III A të kësaj direktive, aktivitetet, të cilat ndërmerren nga sipërmarrja e sigurimit ose nga punonjësi i sipërmarrjes së sigurimit, i cili vepron nën përgjegjësinë e sipërmarrjes së sigurimit, nuk konsiderohen aktivitete ndërmjetëse të sigurimit ose shpërndarje të sigurimeve";

b) shtohet pika si më poshtë:

"13 Për qëllimet e kapitullit IIIA, "produkti i lidhur me skemën e investimeve" është produkti i skemës së sigurimeve, i cili ofron maturimin ose vlerën e dorëzimit, dhe në të cilin, maturimi ose çmimi i dorëzimit ekspozohet plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndaj luhatjeve në treg, pa përfshirë:

a) produktet e sigurimit jojetë, siç renditen në shtojcën I të Direktivës 2009/138/KE (klasat e sigurimit jojetë);

b) kontratat e sigurimit të jetës, për të cilat përfitimet sipas kontratës paguhën vetëm në rast vdekjeje ose në lidhje me paaftësinë për shkak të dëmtimeve, sëmundjeve ose paaftësive fizike apo mendore;

c) produktet e pensionit, të cilat njihen sipas të drejtës së brendshme se kanë qëllim parësor sigurimin e të ardhurave për investitorin e dalë në pension, dhe të cilat i japin investitorit të drejta mbi përfitime të caktuara;

d) skemat e pensioneve profesionale, të njohura zyrtarisht, që përfshihen në qëllimin e Direktivës 2003/41/KE ose Direktivën 2009/138/KE;

e) produktet e pensioneve individuale, të cilat sipas të drejtës së brendshme, i kërkojnë punëdhënësit kontributin financiar, dhe për të cilat punëdhënësi ose punëmarrësi nuk kanë të drejtë zgjedhjeje në lidhje me produktin e pensionit ose ofruesin".

2. shtohet kapitulli i mëposhtëm:

"KAPITULLI IIIA

KËRKESA SHITESË TË MBROJTJES KONSUMATORE NË LIDHJE ME PRODUKTET E LIDHURA ME SKEMËN E SIGURIMEVE

Neni 13/a

Fusha e zbatimit

Duke iu nënshtruar përjashtimit të nënparagrafit të dytë të nenit 2, paragrafi 3, ky krye përcakton kërkesat shtesë për aktivitetet ndërmjetëse të sigurimit dhe për shitjet e drejtpërdrejta

të zhvilluara nga sipërmarrjet e sigurimeve, kur ato zhvillohen në lidhje me shitjen e produkteve të lidhura me skemën e sigurimeve. Këto aktivitete përkufizohen si aktivitete të shpërndarjes së sigurimeve.

Neni 13/b

Parandalimi i konflikteve të interesit

Ndërmjetësi i sigurimeve ose shoqëria e sigurimeve mirëmban dhe zbaton marrëveshjet organizative dhe administruese, në lidhje me marrjen e masave të arsyeshme, të projektuara për parandalimin e konflikteve të interesit, sipas përcaktimit në nenin 13, germa "c", të cilat ndikojnë negativisht në interesin e konsumatorëve të saj.

Neni 13/c

Konfliktet e interesit

1. Shtetet anëtare i kërkojnë ndërmjetësve të sigurimeve dhe sipërmarrjeve të sigurimeve marrjen e hapave të përshtatshme për identifikimin e konflikteve të interesit ndërmjet tyre, duke përfshirë menaxherët e tyre, punëmarrësit dhe palët e lidhura me shoqëritë e sigurimeve, ose çdo person i lidhur me ta përmes kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, dhe konsumatorëve e tyre, ose ndërmjet konsumatorëve, në rastin kur zhvillohen aktivitete të shpërndarjes së sigurimeve.

2. Nëse marrëveshjet organizative ose administrative, që lidhen nga ndërmjetësi i sigurimeve ose sipërmarrja e sigurimit në përputhje me nenin 13, germa "b" për administrimin e konflikteve të interesit, nuk mjaftojnë për garantimin, me siguri të arsyeshme, të parandalimit të rreziqeve të dëmeve në interesat konsumatore, ndërmjetësi i sigurimeve ose sipërmarrja e sigurimeve i komunikon qartësisht klientit natyrën e përgjithshme dhe/ose burimet e konfliktit të interesit përpara ndërmarrjes së veprimtarisë në emër të saj.

3. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 13, germa "e", për:

a) përcaktimin e hapave të mundshme dhe të arsyeshme, të marra nga ndërmjetësit e sigurimeve ose sipërmarrjet e sigurimeve për identifikimin, parandalimin, menaxhimin dhe bërjen publike të konflikteve të interesit gjatë zhvillimit të aktiviteteve të shpërndarjes së sigurimeve;

b) caktimin e kriterëve të përshtatshme për përcaktimin e llojeve të konfliktit të interesit, ekzistenca e të cilave mund të dëmtojë interesat e konsumatorëve ose të klientëve të mundshëm të shoqërisë së investimit.

Neni 13/d

Parime të përgjithshme dhe informacioni për konsumatorët

1. Shtetet anëtare sigurohen që ndërmjetësi i sigurimit ose shoqëria e sigurimit të veprjës me ndershmëri, drejtësi dhe profesionalizëm në përputhje me interesat e klientëve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shpërndarjes së sigurimit.

2. I gjithë informacioni, duke përfshirë komunikimet e drejta, të qarta dhe joçorientuese, të marketimit të adresuar nga ndërmjetësi i sigurimeve ose sipërmarrja e sigurimeve për konsumatorët ose konsumatorët e mundshëm. Të identifikohen qartësisht komunikimet e marketimit si të tilla.

3. Shtetet anëtare ndalojnë pranimin ose marrjen e tarifave, të komisioneve, ose të çdo përfitimi monetar të paguar ose të siguruar për ndërmjetësit e sigurimeve ose për sipërmarrësit e sigurimeve, nga palë të treta ose personat, të cilët veprojnë në emër të palës së tretë, në lidhje me shpërndarjen e produkteve të lidhura me skemën e sigurimeve të konsumatorëve.

Neni 13/e

Ushtrimi i delegimit

1. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara i delegohen Komisionit sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Kompetenca për të miratuar aktet e deleguara që përmendet në nenin 13, germa "c" i jepen Komisionit për një periudhë kohore të përcaktuar, duke nisur nga data 2 korrik 2014.

3. Delegimi i kompetencave që përmendet në nenin 13/c mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli. Vendimi i revokimit i jep fund delegimit të kompetencave të specifikuar në atë vendim. Ai hyn në fuqi një ditë pas botimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme që specifikohet në vendim. Ai nuk cenon vlefshmërinë e ndonjë akti të deleguar të hyrë tashmë në fuqi.

4. Kur miraton një akt të deleguar, Komisioni njofton për këtë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

5. Një akt i deleguar i miratuar sipas nenit 13/c hyn në fuqi vetëm nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim as nga Parlamenti Evropian, as nga Këshilli, brenda një periudhe dymujore pasi Parlamenti Evropian ose Këshilli është njoftuar për këtë akt, ose nëse, përpara përfundimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë shtyhet me dy muaj me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit."

Neni 92

Ndryshimet e Direktivës 2011/61/KE

Vendimi 2011/61/KE ndryshohet si më poshtë:

1. në nenin 4, paragrafi 1, germa "r", shtohet nënparagrafi si më poshtë:

"VII. shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, në të cilin AIFM-të e BE-së ofrojnë shërbimet e përmendura në nenin 6, paragrafi 4";

2. Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

a) titulli zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"Kushtet për administrimin e AIF-ve të BE-së, të caktuara në shtete të tjera anëtare dhe për administrimin e shërbimeve të shteteve të tjera anëtare";

b) paragrafët 1 dhe 2 zëvendësohen me tekstin e mëposhtëm:

"1. Për AIFM-të e BE-së, shtetet anëtare garantojnë drejtpërdrejtë ose përmes themelimit të degës:

a) administrimin e AIF-ve të BE-së, të caktuara në një shtet tjetër anëtar, me kusht që AIFM-të të autorizohen për administrimin e këtij lloji të fondit alternativ të investimit;

b) ofrimin, në një shtet tjetër anëtar, të shërbimeve të përmendura në nenin 6, paragrafi 4, për të cilat ajo autorizohet.

2. AIFM-të që synojnë ofrimin e aktiviteteve dhe të shërbimeve të përmendura në paragrafin 1, i komunikojnë për herë të parë shtetit anëtar të origjinës së tij informacionin si më poshtë:

a) shteti anëtar që synon administrimin e drejtpërdrejtë të AIF-ve ose themelimin e një dege, dhe/ose ofrimin e shërbimeve të përmendura në nenin 6, paragrafi 4;

b) programin operativ, veçanërisht duke përmendur shërbimet e kryera prej tij dhe/ose identifikimin e AIF-ve të administruara prej tij".

Neni 93

Transpozimi

1. Shtetet anëtare miratojnë dhe botojnë deri më 3 korrik 2016, ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë. Ato i komunikojnë menjëherë Komisionit tekstin e këtyre masave.

Shtetet anëtare zbatojnë këto masa duke nisur nga data 3 janar 2017, përveç dispozitave, që transpozojnë nenin 65, paragrafi 2, të cilat zbatohen duke nisur nga data 3 shtator 2018.

Shtetet anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Mënyra sesi do të bëhet kjo referencë përcaktohet nga shtetet anëtare. Gjithashtu, ato përfshijnë një deklaratë se referencat në ligjet, rregulloret dhe aktet administrative ekzistuese ndaj direktivës së shfuqizuar nga kjo direktivë, do të interpretohen si referencë për këtë direktivë. Mënyra sesi do të bëhet kjo referencë dhe formulimi i deklaratës përcaktohet nga vetë shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare zbatojnë masat e përmendura në nenin 92, duke nisur nga 3 korriku 2015.

3. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit të brendshëm që ato miratojnë në fushën që mbulohet nga kjo direktivë.

Neni 94

Shfuqizimi

Direktiva 2004/39/KEE e ndryshuar nga direktivat e renditura në shtojcën III, pjesa A të kësaj direktive, shfuqizohet duke filluar nga data 3 janar 2017, pa cenuar detyrimet e shteteve anëtare në lidhje me afatet kohore për transpozimin në legjislacionin e brendshëm të direktivave, të përcaktuara në shtojcën III, pjesa B të kësaj direktive.

Referimet në Rregulloren 2004/39/KE ose në Direktivën 93/22/KEE interpretohen si referime në këtë direktivë ose në Rregulloren (BE) nr. 600/2014 dhe lexohen në përputhje me tabelën e përputhshmërisë të përcaktuar në shtojcën IV të kësaj direktive.

Referimet në termat e përkufizuar, ose në nenet e Direktivës 2004/39/KE ose Direktivës 93/22/KEE interpretohen si referime në terma të barasvlershme të përkufizuar në, ose nene të kësaj direktive.

Neni 95

Dispozita kalimtare

1. Deri më 3 korrik 2020:

a) detyrimi i klerimit, i përcaktuar në nenin 4 të Rregullores (BE) nr. 648/2012 dhe teknikat e zbutjes së rrezikut, të përcaktuara në nenin 11, paragrafi 3 të saj, nuk zbatohen për kontratat e derivateve të produkteve energjetike C6 të lidhura nga kundërpalë jofinanciare, të cilat përmbushin kushtet e nenit 10, paragrafi 1 të Rregullores (BE) nr. 648/2012 ose nga kundërpalë jofinanciare, të cilat autorizohen për herë të parë si shoqëri të investimit, duke filluar nga data 3 janar 2017; dhe

b) këto kontrata të derivateve të produkteve energjetike C6 nuk konsiderohen si kontrata të derivativëve mbi banak (OTC) për qëllime të kufirit të klerimit të përcaktuar në nenin 10 të Rregullores (BE) nr. 648/2012.

Kontratat e derivateve të produkteve energjetike C6 që përcaktohet në nënparagrafin e parë u nënshtrohen të gjitha kërkesave të tjera të përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 648/2012.

2. Vendimi i përmendur në paragrafin 1 jepet nga autoriteti kompetent përkatës. Autoriteti kompetent njofton ESMA-n mbi kontratat e derivateve të produkteve energjetike C6, për të cilat lejohet përjashtimi sipas paragrafin 1, dhe ESMA nxjerr në faqen e saj të internetit listën e kontratave të derivateve të produkteve energjetike C6.

Neni 96

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi njëzet ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 97

Marrësit

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 15 maj 2014.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti
M. SCHULZ
Për Këshillin
Presidenti
D. KOURKOULAS

SHTOJCA I

LISTA E SHËRBIMEVE DHE AKTIVITETEVE DHE INSTRUMENTEVE FINANCIARE

SEKSIONI A

SHËRBIMET DHE AKTIVITETET E INVESTIMIT

1. Marrja dhe transmetimi i urdhrave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare;
2. Ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve;
3. Tregtimi për llogari të vet;
4. Administrimi i portofolit;
5. Këshillat e investimit;
6. Nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose caktimi i instrumenteve financiare në bazë të angazhimit të shoqërisë;
7. Vendosja e instrumenteve financiare pa baza angazhimi nga shoqëria;
8. Operimi i një MTF-je;

9. Operimi i një Platforme të përbashkët të tregtimit.

SEKSIONI B

SHËRBIMET NDIHMËSE

1. Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare për llogari të klientëve, duke përfshirë kujdestarinë dhe shërbime të lidhura, si administrimi i të hollave/kolateralit dhe përjashtimi i mbajtjes së llogarive të titujve të niveleve të larta;

2. Dhënia e kredive ose huave për investitorët, me qëllimin lejimin e kryerjen e transaksionit të tij në një ose më shumë instrumente financiare, në rastin kur shoqëria kredidhënëse ose huadhënëse përshihet në transaksion;

3. Këshillimi për sipërmarrjet në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë industriale dhe çështje të lidhura, dhe këshillim dhe shërbime në lidhje me bashkimet dhe blerjet e sipërmarrjeve;

4. Shërbimet e këmbimit valutor, në rastin kur ato lidhen me ofrimin e shërbimeve të investimit;

5. Studim për investimin dhe analizë financiare, ose forma të tjera të rekomandimit të përgjithshëm, në lidhje me transaksionet në instrumente financiare;

6. Shërbimet e lidhura me nënshkrimin.

7. Shërbimet dhe aktivitetet e investimit, si dhe aktivitetet ndihmëse të llojit të përfshirë sipas seksionit A ose B të shtojcës 1, që lidhen me derivate përkatëse të përfshira sipas pikave 5, 6, 7 dhe 10 të seksionit C, në rastin e lidhjes së tyre me dispozitën për investimet ose shërbimet ndihmëse.

SEKSIONI C

INSTRUMENTET FINANCIARE

1. Titujt e transferueshëm;

2. Instrumente të tregut monetar;

3. Njësitë në sipërmarrjet e investimeve kolektive,

4. Kontratat e mundësisë (opcionet), kontratat e së ardhmes, kontratat e shkëmbimit, kontratat forward dhe çdo kontratë e derivateve që lidhet me letrat me vlerë, valutën, normat e interesit ose yield-et, kuotat e shkarkimeve ose derivateve të instrumenteve të tjerë financiarë, indekset financiare ose masat financiare, të cilat mund të parashikojnë dorëzimin fizik ose në kesh;

Comment [t3]:

5. Kontratat e mundësisë (opcionet), kontratat e së ardhmes, kontratat e shkëmbimit, kontratat forward dhe çdo kontratë e derivateve që lidhet me mallrat me përdorim të gjerë, e cila

Comment [t4]:

duhet të zgjidhet me para ose mund të zgjidhet me para sipas zgjedhjes së njëres prej palëve, të ndryshme nga arsyet e dështimit apo ngjarjet e tjera të ndërprerjes së aktivitetit;

6. Kontratat e mundësisë (opsionet), kontratat e së ardhmes, kontratat e shkëmbimit, kontratat forward dhe çdo kontratë e derivateve që lidhet me mallrat me përdorim të gjerë, që parashikon dorëzimin fizik, me kusht që ato të tregtohen në tregun e rregulluar, në MTF, ose në platformën e përbashkët të tregtimit, përveç produkteve energjetike të tregtuara me shumicë në platformën e përbashkët të tregtimit, të cilat duhet të parashikojnë dorëzimin fizik;

7. Kontratat e mundësisë (opsionet), kontratat e së ardhmes, kontratat e shkëmbimit, kontratat forward dhe çdo kontratë e derivateve që lidhet me mallrat me përdorim të gjerë, që parashikon dorëzimin fizik, përveç rasteve të përmendura në pikën 6 të këtij seksioni, pa pasur qëllime jotregtare, të cilat kanë karakteristikat e derivateve të tjera të instrumenteve financiare;

8. Instrumente derivate për transferimin e rrezikut të kredisë;

9. Kontratat financiare për diferencat;

10. Kontratat e mundësisë (opsionet), kontratat e së ardhmes, kontratat e shkëmbimit, kontratat forward dhe çdo kontratë e derivateve që lidhet me variablat klimatike, tarifat e transportit ose normat e inflacionit ose statistikave të tjera zyrtare ekonomike, të cilat zgjidhen në para ose mund të zgjidhen në para sipas zgjedhjes së njëres prej palëve, të ndryshme nga arsyet e dështimit apo ngjarjet e tjera të ndërprerjes së aktivitetit, si dhe çdo kontratë tjetër e derivateve, që lidhet me aktivet, të drejtat, detyrimet, indeksat dhe masat e tjera të papërmendura në këtë seksion, të cilat kanë karakteristikat e derivateve të tjera të instrumenteve financiare, duke konsideruar, ndër të tjera, faktin në lidhje me tregtimin e mundshëm në tregun e rregulluar, në platformat e përbashkëta të tregtimit, ose në MTF-të;

11. Kuotat e shkarkimeve që përfshijnë çdo kuotë të njohur në përputhje me kërkesat e Direktivës 2003/87/KE (Skema e Kuotave të Shkarkimeve).

SEKSIONI D

SHËRBIMET E RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE

1. Që operojnë skemën e publikimit të miratuar;
2. Që operojnë QSHKE-në;
3. Që operojnë MRP-në.

SHTOJCA II

KLIENTËT PROFESIONISTË PËR QËLLIME TË KËSAJ DIREKTIVE

Klient profesionist është klienti që zotëron eksperiencën, njohuritë dhe ekspertizën, në lidhje me marrjen e vendimeve të investimit dhe vlerësimin siç duhet të rreziqeve të hasura. Për tu konsideruar klient profesionist, klienti duhet të përmbushë kushtet si më poshtë:

I. KATEGORITË E KLIENTËVE QË KONSIDEROHEN PROFESIONISTË

Sa më poshtë konsiderohen si profesionistë, për të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e investimit, dhe instrumentet financiare, për qëllime të kësaj direktive.

1. Subjektet, të cilave u kërkohet autorizimi ose rregullimi për operimin në tregjet financiare. Lista e mëposhtme kuptohet sipas përfshirjes së të gjitha subjekteve të autorizuara për ushtrimin e veprimtarive karakteristike për subjektet e përmendura: subjektet e autorizuara nga shteti anëtar sipas kësaj direktive, subjektet e autorizuara ose të rregulluara nga shteti anëtar, pa referencë në ndonjë direktivë, dhe subjektet e autorizuara ose të rregulluara nga vendi i shtetit të tretë:

- a) Institucionet kredituese;
- b) Shoqëritë e investimit;
- c) Institucionet e tjera financiare të autorizuara ose të rregulluara;
- d) Sipërmarrjet e sigurimit;
- e) Skemat e investimeve kolektive dhe shoqëritë e administrimit të këtyre skemave;
- f) Fondet e pensioneve dhe shoqëritë e administrimit të këtyre fondeve;
- g) Tregtarët e mallrave dhe derivateve të mallrave me përdorim të gjerë;
- h) Sipërmarrjet rajonale;
- i) Investitorë të tjerë institucional;

2. Sipërmarrjet e mëdha, të cilat përmbushin dy prej kërkesave të madhësisë në bazë shoqërie, si më poshtë:

- totali i bilancit: 20 000 000 euro;
- xhiroja neto: 40 000 000 euro;
- fondet vetjake: 2 000 000 euro;

3. Qeveritë kombëtare dhe rajonale, duke përfshirë organet publike që administrojnë borxhin publik në nivel kombëtar ose rajonal, bankat qendrore, institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale, si Banka Botërore, FMN-ja, BQE-ja, EIB-ja dhe të tjera organizata të ngjashme ndërkombëtare.

4. Investitorë të tjerë institucional, të cilët kanë aktivitet kryesor investimin në instrumente financiare, duke përfshirë subjektet e dedikuara për titullimin e aktiveve ose të transaksioneve të tjera financuese.

Subjektet e lartpërmendura konsiderohen si profesionistë. Ato gjithsesi duhet të lejohen të kërkojnë trajtim si joprofesionist dhe shoqëritë e investimit mund të bien dakord të ofrojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje. Nëse klienti i shoqërisë së investimit është sipërmarrje e lartpërmendur, shoqëria e investimit duhet ta informojë paraprakisht, në lidhje me çdo dispozitë të shërbimeve, që në bazë të informacionit të vënë në dispozicion të shoqërisë së investimit, e konsideron si klient profesionist dhe e trajton si të tillë, përveçse kur shoqëria e investimit dhe klienti bien dakord ndryshe. Shoqëria e investimit gjithashtu informon konsumatorin mbi kërkesën e mundshme për të ndryshuar kushtet e marrëveshjes së tij, me qëllim sigurimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje.

Klienti që konsiderohet si klient profesionist është përgjegjës për të kërkuar një nivel më të lartë mbrojtjeje kur ai gjykon se nuk është në gjendje të vlerësojë dhe administrojë siç duhet rrezikun e përfshirë.

Ky nivel më i lartë mbrojtjeje ofrohet në rastin kur klienti që konsiderohet profesionist, lidh marrëveshje me shkrim me shoqërinë e investimit, me qëllim që mos të trajtohet si profesionist për qëllimet e regjimit të zbatueshëm të ushtrimit të veprimtarisë. Kjo marrëveshje specifikon në lidhje me mundësinë e zbatimit të saj për një ose më shumë shërbime ose transaksione të caktuara, ose për një ose më shumë lloje të produkteve ose të transaksioneve.

II. KLIENTËT QË MUND TË TRAJTOHEN SI PROFESIONISTË SIPAS KËRKESËS

II.1 Kriteret e identifikimit

Klientëve të ndryshëm nga ata të përmendur në seksionin I, duke përfshirë organet e sektorit publik, autoritetet rajonale publike, bashkitë dhe investitorët individualë, gjithashtu duhet t'i lejohet dorëheqja nga një pjesë e mbrojtjeve të mbuluara nga rregullat e ushtrimit të veprimtarisë.

Kështu, shoqërive të investimit duhet t'i lejohet trajtimi i këtyre klientëve si profesionistë, me kusht që të përmbushen kriteret dhe procedurat përkatëse, të përmendura më poshtë. Megjithatë, nuk supozohet se këta klientë zotërojnë njohuri dhe eksperiencë në treg, në raport me atë të kategorive të renditura në seksionin I.

Çdo dorëheqje nga mbrojtja e mbështetur nga standardi i regjimit të ushtrimit të veprimtarisë konsiderohet i vlefshëm vetëm në rastin e vlerësimit të përshtatshëm të ekspertizës, eksperiencës dhe njohurive të klientëve, që ndërmerret nga shoqëria e investimit, ofron siguri të arsyeshme në kontekstin e natyrës së transaksioneve dhe të shërbimeve të parashikuara, në lidhje me aftësinë e klientit për marrjen e vendimeve dhe kuptimin e rreziqeve të hasura.

Testi profesional i zbatuar për menaxherët dhe drejtuesit e subjekteve, të licencuara sipas direktivave të fushës financiare, mund të konsiderohet si shembulli vlerësimit të ekspertizës dhe njohurive. Në rastin e subjekteve të vogla, personi që i nënshtrohet vlerësimit është ai i autorizuar për kryerjen e transaksioneve në emër të subjektit.

Gjatë zhvillimit të këtij vlerësimi, duhet minimalisht të plotësohen dy prej kushteve të mëposhtme:

— klienti ka kryer transaksione të një madhësie të rëndësishme në tregjet përkatëse, mesatarisht 10 transaksione në tre muaj, gjatë katër tremujorëve paraardhës,

— madhësia e portofolit të instrumenteve financiare të klientit, të përcaktuar në lidhje me përfshirjen e depozitave në para dhe të instrumenteve financiare, tejkalon 500 000 euro,

— klienti punon ose ka punuar në sektorin financiar për të paktën një vit, në një pozicion si profesionist, i cili kërkon njohje të transaksioneve ose shërbimeve të parashikuara.

Shtetet anëtare mund të miratojnë kritere specifike për vlerësimin e ekspertizës dhe njohurive të bashkive dhe të autoriteteve publike vendore, duke kërkuar trajtimin e tyre si klient profesionist. Këto kritere mund të alternohen ose t'i shtohen atyre të renditura në paragrafin e pestë.

II.2 Procedurat

Këta klientë mund të heqin dorë nga përfitimi i rregullave të hollësishme të sjelljes, vetëm në rastin kur ndiqet procedura si më poshtë:

— ata duhet t'i deklarojnë me shkrim shoqërisë së investimit, se ata dëshirojnë të trajtohen si klientë profesionistë, qoftë në përgjithësi ose në lidhje me shërbimin ose transaksionin e caktuar të investimit, ose me llojin e transaksionit ose të produktit,

— shoqëria e investimit duhet t'i japë atyre paralajmërimin e qartë me shkrim, në lidhje me të drejtat e mbrojtjes dhe të kompensimit të investitorit, që ato mund të humbasin,

— ata duhet të deklarojnë me shkrim, në dokument të veçantë nga kontrata, në lidhje me ndërgjegjësimin e tyre mbi pasojat e humbjes së këtyre mbrojtjeve.

Përpara se të vendosin të pranojnë çdo kërkesë dorëheqjeje, shoqëritë e investimit duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm për t'u siguruar që klienti që kërkon të trajtohet si klient profesionist plotëson të gjitha kërkesat përkatëse të përcaktuara në seksionin II.1.

Megjithatë, nëse klientët janë të kategorizuar si profesionistë sipas parametrave dhe procedurave të ngjashme me ato të lartpërmendura, rregullat e reja të miratuara sipas kësaj shtojce nuk synojnë ndikimin e marrëdhënieve me shoqëritë e investimit.

Shoqëritë duhet të zbatojnë me shkrim politikat e brendshme dhe procedurat e përshtatshme për klasifikimin e klientëve. Klientët profesionistë janë përgjegjës për mbajtjen e shoqërisë së investimit të informuar, në lidhje me çdo ndryshim, i cili mund të ndikojë në kategorizimin aktual të tyre. Megjithatë, nëse shoqëria e investimit merr dijeni se klienti nuk i plotëson më kushtet fillestare, të cilat e kanë kualifikuar atë për trajtim profesional, shoqëria e investimit ndërmerr veprimin përkatës.

SHTOJCA III

PJESA A

DIREKTIVA E SHFUQIZUAR ME LISTËN E NDRYSHIMEVE VIJUESE

(përmendur në nenin 94)

Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 145, 30.4.2004, f. 1).

Direktiva 2006/31/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 114, 27.4.2006, f. 60).

Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 247, 21.9.2007, f. 1).

Direktiva 2008/10/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 76, 19.3.2008, f. 33).

Direktiva 2010/78/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 331, 15.12.2010, f. 120).

PJESA B

Lista e afateve kohore për transpozim në legjislacionin e brendshëm

(përmendur në nenin 94)

Direktiva 2004/39/KE

Periudha e transpozimit 31 janar 2007

Periudha e zbatimit 1 nëntor 2007

Direktiva 2006/31/KE

Periudha e transpozimit 31 janar 2007

Periudha e zbatimit 1 nëntor 2007

Direktiva 2007/44/KE

Periudha e transpozimit 21 mars 2009

Direktiva 2010/78/KE

Periudha e transpozimit 31 dhjetor 2011

SHTOJCA IV

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË E PËRMENDUR NË NENIN 94

Direktiva 2004/39/KE Direktiva 2014/65/KE Rregullorja (BE) Nr. 600/2014

Neni 1, paragrafi 1, Neni 1, paragrafi 1

Neni 1, paragrafi 2, Neni 1, paragrafi 3

Neni 2, paragrafi 1, germa "a", Neni 2, paragrafi 1, germa "a"

Neni 2, paragrafi 1, germa "b", Neni 2, paragrafi 1, germa "a"

Neni 2, paragrafi 1, germa "c", Neni 2, paragrafi 1, germa "c"

Neni 2, paragrafi 1, germa "d", Neni 2, paragrafi 1, germa "d"

Neni 2, paragrafi 1, germa "e", Neni 2, paragrafi 1, germa "f"

Neni 2, paragrafi 1, germa "f", Neni 2, paragrafi 1, germa "g"

Neni 2, paragrafi 1, germa "g", Neni 2, paragrafi 1, germa "h"

Neni 2, paragrafi 1, germa "h", Neni 2, paragrafi 1, germa "i"

Neni 2, paragrafi 1, germa "i", Neni 2, paragrafi 1, germa "j"

Neni 2, paragrafi 1, germa "j", Neni 2, paragrafi 1, germa "k"

Neni 2, paragrafi 1, germa "k", Neni 2, paragrafi 1, germa "i"

Neni 2, paragrafi 1, germa "l" —

Neni 2, paragrafi 1, germa "m", Neni 2, paragrafi 1, germa "l"

Neni 2, paragrafi 1, germa "n", Neni 2, paragrafi 1, germa "m"

Neni 2, paragrafi 2, Neni 2, paragrafi 2

Neni 2, paragrafi 3, Neni 2, paragrafi 4

Neni 3, paragrafi 1, Neni 3, paragrafi 1

Neni 3, paragrafi 2, Neni 3, paragrafi 3

Neni 4, paragrafi 1, pika 1 Neni 4, paragrafi 1, pika 1

Neni 4, paragrafi 1, pika 2 Neni 4, paragrafi 1, pika 2

Neni 4, paragrafi 1, pika 3, Neni 4, paragrafi 1, pika 3
Neni 4, paragrafi 1, pika 4, Neni 4, paragrafi 1, pika 4
Neni 4, paragrafi 1, pika 5, Neni 4, paragrafi 1, pika 5
Neni 4, paragrafi 1, pika 6, Neni 4, paragrafi 1, pika 6
Neni 4, paragrafi 1, pika 7, Neni 4, paragrafi 1, pika 20
Neni 4, paragrafi 1, pika 8, Neni 4, paragrafi 1, pika 7
Neni 4, paragrafi 1, pika 9, Neni 4, paragrafi 1, pika 8
Neni 4, paragrafi 1, pika 10, Neni 4, paragrafi 1, pika 9
Neni 4, paragrafi 1, pika 11, Neni 4, paragrafi 1, pika 10
Neni 4, paragrafi 1, pika 12, Neni 4, paragrafi 1, pika 11
Neni 4, paragrafi 1, pika 13, Neni 4, paragrafi 1, pika 18
Neni 4, paragrafi 1, pika 14, Neni 4, paragrafi 1, pika 21
Neni 4, paragrafi 1, pika 15, Neni 4, paragrafi 1, pika 22
Neni 4, paragrafi 1, pika 16, Neni 4, paragrafi 1, pika 14
Neni 4, paragrafi 1, pika 17, Neni 4, paragrafi 1, pika 15
Neni 4, paragrafi 1, pika 18, Neni 4, paragrafi 1, pika 44
Neni 4, paragrafi 1, pika 19, Neni 4, paragrafi 1, pika 17
Neni 4, paragrafi 1, pika 20, Neni 4, paragrafi 1, pika 55
Neni 4, paragrafi 1, pika 21, Neni 4, paragrafi 1, pika 56
Neni 4, paragrafi 1, pika 22, Neni 4, paragrafi 1, pika 26
Neni 4, paragrafi 1, pika 23, Neni 4, paragrafi 1, pika 27
Neni 4, paragrafi 1, pika 24, Neni 4, paragrafi 1, pika 28
Neni 4, paragrafi 1, pika 25, Neni 4, paragrafi 1, pika 29
Neni 4, paragrafi 1, pika 26, Neni 4, paragrafi 1, pika 30
Neni 4, paragrafi 1, pika 27, Neni 4, paragrafi 1, pika 31

Neni 4, paragrafi 1, pika 28, Neni 4, paragrafi 1, pika 32
Neni 4, paragrafi 1, pika 29, Neni 4, paragrafi 1, pika 33
Neni 4, paragrafi 1, pika 30, Neni 4, paragrafi 1, pika 35, germa "b"
Neni 4, paragrafi 1, pika 31, Neni 4, paragrafi 1, pika 35
Neni 4, paragrafi 2, Neni 4, paragrafi 2
Neni 5, paragrafi 1, Neni 5, paragrafi 1
Neni 5, paragrafi 2, Neni 5, paragrafi 2
Neni 5, paragrafi 3, Neni 5, paragrafi 3
Neni 5, paragrafi 4, Neni 5, paragrafi 4
Neni 5, paragrafi 5 —
Neni 6, paragrafi 1, Neni 6, paragrafi 1
Neni 6, paragrafi 2, Neni 6, paragrafi 2
Neni 6, paragrafi 3, Neni 6, paragrafi 3
Neni 7, paragrafi 1, Neni 7, paragrafi 1
Neni 7, paragrafi 2, Neni 7, paragrafi 2
Neni 7, paragrafi 3, Neni 7, paragrafi 3
Neni 7, paragrafi 4, Neni 7, paragrafët 4 dhe 5
Neni 8, germa "a", Neni 8, germa "a"
Neni 8, germa "b", Neni 8, germa "b"
Neni 8, germa "c", Neni 8, germa "c"
Neni 8, germa "d", Neni 8, germa "d"
Neni 8, germa "e", Neni 8, germa "e"
Neni 9, paragrafi 1, Neni 9, paragrafët 1 dhe 3
Neni 9, paragrafi 2, Neni 9, paragrafi 5
Neni 9, paragrafi 3, Neni 9, paragrafi 4

Neni 9, paragrafi 4, Neni 9, paragrafi 6

Neni 10, paragrafi 1, Neni 10, paragrafi 1

Neni 10, paragrafi 2, Neni 10, paragrafi 2

Neni 10, paragrafi 3, Neni 11, paragrafi 1

Neni 10, paragrafi 4, Neni 11, paragrafi 2

Neni 10, paragrafi 5, Neni 11, paragrafi 3

Neni 10, paragrafi 6, Neni 10, paragrafi 3, Neni 11, paragrafi 4

Neni 10/a, paragrafi 1, Neni 12, paragrafi 1

Neni 10/a, paragrafi 2, Neni 12, paragrafi 2

Neni 10/a, paragrafi 3, Neni 12, paragrafi 3

Neni 10/a, paragrafi 4, Neni 12, paragrafi 4

Neni 10/a, paragrafi 5, Neni 12, paragrafi 5

Neni 10/a, paragrafi 6, Neni 12, paragrafi 6

Neni 10/a, paragrafi 7, Neni 12, paragrafi 7

Neni 10/a, paragrafi 8, Neni 12, paragrafët 8 dhe 9

Neni 10/b, paragrafi 1, Neni 13, paragrafi 1

Neni 10/b, paragrafi 2, Neni 13, paragrafi 2

Neni 10/b, paragrafi 3, Neni 13, paragrafi 3

Neni 10/b, paragrafi 4, Neni 13, paragrafi 4

Neni 10/b, paragrafi 5, Neni 13, paragrafi 5

Neni 11, Neni 14

Neni 12, Neni 15

Neni 13, paragrafi 1, Neni 16, paragrafi 1

Neni 13, paragrafi 2, Neni 16, paragrafi 2

Neni 13, paragrafi 3, Neni 16, paragrafi 3

Neni 13, paragrafi 4, Neni 16, paragrafi 4
Neni 13, paragrafi 5, Neni 16, paragrafi 5
Neni 13, paragrafi 6, Neni 16, paragrafi 6
Neni 13, paragrafi 7, Neni 16, paragrafi 8
Neni 13, paragrafi 8, Neni 16, paragrafi 9
Neni 13, paragrafi 9 Neni 16, paragrafi 11
Neni 13, paragrafi 1,0 Neni 16, paragrafi 12
Neni 14, paragrafi 1, Neni 18, paragrafi 1, Neni 19, paragrafi 1
Neni 14, paragrafi 2, Neni 18, paragrafi 2
Neni 14, paragrafi 3, Neni 19, paragrafi 4
Neni 14, paragrafi 4, Neni 18, paragrafi 3, Neni 19, paragrafi 2
Neni 14, paragrafi 5, Neni 18, paragrafi 6, Neni 19, paragrafi 3
Neni 14, paragrafi 6, Neni 18, paragrafi 8
Neni 14, paragrafi 7, Neni 18, paragrafi 9
Neni 15 —
Neni 16, paragrafi 1, Neni 21, paragrafi 1
Neni 16, paragrafi 2, Neni 21, paragrafi 2
Neni 16, paragrafi 3 —
Neni 17, paragrafi 1, Neni 22
Neni 17, paragrafi 2 —
Neni 18, paragrafi 1, Neni 23, paragrafi 1
Neni 18, paragrafi 2, Neni 23, paragrafi 2
Neni 18, paragrafi 3, Neni 23, paragrafi 4
Neni 19, paragrafi 1, Neni 24, paragrafi 1
Neni 19, paragrafi 2, Neni 24, paragrafi 3

Neni 19, paragrafi 3, Neni 24, paragrafi 4

Neni 19, paragrafi 4, Neni 25, paragrafi 2

Neni 19, paragrafi 5, Neni 25, paragrafi 3

Neni 19, paragrafi 6, Neni 25, paragrafi 4

Neni 19, paragrafi 7, Neni 25, paragrafi 5

Neni 19, paragrafi 8, Neni 25, paragrafi 6

Neni 19, paragrafi 9, Neni 24, paragrafi 6, Neni 25, paragrafi 7

Neni 19, paragrafi 10, Neni 24, paragrafi 13, Neni 24, paragrafi 14, Neni 25, paragrafi 8

Neni 20, Neni 26

Neni 21, paragrafi 1, Neni 27, paragrafi 1

Neni 21, paragrafi 2, Neni 27, paragrafi 4

Neni 21, paragrafi 3, Neni 27, paragrafi 5

Neni 21, paragrafi 4, Neni 27, paragrafi 7

Neni 21, paragrafi 5, Neni 27, paragrafi 8

Neni 21, paragrafi 6, Neni 27, paragrafi 9

Neni 22, paragrafi 1, Neni 28, paragrafi 1

Neni 22, paragrafi 2, Neni 28, paragrafi 2

Neni 22, paragrafi 3, Neni 28, paragrafi 3

Neni 23, paragrafi 1, Neni 29, paragrafi 1

Neni 23, paragrafi 2, Neni 29, paragrafi 2

Neni 23, paragrafi 3, Neni 29, paragrafi 3

Neni 23, paragrafi 4, Neni 29, paragrafi 4

Neni 23, paragrafi 5, Neni 29, paragrafi 5

Neni 23, paragrafi 6, Neni 29, paragrafi 6

Neni 24, paragrafi 1, Neni 30, paragrafi 1

Neni 24, paragrafi 2, Neni 30, paragrafi 2
Neni 24, paragrafi 3, Neni 30, paragrafi 3
Neni 24, paragrafi 4, Neni 30, paragrafi 4
Neni 24, paragrafi 5, Neni 30, paragrafi 5
Neni 25, paragrafi 1, Neni 24
Neni 25, paragrafi 2, Neni 25, paragrafi 1
Neni 25, paragrafi 3, Neni 26, paragrafët 1 dhe 2
Neni 25, paragrafi 4, Neni 26, paragrafi 3
Neni 25, paragrafi 5, Neni 26, paragrafi 7
Neni 25, paragrafi 6, Neni 26, paragrafi 8
Neni 25, paragrafi 7, Neni 26, paragrafi 9
Neni 26, paragrafi 1, Neni 31, paragrafi 1
Neni 26, paragrafi 2, Neni 31, paragrafët 2 dhe 3
Neni 27, paragrafi 1, Neni 14, paragrafët 1 deri në 5
Neni 27, paragrafi 2, Neni 14, paragrafi 6
Neni 27, paragrafi 3, Neni 15, paragrafët 1 deri në 4
Neni 27, paragrafi 4, Neni 16
Neni 27, paragrafi 5, Neni 17, paragrafi 1
Neni 27, paragrafi 6, Neni 17, paragrafi 2
Neni 27, paragrafi 7, Neni 17, paragrafi 3
Neni 28, paragrafi 1, Neni 20, paragrafi 1
Neni 28, paragrafi 2, Neni 20, paragrafi 2
Neni 28, paragrafi 3, Neni 20, paragrafi 3
Neni 29, paragrafi 1, Neni 3, paragrafët 1, 2 dhe 3
Neni 29, paragrafi 2, Neni 4, paragrafët 1, 2 dhe 3

Neni 29, paragrafi 3, Neni 4, paragrafi 6

Neni 30, paragrafi 1, Neni 6, paragrafët 1 dhe 2

Neni 30, paragrafi 2, Neni 7, paragrafi 1

Neni 30, paragrafi 3, Neni 7, paragrafi 2

Neni 31, paragrafi 1, Neni 34, paragrafi 1

Neni 31, paragrafi 2, Neni 34, paragrafi 2

Neni 31, paragrafi 3, Neni 34, paragrafi 3

Neni 31, paragrafi 4, Neni 34, paragrafi 4

Neni 31, paragrafi 5, Neni 34, paragrafi 6

Neni 31, paragrafi 6, Neni 34, paragrafi 7

Neni 31, paragrafi 7, Neni 34, paragrafët 8 dhe 9

Neni 32, paragrafi 1, Neni 35, paragrafi 1

Neni 32, paragrafi 2, Neni 35, paragrafi 2

Neni 32, paragrafi 3, Neni 35, paragrafi 3

Neni 32, paragrafi 4, Neni 35, paragrafi 4

Neni 32, paragrafi 5, Neni 35, paragrafi 5

Neni 32, paragrafi 6, Neni 35, paragrafi 6

Neni 32, paragrafi 7, Neni 35, paragrafi 8

Neni 32, paragrafi 8, Neni 35, paragrafi 9

Neni 32, paragrafi 9, Neni 35, paragrafi 10

Neni 32, paragrafi 10, Neni 35, paragrafët 11 dhe 12

Neni 33, paragrafi 1, Neni 36, paragrafi 1

Neni 33, paragrafi 2, Neni 36, paragrafi 2

Neni 34, paragrafi 1, Neni 37, paragrafi 1

Neni 34, paragrafi 2, Neni 37, paragrafi 2

Neni 34, paragrafi 3 —

Neni 35, paragrafi 1, Neni 38, paragrafi 1

Neni 35, paragrafi 2, Neni 38, paragrafi 2

Neni 36, paragrafi 1, Neni 44, paragrafi 1

Neni 36, paragrafi 2, Neni 44, paragrafi 2

Neni 36, paragrafi 3, Neni 44, paragrafi 3

Neni 36, paragrafi 4, Neni 44, paragrafi 4

Neni 36, paragrafi 5, Neni 44, paragrafi 5

Neni 36, paragrafi 6, Neni 44, paragrafi 6

Neni 37, paragrafi 1, Neni 45, paragrafët 1 dhe 8

Neni 37, paragrafi 2 Neni 45. paragrafi 7, nënparagrafi i dytë

Neni 38, paragrafi 1, Neni 46, paragrafi 1

Neni 38, paragrafi 2, Neni 46, paragrafi 2

Neni 38, paragrafi 3, Neni 46, paragrafi 3

Neni 39 Neni 47, paragrafi 1

Neni 40, paragrafi 1, Neni 51, paragrafi 1

Neni 40, paragrafi 2, Neni 51, paragrafi 2

Neni 40, paragrafi 3, Neni 51, paragrafi 3

Neni 40, paragrafi 4, Neni 51, paragrafi 4

Neni 40, paragrafi 5, Neni 51, paragrafi 5

Neni 40, paragrafi 6, Neni 51, paragrafi 6

Neni 41, paragrafi 1, Neni 52, paragrafi 1

Neni 41, paragrafi 2, Neni 52, paragrafi 2

Neni 42, paragrafi 1, Neni 53, paragrafi 1

Neni 42, paragrafi 2, Neni 53, paragrafi 2

Neni 42, paragrafi 3, Neni 53, paragrafi 3
Neni 42, paragrafi 4, Neni 53, paragrafi 4
Neni 42, paragrafi 5, Neni 53, paragrafi 5
Neni 42, paragrafi 6, Neni 53, paragrafi 6
Neni 42, paragrafi 7, Neni 53, paragrafi 7
Neni 43, paragrafi 1, Neni 54, paragrafi 1
Neni 43, paragrafi 2, Neni 54, paragrafët 2 dhe 3
Neni 44, paragrafi 1, Neni 3, paragrafët 1, 2 dhe 3
Neni 44, paragrafi 2, Neni 4, paragrafët 1, 2 dhe 3
Neni 44, paragrafi 3, Neni 4, paragrafi 6
Neni 45, paragrafi 1, Neni 6, paragrafët 1 dhe 2
Neni 45, paragrafi 2, Neni 7, paragrafi 1
Neni 45, paragrafi 3, Neni 7, paragrafi 2
Neni 46, paragrafi 1, Neni 55, paragrafi 1
Neni 46, paragrafi 2, Neni 55, paragrafi 2
Neni 47 Neni 56
Neni 48, paragrafi 1, Neni 67, paragrafi 1
Neni 48, paragrafi 2, Neni 67, paragrafi 2
Neni 48, paragrafi 3, Neni 67, paragrafi 3
Neni 49 Neni 68
Neni 50, paragrafi 1, Neni 69, paragrafi 1, Neni 72, paragrafi 1
Neni 50, paragrafi 2, Neni 69, paragrafi 2
Neni 51, paragrafi 1, Neni 70, paragrafët 1 dhe 2
Neni 51, paragrafi 2, Neni 70, paragrafi 5
Neni 51, paragrafi 3, Neni 71, paragrafi 1

Neni 51, paragrafi 4, Neni 71, paragrafi 4
Neni 51, paragrafi 5, Neni 71, paragrafi 5
Neni 51, paragrafi 6, Neni 71, paragrafi 6
Neni 52, paragrafi 1, Neni 74, paragrafi 1
Neni 52, paragrafi 2, Neni 74, paragrafi 2
Neni 53, paragrafi 1, Neni 75, paragrafi 1
Neni 53, paragrafi 2, Neni 75, paragrafi 2
Neni 53, paragrafi 3, Neni 75, paragrafi 3
Neni 54, paragrafi 1, Neni 76, paragrafi 1
Neni 54, paragrafi 2, Neni 76, paragrafi 2
Neni 54, paragrafi 3, Neni 76, paragrafi 3
Neni 54, paragrafi 4, Neni 76, paragrafi 4
Neni 54, paragrafi 5, Neni 76, paragrafi 5
Neni 55, paragrafi 1, Neni 77, paragrafi 1
Neni 55, paragrafi 2, Neni 77, paragrafi 2
Neni 56, paragrafi 1, Neni 79, paragrafi 1
Neni 56, paragrafi 2, Neni 79, paragrafi 2
Neni 56, paragrafi 3, Neni 79, paragrafi 3
Neni 56, paragrafi 4, Neni 79, paragrafi 4
Neni 56, paragrafi 5, Neni 79, paragrafi 8
Neni 56, paragrafi 6, Neni 79, paragrafi 9
Neni 57, paragrafi 1, Neni 80, paragrafi 1
Neni 57, paragrafi 2, Neni 80, paragrafi 2
Neni 57, paragrafi 3, Neni 80, paragrafët 3 dhe 4
Neni 58, paragrafi 1, Neni 81, paragrafi 1

Neni 58, paragrafi 2, Neni 81, paragrafi 2

Neni 58, paragrafi 3, Neni 81, paragrafi 3

Neni 58, paragrafi 4, Neni 81, paragrafi 4

Neni 58, paragrafi 5, Neni 81, paragrafi 5

Neni 58, germa "a", Neni 82

Neni 59 Neni 83

Neni 60, paragrafi 1, Neni 84, paragrafi 1

Neni 60, paragrafi 2, Neni 84, paragrafi 2

Neni 60, paragrafi 3, Neni 84, paragrafi 3

Neni 60, paragrafi 4, Neni 84, paragrafi 4

Neni 61, paragrafi 1, Neni 85, paragrafi 1

Neni 61, paragrafi 2, Neni 85, paragrafi 2

Neni 62, paragrafi 1, Neni 86, paragrafi 1

Neni 62, paragrafi 2, Neni 86, paragrafi 2

Neni 62, paragrafi 3, Neni 86, paragrafi 3

Neni 62, paragrafi 4, Neni 86, paragrafi 4

Neni 62a, paragrafi 1, Neni 87, paragrafi 1

Neni 62a, paragrafi 2, Neni 87, paragrafi 2

Neni 63, paragrafi 1, Neni 88, paragrafi 1

Neni 63, paragrafi 2, Neni 88, paragrafi 2

Neni 64 — —

Neni 64/a

Neni 65 — —

Neni 66 — —

Neni 67 — —

Neni 68 — —

Neni 69 — —

Neni 70 — —

Neni 71 — —

Neni 72 — —

Neni 73 — —

Shtojca I, Shtojca I

Shtojca II, Shtojca II